

**FORCAT SPECIALE NËN NJË PERSPEKTIVË TË RE
TË LUFTIMIT BASHKËKOHOR
RAST STUDIMOR – AFGANISTANI**

DRITAN DEMIRAJ

Dorëzuar
Universitetit Europian të Tiranës
Shkollës Doktorale

Në përmbushje të detyrimeve të programit të Doktoratës në Fakultetin e
Shkencave Sociale, me profil Marrëdhënie Ndërkombëtare, për marrjen e
gradës shkencore “Doktor”

Udhëheqës shkencor: Prof. Dr. Kristaq Xharo

Numri i fjalëve: 82.135

Tiranë, Janar 2018

DEKLARATA E AUTORËSISË

Unë, Dritan Demiraj deklaroj nën përgjegjësinë time të plotë se punimi që paraqes është origjinal dhe nuk janë përdorur ide, të dhëna, ose gjuha e një subjekti tjetër pa njohjen dhe referencën specifike

ABSTRAKTI

Shqipëria si vend anëtar i NATO-s ka rritur shumë kontributin e saj në operacionet jashtë vendit si nga ana sasiore dhe nga ajo cilësore. Kontributi më i madh i FA të Shqipërisë është në Afganistan, në misionin më të madh të drejtuar nga NATO dekadën e fundit, nëpërmjet misioneve luftarake “Eagle” të Forcave Speciale BOS. Ambienti operacional në Afganistan si dhe udhëzimet e ish Komandantit të ISAF-it Gjeneral Joseph Dunford për stërvitjen e trupave pjesëmarrëse në operacion kërkon njohjen e TTP të kryengritësve si dhe rrugët gjithë përfshirëse në luftën kundër kryengritjeve. Në këtë dizertacion shkencor trajtohet një vështrim i përgjithshëm mbi Afganistanin, pikat e forta të talebanëve, TTP e tyre, influenca e fshehtë e al-Qaeda, aktorët dhe faktorët që destabilizojnë Afganistanin, pikëpamjet e luftës kundër kryengritjeve, dallimi ndërmjet tyre dhe OMP dhe mësimet e nxjerra nga Afganistani. Roli i drejtuesve në planizimin dhe zhvillimin e operacioneve speciale dhe kundër kryengritjeve në bashkëpunim me të gjithë aktorët pjesëmarrës, është që të kuptojnë kompleksitetin e luftës kundër kryengritjeve dhe të përshtaten në situata të ndryshme në zonën e operacionit, të vlerësojnë praktikën e suksesshme dhe të pasuksesshme të luftës, kundër kryengritjeve në operacionet speciale të NATO-s dhe të FS Shqiptare, për të qënë të suksesshëm në të ardhmen..

Fjalëkyçe: Lufta asimetrike, Forcat Speciale, operacione speciale luftarake, Afganistan.

Albania as a NATO member has significantly increased its contribution in peace support operations and stability operations overseas. Major contributions of Albanian Armed Forces have been focused in Afghanistan, the biggest NATO mission of the last decade, with combat missions kod named “Eagle” from Special Forces Battalion-BOS”. The operational environment in Afghanistan and the directives of the former ISAF commander, General Joseph Dunford, for preparing NATO troops for conducting successful operations require a deep knowledge of insurgents’ TTPs and Counter Insurgency Operations. This scientific dissertation addresses a general overvieë of Afganistan, Taleban’s strengths, their TTPs, Al-Qaeda’s hidden influence, actors and factors that contribute in the destabilization of Afghanistan, lessons learned from Afghanistan, various Counter Insurgency Operations approaches, and their differences from Peace Support Operations. The role of military leaders at all levels in planning and executing Special Operations and Counter Insurgency Operations in cooperation with all actors in the theater, is to understand the complex nature of Counter Insurgency Operations, adapt according to the operational environment and study the failures and successes of past NATO and Albanian Special Forces Special Operations in order to be successful in the future..

Keywords: Assymetric Warfare, Afghanistan, Special Forces, Special Operations.

FALENDERIME

Pa dyshim që jam tërësisht përgjegjës për analizën dhe përfundimet e materialit “Forcat Speciale në një perspektivë të re të luftimit bashkëkohor, rast analize - Afganistani”.

Gjatë përgatitjes së këtij materiali, kam shfrytëzuar burime të ndryshme literature kryesisht të kufizuar dhe sekrete, burime të internetit dhe një vend të rëndësishëm ka zënë përvoja ime konkrete në operacionin ISAF-it “Enduring Freedom”, si drejtues i Kontingjentit 1-rë luftarak të FS Shqiptare dhe 5 dislokimeve të tjera për ndërrimin dhe marrjen e detyrës nga kontingjentet pasardhëse në Afganistan. Kam fituar njohuri të paçmueshme nga informacionet e marra në lidhje me operacionet ushtarake kundër kryengritjeve, nga metoda e grumbullimit dhe mbledhjes, analizimit, përpunimit dhe shpërndarjes së informacionit të zbulimit, kryesisht atij HUMINT, planëzimit vetëm sipas metodës së FS Amerikane dhe drejtimit drejtpërdrejt në terren të misionëve luftarakë nga njësitë shqiptare dhe amerikane. Përveç kësaj, kam patur një eksperiencë të gjatë në kryerjen e operacioneve speciale antiterroriste dhe kundër drogës, që nga viti 1993 e deri tani. Kjo ka pasuruar njohuritë e mia në lidhje me këto operacione, duke theksuar ndryshimet në kushtet, rrethanat dhe kërkesat e kohës.

Dëshiroj të falënderoj të gjithë ata që më kanë ndihmuar në realizimin e këtij punimi. Falënderime të veçanta i adresohen udhëheqësin tim shkencor, Prof. Dr. Kolonel Kristaq Xharo dhe Prof Dr Pajtim Ribaj. Puna me Prof. Kristaq Xharo, respektivisht një nga akademikët më të mirë ushtarakë shqiptarë, studiues i çështjeve të sigurisë, akademik i institucioneve akademike të mbrojtjes, përkatësisht në Shqipëri dhe më gjerë, më dha mundësinë e ndërthurjes së eksperiencës kombëtare me atë perëndimore.

Një kombinim i tillë eksperiencash e njohurish, më ndihmoi të realizoj një punim shkencor që tenton të ndërthurë eksperiencën ndërkombëtare me atë kombëtare në fushën e Antiterrorizmit.

Një vlerësim dhe mirënjohje për Këshillin e Profesorëve së Forcave të Armatosura, për orientimin shkencor, stafin e Departamentit të Operacioneve, ndër të cilët veçoj Gjeneral (Ret) Prof. Dr. Kostaq Karoli, Kolonel (R) Dr Çapajev File, N/kol (R) Prof As Agron Agolli, për vërejtjet profesionale, gatishmërinë e treguar, për diskutimin periodik dhe miratimin përfundimtar të këtij punimi.

Një falënderim i veçantë shkon për të gjithë operatorët e FS Shqiptare BOS elitës së padiskutueshme të Ushtrisë Shqiptare, FS Amerikane me të cilët kam punuar për një periudhë mbi 16 vjeçare, Admiral William McRaven, Gjenerallejttnant Frank Kisner, Gjeneralejttnant John Mullholland, Admiral Sean Pybus, Gjeneral Major Repass, Gjeneral Ivi Ishimoto, etj, misionet luftarake të FS në Afganistan nga viti 2010-2014 dhe mirënjohje dhe respekt pa fund për Kapiten Feti Vogli, “Dëshmorin e Atdheut” i cili dha jetën gjatë kryerjes së misionit në Kandahar më 20 shkurt 2012, gjatë kryerjes së detyrës në Afganistan.

Dëshiroj të falënderoj nga zemra të gjithë kolegët e mi heronj të BFS-së, pjesëtarë të strukturave të FS të NATO-s, që kanë ndarë me mua përvojën e fituar gjatë punës, karrierës dhe misionëve luftarake si dhe një falënderim të veçantë për ata kolegë të huaj, pjesë e strukturave të Shtabit Qëndror të FS të NATO-s, kolegë të shërbimeve dhe komandave partnere të FS dhe inteligjencës, nëpërmjet të cilëve, gjatë takimeve e konferencave, seminareve, bordeve të ndryshme, kam pasur mundësinë të njihem me eksperiencën Perëndimore dhe të shkëmbej e ndaj me ta koncepte, mendime lidhur me punimin shkencor.

Pikëpamjet dhe opinionet e shprehura në këtë material janë tërësisht të miat dhe jo domosdoshmërisht reflektojnë politikat apo pozicionet zyrtare të Ministrisë së Mbrojtjes, Shtabit të Përgjithshëm të FA apo Komandës së Doktrinës dhe Stërvitjes.

Të fundit, por jo nga rëndësia, do të dëshiroja që të shprehja respektin dhe mirënjohjen më të thellë për vëmendjen shtetare të Presidentit të Republikës, Shkëlqesinë e tij, Zotin Bujar Nishani, për dhënien e dekoratës më të lartë “Nderi i Kombit” dhe ta siguroj Atë, se kjo më detyron që të kontribuoj dhe më shumë në fushën e Sigurisë, të Mbrojtjes dhe jo vetëm...

Ky disertacion vjen pas një pune intensive studimore pesë vjeçare, pas shumë misionëve, konferencave ndërkombëtare, shkrimeve të botuara jashtë shtetit në gazeta, revista, bërfaqje dhe një kohe të gjatë si mësimdhënës brenda e jashtë shtetit në lidhje me Terrorizmin e Gjeneratës së IV-rt, Kërcënimet Asimetrike në Lindjen e Mesme, Operacionet Speciale në Universitetet e Shqipërisë, Akademinë Ushtarake, Akademinë e Mbrojtjes,, Kolegjin e Luftës, Kolegjin e Mbrojtjes, Universitetin e Sporteve të Tiranës, Qendrën e Studimeve Strategjike për Siguri dhe Mbrojtje në Garmish, Gjermani, Universitetin e Operacioneve Speciale JSOU Tampa, Universitetin “Wajne State” në Michigan , Universitetin e Michiganit, në SHBA, etj

PËRMBAJTJA E LËNDËS

KAPITULLI I

HYRJE.....	1
1. Objektivi	1
2. Pyetja Kërkimore	2
3. Hipoteza	3
4. Metodologjia	3

KAPITULLI II

TEORIA E OPERACIONEVE SPECIALE DHE HISTORIKU I KRIJIMIT TË FS.. 6

2.1 Ndryshimi i ambientit të luftimit nga konvencional në jokonvencional.....	6
2.2 Nga ndryshojnë misionet klasike nga ato speciale?.....	11
2.2.1 Karakteristikat dhe cilësitë e këtyre forcave ushtarake.....	13
2.2.2 Realizimi i efekteve maksimale me kapacitete më të kufizuara.....	18
2.3 Historiku i krijimit të Forcave Speciale.....	42
2.3.1 Rëndësia e Forcave Speciale	42
2.3.2 Historiku i krijimit të Forcave Speciale në botë.....	42
2.3.3 Forcat Speciale (FS) në shekullin e 19-të	43
2.3.4 Lufta I-rë dhe e II-të Botërore	44
2.3.5 Lufta II-të Botërore, FS Britanike	45
2.3.6 Historiku i krijimit të Forcave Speciale Shqiptare	56
Përfundime	66

KAPITULLI III

PROBLEMI AFGAN DHE FUSHATA KUNDËR REBELIMIT (COIN) E

FORCAVE ALEATE	68
3.1. Problemi afgan.....	68
3.2. Modeli i fushatës jokonvencionale COIN të Forcave Aleate.....	76
3.3. Grumbullimi i informacioneve gjatë fushatës COIN	82
3.4. Metodologjia e kontrollit të zonave të operacionit	86
Përfundime.....	91

KAPITULLI IV

FORCAT SPECIALE, PJESË E KOALICIONIT NË MISIONE

BASHKËKOHORE	92
4.1. Angazhimi i Aleancës, misioni, përbërja, natyra e Forcave Speciale	92
4.1.1. Operacioni Enduring Freedom, (OEF)	93
4.1.2. E ardhmja e ISAF-it dhe e FS-ve	104
4.2. Një analizë e angazhimit të FS shqiptare në Afganistan.....	110
Përfundime:	125

KAPITULLI V

FORCAT SPECIALE SHQIPTARE- NJË STRUKTURË E ORGANIZUAR

PËR MISIONE TË VËSHTIRA	127
5.1. Të përgjithshme.....	127
5.2. Organizimi dhe funksionimi i FS.....	128
Përfundime.	139

KAPITULLI VI

TAKTIKAT E LUFTIMIT – VËSHTRIM ANALITIK DHE PERSPEKTIVË ... 141

6.1. Forcat speciale në lloje të ndryshme luftimi.....	141
6.2. Lidershipi në luftim.....	146
6.3. Taktika të reja – Sfida të reja “Mësimet e Nxjerra-Lessons Learned” nga misionet “EAGLE 1-7” në Kandahar, 2010-2014.....	159
Përfundime	195

KAPITULLI VII

FORCAT SPECIALE - FORMACIONE PËRHERË NË VETËZHVILLIM..... 199

7.1. Forcat Speciale nën një perspektivë të re - Koncepti i ri Strategjik i NATO-s	199
7.2. Forcat Speciale nën reformën e Forcave të Armatosura, vendi dhe roli i tyre si prioritet	209
7.3. Rekomandime për zhvillimin e Forcave Speciale Shqiptare	215
Përfundime	218

KAPITULLI VIII

PËRFUNDIME PËRMBLEDHËSE

BIBLIOGRAFIA..... 230

LISTA E SHKURTIMEVE DHE E FJALORIT

18 Z/ Specialisti i Operacioneve.

18 A/Komandanti.i Grupit Special.

AOB/ Bazë e Avancuar Operacionale

ASF/ Forcat e Sigurisë Afgane

ADC, Assistant Detachment Commander/ Zv komandanti i Grupit.

AWACS/ Sistemi i Kontrollit dhe Paralajmërimit Ajror.

AI, Area of Interest/ Zona e Interesit.

AO/Zona Operacioneve.

AMF/ Afgam Militia Forces.

AOB, Advance Operating Base/Baza e Avancuar Operacionale.

AOR, Area of Responssibility/ Zona e Përgjegjësisë.

ATO, Air Tasking Order/ Urdhëri i Detyrave Ajrore.

AAR/ Analiza pas kthimit nga detyra.

BFT, Blue Force Tracker/ Gjurmuesi i Forcave Tona.

BLS, Beach Landing Zone/Zonë Zbarkimi në Breg.

C2/ Komandim Kontrolli.

CA/ Marëdhëniet Civilo Ushtarake.

CAS/ Mbështetje nga Ajri.

CAP/ Toga e Aksioneve të Kombinuara.

CASEVAC/ Evakuim të varrësh e të plagosurish.

CSAR/ Kërkim Shpëtim me Luftim.

CCB/ Brifingu i Konceptit të Komandantit.

CEOI/ Sistemet e Operimit të Komunikim Elektronikës.

CAG/ Detashmenti Delta Forcë.

CMO/ Operacionet Civilo Ushtarake.

COIN/ Kundër rrebelimit.

COMSEC/ Sigura e Komunikimit.

CONOP/ Koncepti i Operacionit.

CRD/ Detashment Zbulimi Kimik.

CS/ Combat Support/ Mbështetja e Luftimit.
CSAR/ Kërkim-Shpëtim me Luftim.
CSS/ Mbështetja e Shërbimeve të Luftimit.
CT /Luftë Kundër Terrorizmit.
CENTCOM/ Komanda Qëndrore Amerikane.
CJSOTF/ Task Forca e Përbashkët e Bashkuar e Operacioneve Speciale.
CIA/ Agjensia Kombëtare Amerikane e Inteligjencës.
Devgru/Detashmenti 1 Delta i Forcës.
DA/ Goditje Direkte.
DAR/ Zonë e Përcaktuar Për Rigjenerim.
DZ/ Droop Zone/ Zonë Hedhjeje.
E&E/ Arratisje dhe Shpëtimi.
FA/ Forcat Ajrore.
FID/ Mision i Stërvitjes së Ushtrive të Huaja.
FOB/Bazë e Përparuar Operacionale.
EFP/Rraketat Shpërthyes.
E&E/ Escape Evasion/ Ikje Shpëtim.
ELINT/ Zbulim Elektronik.
EPA/ Plani i Ikje-Shpëtimit.
ERP/ Pikat e Takimit të Emergjencës.
FATA/Wariristani i Veriut, zonë në Lindje të Pakistanit.
FD/ Forcat Detare.
FOB/ Forward Operating Base/Baza e Përparuar Operacionale.
FOS/ Forca të Operacioneve Speciale.
FR/ Rrugët e Fluturimit.
FS/ Forcat Speciale.
FSKA/ Forcat e Sigurisë Kombëtare Afgane.
FID/ Mision Trajnimi i Forcave të Huaja.
GPF/ General Purpose Force.
HLZ/ Zona e Uljes së Helikopterit.
HQ/ Headquarter/Shtabi i një reparti.

HR/ Operacione për Lirimin e Pengjeve.

HN/ Vendi Pritës.

HUM/Harakat ul-Mujahedin (Organizatë terroriste pakistaneze).

HUMINT/ Zbulim me njerëz.

HUJI/Harakat ul-Jehad-Islami (Organizatë terroriste pakistaneze).

HVT/ Objektiv me rëndësi të lartë.

IEP/ Plani i Evakuimit të Pavarur.

IED/ Pajisje Shpërthyes të Improvizuara.

ISI/ Shërbimi i Zbulimit Pakistanez.

IO/ Operacione Informimi.

IOT/ Me qëllim që.

IJT/ Islam Jamiat Talabas (Organizatë terroriste pakistaneze).

ISR/ Inteligjencë, Mbikqyrje dhe Rikonicion.

JM/ Jump Master/ Instruktor Hedhesh me Parashutë.

JAMMERS/ Pajisje e cila pengon valët e celularëve për të vënë në veprim shpërthimin e një mine.

JSOA/ Zona e Operacioneve Speciale të Përbashkëta.

JSOTF/ Task Forcë e Bashkuar e Operacioneve Speciale.

JSTARS/ Sistemi i Përbashkët i Radarëve të Vëzhgimit dhe Sulmit mbi Objektiva.

JSOC/ Komanda e Përbashkët e Operacioneve Speciale.

JFC/ Komanda e Forcës së Bashkuar.

JUI/ Jamiat Ulema-i-Islam (Organizatë terroriste pakistaneze).

JUD/ Jamat-ul-Daëa (Organizatë terroriste pakistaneze).

KLM/ Këshilli i Lartë i Mbrojtjes.

KLE/ Takim i liderve me rëndësi të madhe.

LeT/ Lashkar-e-Taiba (Organizatë terroriste pakistaneze).

LNO/ Ndërlidhës.

LOC/ Linjat e Komunikimit.

LZ/ Landing Zone/ Zonë Zbarkimi.

MA/ Military Assistance/ Asistencë Stërvitjeje Ushtarake.

MDCOA/ Kursi më i Rrezikshëm i Veprimit i Armikut.

MDL/ Linja e Vendimit të Misionit.

MDMP/ Procesi i Marrjes së Vendimit Ushtarak.

MEDEVAC/ Evakuim Mjekësor.

MEE/ Pajisjet Esenciale të Misionit.

Mine Roller/ Pajisje që vendoset përpara një makine e cila kur has në minë e shpërthen atë

përpara se të prekë goma e makinës.

MP/ Policia Ushtarake.

MSS/ Nën sistemi Satelitor Meteorologjik

MSS/ Pikën e Mbështetjes së Misionit.

MM/ Ministri i Mbrojtjes.

MMA/ Muttahida Majtis Amal (Organizatë terroriste pakistaneze).

MSHI/ Mjet Shpërthyes i Improvizuar.

NAI/ Zona e Emërtuar e Interesit.

NWFP/ Provinca Kufitare Veriperëndimorë e Pakistanit.

Navy Seal/ Forcat Speciale Amerikane të Detit.

NFA/ Non Fire Area/Zonat pa Zjarr.

NGO/ Organizatat jo Qeveritare.

NLC/ Celula Logjistike Kombëtare.

NLT/ Jo më vonë se.

OGA/ Agjensia e CIA-s.

OAKOC/ Analizoni Aspektet Ushtarake të Terrenit.

OEF/ Operacioni Enduring Freedom.

ODA/ Operation Detachment Alpha/ Grupi i FS.

ODB/ Operation Detachment Bravo/ Kompania e FS.

ODC/Operation Detachment Charli/ Batalioni i FS.

ODG/ Special Forces Group Airborne/Grupimi i FS (Deri në 3 Batalione).

OJT/ On Job Training/ Stërvitja në Detyrë.

OPCON/ Kontrolli Operacional.

OPCOM/ Komandim Operacional.

OPFUND/Fonde Operacionale.

OPORD/ Urdhër Operacional.

OPSEC/ Siguria e Operacionit.

OSINT/Zbulim nga burimet e hapura.

OMLT/ Misioni Shqiptar i Trajnimit të një Batalioni Afgan.

PACE/ Parësore, Alternative, të Papriturat dhe Emergjente

POI/ Program of Instruction/Program i Instruksionit.

PSYOPS/ Operacionet Psikologjike.

PZ/ Pick Up Zone/ Zona e marrjes.

QRF/ Grup i Reagimit të Shpejtë.

R&S/ Zbulim dhe Survejim.

RFA/ Restrictive Fire Area/ Zonat e Kufizimit të Zjarrit.

RFI/ Kërkesat për Informacion.

RFL/ Restrictive Fire Line/ Linjat e Kufizimit të Zjarrit.

RPG/ Granatëhedhës.

SAD/ Divizioni i Aktiviteteve Speciale të CIA-s.

SAS/ Forcat Speciale Britanike.

SBS/ Forcat Speciale Nënujore Britanike.

SATCOM/ Komunikim Satelitor.

SSP/ Sipah-e Sahaba (Organizatë terroriste pakistaneze).

SF/ Special Forces /Forcat Speciale.

SFOB/ Bazë Operacionale e FS.

SO/ Special Operations/Operacionet Speciale.

SOA/ Aviacioni i Operacioneve Speciale.

SOC/ Komanda e Operacioneve Speciale.

SOCCE/Elementi i Komponentit Komandues së Operacioneve Speciale

SOF/ Special Operations Forces/Forcat e Operacioneve Speciale.

SOP/ Standart Operating Procedure/ Procedura të Veprimit Standart.

SOT/ Grup i Operacioneve Speciale.

SOTG/ Task Grupi për Operacionet Speciale.

SOTU/ Grupi Special për Operacionet Speciale.

SSP/Sipah-e Sahaba (Organizatë terroriste pakistaneze).

SSE/ Ekplorimi i Zonave Sensitive.
 SPINS/ Special Instructions/ Instruksionet e Veçanta.
 SPTC/ Shkolla Afgane e Forcave Speciale të Policisë.
 SHSHP/ Shefi i Shtabit të Përgjithshëm.
 LTHDM/ Lista themelore e Detyrave të Misionit
 TAC/ Kontrolli Ajror Taktik.
 TACON/Kontrolli Taktik.
 TBD/ Për t'u vendosur.
 TF/ Task Forca.
 TIP/ Paketa e Objekteve të Zbulimit.
 TJD/ Taluba Jamat-ud Dawa(Organizatë terroriste pakistaneze).
 TLP/ Troop Leading Procedures/ Procedura e Drejtimit të Trupave.
 TTP/ Taktikat, Teknikat dhe Procedurat.
 UW/ Unconventional Warfare/Luftë Jokonvencionale.
 UAV/ Avion Zbulimi pa Pilot.
 WMD/ Armët e Shkatërrimit në Masë.
 ANA/ Afgan National Army
 ANP/ Afgan National Police
 GOA/ Government of Afghanistan
 GWOT/ Global War on Terror
 AWOL/ Absence Without Leave
 CF/ Constabulary Force
 MTC/ Movement To Contact
 SDF/ Self Defence Forces
 QRF/ Quick Reaction Force
 NSOCC-A/ Komponenti Komandues për Operacionet Speciale i NATO-s në Afganistan

LISTA E TABELAVE

Tabela 3.1. Përmbledhja e Viktimave të Ushtrisë së ShBA-së në Operacionet për Lirinë e Qëndrueshme.	69
Tabela 3.2 “Konvencionaliteti” i Forcave Amerikane në Afganistan.....	71
Tabela 4.1 Pesha e kontributeve të FA të RSH në ISAF gjatë viteve 2009-2013....	123
Tabela 4.2 Pesha e kontributeve në Operacionin ISAF për vitin 2013,	124
Tabelë 4.3 Tabelë përmbledhëse e operacioneve të kryera nga misionet Eagle në Kandahar, Afganistan	124

LISTA E FIGURAVE

Skicë 2-1. Ndryshimi ndërmjet luftës konvencionale dhe jo konvencionale	7
Skicë 2-2. Grafiku i epërsisë relative.....	24
Skicë 2-3. Parimet e Operacioneve Speciale	28
Skicë 4-1. FS të NATO-s që vepronin në Afganistan në vitin 2001.....	94
Harta 4.1. Harta e politike e Afganistanit	95
Harta 4.2. Drejtimet kryesore të hyrjes së FS Amerikane në Afganistan, në vitin 2001	98
Skicë 4-2. Organizimi për detyrë i Batalionit 1-38 të Br 525 në Afganistan.....	112
Skicë 4-3. Organizimi për detyrë i Forcave Speciale BOS në Afganistan.....	113
Skicë 4-4. Zona e operacionit dhe detyrat e realizuara gjatë operacionit “ALL IN” në Afganistan	114
Skicë 4-5. Detyrat e realizuara gjatë operacionit “DESERT VIPER” në Afganistan.	116
Skicë 4-6. Detyrat e realizuara gjatë operacionit “MOUNTAIN RUN “ në Afganistan	116
Skema 5.1 Shembull i zinxhirit komandues të FS në SHP. Propozuar nga grupi i punës për FS në MM në vitin 2012	130
Skema 5.2. Modeli i përgatitjes së Operatorëve të Forcave Speciale	134
Skica 6.1. Misionet themelore që kryejnë FS	141
Skema 7.1. Struktura e Regjimentit të Operacioneve Speciale (ROS) propozim.....	217

KAPITULLI I

HYRJE

“Forcat Speciale (SOF) janë shembulli etik i fuqisë së zgjuar, të shpejtë dhe fleksibël, në mënyrë konstante të adoptueshme duke mësuar gjuhë dhe kultura të reja të dedikuara për të formuar partneritet atje ku ne mund të punojmë së bashku”.

Hilary Clinton (ish-Sekretare e Shtetit, SHBA),
International SOF week, Tampa, Florida, 24 May 2012

1. Objektivi

Mbështetja e operacioneve me Forcat Speciale (FS), në ditët e sotme, është një element i rëndësishëm i vendimmarrjes politiko-ushtarake, në të gjitha nivelet, në kohën kur sot ushtritë e NATO-s përballen me luftën asimetrike. Thënia e Gjeneralit Abdyl Rashid Dostum, Komandant i Aleancës së Veriut për FS Amerikane në Nëntor të vitit 2001 **“Kërkova mbështetjen e disa amerikanëve. Ata sollën me vete kurajën e një armate të tërë, për vetëm një grup special prej 12 vetësh”**, është shumë domethënëse. E gjithë fushata fillestare në Afganistan zgjati më pak se 2 muaj-49 ditë në total, duke filluar nga infiltrimi i grupit të parë special 555, deri në rënien e Kandaharit. Kjo u bë e mundur nga vetëm 100 operatorë të FS dhe 100 agjentë të tjerë të CIA-s, të mbështetur nga Forcat Aleate të Aleancës Veriore (Neville, 2008, 18).

Integrimi i plotë në NATO, përmbushja e detyrimeve dhe angazhimeve që rrjedhin nga anëtarësimi, veçanërisht ato të Forcave të Armatosura, prezenca me kontingjente luftarake të FS në zona operacionesh, në kuadër të komandave operacionale të NATO-s, si në Afganistan, apo dislokime të mundshme të ardhshme të Task-Forcave Tokësore të Forcave të Operacioneve Speciale (SOLTG), reformimi i tyre drejt një force të armatosur, tërësisht profesioniste, të gatshme dhe të përgatitur ushtarakisht, për realizimin e misionit të saj kushtetues, reduktimi i kontributeve sasiore dhe rritja e atyre cilësore në NATO, i vënë FS nën një rol të ri organizimi dhe angazhimi.

Nëpërmjet një qasjeje konceptuale të FS si forca më e përdorshme dhe rezultative në kohën e luftës asimetrike, rolit të saj në mjedisin e ri të sigurisë (kushtet kur Shtetit Islamik paraqet rrezikun më të madh global), disertacioni im synon të identifikojë kërkesat aktuale dhe të perspektivës së përdorimit të FS, të vendimmarrjes politiko-ushtarake, në përballimin e sfidave aktuale të ardhshme, në ambientin e ri të sigurisë. Duke analizuar aktorët dhe faktorët që ndikojnë në procesin e përdorimit të FS në tërësi, konturohet një skemë e re për qasjeje konceptuale, strukturore e FS ushtarake Shqiptare, e parë si pjesë e një mozaiku më të gjerë, në mjedisin e ri strategjik të sigurisë dhe mbrojtjes, në mbështetje të Forcave të Armatosura, në realizimin e misionit të tyre kushtetues dhe përmbushjes së angazhimeve dhe detyrimeve si anëtar i Aleancës së Atlantikut të Veriut.

Shpresoj që ky punim shkencor të kontribuojë, në mënyrë modeste, në reformimin e strukturës së FS Shqiptare, me rekomandime për një strukturë më operacionale dhe të ndërveprueshme me FS të NATO-s, mbi një arkitekturë të re, përmirësime konceptuale, strukturore, infrastruktuore, modernizimi, informative dhe inteligjence, analitike, e parë në shkallë më të gjerë, e ndërthurur me komandat dhe forcat e tjera të ushtrisë, për një prioritarizim strategjik dhe kontribut kombëtar cilësor, të harmonizuar, në sigurinë kombëtare dhe strukturat e FS të NATO-s. Nisur edhe nga fakti që ky është dhe studimi i parë i kësaj natyre në vendin tonë dhe duke e bërë të disponueshëm për publikun e gjerë në realitetin tonë, mbi mënyrat, metodat, rolin mbështetës të Komandës së FS, si një element i rëndësishëm i Sigurisë Kombëtare, si një aset strategjik i RSH në një shoqëri demokratike, larg background-it historik, mendoj se punimi do të kishte vlerë edhe në këtë drejtim.

2. Pyetja Kërkimore

Pyetje kryesore faktuale është se cilat janë mekanizmat që kushtëzojnë efektivitetin e Forcave Speciale në luftën kundër terrorizmit në kushtet e një mjedisi të ri të sigurisë dhe mbrojtjes?

Pyetja kryesore normative që lind si rrjedhojë e së parës është se si duhen strukturuar Forcat Speciale të FARSH për t'iu përgjigjur ndryshimit të mjedisit të sigurisë në kushtet e luftës asimetrike?

3. Hipoteza

Hipoteza bazë faktuale është se Forcat Speciale janë struktura e armatosur më efektive në përballimin me sukses të luftës asimetrike dhe gjeneratës së IVrt.

Hipoteza bazë normative është se Forcat Speciale të FARSH duhet të jenë njësi prioritare e strukturuar posaçërisht për të përballuar me sukses kërkesat e luftës asimetrike.

4. Metodologjia

Dizertacionet në lëminë e shkencave politike janë të shumëllojshme. Stephen Van Evera propozon shtatë modele të punimit shkencor, por ndarja ndërmjet modeleve të propozuara nuk është krejtësisht e qartë. Punimi i mëposhtëm vendoset brenda kuadrit të një studimi që vlerëson një rast specifik për të propozuar politika të posaçme normative në funksion të zgjidhjes së një problemi të veçantë. Punimi me karakter normativ i vlerësimit dhe propozimit të politikave të veçanta “përqëndrohet në një politikë të caktuar; në vlerësimin e zgjidhjeve konkurruese për një problem specifik; ose në implikimet politike të një zhvillimi politik ose teknik” (Van Evera, 97, 91). Metoda e përdorur i referohet studimit të rastit të veçantë (në rastin konkret konflikti në Afganistan) dhe janë përdorur në mënyrë të përzier aspekte të metodës cilësore dhe asaj sasiore sipas nevojave specifike të punimit. Në pikëpamje të metodës empirike, pas përcaktimit të objektit dhe qëllimit të punimit shkencor, u grumbullua materiali me interes për temën. U përpunuan skedat nga pikëpamja e tematikës, elementëve, faktorëve, këndvështrimeve të studiuesve të ndryshëm, kryesisht akademikë dhe studiues të FS të periudhave të ndryshme, nga komandantët më të mëdhenj të këtyre forcave dhe u nënvizuan materialet që mund të përdoren, duke i klasifikuar sipas elementëve të disiplinës së FS, për të arritur të bëhet një vështrim historik analitik. U përcaktua literatura bazë dhe literatura mbështetëse; nga moria e materialeve të grumbulluara, u përzgjedhën ato materiale të studiuesve bashkëkohorë (80%), të cilat kanë ndikuar drejtpërsëdrejti në vendimmarrjen politiko-ushtarake në çështje të sigurisë, të ekspertëve të fushës së FS, që kanë studiuar, komanduar këto forca dhe botimet e tyre janë bërë pjesë e programeve të trajnimit apo studimit në Universitetet apo komandat e Forcave të Operacioneve Speciale (veçanërisht JSOU në USA). U ndërtua një formë tabelore e

këndvështrimeve të ndryshme për këtë çështje. U identifikuan argumentet në formë hipotezash, duke bërë krahasimin e tyre dhe duke nxjerrë hipotezat fituese. U analizuan faktorët, ndërveprueshmëria e tyre, ndikimi tek çdo fazë e ciklit tradicional, ç'ka mundësoi konfigurimin e elementëve të strukturës së re, karakteristikat dhe u nxorën më pas përfundimet. Janë kryer një sërë intervistash me komandantë misionesh të FS, ekspertë të FS të NATO-s, inteligjencës, analistë, etj. Grumbullimi i materialit, përpunimi i skedave, analizimi i tyre, çoi në përgjithësimin e fakteve teorike konceptuale dhe të gjitha metodat e ndjekura ndihmuan në nxjerrjen e përfundimeve. Nëpërmjet një vështrimi analitik krahasues, u mundësua konfigurimi i një arkitekture të re të FS, strukturë në nivel Regjimenti ose në nivel kombëtar (Force). U analizuan avantazhet dhe dizavantazhet, duke e lënë kështu të hapur për lexuesit e punimit, për ta bërë objekt diskutimesh e debatesh, në nivel ekspertësh apo për ta aplikuar atë në një të ardhme të afërt.

Fazat e kërkimit

Faza përgatitore:

- Grumbullimi i materialeve me interes përpunimin.
- Studimi i literaturës.
- Hartimi i pyetësorëve, përpunimi i të dhënave.
- Formulimi i platformës.

Faza e mbledhjes së të dhënave:

- Pyetësorë me ekspertë të çështjeve të sigurisë në nivel strategjik dhe të FS në NATO.
- Intervista të drejtpërdrejta, direkt në terrenet operacionale dhe me kolegët komandantë të FS të NATO-s.
- Literaturë bazë (doktrina, manuale, bazë ligjore, strategji të ndryshme kombëtare dhe ndërkombëtare, etj.).
- Literaturë mbështetëse.

Shqyrtimi i të dhënave dhe analiza e tyre:

- Përqasja me studime të mëparshme, këndvështrimi i eksperiencës bashkëkohore.
- Parashtrimi në formë tabelore e këndvështrimeve dhe qasjeve të studiuesve.
- Analiza e faktorëve që ndikojnë në çdo element të ciklit dhe ndikojnë në realitetin tonë.
- Ngritja e hipotezave, krahasimi dhe nxjerrja e përfundimeve.

Avantazhet dhe Kufizimet e punimit.

Punimi nuk mëton që të krijojë një teori të re për Forcat e Operacioneve Speciale, por merr në shqyrtim të hollësishëm literaturën teorike ekzistuese të Operacioneve Speciale, nxjerr hipoteza nga kjo teori dhe i teston ato, duke përdorur si rast studimor “Operacionin Enduring Freedom” në Afganistan. Hipoteza që nxjerrim nga teoria e Operacioneve Speciale është se: Forcat Speciale janë trupat më efektive në luftën e Gjeneratës së IV-rt (asimetrike) për shkak të strukturës, trajnimit, pajisjeve dhe misionëve për të cilat ato janë krijuar dhe përdorur. Kjo hipotezë vërtetohet në këtë punim që merr në shqyrtim operacionin më kompleks, më të vështirë dhe më të gjatë që Forcat Speciale të Aleancës kanë realizuar në historinë e tyre. Në pikëpamje sasiore, kjo vërtetohet nga fakti se numri i përgjithshëm i Forcave Speciale të angazhuara në “Operacionin Enduring Freedom” në Afganistan, përbënte vetëm 2% të numrit të përgjithshëm të trupave të dislokuara, të cilat kryenin 92% të numrit të përgjithshëm të operacioneve luftarake. Në pikëpamje cilësore/operacionale, kjo pjesë e trupave realizonte operacionet më të vështira në teatrin luftarak si: Zbulim Special (ZS), Goditje Direkte (GD), Stërvitje të Ushtrisë dhe Forcave Speciale Afgane (FID) dhe Operacione për Çlirimin e Pengjeve dhe Kapëse Vrasëse (HR/KKM). Në pikëpamje të vlerësimit të efektshmërisë së Forcave Speciale Shqiptare në teatrin e operacioneve në Afganistan, mekanizmi matës që mëton të provojë hipotezën tone, është sistemi i ponderimit të peshës relative së secilës njësi (shih tabelën nr 4-1 dhe 4-2, faqe 123-124).

KAPITULLI II


TEORIA E OPERACIONEVE SPECIALE DHE HISTORIKU I KRIJIMIT TË FS

2.1 Ndryshimi i ambientit të luftimit nga konvencional në jokonvencional.

Nga analizimi i elementëve të mjedisit operacional dhe mikro-klimat që ata prodhojnë në këtë mjedis, lind nevoja për një formë lufte që është më e preferuar dhe zgjedhja më e duhur, shumë e ndryshme nga lufta moderne konvencionale. Pra lufta jokonvencionale. Ka disa dimensione të cilat shpjegojnë qartë ndryshimin midis luftës jokonvencionale dhe asaj konvencionale, por këtu do të përmend vetëm disa prej tyre. Para se të analizojmë këto dimensione është e nevojshme të përkufizojmë termat “lufta konvencionale” dhe “lufta jokonvencionale”.

Lufta Konvencionale: Është një formë e luftës e cila kryhet duke përdorur armë ushtarake konvencionale dhe taktikat konvencionale në mes dy ose më shumë shteteve apo forcave të armatosura në konfrontim të hapur. Forcat në çdo anë janë të mirë përcaktuara dhe objektivi i secilës forcë është që të shkatërrojë apo eliminojë forcën kundërshtare (Creveld, 2-5).

Lufta Jokonvencionale: Është një luftë e dhunshme mes një shteti dhe aktorëve jo shtetërorë, për të fituar legjitimitetin dhe ndikimin mbi popullsinë. Lufta jokonvencionale favorizon metoda apo taktika josimetrike apo jo të drejtpërdrejta, që të shkatërrojë fuqinë e një kundërshtari, të rrisë ndikimin mbi popullsinë dhe të shkatërrojë dëshirën për të luftuar të kundërshtarit. Lufta jokonvencionale në thelb është një konflikt i tejzgjatur (United States Department of Defense, *Irregular Warfare*, 2007, 5). Grafiku i mëposhtëm ilustron më qartë ndryshimin kryesor midis luftës konvencionale dhe asaj jokonvencionale (po aty, 11).



Skicë 2-1. Ndryshimi ndërmjet luftës konvencionale dhe jo konvencionale

Siç mund të shikohet në pjesën e majtë të grafikut më lart shohim se lufta konvencionale ose “tradicionale” ka si synim apo fokus që të mposhtë forcat e armatosura të kundërshtarit, duke i shkatërruar kundërshtarit kapacitetin luftarak, të kapë ose të mbajë një pjesë të territorit të kundërshtarit në mënyrë që të detyrojë kundërshtarin të ndryshojë politikën apo qeverinë. Me pak fjalë, fokusi i operacioneve ushtarake konvencionale është zakonisht forca e armatosur e kundërshtarit, me qëllim që të influencojë qeverinë e kundërshtarit (*Irregular Warfare*, 10).

Lufta jokonvencionale fokusohet në kontrollin ose ndikimin e popullsisë në zonën operacionale dhe jo në shkatërrimin e forcës kundërshtare apo kontrollin e territorit kundërshtar. Lufta jokonvencionale është një luftë për kontroll apo ndikim dhe fitoren e mbështetjes së popullsisë në zonën operacionale. Me pak fjalë palët në konflikt kërkojnë për të forcuar legjitimitetin dhe kredibilitetin e tyre, për të ushtruar autoritet mbi popullsinë (po aty).

Dimensionet të cilat tregojnë qartë ndryshimin midis luftës konvencionale dhe asaj jokonvencionale janë:

a. Organizimi

Duke u bazuar në historinë e luftërave të mëparshme, veçanërisht të Luftës I-rë dhe II-të Botërore mund të themi se këto dy luftëra janë shembuj të pastër, përse i

përket kuptimit të forcave konvencionale dhe luftës konvencionale. Forcat e armatosura të vendeve të përfshira në këto dy konflikte botërore, ishin të mirë organizuara dhe operonin në linja operacionale të qarta.

Forcat jo të rregullta, forcat guerrile ose në rastin e Afganistanit forcat tribale (fisnore) kanë një organizim të shpërbërë dhe jo të përqëndruar, linjat e operacioneve janë të paorganizuara dhe të paqarta, si dhe nuk kryejnë angazhime strategjike. Këto forca jo të rregullta, janë formuar në bazë fisnore apo klanesh, me përkatësi ideologjike të njëjtë dhe kufizohen në një vend gjeografik specifik dhe janë nën strukturën e një lidhësi tradicional. Talebanët në Afganistan dhe në Pakistan, janë një shembull tipik i një force jo të rregullt apo një force jokonvencionale.

b. Teknologjia Luftarake

Në vendet e zhvilluara dominon ideja se teknologjia e përparuar është një faktor kyç që luan një rol të rëndësishëm në luftë për të arritur epërsinë për fitimin e luftës. Kjo është e vërtetë përse i përket luftës konvencionale, ku kundërshtarët përballen me njëri-tjetrin me të njëjtat fuqi luftarake.

Përse i përket luftës jokonvencionale ajo përfshin shfrytëzimin e çdo burimi; blerjes së pajisjeve luftarake në treg të zi, vjedhjes së të mirave materiale në zonën ku vepron, plaçkitjeve të ndryshme apo prodhimeve lokale. Forcat jo të rregullta janë të specializuara për luftimet në pritë, goditje të befasishme, ku si mjete luftimi kryesore përdorin armët granatahedhëse, automatikët, mitralozët, mortajat dhe minat surprizë. Disa forca jo të rregullta që kanë një organizim më të mirë, ato mund të kenë dhe anije si në rastin e *“Tigrave të Tamilit”* gjatë konfliktit në Sri Lanka, talebanët gjatë kohës që drejtonin Afganistanin kishin avionë, helikopterë, tanke apo artileri tokësore, por forca kryesore varet në përdorimin e armëve të lehta. Rrjedhimisht duke qenë se forcat jo të rregullta nuk zotërojnë atë teknologji luftarake që kanë forcat konvencionale, atëherë për t’i bërë ballë kësaj teknologjie të përparuar forcat jo të rregullta përdorin taktika jokonvencionale.

c. Logjistika

Forcat konvencionale kur dislokohen në zona operacionale të ndryshme, marrin me vete të gjithë sistemin logjistik që është tepër i nevojshëm për kryerjen

e operacioneve. Forca apo njësi të mekanizuara konsumojnë sasi të mëdha naftë, municioni dhe pjesë për riparim e mirëmbajtje. Ky lloj sistemi kufizon lëvizshmërinë dhe fleksibilitetin operacional, duke krijuar disa dobësi që mund të përdoren në avantazh të kundërshtarit.

Forcat jo të rregullta janë shumë më pak të varur ndaj faktorit mbështetës logjistik. Nevojat e tyre për ushqim, armatim dhe municion janë më të thjeshta dhe nuk kanë nevojë që të lëvizin nëpër distanca të largëta. Këto forca kanë mbështetje nga popullsia lokale. Shumica e armatimit transportohet lehtësisht dhe në të njëjtën kohë, këto forca kanë aftësi organike për të riparuar armatimin apo makineritë që disponojnë, pa patur nevojën e një elementi mbështetës. Në këtë aspekt forcat jo të rregullta nuk kanë dobësi logjistike që mund të sulmohen nga kundërshtari, si p.sh.: sisteme transporti rrugor apo hekurudhor, ura apo fabrika prodhimi armësh (Driver & De Feyter, 2008, 20-28).

d. Komandim-Kontrolli

Lufta konvencionale në themel është luftë e një shteti me shtetin tjetër. Duke qenë e tillë kjo luftë ka nevojë për një drejtim qëndror të centralizuar dhe të mirë drejtuar, që të sigurojë organizimin e nevojshëm dhe të menaxhojë burimet luftarake, teknologjike dhe njerëzore. Janë të domosdoshme sisteme komunikimi shumë të avancuara për komandim-kontrollin e forcave në terren. Lufta jo e rregullt apo luftërat tribale janë luftëra të shkallëve të vogla, të cilat drejtohen nga lider lokalë dhe në shumicën e rasteve, për arsye dhe qëllime personale. Është e vështirë të analizosh këto arsye pasi vlerat, qëllimet, strategjitë dhe taktikat e tyre bazohen në faktorë jo të qartë që nuk varen nga njëri-tjetri. Liderët lokalë përdorin metoda komunikimi për distanca të shkurtra, si p.sh: telefona *walkie-talkies*, si dhe korrierë. Për forcat e rregulla, vetëm krisma e armëve mund të shërbejë si sinjal për t'u organizuar dhe në shumicën e rasteve kjo është një metodë po aq e efektshme sa dhe sistemet moderne të komandim-kontrollit (po aty, 29-31).

e. Doktrina

Një nga themelet e një ushtrie moderne konvencionale, është zhvillimi i një doktrine të qartë për nivelet strategjike, operacionale dhe taktike të luftës. Doktrina do

të përcaktojnë se për çfarë do të luftojnë, si do të furnizohen, si do të organizohen dhe dislokohen, armët që do të përdorin dhe si do të luftojnë.

Forcat jo të rregullta nuk kanë një doktrinë të zhvilluar. Kjo forcë është mësuar që të luftojë në një terren të njohur që e vetëzotëron, kanë njohuri të shkëlqyera të terrenit, të armatimit personal dhe adaptohen në çdo situatë në nivelin taktik. Mos ekzistenca e një doktrine për forcat jo të rregullta, e bën tepër të vështirë që forcat konvencionale të kuptojnë se si forcat jo të rregullta operojnë dhe në shumicën e rasteve këto forca nënvlerësohen duke sjellë dhe humbje të mëdha në forca dhe mjete. Është tepër e kushtueshme që të mësohet se si luftojnë forcat jo të rregullta nëpërmjet eksperiencës personale.

f. Beteja / Dyluftime vendimtare

Lufta konvencionale kërkon që kundërshtari të mposhtet shpejt dhe pa shumë pasoja për forcat mike në terren të hapur dhe në një konfrontim ballë-për-ballë. Kjo lloj lufte është për ato forca që janë superfuqi botërore, që kanë resurset e mjaftueshme për investuar në një teknologji luftarake dhe një forcë të armatosur për të fituar luftën në mënyrë vendimtare dhe të shpejtë.

Në luftën jo të rregullt, forcat jo të rregullta, shmangin operacionet që janë të gjata dhe intensive. Ato luftojnë duke përdorur konceptin e goditjes së befasishme dhe tërheqjen e menjëhershme nga fushëbeteja. Terreni, kultura dhe armatimi që zotërojnë, janë faktorët që detyrojnë forcat jo të rregullta të veprojnë në mënyrë të tillë. Në një konflikt të lokalizuar ose të izoluar, lëvizshmëria operationale apo strategjike ka shumë pak rëndësi në krahasim me lëvizshmërinë taktike (Irregular Warfare, 20-25).

g. Ushtarakët dhe Luftëtarët

Ushtarakët dhe luftëtarët nuk janë e njëjta gjë. Ushtritë moderne përdorin një proces modern dhe bashkëkohor stërvitjeje dhe doktrinimi, që nxjerr ushtarakë dhe njësi të rregullta të disiplinuar dhe profesionale. Ushtaraku modern i sotëm, është një produkt i këtij sistemi që e shkëput individin nga jeta civile dhe e shndërron atë në një profesionist të disiplinuar e të gatshëm, nga i cili pritet të kryhen detyrat e caktuara nga

eprrorët dhe gjithë zinxhiri i komandimit të cilët veprojnë për të përmbushur objektivat e qeverisë dhe vendit të tyre.

Luftëtari në krahasim me ushtarakun nuk shkëputet nga shoqëria civile. Ai gjendet në shoqëri me rolin e luftëtarit. Aftësitë dhe armatimi, i tij burojnë nga fisi/grupimi ku ai bën pjesë. Njohuria e tij mbi luftën dhe luftimin, kufizohet nga njohuritë që ka fisi apo grupimi ku ai bën pjesë. Ai vepron në një organizatë jo shumë të rregullt dhe në një sistem disiplinor më të relaksuar. Luftëtari jeton afër zonës ku operon dhe me njerëzit në atë zonë. Në të njëjtat rrethana dhe kushte, ky luftëtar mund të jetë po aq i efektshëm sa edhe ushtaraku modern.

Me pak fjalë, mund të themi se kompleksiteti i mjedisit operacional të sotëm dhe i së ardhmes, do të ketë si themel përpjekjet globale për t'i bërë ballë sfidave të ideologjive dhe politikave rajonale. Duke u përballur me forca konvencionale, kundërshtarët e vendeve të NATO-s do të detyrohen të përdorin kapacitete jotradicionale për të arritur objektivat strategjike të tyre. Si shembull mund të përmendim mundësitë që ekzistojnë që al-Qaeda apo grupe të tjera terroriste të përdorin armë të dëmtimit në masë (WMD) mbi popullsinë civile të vendeve anëtare apo aleatëve të NATO-s. Këto forca kundërshtare, do të vazhdojnë të përdorin luftën jokonvencionale kundër forcave aleate deri në momentin që vendet anëtare të NATO-s dhe aleatët të jenë në gjendje të kryejnë luftë jokonvencionale ashtu siç kryejnë luftë konvencionale.

2.2 Nga ndryshojnë misionet klasike nga ato speciale?

Operacionet speciale shpesh kryhen në bashkëpunim me operacionet ushtarake konvencionale si pjesë e një fushate të qëndrueshme politiko-ushtarake. Disa operacione speciale janë aksione direkte spektakolare që kanë tërhequr vëmendje të gjerë, por shumë të tjera janë afatgjata, ato janë një përpjekje indirekte që asnjëherë nuk janë bërë të njohura. Pavarësisht se në ç'formë kryhet, çdo operacion special realizohet për të zgjidhur sa më ekonomikisht probleme të veçanta në nivel operacional apo strategjik, të cilët janë të vështira ose të pamundura për t'u realizuar vetëm me forca konvencionale (Irregular Warfare, 12).

Duke pasur parasysh natyrën e tyre jokonvencionale, operacionet speciale janë të lidhura drejtpërdrejtë me forma të tjera luftimi, si: terrorizmi, lufta guerrile dhe rebelimi. Megjithatë, FS janë të stërvitura për të luftuar forma të tilla të luftës, duke përdorur taktika, teknika, pajisje, logjistikë dhe manovër superiore për të mposhtur terroristët, guerrilasit dhe kryengritësit, të cilët përdorin taktika jokonvencionale. FS mundohen të privojnë kundërshtarët jokonvencionalë nga disa avantazhe taktike që ata posedojnë, duke iu mohuar manovrueshmërinë, rezervat, befasinë dhe iniciativën. Në raste të tjera, FS mund të organizojnë dhe të zhvillojnë luftë guerrile apo kryengritëse për të rrëzuar shtete të caktuara kundërshtare, të cilët i bazojnë taktikat e tyre në luftën konvencionale, për shembull, duke ndërprerë linjat e furnizimit, ngritjen dhe trajnimin e forcave partizane, krijimin e rezistencës kombëtare me organizatat e E&E, apo duke tërhequr vëmendjen e forcave të armikut nga operacionet konvencionale në kërcënimet që ju kanosen në zonat e përcaktuara si të sigurta nga ana e tyre.

Operacionet speciale gjithashtu duhet të dallohen nga operacionet e kryera nga njësi konvencionale të forcave ushtarake “të specializuara” në një detyrë të caktuar. Këto forca janë të organizuara, të pajisura e të trajnuara për të kryer një detyrë të veçantë. Në rast se do të kërkohej që këto forca të kryenin një detyrë tjetër e ndryshme nga ato lloj detyrash (goditje direkte, operacione kundër terrorizmit, zbulim special, stërvitje e forcave të huaja, etj) për të cilat janë specializuar për të kryer, do t’u nevojitej një kohë e konsiderueshme për ritrajnim.

Dallimet më të mëdha mes forcave të operacioneve speciale dhe forcave të specializuara qëndrojnë në dy fusha të gjera (Spulak, 2007, 10).

Së pari, është shkalla e operacioneve të tyre: operacionet speciale janë operacione relativisht në shkallë të vogël kur kryhen nga kompanitë, grupe apo nëngrupe speciale, ndërsa operacionet e njësive të specializuara zhvillohen nga njësitë e mëdha të tilla si: regjimentet, brigadat apo divizionet.

Fusha e dytë, është konvencionaliteti: operacionet speciale karakterizohen nga

taktika jokonvencionale dhe shpesh indirekte, ndërsa operacionet e forcave ushtarake të specializuara karakterizohen nga taktika konvencionale.

Për të përmbledhur sa thamë më lart, operacionet speciale ndryshojnë nga operacionet konvencionale në bazë të tri kritereve:

1. *Mënyra ekonomike e përdorimit të forcave;*
2. *Konsiderata të ndryshme për llogaritjen e rrezikut politik dhe atij operacional.*
3. *Pajisje, organizim dhe stërvitje krejtësisht e ndryshme nga ajo e forcave konvencionale.*

2.2.1 Karakteristikat dhe cilësitë e këtyre forcave ushtarake.

Cilësitë “Speciale” të këtyre forcave janë një produkt i organizimit të tyre, trajnimit, mbështetjes dhe më e rëndësishmja përzgjedhjes. Të gjithë këta faktorë janë diskutuar me hollësi më poshtë dhe janë këta faktorë, të cilët mundësojnë krijimin e një force fleksibël që përdor taktika jokonvencionale për të zgjidhur probleme të vështira dhe të rrezikshme.

a. Ekonomia dhe Risku

Në operacionet speciale realizohet me përpikmëri parimi i “*ekonomisë së forcës*”. Me një numër të vogël operatorësh të FS, shpesh mund të arrihen rezultate shumë më të mëdha se me operacionet ushtarake konvencionale. Për shembull, në vitin 1977 operatorët FS të Gjermanisë Perëndimore (GSG-9; Border Force Group 9) ishin në gjendje të lironin 90 pengje nga një aeroplan i rrëmbyer nga terroristët islamikë në Mogadishu, Somali, vetëm me një humbje nga forcat e tyre (Chant, 2012, 58). Në qoftë se një përpjekje e tillë do të kryhej nga forcat konvencionale ushtarake apo paramilitare, do të ishte praktikisht e pamundur për arsye politike dhe pa dyshim kjo do të kishte çuar në humbje të konsiderueshme si nga forcat ushtarake dhe nga ana e pengjeve. Duke pasur parasysh që **FS kanë kthim të lartë të investimit të bërë në to**, operacionet speciale kanë vlerë të madhe për vendimmarrësit më të lartë politikë dhe ushtarakë, si në nivel strategjik dhe operacional, si një metodë

me kosto të ulët për zgjidhjen e problemeve të ndërlikuara me një probabilitet të lartë suksesi (Joint Pub 3-05, 1998, 4).

Operacionet Speciale mund të jenë ekonomike, por ato nuk janë pa rrezik. Një rrezik i tillë përfshin edhe kthimin mbi investimin e përmendur më lart. Suksesi nuk është i garantuar në çdo operacion dhe rreziku strategjik është shumë i madh në qoftë se operacioni dështon për të arritur rezultatet e dëshiruara, përgjegjësia pas një dështimi të tillë mund të ketë pasoja të rënda, si politikisht dhe ushtarakisht. Një shembull i tillë është dhe përpjekja e dështuar e FS amerikane Delta Force, për të shpëtuar pengjet amerikane nga Irani në vitin 1980, situatë e cila krijoi imazhin para botës se SHBA nuk mund të kryejnë operacione në mënyrë efektive në prag të përfundimit të Luftës së Vietnamit (NSHQ, Special Forces Study, 2008, 13). Një shembull tjetër shumë i keq ishte dhe reagimi i ngadalshëm dhe performanca e dobët e paramilitarëve të operacioneve speciale të Gardës së Sigurisë Kombëtare të Indisë, gjatë sulmeve terroriste të Mumbait në vitin 2008 të kryer nga ana e organizatës terroriste pakistaneze Lashkar-e-Taiba (LET). Në të dyja rastet, dështimi i plotë apo dështimi për të kryer si duhej operacionin, pati shumë raporte kritike në media, hetime zyrtare dhe një nivel të caktuar të krizës politike së brendshme dhe ndërkombëtare (NSHQ, Study Case, 2009, 15).

Përveç pasojave politike dhe strategjike, një formë tjetër e rrezikut është e lidhur me vetë natyrën e operacioneve speciale. Duke pasur parasysh faktin se shumica e operacioneve speciale ndodhin në territore të mohuara apo armiqësore, duke përdorur një numër të vogël personeli në krahasim me armikun, dështimi taktik përkthehet në vdekje për ata që janë të përfshirë në operacion.

b. Fleksibiliteti dhe përshtatshmëria

Duke pasur parasysh kohën dhe burimet e kufizuara, çdo njësi ushtarake mund të stërvitet për të kryer një detyrë specifike në një standard shumë të lartë. Një stërvitje e tillë përsëritet aq shpesh sa që të gjithë të metat të jenë identifikuar dhe korrigjuar dhe ekzekutimi i misionit të bëhet në mënyrë instiktive. Çfarë i diferencon FS nga forcat konvencionale, është spektri i gjerë i kushteve që ndikojnë nën të cilët prit

që detyra të zbatohet pa ulur standardet. Çdo forcë nuk mund të trajnohet për të kapur një objektiv me vlerë të lartë (HVT) si për shembull një udhëheqës terrorist apo një strukturë ushtarake, me mundësi të lartë për sukses, por FS janë në gjendje të kryejnë misione të shumta dhe me spektër të ndryshëm për një periudhë kohore të vetme me pothuajse pa asnjë reduktim në standardet e zbatimit të misionit. Nën kushtet e pamjes së kufizuar, distancave shumë të largëta, motit të keq dhe lodhjes së tejskajshme nga operatorët e FS pritet që të kryejnë misione përtej aftësisë së njësive të tjera. Përveç kësaj, ashtu siç evoluojnë teknikat e kundërshtarit, FS në të njëjtën kohë duhet të përshtatin vazhdimisht teknikat e tyre sepse ajo që dikur ishte “Speciale” mund të bëhet normë për forcat konvencionale apo nuk mund të jetë më efektive kundër kundërshtarit.

c. Përdorimi direkt dhe indirekt i forcës

Detyrat që kryejnë FS ndahen nën dy kategori të gjera.

Kategoria e parë e operacioneve speciale: është aplikimi i forcës ushtarake në mënyrë direkte ose kinetike. Operacionet e drejtpërdrejta shpesh përfshijnë shkatërrimin, vrasjen ose kapjen e njerëzve, pajisjeve dhe të objekteve me vlera të mëdha. Si shembull mund të jetë misioni i Grupit të 6-të të Sealsve të SHBA-së në Abbottabad, Pakistan, që në shënjestër ishte Osama bin Laden në vitin 2011. Operacionet speciale direkte shpesh bëhen të njohura edhe si “goditje objekti spektakolare”, për të tërhequr vëmendjen e publikut dhe politikanëve duke vënë në pah guximin dhe vendosmërinë e operatorëve specialë, i cili jep rezultate të menjëhershme. FS i klasifikojnë këto misione sipas objektivit që ato kanë: aksioni direkt është lloji më i përgjithshëm i goditjes së objektit; operacionet antiterroriste, targetimi i liderëve specifikë terroristë, organizatorët, ndjekësit e tyre dhe infrastruktura. Në mënyrë për të zbutur rrezikun dhe për të siguruar suksesin, operacionet speciale kërkojnë forca të stërvitura jashtëzakonisht mirë dhe të pajisura me pajisjet më të mira në dispozicion, me mbështetje shumë të mirë logjistike, financiare e ligjore, me një informacion të detajuar zbulimi për objektin që do të sulmojnë dhe që kanë kryer një numër shumë të madh përsëritjesh e provash para ekzekutimit të misionit.

Kategoria e dytë e operacioneve speciale: është aplikimi indirekt i forcës ose mos përdorimi i saj. Operacionet indirekte ose jokinetike kërkojnë durim dhe kohë

të konsiderueshme për t'u realizuar, para se efektet e tyre të jenë të dukshme. FS që të kryejnë operacione indirekte u nevojitet të punojnë nëpërmjet ndërmjetësve (si për shembull, në prapavijat e kryengritësve ose grupe partizanësh që kryejnë “luftë jokonvencionale”, ose palë të treta (p.sh.: qeveritë bien dakord të lejojnë FS të hyjnë në vendet e tyre si pjesë e misioneve “kundër kryengritësve” ose “Ndihmëse për Forcat e Sigurisë”, veprime jo të dhunshme (p.sh.: ndërtimin e shkollave dhe hapje pusesh uji, p.sh.: “çështjet civile” projekte për të përmirësuar jetën e popullatës vendase, mbledhjen e informacionit në mënyrë klandestine nëpërmjet përdorimit të “zbulimit special” dhe mjeteve të tjera të ndryshme (duke përfshirë përdorimin e fletëpalosje dhe të internetit në bashkëpunim me njësitë e “operacioneve psikologjike”). Qëllimi i operacioneve speciale indirekte është ose për të rritur efektivitetin kryengritës vendas apo të forcave të sigurisë ose për të ndikuar në moralin, vullnetin dhe kohezionin e objektivit, e gjithë kjo bëhet sa më ekonomikisht të jetë e mundur dhe me sa më pak ose aspak publicitet për shkak të natyrës së ndjeshme politike të këtyre lloj misionesh.

d. Dallimi mes operacioneve speciale bashkëkohore dhe atyre të Luftës së II-të Botërore

Një nga dallimet në mes operacioneve speciale bashkëkohore dhe atyre të Luftës së II-të Botërore është qëndrueshmëria e njësive të FS. Operacionet Speciale bashkëkohore e kanë gjenezën e tyre në Luftën e II-të Botërore, por gjatë atij konflikti, forcat ushtarake që përdornin taktika jokonvencionale krijoheshin vetëm për të kryer një detyrë të caktuar dhe pasi operacioni të kishte përfunduar këto forca shpërbëheshin. Sot mbajtja e FS mbi një bazë të përhershme u jep atyre aftësi më të mëdha sesa paraardhësit e tyre të Luftës së II-të Botërore (Special Forces Book, 2012, 121).

Njësitë e FS janë ndërtuar mbi tre elemente themelore që i japin atyre emrin “special” dhe që gjithashtu i bëjnë ata të dallohen nga homologët e tyre konvencionalë. Këto tre elementë themelore janë: *emërtimi “special”, përzgjedhja dhe stërvitja e specializuar* ngushtë dhe *pajisjet speciale* (Joint Pub 3-05, Doctrine for Joint Special Ops, 1998, XI).

Emërtimi “special” pasqyron cilësitë unike dhe aftësitë e demonstruara të një force speciale. Emërtimi special shihet jo vetëm në emër dhe gjithashtu në disa pjesë të uniformës dhe jo vetëm por dhe uniformat e tyre janë krejtësisht të ndryshme nga

ata të pjesës tjetër të ushtrisë, gjëja që i dallon pjesëtarët e FS nga anëtarët e njësive të tjera. Anëtarët e Shërbimit Special Ajror Britanik (SAS) dallohen nga bereta ngjyrë rëre dhe emblema “Thikë me krahë”; beretat e gjelbra dallohen nga beretat ngjyrë të gjelbërt, FS shqiptare, gjermane, turke, rumune, hungareze, italiane, franceze, polake, hollandeze, etj dallohen nga bereta ngjyrë vishnje ndërsa rusët *Naznachenije Spetsialnoye* (Spetsnaz) mund të dallohen nga beretat e tyre dhe bluzat me vija shirita (Chant, 2012, 98). Në Shqipëri operatorët e FS dallohen jo vetëm nga bereta vishnje, por edhe nga seti krejtësisht unik i kamuflazhit të tyre. Përveç dallimeve në uniformë dhe emërtimit të njësive, veçanti tjetër është dhe shenjat e ndryshme të vendosura në uniformën e ceremonialit, të cilat janë medalje nderi që mbahen nga ata të cilët kanë përfunduar kurse të ndryshme të FS, si ai i kursit të forcave speciale, komando, parashutës, zhytjes luftimit, snajperit, sportit ushtarak, liderit alpin dhe të operacioneve speciale, si dhe pjesëmarrje në misionet e ndryshme ndërkombëtare luftarake, gjë që e bëjnë vetëm FS.

Përzgjedhja dhe trajnimi: kryhet në funksion të misionit të tyre, mision i cili kërkon cilësi të veçanta të cilat nuk posedohen nga forcat konvencionale. Më konkretisht, seleksionimi, përzgjedhja dhe stërvitja e këtyre forcave i identifikon ato si individë me aftësitë fizike dhe mbi të gjitha, cilësi psikologjike për të kryer operacione speciale (me cilësi të tilla si: niveli i besueshmërisë në situata stresi ekstrem, inteligjenca, pjekuria dhe aftësia e të menduarit për të zgjidhur problemet nën çdo rrethanë). Procesi i përzgjedhjes shpesh ndodh gjatë disa fazave dhe shpesh është i mbikëqyrur nga operatorët më me përvojë (instruktorët). Arsyeja e stërvitjes është që të ngrejë aftësitë e operatorëve specialë në një nivel shumë të lartë, t’i zhvillojë ata për punën në grup dhe gjithashtu vazhdimisht të shqyrtojnë kandidatët për përshtatshmërinë e tyre dhe aftësinë e tyre për të shërbyer në këto njësi. Shembuj të një procesi përzgjedhje dhe trajnimi të tillë përfshin dhe Kursin e FS në SHBA- së “Beretat Jeshile”, programi i përzgjedhjes dhe trajnimit të SAS-it në Britaninë e Madhe, gjithashtu programi i përzgjedhjes dhe trajnimit të Forcave Speciale Shqiptare “Beretat Vishnje”. Trajnimi i operatorëve të FS nuk ka vetëm kërkesë të lartë llogarie, por edhe rrezik të lartë. Regjimi i stërvitjes gjatë kursit të FS është dizajnuar në mënyrë të tillë, që t’i shtyjë kandidatët në kufijtë ekstremë të qëndresës fizike dhe psikologjike dhe të përsosin të gjitha aftësitë taktike si ato individuale, ekipore dhe të zgjidhjes së

detyrave në grup. Specializimi i tyre i ngushtë në specialitete të ndryshme si specialistë operacionesh, zbulimi, snajper, armatimi, xhenioje, shëndetësie dhe komunikimi bën të mundur që grupet të veprojnë të pavarur, në nëngrupe dhe grupe të vogla dhe të realizojnë një spektër të gjerë detyrash (Joint Pub 3-05, Doctrine for Joint Special Ops, 1998, 11).

Elementi i tretë: dhe përfundimtar janë *pajisjet e FS*. Pajisjet mund të përfshijnë pajisje jo standarde jashtë linjave tradicionale të inventarit ushtarak të furnizimit. Në njësitë më të specializuara, operatorët shpesh janë të lirë të zgjedhin pajisjet që i përshtaten preferencave dhe nevojave të tyre personale. Kjo liri reflekton besimin në gjykimin e operatorëve të saj si dhe më kryesorja në aftësinë e njësive të operacioneve speciale për suksesin e misionit. Në pajisje të tilla mund të futem pajisje speciale për zbulimin special si kamera termale, kamera dixhitale fotografi pajisje përgjimi dhe vëzhgimi, etj, pajisje speciale komunikimi si kompjutera, etj, UAV, armatim special që nga kalibri 4.6x30 mm, 45 auto, 9mm, 5.56mm, 7.62x39, 7.62x51mm, 7.62x67mm, 8.6mm dhe 50 Browning (12.7mm), granata 40 mm me të gjitha aksesoret e vendosura si dylbi nate, dite, silenciatorë, pajisje për infi nga deti dhe nga ajri si: parashuta dhe mjete zhytjeje speciale, pajisje për luftë në arktik, mjete speciale dhe të blinduara, etj, të cilat mundësojnë realizimin e të gjithë detyrave të ngarkuara për FS nga toka, deti dhe ajri.

2.2.2 Realizimi i efekteve maksimale me kapacitete më të kufizuara.

Në fushën e literaturës ushtarake nuk është shkruar shumë për teorinë e luftës, duke filluar nga të menduarit e *Herman Kahn* rreth të pamendueshmes, të spektrit të luftës me fund bërthamor, deri te *Liddel Hart* përmes luftës indirekte me fund konvencional. Ka teori të shkallëzimit dhe përfundimit të luftës, teoritë e revolucionit dhe kundërrevolucionit dhe teoritë e kryengritjes dhe kundër kryengritësve. Ka teori të përgjithshme për fuqinë ajrore dhe pushtetin e detit, si dhe teoritë më specifike mbi bombardimet strategjike dhe luftën amfibe.

Një teori me interes të veçantë në lidhje me studimin e operacioneve speciale vjen nga njëri nga studiuesit më të dëgjuar në botë të operacioneve speciale siç është *ADM William Mc Raven* - ish Komandant i FS Amerikane, 2011-2013 (McRaven, 1993). Teoria me anë të së cilës ai synon të bëjë një analizë të thellë e të qartë të operacioneve të forcave speciale, njihet si “*Teoria e epërsisë relative*”. Ajo mund të përkufizohet si një kusht

që kur një forcë më e vogël në numër sulmon dhe fiton avantazh vendimtar mbi një armik të madh në numër. Kur *epërsia relative* është arritur, forcat që sulmojnë nuk janë më në disavantazh, por marrin iniciativën për të shfrytëzuar dobësitë e armikut dhe fitorja është e sigurt. Edhe pse fiton *epërsi relative*, suksesi nuk është i garantuar, kjo thjesht është e nevojshme për të patur sukses.

Nëse mund të përcaktojmë para kryerjes së një operacioni mënyrën më të mirë për të arritur *epërsinë relative*, atëherë mund të planifikojmë operacione speciale dhe përgatitje për të përmirësuar shanset tona për fitore. *Admiral William McRaven* e bazon teorinë e tij të *epërsisë relative* në studimin dhe analizimin e tetë rasteve kryesore (sipas tij) të operacioneve të kryera nga FS.

Në ndryshim nga një aksion i drejtpërdrejtë, këto tetë operacione speciale ishin gjithmonë në nivel strategjik dhe kishin avantazhin të përfitonin burime praktikisht të pakufizuara dhe në nivel kombëtar intelligence¹. Për t'i dhënë një ide më të qartë teorisë së tij, *ADM McRaven* na jep përkufizimin e mëposhtëm në lidhje me atë se çfarë përfaqëson një operacion special.

*“Një operacion special kryhet nga forca të trajnuara posaçërisht, të pajisura dhe të mbështetura për një objektiv të veçantë ku shkatërrimi, eliminimi, apo në rastin e pengjeve, shpëtimi është politikisht ose ushtarakisht i domosdoshëm.”*²

Ky përkufizim nënkupton gjithashtu se operacionet speciale mund të kryhen edhe nga një personel që nuk është forcë speciale (si psh: sulmi i kryer nga ushtarët

1. Joint Pub 3-05 thekson se misionet e aksioneve direkte janë “të dizajnuara për të arritur specifika të rëndësishme, të përcaktuara mirë, dhe shpesh të ndjeshme në kohë ose me një ndikim kritik strategjik, operacional ose taktik”. Ato përfshijnë sulme mbi objektiva kritik, ndalim, ose linja kritike të Komunikimit, vendndodhje, kapje, personelit ose materialeve ose konfiskimit, shkatërrimin, apo neutralizim e objekteve kritike.
2. Doktrina për Operacionet e Përbashkëta Speciale, (PUB JOINT PUB 3-05) përcakton Operacionet Speciale, si: “Operacione të kryera nga forcat ushtarake dhe paraushtarake të organizuara posaçërisht, të trajnuara dhe të pajisura, për të arritur objektiva politike, ekonomike, psikologjike ose objektivat me mjete ushtarake jo konvencionale në zonat armiqësore, të mohuara apo politikisht të ndjeshme. Këto operacione janë kryer gjatë konkurrencës në kohë paqeje, konflikti dhe lufte, të pavarur apo në bashkëpunim me operacionet konvencionale”.

e aviacionit në Dolittle Tokio, apo nëndetëset e përfshira në sulmin mbi luftanijet gjermane në TIRPITZ).

a. Pse operacionet speciale janë unike?

Të gjitha operacionet speciale janë kryer kundër pozicioneve të fortifikuara, qoftë kjo një luftanije e rrethuar nga rrjetat antislurë (britanikët në sulmin me nëndetëse kundër TIRPITZ), një tërheqje nga mali i ruajtur nga trupat italiane (shpëtimi i Musolinit nga *Skorzeny*), një kamp i të burgosurve të luftës (sulmi i trupave *Rangers* në *Cabanatuan*, sulmi i FS Amerikane në *Son Tay*) ose një avioni të rrëmbyer (njësia antiterroriste gjermane (GSG-9), shpëtimi i pengjeve në Mogadishu, Somali). Këto pozicione të fortifikuara pasqyrojnë situatën e luftimit mbrojtës nga ana e armikut.

Carl von Clausewitz në librin e tij “Mbi Luftën” vuri në dukje se:

Forma mbrojtëse e luftës është thelbësisht më e fortë se ajo ofensive.²³ Ajo u kontribuon forcave në mbrojtje aftësinë për të ruajtur dhe për të mbrojtur veten. Kështu, mbrojtja në përgjithësi ka një qëllim të kundërt, atë të rezistencës ndaj vullnetit të armikut ... në qoftë se ne jemi duke filluar një ofensivë për të imponuar vullnetin tonë, duhet të zhvillojmë fuqi të mjaftueshme për të kapërcyer epërsinë e padiskutueshëm të mbrojtjes së armikut (Clausewitz, 76, 358).

Teoria e luftës së shteteve e Clausewitz thotë na mëson për të mposhtur “formacione më të forta luftimi”, arma më e mirë është një ushtri superiore në numër.

Në këtë kuptim, superioriteti i numrave pa dyshim është faktori më i rëndësishëm në rezultatin e një angazhimi, për aq kohë sa ajo është

Trupat jo forcë speciale. Konsideratat politiko-ushtarake shpesh i japin formën e operacioneve speciale, që kërkojnë klandestinitet, mbulim ose teknika të fshehta, apo dukshmëri të ulët në survejim në nivel kombëtar. Operacionet speciale ndryshojnë nga operacionet konvencionale në shkallën e rrezikut fizik dhe politik, teknikat operative, mënyrat e operimit, pavarësia nga mbështetja, dhe varësia në një zbulim operacional të detajuar dhe asetet indigjene.

mjaftueshmërisht e madhe për kundërpeshë të të gjitha rrethanave të tjera që kontribuojnë. Pra, duhet të angazhohen sa më shumë trupa që të jetë e mundur në pikën vendimtare (Clausewitz, 76, 194).

Asnjë ushtarak nuk do të kundërshtojë dobinë e superioritetit në forca, por në qoftë se ky do të ishte “faktori më i rëndësishëm”, por si mundën 69 komando gjermane të mposhtnin forcat belge prej 750 ushtarësh të mbrojtur nga fortesa më e madhe në atë kohë, fortesa në *Eben Emael*? Si mundet që forcat e operacioneve speciale, që kanë dizavantazhin e sulmit në formën më të fortë të luftës (mbrojtjes) dhe më të paktë në numër, të fitojnë *epërsi relative* ndaj armikut? Të kuptosh këtë paradoks, duhet të kuptosh operacionet speciale.

b. Epërsia relative

Epërsia relative është një koncept thelbësor për Teorinë e Operacioneve Speciale. Vlera e të kuptuarit të *epërsisë relative* qëndron në aftësinë e konceptit për të ilustruar se çfarë forcash pozitive ndikojnë në suksesin e misionit dhe po aq e rëndësishme, të shikosh se si elementët e luftës ndikojnë në arritjen e këtij qëllimi. Ky seksion do të përcaktojë tre vetitë themelore të *epërsisë relative* dhe do të përshkruajmë se si shfaqen në luftime këto veti.

Epërsia relative është momenti kryesor në një angazhim.

Për shembull, në Luftën e II-të Botërore, kur gjermanet sulmuan fortesën belge në *Eben Emael*, ata arritën një avantazh vendimtar mbi armikun, *epërsi relative*, brenda pesë minutave të para të sulmit duke përdorur bombarduesit, lëndë plasëse për të fituar efektin surprizë dhe shpejtësi për të mposhtur armikun shpejt. Ndonëse belgët luftuan edhe për 24 orë të tjera, beteja u vendos nga momentet e para dhe rezultati i luftimit praktikisht u siguroi.

Në disa raste, momenti kryesor vjen para betejës. Në vitin 1943, britanikët modifikuan një shkatërrues të vjetër, HMS CAMPBELTOWN, të mbushur me katër ton e gjysmë eksploziv, e mbuluan me pllaka të blinduara dhe e lëshuan në kanal me

qëllim që ta përplasnin në dokun gjerman në St. Nazaire, Francë. Pas këtij veprimi, doku u bë i padobishëm për pjesën e mbetur të luftës. Edhe pse mbrojtja gjermane përreth St. Nazaire ishte më e forta në Atlantik, pasi HMS CAMPBELTOWN arriti portën e jashtme të portit (dy kilometra nga doku), gjermanët nuk mund ta ndalonin më atë. Në këtë pikë të luftimeve aktuale u arrit *epërsia relative*. Pika në të cilën arrihet *epërsia relative* është gjithashtu momenti me rrezikun më të madh, si për shembull mbrojtja rreth një objekti, sa më shumë afrohen forcat sulmuese aq më e fortë bëhet mbrojtja. Megjithatë, sapo të jetë kapërcyer pengesa e fundit probabiliteti i suksesit e tejkalon fuqishëm probabilitetin e dështimit dhe *epërsia relative* është arritur.

Pasi *epërsia relative* është arritur, ajo duhet të jetë e qëndrueshme në mënyrë që të garantojë fitoren. Si shembull mund të përmendim përpjekjen për të shpëtuar diktatorin italian, *Benito Mussolini*, nga Kapiteni SS *Otto Skorzeny*. Ai kreu një sulm mbi një fortesë italiane në majën e *Gran Sasso* në malet Apenine. Brenda katër minutash zbarkim, *Skorzeny* kishte sulmuan fortesën dhe kishte *Mussolinin* nën kontroll. Në këtë pikë ai kishte arritur *epërsinë relative*, megjithatë, para se misioni të quhej i suksesshëm, *Skorzeny* ende kishte për të nxjerrë *Mussolinin* nga maja e malit dhe të siguronte kthimin e sigurt të diktatorit në Romë. Kjo periudhë e ndërmjetme mes shtënies në dorë të diktatorit italian dhe përmbyshja e misionit kërkon mbajtjen e *epërsisë relative*. Kjo u arrit përmes guximit nga ana e *Skorzeny* dhe përforcimit të njësisë së tij të vogël komando me trupat konvencionale.


Aftësia për të mbajtur *epërsinë relative* shpesh kërkon ndërhyrjen e faktorëve moralë (guxim, zgjuarsi, liri të plotë dhe këmbëngulje).

Për shembull, gjatë Luftës së II-të Botërore, Togerit *Luigi Durand de la Penne*, një zhytës italian, hyri në mënyrë klandestine në portin e Aleksandrisë në bordin e një siluri. Ai dhe shoku i tij mposhtën rrjetën kundër nëndetësve, ngarkesat me lëndë plasëse në thellësi, anijet roje, sigurinë në skelë dhe rrjetat antsilur për të arritur luftanijet britanike HMS VALIANT. Misioni i tij ishte vendosja e eksplozivit në trupin (anijes) dhe hedhja e saj në erë. Për fat të keq, ndërsa *De La Penne* drejtonte silurin nën VALIANT, siluri humbi drejtimin dhe u mbyt në baltë dhe zhytësi i dytë i *De la Pennes* humbi vetëdijen dhe pluskonte në sipërfaqe. Edhe pse i lodhur fizikisht nga një zhytje e gjatë, i ngrirë nga uji i ftohtë duke u zvarritur me kostumin e tij të thatë,

De la Penne kaloi dyzet minutat e ardhshme duke lëvizur silurin në pozicion nën HMS VALIANT. Vetëm me anë të këmbënguljes së madhe dhe guximit (dy nga katër faktorët moralë) *De la Penne* ishte në gjendje për të mbështetur *epërsinë relative* dhe të realizonte misionin.

Nëse *epërsia relative humbet*, është e vështirë për ta rifituar. Kur komandot e HMS CAMPBELTOWN shpërthyen dokun në St Nazaire, plani në bord kërkonte që tetëdhjetë komandot të zbarkonin dhe të shkatërronin një sërë objektivash rreth objektit të portit Gjerman. Edhe pse komandot arritën avantazh taktik, kur e hodhën në erë dokun dhe i zunë në befasi gjermanët, kur u përpoqën për të shkatërruar objektivat e tyre në breg, ndërhyrja e marinarëve dhe ushtarëve gjermanë ngadalësoi progresin e tyre. Pas tridhjetë minutash në breg, komandot e HMS CAMPBELTOWN u mposhtën nga përforcimet gjermane dhe *epërsia relative* humbi. Luftimi zgjati edhe dy orë, por britanikët, për shkak të inferioritetit në numër, nuk ishin në gjendje për të rimarrë avantazhin. Përfundimisht komandot u detyruan të dorëzohen. Një dobësi e natyrshme në forcat speciale është mungesa e fuqisë së zjarrit në lidhje me një forcë të madhe konvencionale. Si pasojë, kur ata humbasin *epërsinë relative*, humbasin iniciativën dhe forma e fortë e luftës (mbrojtja) në përgjithësi mbizotëron.

Çelësi për misionet e operacioneve speciale është të fitosh *epërsi relative* në fillim të angazhimit. Sa më gjatë vazhdon një angazhim, aq më shumë ka të ngjarë që iniciativa e armikut, pasiguria dhe elementët e luftës të ndikojnë në rezultat. Në secilën nga tetë studimet e rasteve, koncepti i epërsisë relative do të portretizohet nëpërmjet përdorimit të grafikut të *epërsisë relative*. Diagrami ilustron se si arritja e *epërsisë relative* është e ndikuar nga faktorët pozitivë dhe negativë të luftës. Përveç kësaj, grafi ofron një demonstrim vizual të tre faktorëve të *epërsisë relative*: momenti kryesor mund të shihet si një rritje dramatike e mundësisë së përfundimit të misionit, mbajtja e *epërsisë relative* është një rritje graduale nga momenti i rëndësishëm i realizimit të misionit dhe një rënie vendimtare në probabilitetin e përfundimit të misionit tregon një humbje të *epërsisë relative* (shih skicën 2-2).



Skicë 2-2. Grafiku i epërsisë relative

Boshti X është Koha, Boshti Y është Probabiliteti i përfundimit të Misionit. Pikëprerja e boshteve është Pika e Cënueshmërisë (PC). Pika e cënueshmërisë është përkufizuar si momenti gjatë misionit kur forcat sulmuese arrijnë vijën e parë të mbrojtjes së armikut. Në këtë pikë, elementët e luftës (shansi, pasiguria dhe iniciativa e armikut) do të fillojnë të ndikojnë mbi suksesin e luftës. Kjo pikë e cënueshmërisë është disi arbitrare dhe vendndodhja e saktë mund të debatohet. Mund të jetë ajo kur bombarduesit nisen nga baza, ose kur ata janë në fluturim, ose kur ata janë duke bërë qasjen e tyre përfundimtare? Është momenti kur nëndetëset hynë në ujërat norvegjeze, apo kur ato u ndeshën fillimisht me mbrojtjen gjermane?

Edhe pse elementët e luftës mund të ndikojnë një mision edhe në fazën e planifikimit, unë kam zgjedhur për të përcaktuar pikën e cënueshmërisë, si një aspekt të fazës së angazhimit.

Zona e Cënueshmërisë (ZC) është një funksion i përfundimit të misionit me kalimin e kohës. Sa më shumë kohë të duhet për të arritur *epërsi relative*, aq më e madhe do të jetë zona e cënueshmërisë, si rrjedhim, më i madh do të jetë ndikimi i elementëve të luftës. Grafiku tregon gjithashtu ngjarjet kritike që çojnë deri në *epërsi relative* dhe kur misioni është përfunduar.

Edhe pse ka faktorë në luftë mbi të cilat ne kemi pak kontroll, Teoria e Operacioneve Speciale tregon se janë gjashtë parime të cilat mund të “kontrollohen” dhe të kenë një efekt mbi *epërsinë relative*.

c. Gjashtë parimet e operacioneve speciale

Gjashtë parimet e operacioneve speciale të paraqitura në këtë pjesë, thjeshtësia, siguria, provat, befasia, shpejtësi dhe qëllimi rrjedhin nga një analizë e tetë rasteve historike.¹ Këto parime kanë dominuar çdo mision të suksesshëm. Nëse një nga këto parime është anashkaluar, shpërfillur apo shkelur, ka pasur gjithmonë një dështim. Janë këto parime që lejojnë operacionet e forcave speciale për të arritur *epërsi relative*. A mund të përdorin forcat konvencionale këto parime për të fituar *epërsi relative*? Jo! Epërsia relative është rreptësisht kompetencë e forcave jo konvencionale (grupeve të vogla). Kjo nuk duhet nënkuptuar se forcat e mëdha (konvencionale) nuk mund të fitojë elementin e surprizës ose përdorin shpejtësinë për të arritur qëllimet e tyre, por për të fituar *epërsi relative* kërkohet integrimi i duhur i gjashtë parimeve. Duke u mbështetur në madhësinë e tyre, është e vështirë për forcat konvencionale të zhvillojnë një plan të thjeshtë për të mbajtur fshehur lëvizjet e tyre, të kryejnë prova të detajuara të plota (prova para operacionit deri në nivel ushtari), të fitojnë befasit taktike, shpejtësinë në objektiv dhe motivimin e të gjithë ushtarëve në njësi në një qëllim të vetëm. Clausewitz-i deklaroi qartë kur thotë: “*Sa më e madhe rëndësia e çdo ngjarjeje, më të gjerë janë faktorët dhe rrethanat që e ndikojnë atë*” (Clausewitz, 76, 159).

Forcat e mëdha janë më të ndjeshme ndaj elementëve të luftës. Parimet e Operacioneve Speciale funksionojnë sepse ato kërkojnë për ta ulur luftën në nivelin e saj më të thjeshtë dhe në këtë mënyrë të kufizojnë efektet negative të mundësisë dhe të pasigurisë.

-
1. Fillimisht, rastet u krahasuan me "Parimet e Luftës" së Ushtrisë së SHBA e përkufizuar në Doktrinën e Operacioneve Speciale të Përbashkëta (Joint Special Operations). Pas shqyrtimit të kujdesshëm të këtyre rasteve disa nga "Parimet e luftës" janë eliminuar ose modifikuar për të pasqyruar më saktë lidhjen e tyre në një operacion special. Parimet përfshijnë: objektivin, sulmin, sasinë e forcave, ekonominë e forcës, manovrat, unitetin e komandimit, sigurinë, befasinë dhe thjeshtësinë.

Për të arritur *epërsinë relative*, operatori i forcave speciale duhet të marrë parasysh parimet në të tre fazat e një operacioni, planifikimin, përgatitjen dhe zbatimin. Çdo parim është i ndërlidhur dhe mbështetet në të tjerët. Për shembull, nëse një plan nuk është i thjeshtë, ai do të jetë i vështirë për të fshehur qëllimin e operacionit dhe më i vështirë për të zhvilluar prova para operacionit. Nëse operacioni është i vështirë për të qenë i fshehtë dhe për të bërë prova para operacionit, ai është gati i pamundur për t'u zbatuar me qëllim, shpejtësi dhe befasi.

Komisioni *Holloway* në “Raportin e Misionit të Shpëtimit”, i cili shqyrtoi përpjekjen e dështuar të shpëtimit të pengjeve në Teheran në vitin 1980, tregon se si parimet e sigurisë, thjeshtësisë dhe provave para operacionit janë të lidhura.

Misioni i shpëtimit u ndërpre për shkak të rrethanave kushtëzuese, si psh: pamjaftueshmëria e helikopterëve për të vazhduar operacionin. Megjithatë raporti vuri në dukje, se duke vendosur helikopterë shtesë, do të rritej niveli i vështirësisë që do të çonte në një rritje të panevojshme të rrezikut për OPSEC-ut.

Konsideratat e OPSEC-ut justifikonin një provë në shkallë të plotë dhe ndërsa grupi njohu rrezikun e natyrshëm në sjelljen e të gjitha forcave së bashku në kampin e trajnimit në perëndim të SHBA-së, dizavantazhet e mundshme të sigurisë gjatë një provë të tillë duket se ishin më të mëdha nga avantazhet që pritej të fitoheshin (Komisioni Holloway, 1980, 58-59)

Korrelacioni midis thjeshtësisë, sigurisë dhe provave është i qartë, në qoftë se një plan është i ndërlikuar do të kërkojë siguri të jashtëzakonshme dhe një tepri e sigurisë pengon përgatitjen efektive.


Në fazën e përgatitjes, siguria e duhur dhe provat e vazhdueshme kanë një ndikim të drejtpërdrejtë në aftësinë e forcave që do të kryejnë sulmin për të fituar befasinë dhe shpejtësinë në fazën e zbatimit. *Clausewitz-i* në diskutimin e tij mbi befasinë thotë se: “Surpriza kurrë nuk mund të arrihet në kushte të dobëta të sigurisë” (Clausewitz, 76, 198).

Përsëritja e vazhdueshme, e zhvilluar si në trajnime po ashtu edhe në provat para operacionit, është lidhja midis parimit të thjeshtësisë në fazën e planifikimit, si dhe parimeve të befasisë dhe shpejtësisë në fazën e zbatimit. Për shembull, Nënkoloneli

dhe piloti i HH-3 *Herbert Zehnder*, i cili fluturoi nga Tajlanda në Son Tay, Vietnami i Veriut kishte detyrën e vështirë të ulej në oborrin e vogël të kampit të burgosurve të luftës. Ishte konsideruar e domosdoshme për ta bërë këtë “përplasje” të kontrolluar në oborr, në mënyrë për të fituar disa sekonda befasie. Fillimisht kjo manovër u konsiderua si shumë e vështirë, por pas qindra orë fluturimesh dhe një duzinë provash, ulja e vështirë u bë më e lehtë dhe befasia u arrit. Përsëritja e vazhdueshme e bëri detyrën e uljes në një zonë të mbyllur të lehtë dhe përmirësoi në këtë mënyrë mundësinë për të fituar befasinë.

Provat e vazhdueshme në kushte reale do të përmirësojnë aftësinë e forcave që sulmojnë për të zbatuar sa më shpejt misionin, veçanërisht në kushte luftarake. *John Lorimer*, një efektiv në nëndetësen që dëmtoi luftanijen TIRPITZ tha: “Nëse nuk doni të bëni asgjë të rrezikshme, mënyra më e mirë për ta kryer atë është trajnim, trajnim, trajnim, në mënyrë që gjatë përshkallëzimit të situatës ta bëni çdo gjë automatikisht” (Galager, 1969, 29). Provat për vetë nga natyra e tyre përmirësojnë shpejtësinë në objektiv.

I fundit nga gjashtë parimet e FS është Qëllimi (McRaven, 2008). *Kuptimi i qëllimit*, pra të kuptuarit e objektivave të misionit dhe një angazhim personal për të parë arritjen e këtyre objektivave, është jetike për të arritur *epërsinë relative*. Edhe pse parimi i qëllimit është më i dukshëm në fazën e zbatimit, të gjitha fazat duhet të fokusohen në qëllimin e misionit. Njohja e qëllimit të misionit do të zvogëlojë objektivat e jashtëm (jo të qëllimit të misionit), do të grumbullojë inteligjencën e kërkuar, do të sigurojë kërkesat e OPSEC, do të përqëndrohet në provat para operacionit dhe në luftim për të siguruar që përpjekjet e komandantit apo çdo operatori të përqëndrohen në atë që është më e rëndësishme - **misionin**. Të gjithë shembujt e mësipërm ilustrojnë marrëdhëniet ndërmjet fazës së planifikimit, përgatitjes dhe zbatimit të misionit dhe demonstrojnë natyrën sinergjike të gjashtë parimeve të operacioneve speciale. Modeli i Operacioneve Speciale, i treguar në skicën 3-13, përshkruan Parimet e Operacioneve Speciale, si një piramidë e përmbysur.



Skicë 2-3. Parimet e Operacioneve Speciale

Bllloqet brenda piramidës mund të “ndërtohen” për të arritur *epërsi relative*. Edhe pse arritja e *epërsisë relative* ndaj armikut është thelbësore për sukses, kjo nuk është një garanci. Suksesi i misionit siç tregohet tek piramida e përmbysur, rri i balancuar mbi një kulm të hollë. Ai kërkon faktorët moralë si: guximi, intelekti dhe këmbëngulja për të parandaluar elementët e luftës, ta përmbysin atë dhe të shkaktojnë humbjen. Ky model nuk është një recetë për sukses në fushën e betejës, ai është vetëm një mjet për të ndihmuar lexuesin të analizojë rastet historike dhe të kuptojë marrëdhëniet mes parimeve të operacioneve speciale dhe *epërsisë relative*. Ky model gjithashtu pasqyron teorinë e Operacioneve Speciale. Ajo grafiksht paraqet idenë se Operacionet e Forcave Speciale kanë sukses, pavarësisht inferioritetit numerik të tyre, ata janë në gjendje për të fituar *epërsi relative* nëpërmjet një plani të thjeshtë, veprimeve të fshehta, provave para operacionit sa më afër realitetit dhe zbatimit me shpejtësi, befasi dhe qëllim. Dështimi ndodh vetëm kur elementët e luftës kapërcejnë faktorët moralë. Më poshtë do të përcaktoj gjashtë parimet dhe do të ilustroj se si ata janë manifestuar në Operacionet Speciale.

1. Thjeshtësia

Thjeshtësia është parimi më i rëndësishëm dhe ndonjëherë parimi më i vështirë për t'u përmbushur. Si mund të bëjmë një plan të thjeshtë? Ekzistojnë tre elemente kritike të thjeshtësisë për sukses: kufizimi i numrit të objektivave, inteligjencë sa më saktë dhe risia.

Situata politike ose ushtarake dikton objektivat strategjike ose operacionale të misionit, por planifikuesit në përgjithësi kanë liri për të përcaktuar objektivat taktike për aq kohë sa të dy objektivat përputhen. Prandaj është thelbësore që të kufizohet numri i objektivave taktike në vetëm ato që janë me rëndësi jetike. Për shembull, në fillim të Luftës së II-të Botërore, Hitleri urdhëroi komandot gjermane të shkatërronin rezistencën belge në *Eben Emael* për të parandaluar topat 75 mm dhe mortajat 120 mm, të shkatërronin urat aty pranë dhe të angazhoheshin në avancimin e Divizionit Tankist Gjerman. Edhe pse ishin njëzet grupime (secili grup me 2-3 armë) gjermanët sulmuan vetëm nëntë grupe. Pjesa e mbetur prej njëmbëdhjetë grupesh ishin të orientuar në jug dhe nuk përbënin një kërcënim për urën veriore ose për tanket.

Në anën tjetër, ndërsa bëhej planifikimi për goditjen në *St. Nazaire*, britanikët identifikuan dokun Normand si “objektivin kryesor” dhe me mbylljen e portave të jugut, çdo anije në formë V-je do të realizonte manovrën goditëse si objektiv dytësor (Combined Operations: The Official Story of the Commandos, 1943, 72). Megjithatë, gjatë planifikimit numri i objektivave të rëndësishëm arriti në njëmbëdhjetë. Duke rritur numrin e objektivave nga 3 në 11, trupave sulmuese u nevojitej të shtonin edhe 50 ushtarë të tjerë dhe mbi 200 persona të këmbësorisë detare në mbështetje. Përveç kësaj, dhjetë avionë sulmi duhej të shtoheshin, më shumë stërvitje ishte e nevojshme dhe taktikat duhej të modifikoheshin për të përshtatur këto ndryshime. Kufizimi i objektivave në atë çfarë është thelbësore, fokuson trajnimin kufizon numrin e personelit të kërkuar, redukton kohën në objektiv dhe ul numrin e “pjesëtarëve që manovrojnë” (McRaven, 2008).

Inteligjenca e mirë është elementi i dytë i nevojshëm për të zhvilluar një plan të thjeshtë. Inteligjenca e mirë e thjeshton planin duke reduktuar faktorët e panjohur dhe numrin e variablave që duhet të merren në konsideratë. Gjatë përgatitjes për të shpëtuar pengjet në aeroportin *Entebbe*, inteligjenca Izraelite ishte në gjendje të përcaktonte numrin e terroristëve dhe rojeve nga FA të Ugandës, armatimin e tyre dhe vendosjen e përgjithshme të tyre në aeroport. Ky informacion i dha hapësirë

komandantit të grupit të çlirimit të pengjeve, BG *Shomron-it*, të zvogëlonte forcat e tij në aq sa ishte e nevojshme. Kjo përmirësoi në mënyrë esenciale komandim-kontrollin e cila ishte thelbësore për suksesin. Para goditjes në fortesën *Eben Emael*, gjermanët siguruan planet xheniere që ofronin një përshkrim të detajuar të daljeve të emergjencës. Sikur edhe një pjesë e vogël e 750 forcave belge brenda fortesës të dilte, ata mund të kundërsulmonin dhe shtypnin forcat e pakta gjermane. Por gjermanët zbarkuan me shpejtësi në objekt, shkatërruan daljet e emergjencës dhe aftësinë e forcave belge për kundërsulm.

Megjithatë gjithmonë do të ketë “boshllëqe” në inteligjencë. Ekuipazhi i nëndetëseve, i cili sulmoi luftanijen gjermane TIRPITZ, nuk e dinte se në çfarë distance shtrihej poshtë nën ujë rrjeta antitorpedo. Në *Son Tay*, forcat që do sulmonin, nuk e dinin me saktësi se sa të burgosur lufte ishin apo sa roje të armikut ishin brenda kampit. Në të dyja rastet operatorët ndoqën këshillën e *Clausewitz-it*:

Shumë raporte të inteligjencës në luftë janë kontradiktore, por më shumë janë të rreme dhe të pasigurta. Çfarë kërkoj nga një oficer në mënyrë të arsyeshme, është se ai duhet të ketë një standard të gjyimit ?... Ai duhet të udhëhiqet nga ligjet e probabilitetit. (Clausewitz, 1976, 183).

Ekuipazhi i nëndetëses u përgatit të futej nëpërmjet rrjetës duke “supozuar” se ajo shtrihej 120 metra poshtë nën ujë. Analistët e zbulimit që studiuan kampin e *Son Tay* parashikuan numrin e të burgosurve të luftës dhe rojet bazuar në numrin dhe madhësinë e ndërtesave. Të dyja njësitë e ndërtuan planin e tyre bazuar në atë çfarë ishte e arsyeshme që të prisnin. Elementi i tretë që kontribuon në thjeshtësi është risia. Risia thjeshton një plan duke shmangur apo eliminuar pengesat, të cilat përndryshe do të komprometonin befasinë dhe/ose të komplikonin zbatimin e shpejtë të misionit. Inovacioni është vërejtur zakonisht në teknologjitë e reja, por gjithashtu edhe tek zbatimi i taktikave jo konvencionale. Fortesa në *Eben Emael* ishte tridhjetë kilometra nga kufiri

gjerman. Nëse befasia nuk do fitojë, belgët do të kishin pasur kohën e mjaftueshme për të shkatërruar urat vendimtare për përparimin gjerman. Trupat ajrore nuk ishin në gjendje për të mbajtur artilerinë e rëndë të nevojshme për të shkatërruar grupet e artilerisë dhe hedhja me parashutë do të kishte krijuar një shpërndarje shumë të gjerë të trupave. Hitleri urdhëroi Gjeneralin Kurt që të organizonte një forcë bombarduese sulmi për të pushtuar fortesën. Edhe pse bombarduesit nuk ishin një teknologji e re, ai ishte përdorimi i parë i bombarduesve gjatë luftimit dhe befasoi belgët për një kohë të mjaftueshme, për të lejuar gjermanët të shkatërronin armët që mbulonin urat.

Gjatë trajnimit për çlirimin e pengjeve nga kampi i të burgosurve të luftës në *Son Tay* në Vietnamin e Veriut, FS hasnin vështirësi gjatë angazhimit të objektivave natën. Edhe në rrethanat më të mira “saktësia e qitjes gjatë natës ishte rreth 35 për qind³⁷”. Përmirësimi i saktësisë është konsideruar vendimtar për zbatimin e shpejtë të misionit. Brenda javës me të identifikuar problemin personeli i FS gjeti në treg civil dylbi të shikimit në dritë të ulët, të cilat rritën saktësinë deri në 95%.

Në çdo rast janë përdorur ose teknologjia e re ose taktika të reja për të ndihmuar elementin e sulmit në arritjen e objektivit dhe pastaj shpejt dhe në mënyrë efektive eliminimin e armikut. Bombarduesit, nëndetëset, silurët e drejtuar, pajisja e C-130E me *Forward Looking Infrared (FLIR)* dhe shkatërruesit e modifikuar ishin të gjithë një teknologji e re, e projektuar posaçërisht për të mposhtur mbrojtjen e armikut dhe për të arritur befasinë. Lëndët plasëse, armët automatike, lëndët plasëse të veçanta, dylbitë e shikimit për dritë të ulët, granatat shokuese Stun dhe pajisjet për shikim natën, ishin kryesore për arritjen e shpejtësisë në objektiv.

Edhe pse tre elementet e thjeshtësisë kanë ndikimin e tyre të madh gjatë fazës së zbatimit, ato duhet të identifikohen herët për të ndihmuar në hartimin e planit për ta bërë atë sa më të thjeshtë që të jetë e mundur.

2. Siguria

Qëllimi i sigurisë së “shtrënguar” është parandalimi i armikut për të fituar një avantazh të padrejtë nëpërmjet marrjes së informacionit për sulmin e pritshëm. Megjithatë, natyra e operacioneve speciale është të sulmojë një pozicion të fortifikuar.

Kjo natyrisht kuptohet, qoftë në kohë lufte apo paqe, që armiku është i “përgatitur” për të pritur një sulm. Ndaj në mision, koha kur do zhvillohet dhe mënyra e ndërhyrjes duhet të jenë tepër të fshehta. Për shembull, nxënësit, të cilët morën kontrollin e ambasadës Amerikane në Teheran, prisnin një reagim nga Shtetet e Bashkuara të Amerikës. Ata kishin mbuluar zonën e hapur me copa të gjata prej druri për të parandaluar uljen e helikopterit apo forcave ajrore (McRaven, 2008).

Luftanija TIRPITZ, edhe pse e siguruar deri në 60 milje deri në *Sound Soroy* në Norvegji e mbrojtur me rrjeta anti-nëndetëse, rrjeta antislur dhe pajisjeve kundër zhytësve për t'iu kundërvënë çdo sulmi nënujor, përsëri u godit me sukses nga britanikët. Të katër terroristët në bordin e fluturimit *Lufthansa LH181* e dinin se si Gjermania dhe Izraeli kishin njësi kundër terroriste të afta për të sulmuar në avionë. Terroristët ishin të armatosur me armë automatike, granata dhe shumë lehtë mund të kishin parandaluar ndërhyrjen e GSG-9 në *Boeing 737*. Në shumicën e rasteve historike, kundërshtari në objektiv e kishte përgatitur mbrojtjen në mënyrë adekuate kundër sulmeve. Megjithatë, sulmet ishin kryesisht të suksesshme. Pse? Siguria e pengon armikun të dijë kohën në disa raste mënyrën e sulmit. Siguria shumë e mirë nga ana e personelit të forcave speciale, nuk e ka penguar armikun të përgatiste sulme. Forcat speciale kanë patur sukses kundër një mbrojtjeje të fortë të përgatitur nga ana e armikut. Megjithatë, siguria nuk është një çështje e parëndësishme. Ajo duhet të jetë aq e fortë sa të jetë e mundur, me kusht që të mos pengojë përgatitjen ose kryerjen e operacionit. Siguria është e rëndësishme në arritjen e *epërsisë relative*, sepse ajo pengon armikun për të fi një avantazh të papritur. Një arsye mbizotëruese për suksesin e operacioneve speciale është aftësia e forcave në sulm, të dinë se çfarë mbrojtje ka përgatitur armiku. Një siguri e dobët mund të rezultojë në parapërgatitjen e kundërshtarit dhe më pas parashikimin e sulmit ose zvogëlimin e shpejtësisë në objektiv, të dyja do të reduktojnë në mënyrë dramatike mundësinë e arritjes së *epërsisë relative*.

3. Përsëritja

Rutina, përveç pashmangshmërisë së saj absolute, gjithashtu përmban një avantazh pozitiv. Praktika e vazhdueshme të çon në udhëheqjen e shpejtë, të saktë dhe të besueshme, duke zvogëluar elementët e luftës dhe lehtësimin e

punës. Një rutinë e shkurtër do të jetë më e shpeshtë dhe më e domosdoshme, për nivel të ulët aksioni (Clausewitz, 1976, 153).

Në fazën përgatitore, provat rutinë janë të domosdoshme në eliminimin e barrierave për sukses. Kur Grupi i Task Forcës Ajrore i përfshirë në sulmin në *Son Tay*, u përpoq të fluturonte UH-IH në formacion me C-130, kuptuan që të fluturonin në një formacion aq të ngushtë, ishte shumë e vështirë për pilotët. Pas shumë orësh fluturimi, u provua që ky formacion mund të zbatohej në planet e ardhshme.

Gjeneral *Joshua Shani*, piloti kryesor i C-130, në sulmin në *Entebbe* kishte vetëm një mundësi për të ushtruar uljen e tij në terren të shkurtër para fillimit të misionit, gjë për të cilin nuk ishte problem shqetësues. Ai tha: “Unë kisha bërë qindra ulje në terren të shkurtër, ato janë pjesë themelore e trajnimit... tashmë na është bërë rutinë” (Gjeneral Joshua Shani, intervistuar nga CDR William McRaven, 1993).

Disa njësi luftarake, të tilla si: ekipet e antiterrorit, bombarduesit strategjikë, grupet e FS dhe NAVY SEALS, kryejnë misione me profile standarde si pjesë e “rutinës”. Kjo rutinë u jep aftësi taktike të një shkalle të tillë që lejon reagimin e shpejtë ndaj kërcënimit (me kusht që kërcënimin t’i përshtatet skenarit standard për të cilin njësi është stërvitur). Megjithatë shumë operacione speciale ndryshojnë nga skenarët standardë, ku pajisjet dhe taktikat e reja duhet të vihen në zbatim për të mbajtur peshën e problemit. Kur kjo ndodh, është e domosdoshme të kryhen dy prova të plota para misionit. Plani duket i “thjeshtë” në letër, tashmë duhet të vihet në provë. Nevoja për një provë të plotë ka lindur nga koha dhe nga ato misione (ose aspekte të misioneve) që dështuan gjatë provave ose nuk u provuan dhe dështuan gjatë misionit. Për shembull, gjatë provave për sulmin në *St Nazaire*, dhjetëra komando britanike u “vranë” nga forcat e Gardës (imituesit) gjatë zbarkimit në breg. Edhe pse trajnimi individual u krye disa herë pa ndonjë incident, kur komandot u përpoqën për ta përmbledhur të gjithë planin në një provë gjatë natës, ata kuptuan se zbarkimi i të gjitha trupave njëkohësisht ishte më i vështirë. Kjo u presupozua të ishte një incident i izoluar gjatë trajnimit dhe

se gjatë operacionit të vërtetë komandot “do t’ia dilnin”. Gjatë sulmit u vranë 169 burra, shumica kur ata po përpiqeshin për të dalë në breg (McRaven, 2008).

Britanikët kishin 18 muaj për t’u përgatitur për sulmin mbi luftanijen gjermane TIRPITZ. Misioni kërkonte përdorimin e nëndetëseve të vogla X-Craft, që të tërhiqeshin për tetë ditë përmes Atlantikut të Veriut nga nëndetëset konvencionale. Tërheqja ishte barrë veçanërisht për ekuipazhin dhe për këtë arsye u zhvilluan prova vetëm për një kohë të shkurtër. Në operacionin aktual të rimorkimit u këput kavoja dhe një X-Craft u mbyt bashkë me gjithë ekuipazhin dhe një tjetër u ç’aktivizua pas riparimit. Admirali *Godfrey Place* (Komandanti X-7) komentoi: “... nëse vetëm ne do kishim rimorkiuar anijet (X-Craft) për tetë ditë të plota, atëherë do ta kishim kuptuar se kavoja do të këputej.”¹ Përsëritja individuale dhe aftësitë e skuadrës janë esenciale, ndërsa provat e plota zbulojnë dobësitë në plan, por të dyja janë thelbësore për suksesin në fushën e betejës.

4. Befasia

Doktrina për Operacionet Speciale të Përbashkëta (*Joint Special Operations*) thekson se: befasia është aftësia për të “goditur armikun në një kohë apo vend, ose në një mënyrë, për të cilën ai është i papërgatitur” (*Joint Special Operations*, E-5).

Megjithatë, në të gjitha operacionet speciale të analizuara, armiku ishte tërësisht i përgatitur për t’i rezistuar sulmeve. Për shembull, në fortesën belge në *Eben Emael*, kundërajrorët ishin pozicionuar në krye të fortesës për të parandaluar sulmet ajrore; objektivi në portin e *St. Nazaire* ishte rrethuar me bateri artilerie dhe drita për të parandaluar hyrjen e fshehtë të anijeve britanike deri në lumin Loire; luftanija gjermane TIRPITZ dhe luftanija britanike HMS QUEEN ELIZABETH dhe HMS VALIANT ishin të rrethuar nga antinëndetëse dhe rrjeta kundër silurëve; Vietnami i Veriut kishte sistemin e mbrojtjes nga ajri një nga më të fortët në botë; *Benito Mussolini* ruhej nga 250 ushtarë italianë; robërit e luftës në Cabanatuan ruheshin nga 225 japonezë;

1. RADM Godfrey Place, VC, intervistuar nga CDR William McRaven, regjistrim, Sherborne, Dorset, Angli, 18 qershor 1992. Ka patur dy lloje litaresh të përdorura, kamoshi dhe najloni. Sepse litari kamoshit nuk ishte testuar për tetë ditë të plota dhe nuk kishte asnjë mënyrë për të ditur se sa do të duronte në kushtet aktuale.

aeroporti i *Entebbe* në Uganda ishte i rrethuar nga 100 ushtarë ugandezë me dy batalione. Armiku në secilin prej këtyre rasteve, ishte përgatitur për të parandaluar një sulm nga pozicionet e tyre dhe përsëri, befasia u arrit në të gjitha rastet.

Forcat e operacioneve speciale në përgjithësi nuk e kanë luksin të sulmojnë armikun ku, ose kur ai është i papërgatitur. Forcat e tilla duhet të sulmojnë, gjatë kohës së përgatitjes së armikut. Befasi do thotë të kapësh armikun të pa përgatitur. Ky ndryshim delikat nuk është semantikë e thjeshtë. Po ashtu si dy boksierë në një ring, secili është i përgatitur të presë grushte nga boksieri tjetër, por edhe pse shumë i përgatitur, ai do marrë grushte. Në një operacion special, befasia fitohet nëpërmjet mashtrimit, kohës, dhe duke përfituar nga dobësitë e armikut.

Mashtrimi kur ai funksionon, ose tërheq vëmendjen e armikut larg nga forcat që sulmojnë, ose vonon reagimin e armikut për të fituar kohë të mjaftueshme për të arritur befasinë në këtë moment vendimtar. Për shembull, gjatë sulmit në *Son Tay*, Task Force “Carrier” i Marinës 77 zhvilloi një sulm diversionist në tre drejtime, i cili shërbeu për t’i mohuar armikut mundësinë për të përqëndruar vëmendjen e tij në sulmin primar. Ky devijim ishte shumë i suksesshëm dhe u lejonte forcave sulmuese *heliborne* të depërtonin në mbrojtjen e Vietnamit të Veriut nga ajri, toka dhe zbarkuan pa u diktuar në kampin e të burgosurve të luftës. Mashtrimi që tërheq vëmendjen mund të jetë i rrezikshëm dhe kur ajo dështon, ajo mund të jetë katastrofike. Në *St. Nazaire*, *Royal Air Force* ishte urdhëruar të bombardonte qytetin portual për të tërhequr vëmendjen e gjermanëve larg nga armata e vogël e anijeve në lumin Loire. Fatkeqësisht, sulmi nga ajri shërbeu vetëm për të rritur vigjilencën e gjermanëve dhe të bënte të përealizueshme arritjen e befasisë.

Edhe pse mashtrimi funksionoi për sulmin në *Son Tay*, në operacionet speciale mashtrimi është përdorur më me sukses për të vonuar veprimet nga ana e armikut. Për shembull, kur izraelitët sulmuan aeroportin *Entebbe*, ata përdorën një *Mercedes Sedan*, të ngjashëm me makinën që përdorej nga Presidenti i Ugandës. Kur *Skorzeny* zbarkoi në *Gran Sasso* për të shpëtuar Musolinin, ai kishte me vete një gjeneral italian të nivelit të lartë. *Skorzeny* besonte se prania “e gjeneralit ndoshta do të shërbente për të krijuar konfuzionin e caktuar, ... një lloj hezitimi nga ana e tyre që të reagonin

menjëherë, ose do të parandalonte vrasjen e Duçes” (Skorzeny, 1950, 87). Supozimi i *Skorzeny* doli i saktë dhe konfuzioni i dha kohë që të gjente dhe merrte Musolinin. Siç e theksova dhe më lart, mashtrimi mund të jetë një mjet i dobishëm për fitimin e befasisë, por mbështetja duhet të shmanget tërësisht në mashtrim, me qëllim që të përdoret për të vonuar reagimin e armikut se sa për të devijuar vëmendjen e tij.

Ora e sulmit është një faktor kyç në arritjen e befasisë. Shumica e forcave në sulm preferojnë të sulmojnë një objektiv gjatë natës, kjo për shkak se errësira siguron mbulesë, gjatë natës armiku është i lodhur dhe vigjilenca është më e ulët dhe më e ndjeshme ndaj befasisë. Por ka ndodhur që disa prej operacioneve speciale më të suksesshme janë kryer edhe gjatë ditës dhe kanë arritur një shkallë të lartë befasie. *Skorzeny*, për shembull zbarkoi në *Gran Sasso* në ora 2:00 pasdite. Ai e dinte që rojet italiane sapo kishin mbaruar drekën dhe më pas do të vinte ora e pushimit. Gjermanët të cilët sulmuan *Eben Emael*, zbarkuan në të gdhirë dhe drita e mëngjesit u dha ndriçimin e duhur bombarduesve në tokë. Nëndetëset që shkatërruan TIRPITZ-in gjithashtu sulmuan në mëngjes. Inteligjenca Britanike njoftoi se pajisjet sonore të nëndetëses TIRPITZ do të fikeshin për riparim gjatë mëngjesit të sulmit.

Në operacionet speciale armiku gjithmonë do të jetë në gatishmëri, por pyetja që shtrohet, është: kur do të jetë armiku më pak në gatishmëri dhe cila pjesë e ditës i leverdis më shumë forcave në sulm?

Çdo mbrojtje ka një pikë të dobët. Të arrish befasinë do të thotë të dish të shfrytëzosh atë dobësi. Edhe pse Vietnamezët e Veriut kishin rrjetin e mbrojtjes kundërajrore më të gjerë në Azi, Inteligjenca e Forcave Ajrore ishte në gjendje të gjente një boshllëk pesë minuta në ciklin e rotacionit të radarit. Kjo e lejoi C-130 dhe helikopterët të futeshin në *Son Tay*, në Veri të Vietnamit të pazbuluar (McRaven, 2008).

Një problem i ngjashëm u has nga britanikët gjatë Luftës së Dytë Botërore. *Royal Air Force* kishte bërë përpjekje të panumërta të fundoste luftanijen TIRPITZ nga ajri. Luftanija, e cila ishte ankoruar në *Kaa Fiord*, Norvegji, mbrohej nga bateritë kundërajrore dhe në sistemin e mbrojtjes së anijes që përfshiheshin gjashtëmbëdhjetë sisteme armësh 37 mm dhe tetëdhjetë armë 20 mm kundërajrore. Përveç kësaj, shumica e anijes ishte mbështjellë me blind 12 cm të trashë. Megjithatë, pika e dobët

e anijes ishte kuverta e saj. Ajo ishte “pjesa e butë” që britanikët zgjodhën për të sulmuar. Befasia u arrit nga dy nëndetëset (X-6 dhe X-7), kur ato depërtuan mbrojtjen gjermane dhe lëshuan eksplozivin e tyre. Në rastin e TIRPITZ-it, dobësia në mbrojtje ishte një term relativ. Gjermanët kishin mbrojtje nga nëndetëset dhe silurët, sidoqoftë, në krahasim me mbrojtjen e tyre kundërajrore, mbrojtja nga nëndetëset ishte dukshëm më e dobët. Shumë takticienë e konsiderojnë parimin e befasisë të jetë faktori më i rëndësishëm në një operacion special të suksesshëm. Ata gabimisht besojnë se është befasia ai element që u jep atyre përparësi vendimtare mbi armikun. Kjo është sikur të thuhet se thjesht duke e kapur armikun të papërgatitur, forcat sulmuese mund të fitojnë. Kjo nuk është e vërtetë. Befasia është e parëndësishme dhe vërtet e paarritshme pa ndërthurjen me parimet e tjera. Çfarë suksesi do të sillte befasia mbi armikun, nëse nuk do kishim në dispozicion pajisjet e duhura për ta luftuar atë? *Epërsia relative* fitohet vetëm përmes zbatimit korrekt të të gjitha parimeve. Befasia është thelbësore, por kjo nuk duhet të shihet si e vetme. Ajo është e vlefshme vetëm si pjesë e “piramidës së plotë” të parimeve.

5. Shpejtësia

Në misionet e Operacioneve Speciale, koncepti i shpejtësisë është i thjeshtë: “Afrohu në objektiv sa më shpejt që të jetë e mundur. Çdo vonesë do të zgjerojë zonën tuaj të cënueshmërisë dhe do të ulë mundësinë tuaj për të arritur *epërsi relative*!”

Manuali (FMFM) i Flotës së Forcave Detare 1-3 citon: “Si çdo gjë në luftë edhe shpejtësia është relative” (Departamenti i Marinës, FMFM Taktikat 1-3, fq. 63). Kjo deklaratë nënkupton se shpejtësia është e lidhur me aftësinë e armikut për të reaguar, në qoftë se armiku nuk është duke reaguar ndaj sulmit tuaj, atëherë kemi më shumë kohë për të kursyer. Kjo mund të jetë e vërtetë në luftën konvencionale, ku trupat e manovrës gjatë betejës veprojnë duke zbatuar përparime të caktuara taktike, por në operacionet speciale, armiku është në një pozicion mbrojtës dhe dëshira e tij e vetme është t’i kundërvihet sulmit tuaj. Prandaj, vullneti i armikut për të rezistuar ekziston dhe aftësia e tij për të reaguar është konstante. Si pasojë, me kalimin e kohës elementët e luftës funksionojnë vetëm kundër operacioneve të forcave speciale dhe jo armikut. Është e domosdoshme pra që të veprohet sa më shpejt të jetë e mundur, pavarësisht nga reagimi i armikut.

Për shembull, në dy rastet që përfshinin sulmin mbi nëndetëset, sulmi i britanikëve në TIRPITZ dhe sulmi italian drejtuar Flotës Britanike në Aleksandri, forcat sulmuese ishin krejtësisht të fshehta gjatë afrimit të tyre. Armiku nuk ishte në dijeni të pranisë së tyre dhe për këtë arsye nuk u përpoq t'i kundërvihej forcave sulmuese. Megjithatë, shpejtësia nuk ishte relative, ajo u bë një faktor kritik për suksesin e misionit. Nëndetëset, të cilat kishin kaluar përgjatë Atlantikut të Veriut dy ditë më parë, filluan të kishin probleme katastrofike në sistemet e tyre elektrike dhe balistike. Pas çdo minute që kalonte, balistika dhe gjendja fizike e nëndetëseve sa vinte dhe përkeqësohej. Koha u bë një faktor kaq vendimtar, aq sa komandanti i nëndetëses, togeri *Cameron*, vendosi të mos kalonte në mënyrë të fshehtë midis rrjetës antitorpedo, por të qëndronte në sipërfaqe dhe të bënte një goditje të çmendur kundër TIRPITZ-it. Ky veprim vinte në rrezik të madh suksesin e misionit, por *Cameron* e kishte kuptuar qartë se në ato momente, armiku i tij më i rrezikshëm ishte koha dhe jo gjermanët.

Zhytësit italianë, të cilët hynë në portin Aleksandria me silurët e drejtuar, ishin të ekspozuar në ujin e ftohtë. Ata e dinin se, nëse armiku nuk do t'i zbulonte, forcat e natyrës dhe lodhja fizike do t'i mposhte ata. Kështu, togeri *Durand De La Penne*, i cili u mbyll në luftanijen britanike HMS VALIANT, kujton: “.... jam torturuar nga etja ... Nuk mund të vazhdoja të punoja nga lodhja ekstreme dhe marrja e frymës”. Ai e dinte se “Shpejtësia ishte thelbësore. Nëse lodhja do ta detyronte të dilte në sipërfaqe, alarmi do të jepej, ngarkesat me lëndë plasëse do hidheshin dhe operacioni do të dështonte” (Botghese, 1954, 148). Por, togeri veproi shpejt dhe nuk u zbulua derisa doli në sipërfaqe. Disa orë më vonë, siluri shpërtheu dhe HMS VALIANT u mbyt në portin e Aleksandrisë. Në të dyja këto raste, armiku nuk ishte faktor, por përsëri koha ishte kundër një përfundimi të suksesshëm. Shumica e operacioneve speciale përfshijnë kontaktin e drejtpërdrejtë me armikun dhe në shumicën e rasteve kontakti i menjëhershëm është shumë i rëndësishëm, ku minutat dhe sekondat bëjnë dallimin mes suksesit dhe dështimit.

Nga misionet e suksesshme kam analizuar vetëm sulmin në *St.Nazaire*, që iu deshën më shumë se tridhjetë minuta për të arritur *epërsinë relative* nga Pika e

cënueshmërisë. Në shumicën e rasteve të tjera, *epërsia relative* është arritur në pesë minutat e para dhe misionet kanë përfunduar brenda tridhjetë minutash.¹

Në mënyrë që të fitohet befasia dhe shpejtësia, FS në përgjithësi janë të pakta në numër e të armatosur lehtë, për këtë arsye nuk janë në gjendje për të vazhduar veprimet luftarake kundër një force konvencionale për periudhë të gjatë kohore dhe një numri të madh kundërshtarësh. Sulmi në *St. Nazaire* ilustron problemet që lindin kur forcat speciale tentojnë të zgjasin luftimin. Kur numri i objektivave në *St Nazaire* u rrit nga 3 në 11, operacionit i nevojitej kohë shtesë në breg, që komandot të shkatërronin objektivat. Në një draft memorandum të shefave në Shtabin e Operacionit “*Chariot*”, këshilltari i operacioneve të përbashkëta deklaroi se për të arritur të gjitha objektivat, të gjithë trupave ... do t’ju nevojitej një periudhë maksimale prej 2 orësh në breg.⁵²

Avantazhi që komandot fituan nga befasia, e humbën gjatë zbatimit duke planifikuar një operacion prej dy orësh sulmi të vazhdueshëm. Kjo kërkonte që forcat e tyre të armatosura dhe në disa raste të paarmatosura të luftonin kundër Brigadës Gjermane të armatosur rëndë të përbërë prej 300 ushtarësh. *Clausewitz-i* paralajmëron: “sa më e kufizuar forca, aq më të kufizuara duhet të jenë qëllimet, më tej, sa më e kufizuar forca, aq më e kufizuar kohëzgjatja” (Clausewitz, 1976, 283). Prej më shumë se dy orësh, 18 motorët MLS, të cilët kishin dorëzuar komandën në *St. Nazaire*, ishin të ekspozuar ndaj zjarrit dhe brenda nëntëdhjetë minutash pothuajse të gjitha u shkatërruan. Ishte e domosdoshme që komandot të godisnin shpejt dhe të tërhiqeshin. Probabiliteti i suksesit të misionit do të ishte rritur në mënyrë dramatike. Shpejtësia është një funksion i kohës dhe jo një faktor relativ i ndikuar nga vullneti i armikut për të rrezistuar. Më poshtë, do përpiqem tu tregoj se *epërsia relative* mund të fitohet, pavarësisht përpjekjeve të armikut, edhe për shkak të forcave sulmuese që lëvizin me një shpejtësi të tillë, që e bën reagimin e armikut të mos jetë më faktor (McRaven, 2008).

1.Ka pasur disa raste, d.m.th. sulmi në Cabanatuan, kampi i të burgosurve të luftës, Sulmi në Son Tay dhe shpëtimi i Musolinit nga Skorzeny, ku misioni nuk quhej i përfunduar derisa kthimi të ishte i suksesshëm.

2.Memorandumi Sekret nga Këshilltari për Operacionet e kombinuara, Draft Memorandumi për Shefat e Shtabit". Operacioni “Chariot”.

6. Qëllimi

Qëllimi është të kuptuarit e misionit dhe më pas realizimi i objektivit kryesor, pavarësisht nga pengesat apo mundësitë. Së pari, qëllimi duhet të përcaktohet në mënyrë të qartë nga *misioni*, si psh: shpëtimi i të burgosurve të luftës, shkatërrimi i dokut, mbytja e anijes luftarake, lirimi i pengjeve, etj. Misioni duhet të jetë i hartuar në mënyrë të tillë që çdo ushtar duhet të kuptojë objektivin primar qysh në kulmin e betejës (faza e zbatimit). Për shembull, gjatë sulmit në luftanijen TIRPITZ, nëndetësja X-6 vuante nga difekte të shumta të pajisjeve (periskop sulmi i thyer, përmbytja e ngarkesave në anën e portit, rrjedhje në veshjen e jashtme të anijes dhe një anim prej pesëmbëdhjetë gradësh^o) dhe komandanti togeri *Don Cameron* duhej të merrte vendimin nëse do të sulmonte apo jo. Kishte shumë mundësi që duke sulmuar dhe dështuar ai mund të komprometonte suksesin e dy X-Crafteve të tjerë të caktuar për të sulmuar TIRPITZ-in.¹ Pas shqyrtimit të qëllimit të misionit të tij, siç ishte përcaktuar në urdhrin e tij operacional, *Cameron-i* vendosi të sulmojë. Urdhrat e tij ishin të qarta. Nëse ai ishte ende në gjendje të vendoste të paktën një ngarkesë, *Cameron-i* përfundonte misionin.

Gjatë sulmit të Flotës Britanike në portin e Aleksandrisë gjatë Luftës së Dytë Botërore, zhytësi italian, Kapiteni *Gunner Vincenzo Martellota* dhe partneri i tij *Mario Marino*, pozicionuan silurët e tyre poshtë kryqëzorit Britanik pa kuptuar se ai ishte objektivi i gabuar. Edhe pse rrezikuan jetët e tyre nga anijet roje, ngarkesat me lëndë plasëse në thellësi dhe fundosja e kryqëzorit do të kishin qenë të pranueshme, por ajo nuk ishte anija që ata ishin urdhëruar për të sulmuar. Më pas, *Martellota* u largua nga anija dhe vazhdoi më tej. Përfundimisht italianët e arritën objektivin e tyre, çisternën e naftës. Duke ndjekur urdhrat, *Martellota dhe Marino* jo vetëm fundosën një çisternë të madhe, por gjithashtu dëmtuan rëndë një destroyer aty afër. Në të dyja rastet si në atë britanike dhe italiane, ata i kishin urdhërat të përcaktuara qartë: të drejtonin veprimet e tyre në kulmin e betejës dhe të fokusonin përpjekjet në atë që ishte më e rëndësishme.

Aspekti i dytë i parimit të qëllimit është *angazhimi personal*.

Shembull tipik i angazhimit personal është Nën/koloneli *Henry Mucci*, i cili

1. X-10 e komanduar nga Toger Ken Hudspeth ishte caktuar për të sulmuar SCHARNHORST, një kryqëzor gjerman i vendosur vetëm një milje nga TIRPITZ. Hudspeth gjeti veten në vështirësi të ngjashme mekanike, por urdhrat ishin të qartë dhe e ndalonin atë për të sulmuar në qoftë se ky sulm do të vinte në rrezik shkatërrimin e objektivit primar - TIRPITZ.

komandoi Batalionin e 6-të *Ranger* dhe shpëtoi 512 të burgosur lufte nga një kamp vdekjeje japonez. Para operacionit ai u tha njerëzve të tij:

Ju më mirë uluni në gjuhë dhe lutuni! Dreqi ta hajë ... mos u shtirni! E kam seriozisht... LUTUNI! Dhe unë dua që ju të betoheni para Zotit ... Të betoheni se do të vdisni duke luftuar, sesa të lejoni rrezikimin e jetës të burgosurve të luftës! (Johnson, 1978, 171).

Në mënyrë të ngjashme, Gjenerali *Joshua Shani*, komandanti i ajrit gjatë operacionit në *Entebbe* deklaroi disa vite pas sulmit se ne ishim të angazhuar absolutisht në maksimum që të realizonim detyrën ... Ne ishin duke luftuar për Izraelin”. Parimi i qëllimit nuk duhet të ngatërrohet me faktorët moralë. Faktorët moralë ekzistojnë jashtë kufijve të kontrolluara të piramidës së përmbysur (siç është treguar në figurën 3-13), ato nuk mund të planifikohen ose të parashikohen; qëllimi i misionit duhet të kuptohet në tërësi paraprakisht dhe burrat duhet të jenë të frymëzuar me një ndjenjë të përkushtimit personal që nuk njeh kufizime.

Kapiteni SS *Otto Skorzeny* është shprehur: “Kur një njeri vepron me entuziazëm, pastër dhe me bindjen se ai është duke rrezikuar jetën e tij për një çështje të lartë ... ai jep elementët thelbësorë për sukses.” (Skorzeny, 24). Në epokën e teknologjisë së lartë dhe “Jedi Knights” shpesh vëmë re nevojën për përfshirjen personale, por e bëjmë këtë në rrezikun tonë personal. Siç na paralajmëron dhe *Clausewitz-i*: “Teoricienët janë të prirur të shikojnë luftën në konceptin e gjykimit të forcës, pa hyrë në emocion në të. Kjo është një nga një mijë gabime të cilat ata kryejnë me vetëdije, sepse nuk kanë asnjë ide të ndërlikimeve dhe pasojave” (Clausewitz, 1976, 138).

Parimet e operacioneve speciale të përcaktuara më sipër nuk janë thjesht një derivat i parimeve të luftës së ushtrisë. Ato përfaqësojnë elementë unike të luftës, që vetëm forcat jo konvencionale i zotërojnë dhe mund t’i përdorin në mënyrë efektive. Pjesa tjetër përshkruan metodologjinë e përdorur për të paraqitur këto parime dhe për të treguar që ato janë të vlefshme (McRaven, 2008).

2.3 Historiku i krijimit të Forcave Speciale

2.3.1 Rëndësia e Forcave Speciale

Disa historianë kanë pyetur vazhdimisht për rëndësinë e kontributit të përgjithshëm, të dhënë nga këto njësi relativisht të vogla, për arritjen e suksesit nga Forcat Aleate. Megjithatë, gjatë Luftës II Botërore, Forcat Speciale (FS) luajtën një rol të dukshëm në shkatërrimin e pikave jetësore të armikut. Gjatë viteve të acarta të fillimit të luftës, kur disfata e trupave britanike dukej e pashmangshme, repartet e FS, jo vetëm që lodhën dhe mundën forcat gjermane, japoneze dhe italiane, por gjithashtu arritën të dëmtonin një numër të madh të objekteve strategjike, për të pasuar më tej luftën. Duke ndjekur sulmin e Aleatëve mbi Normandi në Francë, në datën 6 qershor 1944, FS Britanike u dislokuan në ballë të operacioneve. Misioni i tyre ishte që të grumbullonin informacione, zbulonin terrenin dhe të përçanin vijat e mbështetjes së armikut. Oficeret vizionarë që krijuan këto reparte lanë një trashëgimi që ka rëndësi të jashtëzakonshme dhe sot e kësaj dite. Ata treguan rëndësinë e njërive të vogla, shumë të stërvitura, të pajisura mirë, të cilat dëmtonin objektiva me rëndësi strategjike (McManners, 2006, 31).

2.3.2 Historiku i krijimit të Forcave Speciale në botë

Ideja për krijimin dhe përdorimin e FS është aq e vjetër sa dhe vetë lufta. Ato ishin speciale sepse kishin stërvitje dhe pajisje superiore ose dhe për arsye se kishin shumë më tepër eksperiencë luftimi. Për këto trupa nuk kishte rëndësi se me çfarë ishin të pajisura me shtizë, shpatë apo mushqetë, elitat kishin një gjë të përbashkët: secila nga ato ishte njësi që luftonte e pavarur dhe ishin reparte që fitonin çdo betejë. Në Perandorinë Persiane (550-330 Para Krishtit), ekzistonte një njësi elitë që quhej *Të Pavdekshmit*, të cilët ishin dhe badiguardë të mbretit dhe në kohë lufte ishin reparti më kryesor i luftimit (McManners, 2006, 31). *Të Pavdekshmit* e morën emrin sepse mbaheshin në një sasi të pandryshueshme, rreth 10.000 luftëtarë kushdo që vritej në mënyrë të menjëhershme

zëvendësohej. Si shpërblim *Të Pavdekshmit*, ishin krejtësisht besnikë ndaj Familjes Mbretërore Persiane.

Në vitin 1184 PK, gjatë rrethimit të Trojës 50 luftëtarë helenë u futën së bashku me Odiseun e famshëm, brenda “Kalit të Trojës” si forcat speciale nga më të parat në botë dhe bënë të mundur marrjen e qytetit të Trojës, qytet të cilin po e merrnin prej shumë kohësh (Dupuy, 1980). Në Romën e Lashtë (280 PK-AD 476), *Rojet Pretoriane* të cilët mbronin qytetin, u bënë badiguardët e Perandorit. Megjithatë, ky repart u dobësua kur filloi që të përfshihej në politikë. Së bashku me rënien e Perandorisë Romake, ra dhe ky repart. Gjatë kësaj periudhe kohe në të gjithë Europën, mbretërit kishin repartet e ruajtjes së tyre personale dhe ideja për forca elitë u neglizhua. Vetëm në shekullin e 13-të dhe të 14-të, repartet elitë filluan të dukeshin përsëri në Europë. Zvicëranët krijuan reparte këmbësorie të njohura si heshtarët, të cilët përdornin heshtat dhe shpatat për të fituar betejat (Dupuy, 1980, 24). Në atë pjesë territori që sot quhet si Turqi, turqit otomanë formuan *Jeniçerët*, një njësi elitë e përbërë nga 12.000 burra. Fillimisht u krijuan nga Sulltan Mehmeti, në vitin 1326 dhe shërbyen si rojet e tij. Ata fillimisht ishin të burgosur të marë me forcë nga tokat dhe familjet e tyre, origjina e tyre ishte katolike, ishin shumë të stërvitur për luftë që kur ishin fëmijë (rasti i Gjergj Kastriot-Skënderbeut) (Turkish Ozel Kuvvetler, 1995, 54). Ata qëndruan si pjesa më vitale e ushtrisë perandorake, Osmane, deri në kolapsin e kësaj perandorie në vitin 1923.

2.3.3 Forcat Speciale (FS) në shekullin e 19-të

Në shekullin e 19-të, *Rojet Perandorake* të Napoleon Bonapartit (1769-1851), perandorit francez, ishin të ndryshëm nga *Të Pavdekshmit* e Persisë. Ata u përdorën vazhdimisht në vitet 1813-1814 në betejat kundër prusianëve dhe rusëve. Në të gjitha rastet *Rojet e Perandorake* vulosën fatin e fitoreve. Megjithatë edhe kjo lloj elite nuk mund të parandalonte humbjen fatale të Napoleonit në Waterloo, Belgjikë, në vitin 1815. Në mesin e shekullit të 19-të natyra e FS ndryshoi. U shfaqën reparte më të vogla, me më pak formacione luftimi (McManners, 2006, 18). Në luftën Civile Amerikane (1861-1865), konfederatat rritën numrin e formacioneve sulmuese siç ishin *Renxhërsat*, të cilët vepronin prapa

vijave të Unionit dhe sulmonin hekurudhat dhe depot e furnizimit. Nga të dyja anët, u dislokuan snajperë për të asgjësuar armikun dhe për të ulur moralin e tij. Taktikat e snajperëve u përdorën gjithashtu dhe gjatë luftës së Boerit në Afrikën e Jugut (1899-1902), një konflikt që u zhvillua ndërmjet holandezëve që kishin tokat e tyre atje dhe pushtuesve anglezë që drejtonin koloninë. Komandot e Boerit ishin snajper ekspertë dhe ngarës të shkëlqyer kuajsh, por patën shumë të vrarë si rezultat i numrit të madh të ushtarëve anglezë. Taktikat “*godit dhe largohu*” u përdorën më vonë me shumë efektivitet nga takticienët ushtarakë gjermanë dhe u përdorën në mënyrë shkatërruese gjatë Luftës I Botërore.

2.3.4 Lufta I-rë dhe e II-të Botërore

Gjatë Luftës I-rë Botërore Kolonel Bassi, pjesëtar i ushtrisë italiane formoi batalionin e 27-të të quajtur “*Repartet e sulmit*” i cili njihej me emrin Arditi. Ata njerëz ishin ngarkuar të realizonin detyra taktike të ndryshme dhe kishin si mision primar sabotimin e mbrojtjes së armikut, duke lehtësuar ecjen përpara të trupave të këmbësorisë. Ndërtimi i një strukture të tillë ushtarake ishte një risi, pasi deri në atë kohë ishte vepruar dhe luftuar në mënyra tradicionale, me pozicione fikse. “*Arditi*” nuk konsiderohej si një trupë këmbësore, por ishte e organizuar si një njësi e re, e cila i'u nënshtrua një stërvitje shumë të veçantë dhe u pajis me armatim special dhe modern. Ata ishin disa nga njerëzit e FS që mund të konsiderohen pa frikë nga të parat e llojit të tyre. Në anën gjermane, suksesi i ofensivës së Pranverës, reflektoi suksesin e pjesëmarrjes së trupave që kishin kryer një stërvitje speciale dhe që quheshin *Sturmturppen*. Teknikat e infiltrimit dhe të luftës që ata përdorën, suksesi i tyre, i bënë automatikisht të krahasueshëm me FS të kohës së sotme (Enciklopedia e FOS, 2009, 15). Në vitin 1917, Lufta I-rë Botërore, në Frontin Perëndimor, në Veri të Francës dhe Belgjikës, kishte arritur në rrugë pa krye. Trupat gjermane përballeshin me aleatët (në mënyrë të veçantë me francezët dhe anglezët) në një betejë në terren të hapur, duke përdorur artilerinë nga vijat e fortifikuara me hendeklidhje. Të dyja anët përdorën sasi të mëdha artilerie dhe njerëzish, me qëllim që të zaptonin vijat e kundërshtarit. Rezultatet qenë katastrofike, psh: në betejën e Ypresit në Belgjikë, e cila filloi më 15 Qershor të vitit 1917, me një bombardim masiv me artileri, komandanti anglez, *Sir Douglas Haig*

(1861-1928) shpresonte që të shtynte pozicionet gjermane deri në gjunjëzim. Por, pas një farë kohe, beteja u ndalua nga fundi i Tetorit, ku 400.000 ushtarë të Aleancës dhe 270.000 gjermanë ishin vrarë për vetëm pak tokë të pushtuar (I-st World War, volum 3, 231). Të dyja anët kishin nevojë për të ndërprerë rrugët qorre, por nevoja e gjermanëve që më e madhe sepse Marina Mbretërore Angleze, po po ju pengonte gjermanëve furnizimin me ushqime dhe materiale logjistike, aq të nevojshme për vazhdimin e luftës duke ju mbytur anijet. Në këtë situatë liderët ushtarakë gjermanë gjetën një përgjigje taktike. Zgjidhja duket se u gjet në përdorimin e trupave sulmuese, reparteve të këmbësorisë elitë që mund të sulmonin shpejt në vende që ishte e vështirë të kaloheshin nga ushtarët e tjerë dhe të sulmonin në befasi armikun.

Lufta duke përdorur Trupat Sulmuese

Taktika të reja u përdorën në Shtator të vitit 1917 në Frontin Lindor, atje ku gjermanët u përballën me rusët (McManners, 2006, 23). Të krijuara nga Gjenerali Gjerman *Oskar von Hutier* (1857-1934), bazat e taktikave të trupave sulmuese ishin të përbëra nga formacione të vogla togash dhe skuadrash. Po ashtu si FS të kohëve moderne, secila skuadër vepronte e pavarur nga tjetra për të gjetur pika të pambrojtura mirë nëpër prapavijat e armikut, duke ruajtur momentin dhe avancimin. Prapa tyre, me shpejtësi vinin trupat e tjera që përforconin fitoren e tyre dhe mbanin pozicionet e kapura. Gjatë muajve të Dimrit të vitit 1918-1919, gjermanët krijuan 40 batalione sulmuese. Ato, fillimisht, u përdorën në *Flanders* në Veri të Francës, në Mars të vitit 1918 dhe arritën suksese spektakolare, duke u futur ndërmjet vijave të pambrojtura mirë të Aleancës. Megjithatë, gjermanët e kishin të pamundur që të përdornin mbështetjen me artileri dhe dërgimin e përforcimeve të vijave të kapura për të finalizuar fitoren. Me fillimin e ofensivës në muajin Gusht, shumica e trupave sulmuese gjermane u asgjësua.

2.3.5 Lufta II-të Botërore, FS Britanike

Historia e FS Britanike është një nga aspektet më dramatike të Luftës II-të Botërore. Krijimi i këtyre forcave elitë ishte një shembull i fuqishëm i krijimit të diçkaje

që rezultoi shumë e suksesshme gjatë luftës dhe pas saj, deri në ditët e sotme. Gjatë kohës që britanikët luftonin që të gjenin një mënyrë për të goditur nga prapa forcat gjermane dhe japoneze, në fillim të viteve të luftës, repartet speciale si *Komandot e Marinës Mbretërore* realizuan sulme mbi objektivat e rëndësishme të armikut. Ndërkohë që lufta vazhdonte, FS Britanike luajtën një rol dhe më të rëndësishëm në shkatërrimin e urave, hekurudhave, depove të mbështetjes logjistike, qendrave të kërkimeve strategjike dhe instalimeve të tjera të rëndësishme ushtarake gjermane dhe japoneze.

Fillimi i Forcave Speciale moderne

Në fakt, FS angleze u krijuan nga repartet ekzistuese të ushtrisë angleze gjatë luftës. *Shërbimi Special Ajror (SAS)* u krijua në vitin 1941 nga një ofi skocez, N/kolonel *David Stirling*. Ai, fi shërbeu si një repart *Komando* në Afrikën e Veriut. N/kolonel *Stirling*, në mënyrë të veçantë, pa si shumë të rëndësishme potencialin për përdorimin e operacioneve speciale në prapavijat e armikut. Ai e kuptoi shpejt se një grup i vogël, i stërvitur shumë mirë, me ushtarë të motivuar, mund të futej në prapavijë të fronteve dhe bazave gjermane të mbështetjes dhe të shkaktonte uljen e moralit të tyre, duke i dëmtuar në vazhdimësi. Praktika tregoi se ai kishte patur të drejtë. Duke punuar me *Grupin e Shkretëtirës së Distancave të Largëta (LRDG)*, të cilët siguronin transport dhe ndërlidhje, SAS-i sulmoi aeroportet gjermane duke shkatërruar shumë avionë në tokë. Më vonë, SAS-i “shpiku” përdorimin e *Jipi-t* me dy mitraloza 12.7 mm të vendosur mbi të. Përdorimi i këtyre *Jip-ave* për taktikat “*godit dhe largohu*”, për të cilat SAS-i është i specializuar ngushtë, solli avantazhe të mëdha. Po ashtu gjatë Luftës së Dytë Botërore, mjafton të përmendim shkatërrimin e “*Heavy Water-it (Ujit të Rëndë)*” të faciliteteve gjermane që punonin për prodhimin e bombës atomike, të cilin aleatët nuk kishin arritur ta shkatërronin dot me anë të bombardimeve dhe që përbënte një rrezik të madh për ta, nëse nazistët do të krijonin këtë armë në vitin 1943. Ky mision u realizua me sukses nga 9 FS norvegjeze të cilët ishin të trajnuar nga Forcat Komando Angleze. Ky mision dëshmoi sukses që në fazën e depërtimit, shkatërrimit dhe largimit pa humbje dhe dëmtime. Mision tjetër i suksesshëm ishte dhe përdorimi i forcave SAS angleze

për shkatërrimin e avionëve nazistë gjatë Luftës së Dytë Botërore. Përveç SAS-it, një tjetër repart u krijua. Ai njihej me emrin *Skvadroni Special i Anijeve* (SBS), një degë e *Marinsave Mbretërorë*. Ky repart ishte i specializuar për operacione detare, duke përfshirë dhe sulmin e anijeve armike dhe bazave detare. Forca të tjera Speciale u krijuan gjatë Luftës së II-të Botërore, përfshirë këtu *Regjimentin Anglez të Parashutistëve* i cili u krijua si kundër peshë e *Parashutistëve Gjermanë* dhe ishin të dislokuar në të njëjtat linja si ata. Në Azi, në luftë kundër Japonezëve, trupat çinditse, nën komandën e Gjeneralmajor *Orde Wingate*, luajtën një rol të madh në fushatën britanike të Burmës. Përveç këtyre, u krijuan dhe reparte të tjera speciale si psh: *Austalianët* krijuan vëshguesa të bregdetit të cilët grumbullonin inteligjencë mbi lëvizjet e anijeve japoneze.

Operacione Elitë të Shquara

Shumë nga operacionet e shquara në luftë janë ndërmarrë nga FS. *Komandot Britanike* sulmuan, në vitin 1942, portin gjerman në *Sant Nazaire* në Francë, mision në të cilin u shkatërrua doku i portit dhe mospërdorimi i saj nga anija gjermane *Tirpitz*. Plani ishte që të përplasej dhe të shkatërrohej dokun, duke e maskuar anijen *HMS Campbeltoun* si anije gjermane, e cila ishte e mbushur me eksploziv. Operacioni ishte një sukses i plotë. Doku u prish aq shumë saqë nuk u përdor më kurrë gjatë luftës, por ky mision shkaktoi humbjen e 64 trupave britanike. *Komandot e Marinës Mbretërore* morën gjithashtu pjesë në një sulm në portin Francez të Bordosë, në muajin Dhjetor të vitit 1942. Një grup prej 10 komandosh, në kanoe dyshe, vozitën 56 km, brenda në port dhe nën hundën e garnizonit gjerman vendosën mina në një numër anijesh poshtë tyre. 5 anije u dëmtuan shumë, të cilat më vonë dhe u mbytën. Ai person që mori pjesë dhe e drejtoi këtë sulm mori emrin si “*Njeriu guackë molusku*”, pas vozitjes së kanoeve të përdorura në sulm. *Regjimenti i Parashutistëve* ka qenë gjithashtu i përfshirë në një numër operacionesh të shquara gjatë Luftës II-të Botërore. Megjithëse Regjimenti u krijua në fi të luftës, ai u rrit dhe arriti të bëhej një repart shumë i fuqishëm luftimi.

Regjimenti i Parashutizmit u përfshi në një sulm mbi instalimet gjermane të

radarëve në Buneval, Francë, në Shkurt të vitit 1942. Duke u hedhur me parashutë natën mbi dëborë, reparti i drejtuar nga Major *John Frosti* vodhi me sukses pajisjet *top secret* të radarëve gjermanë dhe u evakuua nga deti. 3 parashutistë u vranë gjatë sulmit dhe 6 u kapën të gjallë. Parashutistët britanikë morën pjesë në sulmin e Aleatëve mbi *Arnhem* të Holandës, në Shtator të vitit 1944. Misioni i tyre ishte që të kapnin urën me rëndësi të madhe mbi lumin Rin dhe të lejonin kolonat e tankeve dhe të trupave aleate që të kalonin në mënyrë të sigurtë në Gjermani. Forcat Aleate e mbajtën urën për disa ditë me radhë, duke përballuar me sukses sulmet dhe kundërsulmet e gjermanëve, derisa u detyruan të tërhiqen. Në këtë betejë u përfshi një forcë totale prej 10.000 ushtarësh, nga të cilët 1.200 u vranë dhe 6.642 u kapën rob.

Forcat Speciale Gjermane

Blitzkriegu Gjerman kishte si qëllim që të fitonte fushatat me veprime të shpejta dhe vendimtare. Me kombinimin e fuqisë së pakalueshme (tankeve, artilerisë dhe mbështetjes nga ajri) me lëvizje të shpejta të përparuara, forcat gjermane do të mundnin, si fillim, t'i rrethonin dhe pastaj t'i asgjësonin forcat armike. Për të realizuar këtë ata kishin nivel të lartë stërvitjeje, koordinim të mirë të burimeve në fushëbetejë dhe përdorim efektiv të FS. Paraardhësit e vërtetë të reparteve të sotme të FS ishin *Brandenburgersat*, trupa gjermane komando, të stërvitura në mënyrë speciale. Duke vepruar me grupe të vogla, shpesh në fshehtësi të plotë, në mënyrën më sekrete, ata hynin në territorin e armikut dhe kapnin objektiva kyç të tij. Në muajin Maj të vitit 1940, trupat *Brandenburgersat*, të veshur si ushtarë të ushtrisë Holandeze, infiltruan nga Gjermania në Hollandë dhe kapën një urë me rëndësi strategjike mbi lumin *Mouse*, në mënyrë që t'i krijonin mundësi tankeve gjermane të kalonin për pushtimin e Holandës.

Diktatori gjerman *Adolf Hitler* (1889-1945), një veteran i Luftës I-rë Botërore, urdhëroi me shpejtësi krijimin e grupeve speciale dhe dërgimin e trupave parashutiste në prapavijat e armikut nga ajri, duke shmangur luftën në fortifikata, të cilën e pati vuajtur vetë. Pa filluar lufta, në Shtator të vitit 1939, ai kishte të gatshëm *Divizionin e 7-të Parashutist*, krejtësisht të stërvitur. Efektshmëria e tyre u provua në Maj të vitit 1940, kur parashutistët e tij kapën në Belgjikë, fortesën e *Eben Emaelit* dhe në urat

kyçe afër Roterdamit në Holandë (Skorzeny, 1950, 71). Komandanti më i spikatur dhe themelues i Forcave Speciale Gjermane ishte N/kolonel *Otto Skorzeny*, një ushtarak SS. Në datën 21 Tetor 1944, Hitleri i frymëzuar nga një veprim i ushtrisë amerikane, ku 3 tanke të kapura gjermane i përdorën për të shkatërruar Aachen, udhëroi N/kolonel *Otto Skorzenyn* që të ndërtonte një brigadë të korracuar sabotimi. Ai planifikoi një sulm, ku morën pjesë 12 persona ku shumica përdorte makina të cilat u ishin kapur amerikanëve. Ata u veshën si pjesëtarë të ushtrisë amerikane dhe u infiltruan pas prapavijës së armikut, në betejën e Bulge-s në Francë, duke shkaktuar shkatërrime, sabotime dhe ç'oroditje në prapavijën e forcave aleate. Në këtë mënyrë ata ai arritën qëllimin, pasi tërhoqën vëmendjen mbi to, duke e larguar nga fronti. Vetëm njeri prej pjesëmarrësve në këtë operacion u kap i gjallë nga forcat aleate dhe pati zëra që thonin se N/kolonel *Otto Skorzeny* do të udhëtonte drejt Parisit për të vrarë ose për të kapur të gjallë Gjeneralin Aizenhauer (Enciklopedia e FOS, 2009, 16). Edhe pse kjo mund të ishte e tëra një sajesë, Aizenhaueri u mbyll nën masë të larta sigurie, në komandën qëndrore për javë të tëra. Ai kreu disa nga operacionet speciale më të rëndësishme gjatë Luftës II-të Botërore si shpëtimin e liderit italian *Benito Mussolini*, nga partizanët italianë, në hotelin *Gran Sasso*, Itali, në vitin 1944, në krye të një grupi specialësh gjermanë, rrëmbeu djalin e Admiralit Hungarez *Miklos Horthy*, duke shkaktuar dezertimin e tij nga Aleatët. Operacion tjetër ishte dhe kundër ofensiva mbi Trupat Aleate, në vitin 1944 ku ai me një grup specialësh gjermanë anglishtfolës, të veshur si ushtarë amerikanë, shkaktuan shumë dëme në prapavijat e armikut. Një nga operacionet e tjera speciale i quajtur Operacioni “Teodor” që mori detyrë N/ kolonel Skorzeny, ishte dhe vrasja e Mareshallit Tito, e cila nuk u realizua dot. Por pas tij kjo detyrë iu ngarkua një hollandezi *Andreas Engvirdo*, të cilin Tito duhet që ta priste në takim, por ai u kap në Mostar të Bosnjës dhe nuk e realizoi dot atë (Skorzeny, 1950, 92). N/ kolonel *Otto Skorzeny* u cilësua në atë kohë dhe u klasifikua si njeriu më i rrezikshëm në të gjithë Europën (Enciklopedia e FOS, 2009, 16).

Forcat Speciale Amerikane

Gjatë Luftës II Botërore, FS Amerikane u krijuan me qëllim kryerjen e operacioneve speciale. Mënyra se si ato u krijuan ishte në vartësi të betejave që u zhvilluan në Paqësor dhe në Europë. Ato që u përdorën në Europë, u dislokuan në avancë të territorit armik dhe të kombinuar me përdorimin e forcave amfibe, me qëllim që të përcanin linjat e furnizimit të armikut dhe të shkatërronin objektivat kyçe të tij si psh: urat. *Renxhërsat* e ushtrisë amerikane dhe *Divizioni 82* dhe *101 Parashutist* kryhen misione të tilla. Major *William Darby* (1911-1945) krijoi një forcë *Renxhërs* të stilit komando, prej 520 vetësh. Në Itali, ata përdorën aftësitë e tyre në stërvitjen alpine për neutralizimin e pozicioneve të gjermanëve, në datën 6 Qershor të vitit 1944. *Renxhërsat* zbarkuan në brigjet e Normandisë dhe ngjitën shkëmbinjtë vertikalë për shkatërrimin e baterive të armëve gjermane që mbronin brigjet. *Forcat Parashutiste Amerikane* ishin elita tjetër që u përdor me sukses në Europë. Ata i mundësuan komandantëve të Aleatëve që të zbarkonin një forcë kryesore prapa frontit armik.

Dy operacionet speciale më kryesore të parashutistëve ishin hedhja mbi Francë dhe e *Divizionit 101 Parashutist*, mbrojtja e Bastanjës, Belgjikë, në Dhjetor të vitit 1944 (McManners, 2006, 34). Në të dyja rastet, parashutistët luftuan heroikisht kundër përpjekjeve për krahë marrje të armikut. Në pjesën tjetër të botës, në zonën e Paqësorit, roli i tyre si FS ishte që të depërtonin thellë prapa vijave të kundërshtarit, me qëllim grumbullimin e informacioneve të inteligjencës ose për sulmin e objekteve të caktuara me rëndësi të madhe strategjike. Sulmuesit e *Korpusit të Marinës Amerikane* kryenin misione speciale që kishin të bënin me lëvizjet e anijeve dhe të trupave të armikut. Ata mund të mbijetonin për javë të tëra, duke sulmuar hekurudhat dhe kampet ushtarake japoneze, përpara se të shkonin prapë në xhungël. Sulmuesit e Marinës fshiheshin në ishujt e Paqësorit të Guinesë së Re dhe të Guadalit. Ushtria Amerikane kishte repartin e vet të FS në "*Merril Maraudersit*" të cilat e morën emrin nga lideri i tyre Brigadier Frank Merrill (1903-1950). Ata ishin një forcë vullnetare, e përbërë nga 3.000 ushtarë të stërvitur në mënyrë të veçantë, për misione të distancave të largëta kundër vijave të komunikimit dhe mbështetjes së japonezëve, gjatë fushatës së Burmës. Reparti udhëtonte në distanca të mëdha përmes xhunglës, duke i shkaktuar humbje të mëdha armikut. Me trimëri dhe

vetëbesim, elitat e FS amerikane në Europë dhe Paqësor, avancuan deri në fi përfundimtare të Aleatëve.

Forcat Speciale Ruse

Gjatë Luftës së II-të Botërore (1939-1945), kundër pushtimit Gjerman grupe specialistësh luftëtarësh Rus si “Desantikët” dhe “Rekjavikët”, u stërvitën që të organizonin luftën në paravijë të trupave gjermane, të grumbullonin informacione për dislokimet e forcave të tyre, të kryenin operacione sabotazhi dhe të hidhnin në erë shinat dhe vagonat e trenit, të cilat furnizonin makinerinë gjermane për vazhdimësinë e luftës, etj. Spetsnaz është shkurtimi për “Yoiska Spetsialnoye Nasranie” një shkurtim në rusisht që nënkupton “trupa për qëllime speciale”. Këto trupa u formuan në fillim të viteve 1945 gjatë luftës së ftohtë (1954-1990). Spetsnaz GRU janë specialët e ushtrisë ruse dhe konsiderohen si më të mirët e FS Ruse. Megjithatë ata nuk janë shumë të ngjashëm me FS amerikane. Kanë një reputacion në tërë botën si të pathyeshëm. Suksese i tyre është i bazuar krejtësisht tek stërvitja e tyre jashtëzakonisht e vështirë. Janë të kontrolluar nga GRU (agjensia ushtarake e inteligjencës) . Njësitë e këtyre forcave nuk kanë emra por vetëm numra. Ato hera-herës kanë shkrirje në strukturat normale të FA, por dihet se janë të përfshirë gjerësisht në operacionet e kryera si në Afganistan, Çeçeni dhe në Siri sot. Kanë uniformë dhe beretë karakteristike me ngjyrën blu dhe shenja dalluese kursesh të veçanta. Spetsnaz ky është termi në Rusisht për emërtimin e tyre. Emërtimi Spetsnaz mund të përdoret për të tëra ato forca elitare që kontrollohen nga FSB (Byroja Federale e Sigurisë) dhe që kanë mision aksionet anti-terrorizëm.. Të gjitha njësitë Spetsnaz që operonin për KGB-në dhe FSB-në quheshin me emrin Osnaz, një akronim që përdorej për të klasifikuar ato trupa që kryenin operacione tepër sekrete. Këto njësi ishin të orientuara për të vepruar në operacionet kundër terrorizëm, në situata tepër sekrete, etj. Sot termi Oznas është një term që përdoret më shumë në terminologjinë e radiozbulimit (Hitoaliaj, 2009). Spetsnazët filluan të dislokoreshin në Afganistan në 10 Dhjetor 1979 në bazën ajrore strategjike të Bagram- it në Veri të kryeqytetit Kabul. Këta ushtarë së bashku nga repartet e Divizionit 105 të Parashutistëve Roje morën për rreth dy javë qytetin e Bagramit, duke lëvizur në drejtim të jugut dhe marrë Aeroportin ndërkombëtar të Kabulit në datën 24 Dhjetor

1979. Kjo datë sinjalizoi dhe fillimin e pushtimit sovjetik të Afganistanit. Forcat Spetsnaz në vazhdimësi kapën instalimet kryesore siç ishin bazat strategjike ajrore të Shindandit dhe Kandaharit. Kapacitet të lartë treguan në datën 25 Dhjetor 1979 me operacionin e bujshëm për vrasjen e Presidentit të Afganistanit Hafizullah Amin, i cili u ekzekutua me të gjithë familjen dhe stafin e tij (McManners, 2003, 84). Që nga Janari i vitit 1980, sovjetikët morën të gjithë Afganistanin, por shumë shpejt u ndeshën me një luftë guerrile të paparë deri atëherë, me një efektivitet të lartë nga fraksionet pro-islamike Muxhahedine. Roli kryesor i Spetsnazëve gjatë kësaj lufte ishte shkatërrimi i pikave të forta të muxhahedinëve dhe bazave të tyre në male dhe shpella, të cilat përgjithësisht ishin të suksesshme.

Forcat Speciale Izraelite (1945-1980)

Fillimisht u krijuan në vitin 1920 që të mbronin Çifutët në Palestinë nga sulmet e arabëve, ku numri i tyre ishte shumë më i vogël, në krahasim me numrin e arabëve. Nga viti 1920-1945, Palestina ishte nën mandatin e Anglezëve. Gjatë kësaj periudhe në mënyrë të vazhdueshme arabët dhe çifutët luftonin njëri-tjetrin në mënyrë të vazhdueshme. Anglezët kryesisht mbanin anën e arabëve dhe vetëm ata ishin lejoreshin që të mbanin armë, çifutët jo. Si rezultat i kësaj çifutët në mënyrë të fshehtë krijuan një lëvizje rezistence që ti rezistonin sulmeve terroriste arabe dhe të detyronin anglezët që të iknin nga Palestina. Lëvizja më e madhe e fshehtë dhe më e fuqishmja ishte “Hagana-defense”. Në vitin 1941, Hagana formoi kompanitë Smash “Palmach” të cilat ishin dhe grupet e para të FS. Bashkë me Palmach-in vepronin dhe grupet shumë të fshehta “Mistaravim” të cilët visheshin si arabë dhe në mënyrë të fshehtë lëviznin armatimin dhe municionet (McManners, 2003, 40). Palmachu kryente misione në tokë, kurse Hagana realizonte misionet në det. Kështu në vitin 1943, Hagana formoi kompaninë detare Plugot Hayam-Palyam. Ajo kishte si mision të kryente misione shpërthimi nën ujë dhe aktivitete në det. Në vitin 1948, kur u formuan Forcat e Mbrojtjes Izraelite (IDF) formuan një lëvizje rezistence të gjitha së bashku. Palyami u quajt Sayetet 13 (Flotilia e 13-të speciale). Një nga njësitë e Haganas u quajt brigada “Golani e këmbësisë”. Kur shteti i Izraelit u shpall ndërkombëtarisht në vitin 1948, u krijuan togat e zbulimit special. Më pas në vitin 1950, kur shtetet Arabe lëshuan me qindra

sulme kundër Izraelit ata krijuan repartin 30, 101 të cilat ishin të përbëra nga 25 vetë shumë të stërvitur. Në vitin 1956, 395 parashutistë Izraelitë me 16 avionë u hodhën në Mitla Pass dhe në shkretëtirën e Sinait dhe e mbajtën atë për kohë të gjatë kundër sulmeve të fuqishme të një numri shumë të madh luftëtarësh arabë. Në vitin 1960 dhe deri më sot, FS Izraelite janë kthyer në një forcë fituese kundër terroristëve arabë dhe janë nga FS më të mira në botë në ditët e sotme. Elita e ushtrisë izraelite është reparti “Sayeret Matkal” i cili u themelua në vitin 1975 nga Avraham Arnani, i cili ishte një student për rabin dhe ish luftëtar i Palmach-ut, i cili konsiderohet dhe si komandoja i parë izraelit. Fillimisht ishte pjesë e Njësisë Aman-157, por një vit më vonë filloi të operojë në mënyrë të pavarur në vartësi të Shtabit të Përgjithshëm. Pjesëtarët e njësisë u trajnuan nga ndjekësit beduinë, për të perfeksionuar mënyrën e të sjellurit, pamjen dhe mënyrën e mendimit, që të ngjanin sa më tepër me atë arabe. “Sayeret Matkali” u krijua një vit më vonë pas formimit operacional të skuadriljes së parë të helikopterëve dhe bashkëpunimi i ngushtë i tyre, mundësoi që reparti të hynte më në thellësi dhe me kohëzgjatje më të madhe në territoret e armikut. Në vitin 1959, një rekrut i ri u pranua në njësi. Ai quhej Ehud Barak dhe një vit më vonë do të kishte shumë sukses me repartin “101 Komando”, më vonë ai do të bëhej ushtari më i dekoruar i Izraelit. Me “Sareyet Matkalin”, Ehud Baraku do të drejtonte shumë operacione si në shpëtime pengjesh në avionë në vitin 1972, operacionin Isotope dhe në Liban në vitin 1973, duke qënë dhe SHSHP i Izraelit deri në vitin 1995. Në vitin 1999 ai u bë Kryeministri i 10-të i Izraelit.

Forcat Speciale Amerikane në Kore (1945-1960)

Dy faktorë kryesorë detyruan zhvillimin e reparteve të FS, gjatë luftës në Kore (1950-1953). *Së pari*, bregdeti korean i cili shtrihet në 1.600 km gjatësi dhe zbulimi i bregdetit mund të bëhej vetëm nga njësi speciale amfibe. *Së dyti*, partizanët që vepronin prapa në thellësi të territorit, kërkonin operatorë specialë për të koordinuar përpjekjet e tyre me veprimet e Kombeve të Bashkuara. *Grupet e Reparteve të Shkatërrimit Nën ujë* (Seals) ishin ekspertë për kryerjen e operacioneve speciale nën ujë, për grumbullimin e informacionit afër brigjeve dhe në bregdet, për heqjen e pengesave dhe infiltrimet nën ujë. Vetëm 11 persona të tillë kishte aktivë (të gatshëm për operacione) në vitin 1950 komanda e forcave detare amerikane, por shpejt numri i tyre u rrit në 300 vetë. Po

ashtu një detyrë kryesore e tyre ishte dhe hedhja në erë e rrugëve shkëmbore, tuneleve, urave, por gjithashtu ata bënë dhe zbulime hidrografike për matjen e thellësive të brigjeve në Inçon, vend i cili u përdor për zbarkimin e një sasie të madhe anijesh dhe repartesh Amerikane në Shtator të vitit 1950, nën hundën e armikut. Grupet Seals nuk ishin të vetmit FS amfibe që vepronin në Kore. Në 5 Qershor të vitit 1950 u krijua Kompania I-rë e Sulmuesve (GHQ). Misioni i saj ishte sabotazhi, zbulimi dhe sulmet në prapavijë të armikut. Aksioni i saj i parë ishte në 12 Shtator të vitit 1950 në plazhin e Kunsanit. Specialët realizuan një sulm amfib, me qëllim mashtrimin e armikut nga planëzimi i zbarkimit në Inçon për datën 15 Shtator. Një shkëmbim zjarri filloi si pasojë e të cilit humbën jetën 3 specialë, por Kompania mori pjesë në zbarkimin e Inçonit 3 ditë më pas, duke asistuar në sulmin kundër një fushe aviacioni të avionëve armiq.

Forcat Speciale të kohëve moderne

Koncepti për operacionet speciale nga forcat që kryejnë këto lloje operacionesh është përfshirë në mënyrë të rëndësishme për më shumë se 3 dekadat e fundit. Në shumë shembuj, operacione të tilla janë kryer me shumë sukses por dhe disa të tjera kanë dështuar, të cilat kanë shërbyer si katalizatorë për këto ndryshime. Për shembull, viti 1980 dëshmoi suksesin e padiskutueshëm të SAS-it Anglez në ambasadën Iraniane në Londër dhe dështimin e Delta Forcës në misionin në Iran për shpëtimin e pengjeve amerikane të mbajtura peng për një kohë të gjatë në Teheran. Prej më shumë se 15 viteve të fundit FOS (Forcat e Operacioneve Speciale) të NATO-s kanë qenë dhe janë të angazhuara në mënyrë të vazhdueshme, në ekspedita operacionale në zona gjeografi me interes ekonomik dhe politik të vendeve të tyre si në Ballkan, Afrikë, Irak, Siri, Jemen, Nigeri dhe Afganistan. Këto reparte FOS kanë qenë shumë të suksesshme duke realizuar me sukses një gamë të gjerë misionesh, në mënyrë të njëanshme, ose në kombinim me FOS të shteteve të tjera, nën rrethana të paparashikuara në kohën kur këto reparte ishin krijuar, stërvitur, pajisur si asete strategjike kombëtare për t'u përdorur gjatë Luftës së Ftohtë. Ajo që është më e rëndësishme është se repartet FOS i realizuan këto misione duke përdorur

ad hoc me t'u dislokuar në terren dhe jo nëpërmjet marrëveshjeve të koordinuara për ndërveprueshmëri.

Gjatë këtij procesi ata mësuan një gjë shumë të rëndësishme rreth asaj se si të veprojnë më me efektivitet së bashku, si elementë të përbashkët (kombëtar) dhe me njësitë e koalicionit (shumëkombësh). Në të njëjtën kohë, në vendet e tyre, nivelet e larta komanduese (Mbretërit, Presidentët, Kryeministrat) mësuan rolin kritik që Forcat e tyre Speciale mund të luanin në ambientin dinamik tashmë të pasigurt dhe të ardhshëm së sigurisë globale. Gjatë kryerjes së këtij procesi, FOS dolën në pah nga hija që ndodheshin dhe po marrin një interesim të madh publik sa më shumë që imazhet e tyre shfaqen nëpër botë. Megjithatë, këto ngjarje të rëndësishme shumë shpesh hedhin hije me faktet që një arkitekturë mbështetëse e rëndësishme e ka prejardhjen nga investimet që janë bërë prej shumë vitesh, të cilat i krijuan kushtet koalicionit që të arrijë këtë sukses (NCSS Special Ops Forces Study, 2008, 2). Lidhja e FOS me ambientin e sotëm operacional ka rezultuar në rritjen e kërkesave për FOS vit pas viti. Eksperiencat operationale të FOS të NATO-s nga lufta e Gjirit në vitin 1991 deri tek operationet në vazhdimësi në Afganistan, Siri dhe në Irak kanë demonstruar boshllëqe në politikat, organizimet, ndërveprueshmërinë, pajisjen dhe mbështetjen të cilat i kanë shkaktuar këtyre forcave me vlerë të madhe, të operojnë në mënyrë jo eficiente. Gjithmonë e më shumë, vende të ndryshme të NATO-s po i kuptojnë këto të meta dhe në të njëjtën kohë, vlerat strategjike të njësive FOS dhe në të njëjtën kohë po vazhdojnë të bëjnë përpjekje që t'i integrojnë ato në rrjedhën e përgjithshme të mbrojtjes kombëtare dhe Strategjisë së Sigurisë Kombëtare⁹⁴. Kohët e fundit ka një trend lëvizjeje në drejtim të mos mbajtjes së kontrollit më nga Ushtria, Marina dhe Forcat Ajrore të FOS të tyre por të unifi kombëtar të komandave të FOS, me qëllimin e vetëm që të integrojnë repartet kombëtare FOS dhe të adresojnë dislokimin dhe mbështetjen e duhur të tyre. Ky trend ka prejardhje nga pranimi i këtyre vendeve që e kuptuan, duke bërë zgjedhjen e duhur që FOS kërkon një strukturë operationale të dedikuar kombëtare për Operationet Speciale (OS) që të sigurojë organizim gjithëpërfshirës, autoritet dhe

drejtim të të gjithë aspekteve të OS dhe të sigurohet që FOS janë të organizuara siç duhet për të arritur sukses.

Vendet anëtare të NATO-s kuptuan gjithashtu se struktura e Shtabit të FS të NATO-s ishte jo adekuate për ambientin e ri të sigurisë dhe që FS të vendeve të tyre të dislokuara nën komandën e koalicionit ishin të mbështetura në mënyrë jo të duhur, për të realizuar kërkesat e tashme dhe të së ardhmes. Kjo bëri që të krijohej Iniciativa e Transformimit të FS të NATO-s (NSTI). Si rezultat e mësimave të nxjerra Këshilli Atlantik i Veriut aprovoi që NSTI të krijonte mundësinë që FS të NATO-s të stërviteshin dhe të vepronin së bashku dhe në këtë mënyrë mund të adresonin më mirë sfidat që haste NATO sot dhe në të ardhmen. Deklarata e Krerëve të Shteteve dhe të Qeverive që morën pjesë në takimin e Këshillit të Atlantikut të Veriut në Riga në 29 Nëntor të vitit 2006, kishte si qëllim “rritjen e aftësive të FS të NATO-s për t’u stërvitur dhe vepruar së bashku, duke përfshirë dhe përmirësimin e kapaciteteve të pajisjeve speciale”.¹

2.3.6 Historiku i krijimit të Forcave Speciale Shqiptare

Në vitet 1960-1970 në komandën e Forcave Detare në përbërje të Brigadës së nëndetseve u krijua një grup zbulues diversionist nënujor i përbërë nga 24 persona. Komandant i saj ka qënë zoti Rremë Abazi. Detyra e tyre ishte: kapja dhe asgjësimi i objekteve hidroteknike (moleve, bankinave, etj) me eksplozivë, pikave të vrojtimit, qendrave mobile, vendkomandave të përparuara në afërsi të bazës së ujit, deri në afërsi të rajonit të veprimeve luftarake. Mënyra e veprimit të tyre ishte e njëjtë me atë që përdoret sot dhe nga trupat Navy Seals amerikane, infiltroheshin nëpërmjet nëndetseve, lëshoheshin jashtë nëpërmjet tubit të lëshimit të silurit (53 cm diametër), të pajisur me armatim të lehtë, eksploziva dhe lëshimi i tyre bëhej nga nën uji në mënyrë që të ruanin befasinë. Stërvitja e tyre ishte shumë rigoroze dhe ishte e shtrirë gjatë gjithë vitit. Përveç stërvitjes në ujë, një rëndësi të madhe kishte dhe stërvitja zbuluese në tokë, program i cili ishte i njëjtë me atë të Detashmentit të Zbulimit në Zall-herr. Në Llogara bënë stërvitjen dimërore dhe skitë (File, 1999, 34).

Detashmenti i Zbulimit 1967-1974

Detashmenti i Zbulimit është krijuar në mesin e viteve 1950, me një përbërje prej një grupi zbulimi dhe ndërlidhje. Ai u krijua si strukturë në vartësi të SHP dhe varej e drejtohej nga Drejtoria e Zbulimit e MMP. Detyrat e tij luftarake në kohë lufte ishin: të siguronte të dhëna informative mbi përbërjen, vendosjen dhe karakterin e veprimeve të armikut të pritshëm, kryesisht në prapavijat e tij. Plotësimi i detyrave të zbulimit dhe sigurimi i të dhënave informative mbi armikun nga ana e detashmentit të zbulimit vlerësohej me ndikime të rëndësishme në aktivitetin e SHP të ushtrisë, sidomos në kuadrin e përpunimit nga ana e tij të vlerësimeve dhe të orientimeve për veprimet luftarake të forcave tona edhe pse veprimet e detashmentit ishin të përmasave taktike, për nga rëndësia vlera ushtarake e tyre ishte me ndikime të nivelit operativ-strategjik të vendimmarrjes. Fillimisht Detashmenti është vendosur në garnizonin ushtarak pranë Rrapit të Treshit, më pas në mjediset e shkollës së oficerëve, në afërsi të Pallatit të Brigadave dhe së fundi në vitin 1967 përfundimisht në Zall-Herr. Një rol të rëndësishëm në krijimin e tij, ka luajtur Drejtori i Zbulimit në MM, Kolonel Anton Sheti, ku me nismën e tij u ndërtua garnizoni i Zall-herrit dhe Pika e zbulimit (pushimit) në Jalë pranë detit Jon, krejtësisht moderne për kohën.

Nisur dhe nga karakteri i detyrave dhe nga mundësitë reale, fillimisht detashmenti ka qënë planifikuar vetëm për detyra zbulimi, i cili konsistonte në mbledhjen e të dhënave mbi armikun me anë të vrojtimit, patrullimit, përgjimit, kërkimit, pritave për kapjen e robërve dhe të ndonjë veprimi të vogël diversionist. Më vonë në kuadrin e eksperimentimit dhe të zbatimit të tezave të Këshillit të Mbrojtjes, në kuadrin e rishikimit të strukturës, detyrave dhe të programit të përgatitjes luftarake të ushtrisë, u rikonceptua dhe ridimensionua dhe struktura, detyrat dhe mënyrat e përgatitjes së zbulimit me trupa, po ashtu dhe të Detashmentit të Zbulimit të SHP. Në çdo Brigadë u organizuan Batalione zbulimi me kuadro dhe efektiv të përzgjedhur, ndërsa Detashmenti i Zbulimit për nga shtrirja dhe përbërja mori përmasat e një Regjimenti, strukturë në të cilën kaloi në vitin 1973 dhe në përbërje të saj kishte pesë grupe zbulimi operacionale, një togë ndërlidhjeje, një bateri me topa 75 mm pa sprapsje dhe mortaja 82 mm. Tashmë zbulimi me trupa veç detyrës tradicionale të sigurimit të të dhënave informative, do të kryente dhe detyra luftarako-diversioniste, sipas parudhës *“zbulues + lëndë plasëse=armë me larghedhje të madhe”*. Nën drejtimin e kuadrove

të mirënjohur të zbulimit ushtarak: M Ormeni, R Kuca, Dh Dhrose, J Cino dhe Gani Elezi periudha 1964-1966 shënoi hapat e para të intensifikimit dhe të përsosjes cilësore të stërvitjes së Detashmentit, në përputhje me orientimet e reja. Stërvitjet e grupuara dhe mësimet treguese në Mezhgoran, Dragot, Voskolojë, zhvillimi i fushimeve dimërore dhe verore, hedhjet me parashutë në vitin 1964 i të gjithë efektivit të Detashmentit, ishin hapat e para dhe të sigurtë për të arritur më pas në nivelet e larta ushtarako-profesionale¹. Pikërisht në këtë periudhë evidentohen dy momente që patën ndikim të dukshëm në përsosjen e programit dhe ngritjen e aftësive luftarake të zbulimit me trupa, e në veçanti të detyrave të zbulimit. Së pari: përvoja që solli nga Vietnami grupi i drejtuar nga Spiro Adhami, shef i degës së zbulimit me trupa, përshtatja dhe aplikimi i kësaj përvoje në kushtet tona. Së dyti: organizimi i kursit dy mujor (Gusht-shtator 1967) në Zall-herr me pjesmarrjen e të gjithë kuadrove aktivë të zbulimit me trupa për përvetësimin e kësaj përvoje. Përvoja e përfituar në këtë kurs ishte e një rëndësie të madhe dhe me ndikim të menjëhershëm në përsosjen dhe rritjen e nivelit të përgatitjes luftarake të zbulimit me trupa në tërësi, e të Detashmentit në veçanti, duke u bërë prologu i një periudhe tepër intensive dhe rezultative në historinë e tij. Komandant në këtë kohë ka qënë zoti Qani Abazi.

Periudha 1967-1974. Kjo periudhë ka qënë nga më të ngarkuarat për sa i përket detyrave që ka zgjidhur Detashmenti, e cila ka qënë nga më efektivet për sa i përket rezultateve të përgatitjes luftarake, gadishmërisë dhe disiplinës, duke e vënë Detashmentin e Zbulimit në radhën e repartit më të mirë të ushtrisë. Pas viti 1973, duke qënë se u dha direktiva që programet e përgatitjes së ushtrisë të ndërtoheshin në bazë të programeve të reparteve të zbulimit, Detashmenti i Zbulimit u angazhua më drejtpërdrejtë në intensifikimin e procesit të përgatitjes ushtarakë të ushtrisë (Agolli, 2003, 74). Komandanti i Regjimentit (Detashmentit) të Zbulimit së fundmi ka qënë Zoti Arseni Stroka.

Në Mars të vitit 1975, Regjimenti i Zbulimit u suprimua, por fakti që mbi bazën e komandës, të trupës së kuadrove, të programeve dhe të përvojës së fituar u organizua shkolla e përgatitjes së oficerëve rezervistë, bëri të mundur që kontributi i kuadrove të zbulimit të ishte më i drejtpërdrejtë në interes të përsosjes së stërvitjes së

1. Intervistë e Zotit Gani Elezi (Kolonel R), ish komandant i Detashmentit të Zbulimit, dt 11 Nëntor 2000.

ushtrisë, nëpërmjet përgatitjes së oficerëve rezervistë të të gjithë llojeve të armëve dhe shërbimeve të saj, të cilët përbënin në atë kohë pjesën dërmuese të kuadrit të njësive dhe të reparteve ushtarake.

Batalioni i Forcave Speciale 1998-2014

Batalioni i Forcave Speciale është krijuar me Vendim të Këshillit të Mbrojtjes Nr-2, datë 16 Tetor 1998¹ si njësi më speciale e Ushtrisë Shqiptare, me qëllim realizimin e detyrave të operacioneve speciale. Si fillim, vendi i parë i dislokimit të njësisë ishte në Garnizonin e Farkës, meqenëse atje ndodheshin të dislokuar dhe helikopterët e Forcave Ajrore, të cilët do të mundësonin përdorimin e këtyre forcave me shpejtësi dhe efikasitet të plotë. Ndërsa që nga Marsi i vitit 2008, venddislokimi i Batalionit të Forcave Speciale është në garnizonin e Zall-Herrit (ish Regjimenti Komando), një terren i cili mundëson plotësimin e të gjithë spektrumit të mbështetjes së stërvitjes së këtyre forcave. Komandant i parë ka qënë Kolonel Hysen Ymeri.

Ky repart e ka filluar aktivitetin në datën 24 Shkurt 1999 dhe ishte i përbërë nga Shtabi dhe nga 4 grupe speciale. Në ditën e inaugurimit të repartit morën pjesë Ministri i Mbrojtjes dhe Shefi i Shtabit të Përgjithshëm të Ushtrisë, ku në rreshtimin e parë Reparti kishte 76 ushtarakë.

Në datën 3 Gusht të vitit 1999, u zhvillua ceremonia e marrjes në dorëzim të flamurit luftarak të Batalionit. Në ceremoninë e dorëzimit mori pjesë Ministri i Mbrojtjes dhe Shefi i Shtabit të Përgjithshëm të Ushtrisë.

Për realizimin e këtyre detyrave u fillua me përzgjedhjen e personelit, i cili në fillimet e batalionit trajnohej nga instruktorë turq të Forcave Speciale në një proces seleksionimi që zgjaste rreth 3 javë (Demiraj, 2008, 7). Më pas, me rritjen e kapaciteteve të këtij batalioni pas vitit 2007, kurset e FS filluan të realizohen nga vetë efektivët tanë, të cilët kanë si cilësi të veçanta dashurinë ndaj atdheut, profesionalizmin maksimal, durim të kalitur, precizion në qitje dhe saktësi në veprimet taktike dhe teknike. Ky personel përzgjidhet nga të gjitha repartet e Forcave të Armatosura (FA) në bazë të dëshirës dhe vullnetit të tyre. Mbas përzgjedhjes në këtë mënyrë, ky efektiv i nënshtrohet disa testeve të ndryshme 3-javore në mënyrë që të përfitojë të drejtën për të vazhduar

1. Vendim i Këshillit të Mbrojtjes, për krijimin e Batalionit Special Komando të Brigadave Komando, dt 16 Tetor 1999.

Kursin Bazë të Forcave Speciale, një kurs selektiv që zgjat 52 javë, pa të cilin asnjë efektiv nuk mund të bëhet pjesë e Forcave Speciale.¹ Por kjo nuk mbaron me kaq. Vetëm ata që arrijnë ta mbarojnë me sukses këtë kurs mund të bëhen pjesë e trupës së Forcave Speciale dhe më tej, sipas specialitetit dhe aftësive individuale që ata kanë, bëhen e pjesë e Kompanive të Antiterrorit, Kompanisë së Aksioneve Speciale Alpine, Parashutiste ose e Kompanisë së Zhytjes së Luftimit.

Që nga periudha e krijimit të Batalionit të Forcave Speciale (BFS), njësitë e tij kanë zhvilluar stërvitje të shumta, në bashkëpunim me FS të NATO-s dhe kanë realizuar detyra të ndryshme, si brenda edhe jashtë vendit si dhe kanë marrë pjesë në shumë misione paqeruajtëse në Bosnjë Hercegovinë, Afganistan, Irak, Çad dhe së fundmi në Misionet Luftarake në Kandahar, Afganistan. Të gjitha këto misione janë realizuar me sukses dhe me një përkushtim të plotë nga ana e trupave tona. Gjatë kryerjes së këtyre detyrave, në datën 20 Shkurt 2012, ra në krye të detyrës Dëshmori i Atdheut, Kapiten Feti Vogli, komandant i grupit të parë special të Kompanisë së Zhytjes, në Daman të Afganistanit dhe u plagos nëntetari Aleksandër Peci.

Në fillim, BFS ka qenë i përbërë nga shtabi dhe 4 grupe speciale. Në vitin 2000, batalioni u rrit në 7 grupe speciale; në vitin 2001 u rrit në 10 grupe speciale, ndërsa me riorganizimin e ri të FA-së, organizimi më i fundit u bë në vitin 2012 i BFS-së dhe për herë të parë, u krijuan 4 kompani speciale (antiterrori, alpine, parashutizmi dhe zhytje luftimi) dhe një kompani mbështetjeje luftimi, e njëjtë me organizimin e njësive më moderne të FS si ato amerikane, gjermane dhe angleze. (strukturë e cila u prish me marrjen e drejtimit të kësaj njësie nga një drejtues krejtësisht i paaftë dhe që nga Nëntori 2013 e deri më sot nuk është bërë asnjë investim në këtë njësi elitë).

Dërgimi për herë të parë i një anëtari të FS (Major Sajmir Mustafës) në Shtabin Qëndror të Forcave Speciale të NATO-s në Mons, Belgjikë (NSHQ) dhe krijimi i dokumentit strategjik për FS, në dhjetor të vitit 2011, me urdhër të MM dhe të SHSHP, solli dhe njohjen për herë të parë të Forcave Speciale në komunitetin e FS të NATO-s dhe rritjen ndjeshëm të kapaciteteve të saj.

1. Rregullore e pranimit në FS , viti 2003 fq. 1.

Detyrat operacionale dhe operacionet humanitare

Që prej krijimit, BFS ka marrë pjesë në qindra operacione dhe shërbime të ndryshme, brenda dhe jashtë vendit. Operacionet e para të BFS-së kanë filluar gjatë konfliktit të Kosovës, në vitin 1999. Gjatë këtij viti, në një periudhë kohe prej 6-7 muajsh, grupet speciale të BFS kanë marrë pjesë aktive në monitorimin e kufirit, në menaxhimin e krizave të ndryshme përgjatë kufirit shtetëror dhe në prapavijë të armikut për grumbullim informacionesh ushtarake si dhe kanë kryer detyra speciale si psh: për ndalimin e infiltrimit të grupeve speciale serbe në territorin tonë.

Kulmi i operacioneve ka qenë kur forcat kundërajrore serbe arritën të rrëzojnë një avion zbulimi amerikan dhe kur dy grupe specialësh amerikanë dhe shqiptarë u nisën për të mbledhur copat e tij dhe kutinë e zezë. Ky veprim u krye 15 kilometra në thellësi të territorit të armikut dhe u përmbush me sukses të plotë nga forcat tona, duke bërë të mundur dorëzimin e tyre tek FS Amerikane.

Në vitin 2001-2002, grupet Speciale të BFS morën pjesë, në bashkëveprim me Forcat e Policisë së Shtetit në vendosjen e rendit kushtetues dhe qetësisë publike në rrethin e Tropojës, duke kryer shumë operacione speciale. Në vitin 2001, në kohën e konfliktit me armë kundër shqiptarëve të Maqedonisë, katër grupe speciale kanë marrë pjesë në monitorimin e kufirit shtetëror me Republikën e Maqedonisë, si dhe kanë kryer detyra të ndryshme zbulimi si kryerja e misioneve për parandalimin e trafikeve të qenieve njerëzore në zonën e Vlorës, në Gusht të vitit 2001.

Gjatë operacioneve humanitare në ndihmë të popullsisë së përmbytur në Prefekturën e Lezhës dhe në Tiranë, në Shtator të vitit 2002, misionet e BFS kanë konsistuar në dhënien e ndihmës dhe largimin e banorëve nga zonat e përmbytura, evakuimet e njerëzve të cilët kishin nevojë urgjente për t'u dërguar në spital. Operacione të tjera kanë qenë kryerja e misionit për monitorim kufiri në zonën Veri-lindore, gjatë muajit Shtator të vitit 2002; ruajtja e objekteve të rëndësisë së veçantë gjatë procesit zgjedhor, në Shtator të vitit 2003; operacioni 6-mujor për kërkimin e viktimave të tragjedisë së 9 Janarit të vitit 2004, përgjatë vijës bregdetare Vlorë-Himarë.

Në vitin 2003-2004, BFS ka marrë pjesë në shumë misione në të cilat, detyrat kryesore kanë qenë monitorimi i gjithë vijës bregdetare, lufta kundër trafikimit të

qenieve njerëzore, drogës dhe armëve, në bashkëveprim me Forcat e Antiterrorit të Ministrisë së Brendshme, duke bërë të mundur realizimin me sukses të plotë të të gjitha misionëve të ngarkuara.

Të tjera operacione kanë qenë kërkimi dhe transportimi i të mbyturve të gomones së mbytur në lumin Vjosa në vitin 2004; operacioni për kërkim-shpëtim të ushtarakëve amerikanë gjatë aksidentit ajror në rrethin e Gramshit, Mars-prill 2005; kërkimi dhe transportimi i të mbyturve në liqenin e Farkës në Mars 2008, ku u nxorën 13 të mbytur nga uji.

Nga data 15.03.2008-02.04.2008, BFS mori pjesë në Operacionin “Gërdec-08”, në dhënien e ndihmës së parë të të plagosurve, pastrimin e zonës së infektuar nga shpërthimi, grumbullimin e municioneve, ngritjen e çadrave dhe shpërndarjen e ushqimit për banorët, etj. Në Nëntor të vitit 2008, BFS mori pjesë në ndihmë të Bashkisë së Gjirokastrës për nxjerrjen e personave nga rrënojat e shembjes së një pallati, ku vetëm efektivët tanë u angazhuan nën rrënoja duke nxjerrë njerëzit e zënë poshtë saj.

Në datat 01.01.2010-20.03.2010 BFS u angazhua në Emergjencat Civile në ndihmë të popullsisë së përmbytur nga shirat dhe përmbytjet në zonën e Shkodrës, ku kryesisht kompania speciale ujore veprroi në zonën e Komunës Dajç. Duke qenë se kjo zonë ishte zona më e përmbytur dhe pa lidhje tokësore me pjesën tjetër të Shkodrës, BFS bëri matjen e thellësisë së lumit Buna, atje ku bashkohet me detin Adriatik, vendosjen e eksplozivave dhe thellimin e saj me plasje nën ujë, në një mot shumë të ftohtë, me rreth -2° dhe 6 ballë det, mision të cilin nuk e mori përsipër asnjë njësi tjetër, as e policisë, as e ushtrisë.

Nga data 01.12.2010-20.02.2011, BFS u angazhua përsëri në Emergjencat Civile, në ndihmë të popullsisë së përmbytur nga shirat në zonën e Shkodrës dhe përsëri kompania speciale ujore veprroi në zonën e Komunës Dajç, duke qenë se kjo zonë ishte zona më e përmbytur dhe pa lidhje tokësore me pjesën tjetër të Shkodrës. Ndihma konsistonte kryesisht në kërkim-shpëtimin dhe evakuimin e popullsisë, nëpërmjet lumit të Bunës, dhënien e ndihmës për transportimin e të sëmurëve, ndarjen e ndihmave ushqimore për njerëz dhe kafshë, ndihmave mjekësore, dërgimin e njerëzve të sëmurë në spital, etj.

Për kryerjen me sukses të të gjitha këtyre misionëve, qofshin këto brenda dhe jashtë vendit, BFS dhe personeli i tij është dekoruar me qindra medalje nga Presidenti i Republikës, Ministri i Mbrojtjes dhe Shefi i Shtabit të Përgjithshëm përfshirë dhe Medaljen “Repart i Shquar” nga SHSHP Gjeneral Major Xhemal Gjunkshi, Medaljen “Repart Elitë” nga MM Zoti Arben Imami, “Medaljen e Artë të Shqiponjës” nga Presidenti Zoti Alfred Moisiu dhe Dekoraten më të lartë “Nderi i Kombit” në muajin Shtator 2014 nga Presidenti Bujar Nishani “Për përfundimin me sukses të tetë misionëve luftarake të cilat ishin misionet e para luftarake në historinë e Shqipërisë pas luftës së II-të Botërore”.

Misionet paqeruajtëse dhe luftarake

- Në Gusht të vitit 2002 deri në Shtator të vitit 2004, BFS ka marrë pjesë, me dy grupe speciale, në 4 misione paqeruajtëse, në Kabul të Afganistanit, nën komandën e ISAF-it.
- Në vitin 2002 dhe 2003, pjesëtarë të Shtabit të Batalionit (2 oficerë dhe 1 n/ oficer) kanë marrë pjesë në tre misione paqeruajtëse në Bosnjë Hercegovinë, në shtabin e SFOR-it.
- Nga viti 2005 deri në vitin 2008, BFS ka marrë pjesë, me dy grupe speciale, në 8 misione paqeruajtëse në Mosul të Irakut, nën komandën e Forcave Amerikane, në operacionin “Liria e Irakut”, me detyra të tilla si ruajtje baze, ngritje postblloqesh, kontroll banesash, shoqërime personalitetesh të larta me eskorta të përforcuara¹¹².
- Në vitin 2010, ka marrë pjesë në misionin “EUFOR ” në Çad (Afrikë) në 1 mision me një grup special, në përbërje të Forcave Ushtarake Franceze.

Misionet Luftarake

- Kontigjenti “EAGLE-1”

Për herë të parë në historinë e Forcave tona të Armatosura që pas luftës së II-të Botërore, në muajin Korrik të vitit 2010 deri në muajin Shkurt të vitit 2011, nga BFS u nis misioni i parë luftarak “EAGLE-1” në Kandahar të

Afganistanit, në përbërje të Forcave të Ushtrisë Amerikane, për zbulimin dhe kërkimin e terroristëve dhe grupeve terroriste që veprojnë në atë zonë, duke realizuar me sukses misione të *Goditjeve Direkte* (DA),

- Kontigjenti “EAGLE-2”

Në muajin Janar të vitit 2010 deri në muajin Gusht 2010, nga BFS u nis misioni i dytë luftarak “EAGLE-2” në Kandahar të Afganistanit, në përbërje të Forcave të Ushtrisë Amerikane për zbulimin dhe kërkimin e terroristëve dhe grupeve të tyre që veprojnë në zonën operacionale AO “Gryffon”, duke realizuar me sukses misione të *Goditjeve Direkte* (DA), *Zbulimit Special* (SR) dhe *Stërvitjeje të Policisë Afgane* (FID).

- Kontigjenti “EAGLE-3”

Në muajin Korrik të vitit 2011 deri në muajin Shkurt 2012, nga BFS u nis dhe përfundoi detyrën, misioni i tretë luftarak “EAGLE-3” në Kandahar të Afganistanit, në përbërje të Forcave të Ushtrisë Amerikane, me detyrë zbulimin dhe kërkimin e terroristëve dhe goditjen e elementëve terroristë që vepronin në zonën operacionale AO “Traccer”, duke realizuar me sukses misione të *Goditjeve Direkte* (DA), *Zbulimit Special* (SR) dhe *Stërvitjeje të Policisë Afgane* (FID).

- Kontigjenti “EAGLE-4”

Në muajin Janar të vitit 2012 deri në Korrik të po këtij viti, nga BFS u nis dhe përfundoi me sukses detyrën misioni i katërt luftarak “EAGLE-4” në Kandahar të Afganistanit, në përbërje të Forcave të Ushtrisë Amerikane, me detyrë zbulimin dhe kërkimin e terroristëve e grupeve të tyre që vepronin në zonën AO “Vipper”, duke realizuar me sukses misione të *Goditjeve Direkte* (DA), *Zbulimit Special* (SR) dhe *Stërvitjeje të Policisë Afgane* (FID).

- Kontigjenti “EAGLE-5”

Në muajin Korrik të vitit 2012, nga BFS u nis dhe përfundoi me sukses detyrën misioni i pestë luftarak “EAGLE-5” në Kandahar të Afganistanit, në përbërje të Forcave të Ushtrisë Amerikane, me detyrë zbulimin dhe kërkimin e terroristëve e grupeve të tyre që veprojnë në zonën operacionale AO “Lifer”, duke realizuar me sukses misione të *Goditjeve Direkte* (DA), *Zbulimit Special* (SR) dhe *Stërvitjeje të Policisë Afgane* (FID).

- Kontigjenti “EAGLE-6” dhe SFMAT 1

Në muajin Janar të vitit 2012, nga BFS u nis dhe u kthye pas 6 muajsh, pasi kreu me sukses detyrën, misioni i gjashtë luftarak “EAGLE-6” në Kandahar¹¹³ të Afganistanit, në përbërje të Forcave të Ushtrisë Amerikane, me detyrë zbulimin dhe kërkimin e terroristëve e grupeve të tyre që veprojnë në zonën operacionale AO “Viper”, duke realizuar me sukses misione të *Goditjeve Direkte* (DA), *Zbulimit Special* (SR) dhe *Stërvitjes së Policisë Afgane* (FID).

Po ashtu, nga Batalioni i Forcave Speciale, niset dhe misioni i parë i trajnimit të FS dhe Komandove Afgane, prej 5 vetësh në SPTC, Wardak, afër Kabulit në Afganistan.

- Kontigjenti “EAGLE-7”

Në muajin Gusht të vitit 2013, nga BFS u nis dhe mbaroi me sukses detyrën misioni i shtatë luftarak “EAGLE-7” në Kandahar të Afganistanit, në përbërje të Forcave të Ushtrisë Amerikane, me detyrë zbulimin dhe kërkimin e terroristëve e grupeve të tyre që veprojnë në zonën operacionale AO “Texas”, duke realizuar me sukses misione të *Goditjeve Direkte* (DA), *Zbulimit Special* (SR) dhe *Stërvitjes së Policisë Afgane* (FID).

- Misioni në SOCC-A (SF Intelligence Fusion Cell)

Në muajin Tetor 2013, Major Sajmir Mustafa merr për herë të parë detyrën e zv/drejtorit të zbulimit të (SOFFC-A) në një ambient komandues të FS të NATO-s dhe 3 muaj më vonë në këtë drejtori më e rëndësishmja në Afganistan, nisen me mision 6 mujor dhe Major Evis Spahi dhe Kapiten Arben Hasimllari efektivë të BFS.

Përfundime

Ideja për FS është aq e vjetër sa dhe vetë lufta. Ato ishin speciale sepse kishin stërvitje dhe pajisje superiore ose kishin shumë eksperiencë luftimi. Nuk ishte shumë e rëndësishme a ishin të pajisura me shtizë, shpatë apo mushqetë, elitat kishin një gjë të përbashkët: secila nga ato ishte njësi që luftonte e pavarur dhe ishin reparte që fitonin çdo betejë.

Ajo që del në pah në këtë kapitull është rëndësia e përdorimit të FS që në kohët të lashta. Ato janë përdorur në vendet më të rrezikshme dhe futja e tyre në luftim ka qenë vendimtare. Që në atë kohë i është kushtuar një rëndësi e madhe përzgjedhjes, stërvitjes, pajisjes dhe mbështetjes së këtyre forcave. Ato mbaheshin gjithmonë afër nga udhëheqësit, perandorët, mbretërit dhe në momentin që kishin për të zgjidhur detyra të cilat ishin vendimtare për fatet e betejës, fushin në luftim këto forca. Dhe më pas, këto forca janë përdorur në betejat më kyçe. Siç po vërtetohet dhe sot e kësaj dite, përdorimi i këtyre forcave në terrenet e vështira të Afganistanit, Sirisë, Nigerisë, Irakut, etj është themelore dhe vendimtare. Ajo që arrihet vetëm nga numër shumë i vogël trupash FOS, nuk mund të arrihet kurrë nga trupat konvencionale, shumë më të mëdha në numër. Koncepti për operacionet speciale nga forcat që kryejnë këto lloje operacionesh është përfshirë në mënyrë të rëndësishme për më shumë se në 3 dekadat e fundit. Në shumë shembuj, operacione të tilla janë kryer me shumë sukses, por disa të tjera kanë dështuar, të cilat kanë shërbyer si katalizatorë për këto ndryshime. Për shembull, viti 1980 dëshmoi suksesin e padiskutueshëm të SAS-it Anglez në ambasadën Iraniane në Londër dhe dështimin e Delta Forcës në misionin

në Iran, për shpëtimin e pengjeve amerikane të mbajtura peng për një kohë të gjatë në Teheran.

Prej më shumë se 15 vitesh FOS (Forcat e Operacioneve Speciale) të NATO-s kanë qenë dhe janë të angazhuara në mënyrë të vazhdueshme, në ekspedita operacionale në zona gjeografike me interes ekonomik dhe politik të vendeve të tyre si në Ballkan, Afrikë, Irak, Siri dhe Afganistan. Këto reparte FOS kanë qenë shumë të suksesshme duke realizuar me sukses një gamë të gjerë misionesh, në mënyrë të njëanshme, ose në kombinim me FOS të shteteve të tjera, nën rrethana të paparashikuara në kohën kur këto reparte FOS ishin krijuar, stërvitur, pajisur si asete kombëtare strategjike për t'u përdorur gjatë Luftës së Ftohtë.

Eksperiencat operacionale të FOS të NATO-s nga lufta e Gjirit në vitin 1991 deri tek operacionet në vazhdimësi në Afganistan, Siri dhe në Irak kanë demonstruar boshllëqe në politikat, organizimet, ndërveprueshmërinë, pajisjen dhe mbështetjen, të cilat i kanë shkaktuar këtyre forcave me vlerë të madhe, të operojnë në mënyrë jo eficiente dhe në mënyrë jo të duhur. Vendet anëtare të NATO-s që në vitin 2001, kuptuan gjithashtu se struktura e Shtabit të FS të NATO-s ishte jo adekuate për ambientin e ri të sigurisë dhe që FS të vendeve të tyre të dislokuara nën komandën e koalicionit ishin të mbështetura në mënyrë jo të duhur, për të realizuar kërkesat e tashme dhe të së ardhmes. Kjo bëri që të krijohet Iniciativa e Transformimit të FS të NATO-s (NSTI). Si rezultat e mësimave të nxjerra Këshilli Atlantik i Veriut aprovoi që NSTI të krijonte mundësinë që FS të NATO-s të stërviteshin dhe të vepronin së bashku dhe në këtë mënyrë mund të adresonin më mirë sfidat që haste NATO sot dhe në të ardhmen.

KAPITULLI III

PROBLEMI AFGAN DHE FUSHATA KUNDËR REBELIMIT (COIN) E FORCAVE ALEATE

3.1. Problemi afgan

Forcat ushtarake të Aleancës, padyshim, janë forca të huaja në Afganistan. Kuptohet plotësisht se “problemi afgan” është një problem i vjetër, jashtëzakonisht kompleks dhe shumë i vështirë për t’u përmbledhur në pak faqe të këtij disertacioni. Sidoqoftë, problemi thelbësor afgan pas vitit 2006, është mjaft i qartë. Me gjithë përpjekjet maksimale të Aleancës gjatë fushatës konvencionale kundër rebelimit (COIN), rebelimi taleban po ashtu dhe al-Qaeda mbeten një kërcënim i madh në këtë vend. Situata në Afganistan mbetet e paqëndrueshme dhe rrjeti i talebanëve dhe i al-Qaeda-s ruan lirinë e lëvizjes në shumë zona “të kontestuara”.

Përgjatë këtij kapitulli, do të përpiqem që të shqyrtoj më këtë problem kaq të rëndësishëm sa më mirë që të jetë e mundur. Ky kapitull gjithashtu identifikon katër çështje kyçe të cilat gjykoj se kanë mundësuar këtë mungesë stabiliteti dhe dhune. Këto janë “konvencionaliteti” i forcave ushtarake të ISAF-it dhe të SHBA-së, strategjia e luftës në Afganistan, Ushtria Kombëtare Afgane (ANA) krejtësisht jo efektive dhe Policia Kombëtare Afgane (ANP) e pa pajisur, e pa stërvitur dhe analiza mbi kryekomandantët dhe milicinë afgane.

Shtimi i dhunës dhe i paqëndrueshmërisë nga ana e Talebanëve dhe e al-Qaeda-s

Me gjithë 130.000 trupat konvencionale të ushtrisë së SHBA-së dhe përafërsisht 75.1 trupave afgane “të trajnuara” dhe 80.000 trupave të policisë në terren, burime të shumta konfirmojnë se vitet 2006-2013 ishin vitet më të dhunshme që nga viti 2001.

Për analizë studimi do të përpiqem të marr në analizë vitin 2005.

Numri i amerikanëve të vrarë në luftime (KIA), gjatë vitit 2005, ishte në total 99 ushtarë (shih tabelën 2.1: Përmbledhja e Viktimave të Ushtrisë së SHBA në

Operacionin për Lirinë e Qëndrueshme). Ky numër është më i lartë se katër vitet e mëparshme të luftës në Afganistan.¹ Raportet nga terreni vënë në dukje se rritja e këtij numri, ka ndodhur për shkak të shtimit të përdorimit të pajisjeve shpërthyes të improvizuara (IEDs) dhe makinave bombë kamikaze (VBIED) pranë bazave të mëdha Amerikane ose rrugëve kryesore të furnizimit (MSR-s) nga ana e Talebanëve dhe e grupeve të tjera terroriste që operojnë në Afganistan, sulmeve indirekte dhe shtimit të sulmeve direkte mbi bazat e përparuara operacionale, autokolonave dhe pritave të ndryshme. Pas kësaj, pak trupa Amerikane, përveç disa Forcave Speciale (FS) dhe disa njësisve të Çështjeve Civile (CA) operojnë rregullisht në zonat rurale të Afganistanit, krahas operacioneve që ndërmerren nga forcat konvencionale të llojit “*pastro dhe largo*”.

Tabela 3.1.

Përmbledhja e Viktimave të Ushtrisë së ShBA-së në Operacionet për Lirinë e Qëndrueshme.²

Viti	Të plagosur	Të vrarë
2001	35	12
2002	72	48
2003	96	48
2004	214	52
2005*	240	99
TOTALI*	657	259

* deri më 1 janar 2006

Në vijim të dhunës tipike të paraqitur më lart, duke marrë si shembull vitin 2006, rebelët Talebanë dhe al-Qaeda në Afganistan, kanë shtuar përdorimin e sulmeve kamikaze. Rebelimet në Afganistan duket se po imitojnë suksesin e sulmeve kamikaze, të përdorura kundër forcave të Koalicionit në Irak. Për shembull, në vitin 2004, rebelët afganë kryen pesë sulme kamikaze me bomba dhe i shtuan ato në 17 sulme kamikaze gjatë vitit 2005. Kjo prirje alarmante vazhdoi ndërkohë që Talebanët dhe al-Qaeda ndërmorën 13 sulme kamikaze me bombë vetëm në 10 javët e para të vitit 2006 (Harding, 2006).

1 “OEF–U.S. Casualties,”(n.d.):<http://icasualties.org/oef/>.

2 “OEF–U.S. Casualties,”(n.d.):<http://icasualties.org/oef/>

Rebelët në Afganistan duket se e kanë kuptuar qartë efektivitetin e bombave kamikaze në Irak: popullata është e destabilizuar, trupat qeveritare janë irrituar dhe shpesh civilët e pafajshëm sulmohen si të dyshuar për bomba kamikaze duke bërë që qeverisja të humbasë legjitimitetin. Ndikimi i përgjithshëm në Irak, ishte dëmtimi i disa partnerëve kyç të Koalicionit të cilët pas humbjeve të mëdha në njerëz dhe mjete, janë tërhequr nga Iraku, si rezultat i përdorimit të këtyre metodave dhe i këtij destabiliteti. Padyshim që rebelët afganë po shpresojnë të arrijnë të njëjtat rezultate dhe në Afganistan.

Presidenti i Afganistanit, Hamid Karzai, tha për *Newsweek* “se situata e keqe e sigurisë ka inspiruar trazirat në muajin Maj dhe për pasojë, reagimi i vrazhdë i ushtrisë dhe policisë afgane tregon se institucionet e Afganistanit, policia, ushtria, nuk janë ende të gatshme që t’iu bëjnë ballë protestave dhe demonstratave.”³ Edhe lideri më i lartë i Afganistanit e pranon se qeverisë së Afganistanit i mungon kontrolli mbi popullatën e saj. Sigurisht, jeta e përditshme në Afganistan mbetet tejte e pasigurt dhe ndikimi mbi Afganistanin rural kontestohet shumë nga një rebelim i vazhdueshëm dhe në rritje i Talebanëve dhe al-Qaedës. “Konvencionaliteti” i forcave kundër rrebelimit të SHBA dhe Aleancës në Afganistan dhe strategjia e tyre joefektive, është një tjetër faktor kyç për t’u marrë parasysh për rikthimin e kërcënimit të Talebanëve dhe al-Qaedës.

“Konvencionaliteti” i Forcave të SHBA-së, Aleancës dhe strategjia e tyre.

Pavarësia operationale e grupeve speciale të FS në vjeshtën e 2001, megjithëse tepër efektive, pati jetë të shkurtër. Energjike për t’u përfshirë në të vetmen luftë që u bë e njohur në arenën ndërkombëtare me termin Global War on Terror (GWOT), menjëherë pas tyre, Forcat Konvencionale të SHBA filluan zbarkimin në Afganistan në fund të Dimrit të vitit 2001.

18.000 trupat konvencionale të SHBA-së që përfundimisht do të dislokoreshin në Afganistan, do të tejkalonin shumë angazhimin fillestar të disa qindra operatorëve amerikanë të FS, të cilët mundësuan rrëzimin e regjimit të Talebanëve (shih Tabelën 2.2: “Konvencionaliteti” i Forcave Amerikane në Afganistan). Rasti në Afganistan ilustron qartë se thjesht shtimi në numër i trupave konvencionale amerikane në luftimet COIN, nuk e garanton fitoren.

3 “Four Killed in Afghan Anti-U.S.Riots,” (Maj 11, 2005): <http://www.foxnews.com/story/0,2934156169,00.html>.

Tabela 3.2

“Konvencionaliteti” i Forcave Amerikane në Afganistan

Data	Dhjetor 2001	Nëntor 2005
Komanda Amerikane	TF-Dager	CJTF-76
Përbërja	Elementë të 1/5 ^{ës} SFG (grupi % i FS), 2/5 ^{ës} SFG, 3/5 ^{ës} SFG, HQ 5 ^{të} SFG, të tjera SOF, FS aleate dhe njësitë e CIA-s (shërbimeve sekrete) ⁶	82 ^{të} ABN (parashutiste), 173 ^{të} ABN, 158 ^{të} AVN, B/2/6 ^{të} , CAV(Delta Force), F/159 ^{të} AVN (aviacion), 65 ^{të} MI (zbulim ushtarak), 391 ^{të} EN (xhenio), 864 ^{të} EN, 141 ^{të} IN, 249 ^{të} MED (mjekësi), A/44 SIG (ndëlidhje), 155 SIG, 580 SIG, 749 ^{të} ORD, 789 ^{të} EOD, 11 ^{të} ASOG, 92 ^{të} MP, 298 ^{të} EN, 74 ^{të} LRSD (logjistikë dhe mbështetje luftimi), CJSOTF-A, njësi të tjera të Ushtrisë të Shteteve të Bashkuara, Marinsat dhe Flota.
Forca	Më pak se 500 trupa SOF	Afërsisht 18.000 ushtarë

Faktorët kyç të cilët kanë kontribuar në “konvencionalitetin” e fushatës së Afganistanit. Janë: Krijimi i Task Forcës së Përbashkët Konvencionale (CJTF); mbizotërimi i operacioneve konvencionale “*pastro dhe largo*” dhe reduktimi i FS.

Së pari, krijimi i një komande konvencionale në Afganistan, e quajtur CJTF-76, sipas gjykimit tim ishte jo produktive në një luftë, të cilën e pranojmë se vazhdon të jetë “jokonvencionale” për nga natyra. CJTF komandohet nga një Gjeneral i forcave konvencionale me tre yje. Oficeri atë vit me gradën më të lartë të FS në Afganistan, Kolonel, nuk kishte as “një vend në tavolinë” gjatë mbledhjeve dhe vendimeve të rëndësishme. Është jo produktive që një komandë konvencionale e ushtrisë, të ngarkohet të drejtojë atë që është qartësisht një luftë jokonvencionale.

Së dyti, mbizotërimi i mentalitetit të një ushtrie konvencionale demonstron në kryerjen e operacioneve “*pastro dhe largo*” në shkallë të gjerë për të përzënë armikun.

Operacioni *Anaconda* (në muajin Mars të vitit 2002, i shpjeguar në kapitullin e III-të), operacioni *Mountain Viper* (Gusht 2003), operacioni *Avalanche* (Dhjetor 2003), operacioni *Mountain Storm* (Korrik 2004), operacioni *Lightning Freedom* (Dhjetor 2004), operacioni *Mountain Run* (Dhjetor 2010) etj janë të gjithë shembuj themelorë të operacioneve “*pastro dhe largo*” tërësisht jo efektivë (Katzman, 2005, 22). Këto lloj operacionesh nuk funksionuan as në Vietnam dhe nuk janë duke funksionuar as tani në Afganistan. Një komandant i forcave konvencionale të këmbësisë në Afganistan pranon se operacionet e tilla kryhen vetëm për të nxjerrë jashtë rrethimit trupat e veta. Përfundimisht, FS, të cilat janë ekspertët e vetëm të ushtrisë në luftën konvencionale (UË) dhe COIN, u lanë lënë mënjane në Afganistan.

Potenciali i pafund i FS ishte zbehur nëpërmjet keqpërdorimit kronik të tyre, nga ana e komandantëve të këmbësisë. Besoj se edhe vetë FS duhet të marrin përsipër pjesën e vet të fajit për këtë keqpërdorim, duke qenë se këto forca u mbajtën larg operacioneve jokonvencionale dhe kundër kryengritëse (COIN) në Afganistan. Grupet e FS ndërprejnë operacionet në shkallë të gjerë “*nëpërmjet dhe*” me forcat vendase afgane dhe u zhvendosën në operacione më të vogla në kufirin e Pakistanit duke mbledhur të dhëna zbulimi dhe duke ndjekur terroristët, duke realizuar goditje direkte (DA). Besoj se kjo zhvendosje e fokusit ishte një gabim serioz dhe duhet që këto forca të riktheheshin në rolin e tyre më tradicional të bashkëpunimit me forcat afgane të sigurisë.

Ushtria Kombëtare Afgane (ANA) ishte jo efektive

Ushtria afgane (ANA) është forca kryesore vendase e sigurisë në Afganistan. Në vitin 2002, FS fillimisht organizuan, pajisën dhe stërvitën njësitë e ANA-së për të mbushur me shpejtësi vakumin e shtetit, të lënë nga regjimi i Talebanëve. Megjithatë, me kalimin e kohës forcat konvencionale të SHBA dhe NATOs morën përgjegjësinë për trajnimin e ushtrisë afgane. Në vend të kësaj, pjesa më e madhe e FS u ngarkuan me misione më “të rëndësishme”: përgatitjen për luftën në Irak, ose ndjekjen e rebelëve të

mbetur të Talebanëve dhe të al-Qaeda në kufirin Afgano-pakistanez.

Ushtria afgane u vendos nën përgjegjësinë e stërvitjes së ushtarëve të *Rojës Kombëtare* të Ushtrisë së SHBA nga *Task Force “Phoenix”* dhe përkatësisht, u organizua, stërvit dhe u përdor kryesisht sipas modeleve “konvencionale” të këmbësisë së lehtë amerikane. Me fjalë të tjera, ANA është strukturuar përgjatë 10 viteve të fundit, sipas strukturës së ushtrisë konvencionale amerikane. ANA ka krijuar së fundi shtabet e centralizuara në “përmasat e Divizioneve” në Herat, Gardez, Kandahar dhe Mazar-e-Sharif. “Brigada e rëndë” e ushtrisë afgane është stërvitur në Pol-e-Sharke (Katzman, 2005, 29). Megjithatë, raportet nga terreni vënë në dukje se ushtria e tyre është ende e paaftë për operacione të pavarura në nivel batalioni (ose “kandak-u”) (Bragg, 2005). Pjesa më e madhe e operacioneve të tyre janë në përmasat e kompanisë ose më të vogla, të cilat përdoren veçanërisht për të shtuar forcat konvencionale COIN të koalicionit.

Misionet e ushtrisë afgane mbyllin listën e zakonshme të taktikave konvencionale të COIN-it, për të përfshirë “patrullat e prezencës” dhe operacionet e lëvizjes-për-kontakt (si të thuash teknikat dhe taktikat “*pastro dhe largo*”). Ndërkohë që forca aktuale e ushtrisë afgane është përafërsisht 180.000 trupa (viti 2014) dhe një grup tjetër prej 6.000 trupash janë në trajnim, në njësinë e Trajnimit Ushtarak në Kabul. Këto shifra konsiderohen optimiste nga pjesa më e madhe e analistëve, por raportohet se dezertimi mbetet një problem konstant në ushtri. Rreth 50% e trupave të ushtrisë afgane largohen (mungesë pa leje) ditën e pagesës, pasi duhet të ecin me ditë për të çuar rrogën e tyre në shtëpi (Bragg, 2005). Ndërtimi i ushtrisë afgane është një investim i cili i ka kushtuar shumë SHBA-së. Qeveria e Afganistanit, në vitin 2005, raportoi se vetëm SHBA-të shpenzuan 4.1 miliardë dollarë, për të ngritur këtë forcë (Katzman, 2005, 30).

FS duhet t’i jepnin një formë tjetër ushtrisë afgane (dhe policia afgane ashtu siç do ta diskutojmë në paragrafin tjetër) në një forcë për mundësi suksesi më të madh. Ndërkohë që ushtria afgane është kyçi i suksesit afatgjatë në Afganistan, unë personalisht e pranoj se organizimi në “ushtri të rregullt” nuk është zgjidhja më e mirë për sigurimin e stabilitetit afatgjatë për të ardhmen e Afganistanit. Më mirë

një forcë paraushtarake, apo një forcë në stilin e xhandarmërisë, e cila mund të jetë zgjidhja më e mirë? Sipas gjykimit tim nga eksperiencia në Afganistan një forcë policie “paraushtarake” ose një forcë në stilin e xhandarmërisë do të ishte zgjidhja më e mirë.

Policia Kombëtare Afgane (ANP) e pastërvitur

Pavarësisht kushteve të këqija, në gjykimin tim besoj se roli i ardhshëm i policisë afgane (ANP) do të jetë etapa qendrore në çdo strategji efektive afatgjatë kundër guerrile në Afganistan. Komanda e ISAF-it ka raportuar se afërsisht 134.000 trupa të policisë afgane kanë qenë në detyrë deri në fund të 2011.¹ Sidoqoftë, ndërsa këto shifra duken impresionuese, niveli i stërvitjes, pajisjeve dhe komandim-kontrolli në policinë afgane vihen në pikëpyetje. Për më tepër, mungesa e udhëheqjes dhe e drejtimit brenda saj është pasqyruar qartë në operacionet e tyre të fundit në Jalalabad, për shuarjen e protestave antiamerikane. Realiteti është se policia afgane ka kontroll minimal në qendrat urbane afgane dhe thuhet se nuk ka prani apo kontroll në fshatrat afgane. Korrupsioni mbetet një problem shumë i madh. Policia afgane është agjencia parësore, përgjegjëse për sigurinë e brendshme brenda Afganistanit dhe si e tillë, ajo duhet të bëhet baza e Forcës të Xhandarmërisë së Afganistanit. Sigurisht që kjo do të ketë nevojë për punë më të madhe për sa i përket detyrës së stërvitjes së tyre. Sidoqoftë, pranojmë se FS janë një organizatë e cila mund të ndihmojë shumë në këtë drejtim. Policia afgane aktuale është e udhëhequr shumë keq, pak e trajnuar, e pamotivuar, shumë e korruptuar, pa pajisjet e duhura, jo e motivuar për ta realizuar misionin e tyre dhe më e rëndësishmja, nuk është pozicionuar në vendin e duhur (ose shpesh nuk është fare e pozicionuar) në zonat e Afganistanit, të cilat kanë më së shumti nevojë për ta, fshatrat dhe qytetet afgane (Bragg, 2005).

Kërcënimi i kryekomandantëve dhe milicëve afganë

Kryekomandantët afganë dhe milicia e tyre e ç'rregullt janë po aq të vjetër sa dhe vetë Afganistani dhe “problemi i kryekomandantëve” sipas gjykimit tim është mbase një nga çështjet më të rëndësishme që shqyrtohet në këtë pjesë të këtij kapitulli. Kryekomandantët dhe militantët e tyre kanë pasur dhe kanë në shumë zona rurale

1. Cheryl Pellerin, American Forces Press Service, *Afghan Security Forces Grow in Numbers, Quality* <<http://www.defense.gov/news/newsarticle.aspx?id=64044>>

afgane kontroll të plotë të popullatës vendase në nivel fshati dhe qyteti. Natyrisht, qeveria e Afganistanit (GOA) është e kërcënuar nga fuqia e kryekomandantëve dhe militantëve të tyre, ndërkohë që këta militantë shpesh janë forca ushtarake më efektive dhe më të pajisura në zona të veçanta. Ky ishte shqetësim i drejtë i Presidentit Afgan Hamid Karzai, veçanërisht kur marrim parasysh historinë e gjatë të Afganistanit në kryengritje, rebelime dhe fuqinë e madhe që kanë shpesh kryekomandantët të cilët luftojnë dhe bashkëpunojnë ngushtë me talebanët. Qeveria afgane është përpjekur të neutralizojë kryekomandantët e ditëve të sotme, duke i asimiluar ata me qetësi në qeveritë e reja, si Guvernatorë ose si Ministra të Provincave.

Disa kryekomandantë janë izoluar dhe disa prej tyre të cilët nuk dëshirojnë të bashkëpunojnë me qeverinë e Afganistanit janë shënjestruar si pro-talebanëve. Qeveria e Afganistanit ia ka frikën kryesisht militantëve të ç'rregullt të kryekomandantëve dhe ka ndërmarrë hapa të mëdhenj për t'u siguruar që Forcat e Milicisë Afgane (AMF) të jenë plotësisht të ç'mobilizuara. Forcat e Milicisë Afgane të cilat më parë kanë punuar me FS, kanë një forcë vendase kundër kryengritëse tepër efektive. Për ironi, forcat e milicisë ishin mbase trupat më të mira për këto lloje operacionesh në dispozicion të qeverisë Afgane, pasi kishin mundësi të shkëlqyer për të hyrë në rrjetet informale sociale dhe kishin shumë inteligjencë të nevojshme në dispozicion në zonat e tyre operative. Burimet tona në terren tregojnë se Kombet e Bashkuara (UN) sponsorizuan programin e çmobilizimit, i cili ishte jo efektiv. "Programet ritrajnuese profesionale" të premtuara nga ana e tyre janë praktikisht jo ekzistente dhe militantët kanë ruajtur aktualisht pjesën më të mirë të armëve të tyre, kështu që ç'mobilizimi i forcave të milicisë ka krijuar dy probleme:

Së pari, njësia vendase kundër kryengritëse më efektive që ekzistonte në Afganistan, është shpërndarë në mënyrën më efektive (disa u rekrutuan nga njësitë e policisë kufitare, por pjesa më e madhe e ish milicisë, vazhdojnë të presin për ritrajnime profesionale).

Së dyti, tashmë kemi një numër të madh të luftëtarëve të cilët kanë marrë pjesë në luftimet që nga koha kundër sovjetikëve dhe nuk kanë dëshirë të dorëzojnë armët e tyre. Milicët e ish-AMF janë duke iu kthyer në mënyrë aktive aktiviteteve kriminale dhe terroriste dhe më keq akoma, janë duke rekrutuar njerëz për Talebanët.

3.2. Modeli i fushatës jokonvencionale COIN të Forcave Aleate

Kushtet e luftërave të vogla janë aq të larmishme, mënyra e të luftuarit të armikut është aq e pazakontë dhe arenat e operacioneve paraqesin tipare kaq të veçanta, sa që përgjithësisht duhet bërë luftë e ç'rregullt mbi një metodë totalisht të ndryshme nga sistemi stereotipik (Callwell, 1996).

Më poshtë po të paraqes një nga zgjidhjet e mundshme për problemin në Afganistan-Modelin e Fushatës jokonvencionale kundër rrebelimit. “Pjesët lëvizëse” të mëdha të modelit të fushatës jo konvencionale kundër rebelimit gjykoj se duhet të jenë: Forcat e Xhandarmërisë (CF), Forcat vetëmbrojtëse të fshatrave (SDF), Forcat e ndjekjes (MCT), Forcat e Reagimit të Shpejtë (QRF).

Forcat e Xhandarmërisë (CF)

Forca kryesore e ndërhyrjes ose “thelbi” i modelit tonë jokonvencional kundër rrebelimit duhet të jetë një forcë xhandarmarie afgane, e cila duhet të jetë e këshilluar dhe stërvitur nga FS. Funkcioni parësor i forcës së xhandarmarisë duhet të jetë mbrojtja dhe sigurimi i popullatës lokale nëpërmjet një kombinimi të policisë paramilitare dhe taktikave të njësive të vogla, duke e kontrolluar ushtarakisht popullatën. Çdo fshat afgan i “kontestuar” duhet të ketë një skuadër ose një element në përmasa-toge të një forcë xhandarmarie afgane. Anëtarët e kësaj force të xhandarmarisë duhet që të jenë idealistë, të rekrutuar direkt nga policia kombëtare afgane, jashtë zonës operacionale ku ata janë të punësuar. Kështu anëtarët e xhandarmarisë jo vetëm që përfaqësojnë vendasit brenda qytetit ose fshatit të tyre të banimit, por gjithashtu sjellin edhe rrjetet e tyre sociale para-ekzistuese në këtë zonë. Aty ku policia afgane nuk është e disponueshme, mund të zëvendësohet nga trupat e xhandarmërisë, derisa vendasit të mund të rekrutohen dhe të trajnohen si pjesë e policisë kombëtare. Ndryshe nga policia aktuale, e cila është trajnuar dhe pastaj është shpërndarë në zona jo-mbështetëse, një trupë e xhandarmarisë e njeh qytetin ose fshatin e tij, terrenin dhe popullatën vendase dhe do të përpiqej shumë më tepër për të ruajtur, ndërtuar dhe zhvilluar zonën e vet.

Një trupë e tillë duhet të jetë kompetente në rolin e tij mbrojtës, por më e rëndësishmja që duhet të arrijë, të ketë lidhje me komunitetin vendas nëpërmjet familjes, miqve dhe punëve të përditshme, duke bërë të mundur që të sigurojë në mënyrë të vazhdueshme mbështetjen e tyre.

Trupat e xhandarmarisë dhe këshilltarët e tyre të FS, duhet të jenë përherë në garnizone të vogla (shtëpi të mbrojtura mirë) në fshatrat afgane, në të cilat të ofrohet siguri me skuadra policie ose me elementë me përmasat e togës. Strategjia konvencionale “lëvizje-për-kontakt” e cila ka për qëllim të pastrojë një zonë të dominuar nga rebelët, vepron vetëm përkohësisht për të vendosur sigurinë për banorët e qytetit ose të fshatit. Përfundimisht, trupat qeveritare pas operacioneve largohen nga zona dhe nuk kanë mundësi që në vazhdimësi të sigurojnë mbrojtjen e vendasve. Në dallim nga këta, trupat e xhandarmarisë ruajnë gjithnjë terrenin duke jetuar dhe punuar në zona të tilla. Në mënyrë që të dobësohet dhe të merret kontrolli i një zonë që është jashtë kontrollit, gjykoj se duhet të arrihen dy qëllime të rëndësishme: dikush duhet të jetë i aftë që *së pari* “të mbrojë popullatën” dhe *së dyti* “ta izolojë popullsinë nga guerilet” (Hamby, 2002). Një forcë vendore që është e përbërë nga anëtarët e komunitetit, të cilët mund të ruajnë paqen me kompetencë dhe qëndrueshmëri, do të fitojë besimin e banorëve të qytetit ose fshatit. Nëse vendasit do të mbrohen prej rebelimeve nga forcat e xhandarmërisë, më në fund do të fillojnë të besojnë tek ta dhe nuk do të ofrojnë më mbështetje për rebelët. Gjëja më e rëndësishme që do të arrihet është që çdo popullatë që ndihet e mbrojtur, do të fillojë t’i ofrojë qeverisë informacione dhe inteligjencë në lidhje me veprimtarinë e rebelëve.

Forca Vetëmbrojtëse (SDF)

FS dhe homologët e tyre të xhandarmërisë duhet të organizojnë, stërvisin dhe pajisin Forcat e Vetëmbrojtjes në përmasën e një toge ose kompanie (në zona të mëdha të banuara), brenda çdo fshati “të pasigurt” afgan, për të mbështetur misionin e xhandarmarisë. Forcat vetëmbrojtëse janë forca që mund të kryejnë shumë funksione, të cilat mund të ofrojnë fuqi njerëzore shtesë për sigurinë fizike të xhandarmarisë, patrullime jashtë zonave të banuara, kontroll njerëzish dhe makinash në pika kontrolli dhe operacione të tjera të këmbësorisë së lehtë, atje ku është e nevojshme fuqia shtesë

për t'u angazhuar në luftim. Këto forca, lehtësisht dhe me shumë cilësi, mund të zëvendësojnë milicinë tradicionale vendase, me një forcë e cila është e kontrolluar edhe nga qeveria afgane dhe gjithashtu e sanksionuar me ligj. Ajo ofron mundësinë që vendasit të mbrojnë veten e tyre kundër Talebanëve dhe bashkëpunëtorëve të tyre, nëpërmjet konceptit “*ruajtja e lagjes*”. Forcat e xhandarmarisë janë të ndërtuara si një element i vogël në numër, zakonisht në përmasën e një toge ose më e vogël, por aftësia për të fuqizuar vetveten kur është e nevojshme me fuqi njerëzore nga një këmbësori e lehtë e forcave vetëmbrojtëse, është një mundësi për t'u vlerësuar dhe gjykoj se po të angazhohej si duhej me një komandim-kontroll të centralizuar dhe nën një lidhësi të mirë, do të angazhoheshin me shumë sukses kundër kryengritësve. Një kontroll i tillë i forcave të vetëmbrojtjes duhet të realizohet dhe monitorohet nga afër nga FS. Së fundi, trupat e vetëmbrojtjes të cilët jetojnë dhe punojnë me popullatën vendase) mund të jenë një burim i shkëlqyer informacioni për trupat e xhandarmarisë dhe FS po ashtu.

Forca e Lëvizjes për Kontakt-ndjekjes (MCT)

Forca e ndjekjes ose të Lëvizjes-për-Kontakt janë një forcë e rëndësishme mbështetëse për modelin e luftës jokonvencionale kundër kryengritësve. Ato janë të strukturuar në formën e *kondakë-ve* (batalioneve) të ushtrisë afgane dhe këshillohen nga FS të ISAF-it (RSM) të cilët janë të dislokuara në bazat e avancuara operacionale (AOB). Misioni i këtyre trupave është të mbajë rebelët nën presion të vazhdueshëm, duke patrulluar vazhdimisht kufirin pakistanez/afgan për t'u mohuar atyre lëvizjen e lirë, strehimin, kalimin e materialeve dhe veprimin kundër banorëve të zonave përreth. Kjo strategji për grumbullimin e informacioneve, gjetjen dhe goditjen e rebelëve u drejtua, në mënyrë të ngjashme, nga forcat e efektivit të misioneve “Eagle” në zonën e Kandaharit, Spin Buldakut, Takho Polit, Shkretëtirës së Regestanit, Lakarayit, Shorabakut dhe Damanit kundër grupeve terroriste, trafikantëve të heroinës, armëve, minave, etj dhe mbështetësve të tyre, të cilët mbanin në mënyrë të vazhdueshme mbanin nën goditje trupat amerikane dhe fshatarët e zonave që përmendëm më lart, kur ata bashkëvepronin me forcat tona. Efektivët e misioneve “Eagle” stërvitën në mënyrë të kujdesshme dhe profesionale, krijuan lidhje shpirtërore me to dhe komandantin e tyre, trupat e QRF të Spin Buldokut, një njësi model për këtë zonë ku ky Kandak i Brigadës 3-të të Policisë Kufitare të Kandaharit drejtohej nga Kolonel Haji Xhanan u kthye me të vërtetë “një makinë vrasjeje talebanësh”. Kjo forcë e bashkuar patrullonte, në mënyrë

aktive, zonat që përdorshin më shumë nga terroristët për kalimin e drogës dhe futjen e armëve dhe materialeve shpërthyes (Cable, 1986, 100). Në Afganistan, misioni i forcave ndjekëse është ndjekja, kapja ose asgjësimi i rebelëve në zonat rurale larg fshatrave. Rebelët të cilët kthehen në fshatrat e kontrolluara nga xhandarmaria, duhet të identifikohen, kapen ose vriten në këtë mënyrë, “duke mos iu lejuar strehë të sigurt, qetësi ose vend për t’u fshehur” (po aty, 154). Nëse një forcë e konsiderueshme rebelësh lëviz në fshatin e tyre, atëherë forcat e xhandarmërisë mund të thërrasin forcat e reagimit të shpejtë (QRF) për ndihmë.

Forcat e Reagimit të Shpejtë (QRF)

Në rastin kur trupat e xhandarmarisë kërcënohen nga një forcë e fuqishme rebelësh, duhet që të ketë në dispozicion 24 orësh gjithmonë një forcë të reagimit të shpejtë (QRF). Këto forca janë forcë e ushtrisë afgane, në përmasën e Kompanisë ose Batalionit dhe të stërvitura nga FS, të cilat operojnë si forcë e gatshme nga një bazë e avancuar operationale (AOB) e dislokuar në një qendër të banuar. Përdorimi i një QRF-i nuk është koncept i ri, ka qenë një procedurë operative standarde si në operationet konvencionale dhe në ato jokonvencionale. QRF-i tipik është mirë që të përbëhet dhe nga një grup i FS ose komando afgane dhe të përdoret si një forcë sulmi që dërgohet në vendin e incidentit nga ajri, pra duke përdorur konceptin e sulmit ajror (air assault), e cila mund të mbërrijë shpejt me një element nga FS, në përmasën e grupit special (12 veta) ose të ndonjë toge këmbësorie, e pajisur dhe stërvitur mirë e cila sapo merr urdhrin, vepron direkt. Sidoqoftë, QRF-i me helikopter në dispozicion, nuk është shumë e sigurt dhe praktik në zonat malore të Afganistanit, për shkak të kufizimit të peshës së rëndë dhe rrezikshmërisë së asgjësimit nga mjetet kundërajrore të Talebanëve. QRF që propozoj unë, duhet të jetë i stërvitur mirë dhe në gjendje të lartë gadishmërie dhe furnizimi. Ai duhet të lëvizë nëpërmjet tokës dhe të jetë i dislokuar jo larg nga qyteti ose fshatrat e mëdhenj. QRF-i për të cilin ndihmuam që të ngrihej në zonën shumë problematike të Spin Buldokut në vitin 2010 në Kandahar nga kontigjenti i “Eagle-1” së bashku me Brigadën e Survejimit 525 nën komandën e Kolonel James D. Edwardit, fillimisht u përqëndruam në kontrollin e pastërtisë së figurës morale të pjesëtarëve të saj. Pastaj për 6 javë u morëm me

stërvitjen e saj në drejtim të përgatitjes për qitje, veprimeve taktike në postobloqe dhe gjatë kontrollit të banesave, makinave, dhënie të ndihmës së shpejtë dhe në turin e tretë nga “Eagle-3” kursin e luftimit të afërt. Me kontigjentin e “Eagle 4-5” u dha një ndihmë e madhe për stërvitjen në drejtim të ruajtjes së personaliteteve jo vetëm me pjesëtarë të këtij “kondaku” por me trupat SFAT amerikane, pasi na u kërkua nga komandanti i Brigadës 3-të Kufi Gjeneral brigade Abdyl Raziqi dhe komandanti i QRF të Spin Buldokut, Kolonel Haji Xhanani. Vetëm brenda një viti (2010-2011) këtyre dy personave iu bënë mbi 32 sulme nga talebanët për ti vrarë, gjë që ja dolën me sukses vetëm për Guvernatorin e Kandaharit Muhhamed Karzain, vëllain e Presidentit Hamid Karzai dhe disa komandantë të lartë të policisë dhe ushtrisë afgane. Kjo stërvitje e dhënë nga FS të kontigjenteve “Eagle” dha një impakt të madh në disa drejtime:

1. Rriti ndjeshëm respektin e kontigjenteve tona në drejtim të efektit që sillte direkt në mjedisin e sigurisë së qytetit të Spin Buldokut, stërvitja e avancuar e trupave afgane, qytet i cili është direkt në kontakt me kufirin me Pakistanin, në të cilin kryheshin deri në dy shpërthime me makina dhe me kamikazë njerëzish në ditë,
2. Rriti prestigjin e efektivëve tonë të cilat në çdo planizim operacionesh në nivel Komande Jugore, thirreshin dhe dëgjoheshin me shumë respekt nga ana e komandantëve amerikanë për kurset e veprimit dhe deri në ekzekutimin e operacioneve. Vetëkuptohet që pjesëmarrja në llojet të tilla takimesh dhe kryerja direkt e operacioneve në terrene luftarake shumë të ashpra, rrezikshme, me kohë të gjatë, por rriti ndjeshëm kapacitetet e grupeve tona speciale në drejtim të planizimit dhe ekzekutimit të operacioneve speciale.
3. U rrit ndjeshëm bashkëpunimi midis trupave shqiptare, amerikane dhe afgane, pasi pa ndihmën tonë, skuadroni amerikan i partnerizuar me ne, nuk do të mund të arrinte sukseset që arriti dhe të vendosnim qetësinë në qytetin e Spin Buldokut.
4. U rrit niveli i mësimdhënies së SF dhe u organizuan shumë operacione të përbashkëta për kapjen ose asgjësimin e një numri të konsiderueshëm objektivash me vlerë të madhe (HVT) së bashku me afganët, ku sigurimi i MEDEVAC-ut dhe CAS-it u bë e mundur nga ana e ushtrisë amerikane për ne dhe trupat e sigurisë afgane.

Roli i Forcave Konvencionale

Kush janë forcat dhe roli i trupave konvencionale? Kjo zakonisht i referohet forcave të këmbësorisë së zakonshme, malore ose parashutiste. Ajo që unë mendoj se del si konkluzion pas kaq vitesh operacionesh në afganistan, është se forcat konvencionale duhet të jenë forca mbështetëse për FS dhe bashkëpunëtorët e tyre vendas afganë. Forcat konvencionale (GPF) duhet të jetë përgjegjëse për tre misione bazë mbështetëse:

Së pari, forcat konvencionale duhet të sigurojnë lirinë e lëvizjes në rrugë dhe autostrada, ndërtesat me rëndësi, aeroportet, rrugët e furnizimit, etj.

Së dyti, forcat konvencionale mund të decentralizohen në elemente të përmasës së skuadrës ose togës, për të përforcuar FS gjatë kryerjes së operacioneve të tyre, veçanërisht në vatrat “e nxehta” të zjarrit.

Së fundi, forcat konvencionale mund të përfshihen në operacionet e kufizuara të tipit lëvizje-ndjekje kur ekzistojnë kushtet si më poshtë vijon:

- trupat e forcave të kërkim-ndjekjes, duhet të mbështeten me informacione të sakta dhe të përditësuara zbulimi përpara se të nisen në operacion;
- operacionet duhet të kryhet në partneritet me trupa të ushtrisë afgane, në numër të barabartë ose më të madh dhe me këshilltarët e FS. Të gjitha operacionet e forcave konvencionale, trupave të xhandarmërisë dhe të kërkim-ndjekjes, duhet të miratohen nga komandanti i komandës rajonale të ISAF-it (RSM), që është përgjegjës për atë zonë operationale.

Roli këshillues dhe trajnues i Forcave Speciale në Afganistan

Unë personalisht besoj se ka të paktën tre arsye pse FS janë zgjidhja më e mirë për të organizuar, stërvitur, pajisur dhe këshilluar forcat e sigurisë afgane:

Së pari, operatorët FS janë të vetmit specialistë të ushtrisë që janë të përgatitur për t’ju kundërpërgjigjur luftës jo konvencionale. Ata janë të selektuar, stërvitur dhe pajisur për të kryer “operacione ushtarake dhe paraushtarake, kryesisht bashkë me vendasit” (Department of the Army, FM 3-05.20, Special Forces Operations, 2001). Personeli i FS është i përzgjedhur dhe i stërvitur veçanërisht për t’u shkrirë me popullatën dhe me kulturën e vendit. Kjo është thelbësore për këshilltarët e FS

shqiptare dhe të NATO-s të cilët duhet të jetojnë dhe punojnë me trupat e xhandarmërisë në fshatrat dhe zonat rurale të Afganistanit.

Së dyti, operatorët e FS janë oficerë dhe nënoficerë me eksperiencë, me shumë ture luftimi në të gjithë globin dhe janë të vetmet forca ushtarake, të cilat kanë eksperiencë të drejtpërdrejtë luftimi. Drejtuesit e tyre janë veçanërisht ekspertë në operacionet e pavarura dhe kanë nevojë për shumë pak ose aspak mbështetje dhe mbikqyrje. Ata janë të përshtatur në mënyrë ideale për natyrën e decentralizuar të luftës kundër kryengritëse në “shtetin e vështirë” të Afganistanit.

Përfundimisht, FS janë nga të paktat njësi ushtarake të cilat kanë zbuluar kodin në përdorimin e “organizimit bazë” të zbulimit me njerëz (HUMINT) në terren, duke bërë të mundur që të jenë gjithmonë një hap para forcave të tjera, qofshin ato dhe të agjensive të inteligjencës ushtarake dhe kombëtare.

Një vend veçanërisht të rëndësishëm në këtë drejtim kanë luajtur operatorët e BFS në Distriktin e Kandaharit dhe zonat përreth tij, duke u bërë shembull, në nivel strategjik (ISAF), për sigurimin e informacioneve shumë më parë se të arrinin në *Fusion Cell*-in e Zbulimit të Brigadës, në zonën e tyre operacionale nën komandën ku ata vepronin. Zbulimi me njerëz që përfitohet direkt në terren nga vendasit, ka rëndësi të madhe për të arritur kontrollin e popullatës dhe të situatës, duke bërë të mundur që të jemi të informuar deri në nivel fshati. Në fakt, pjesa tjetër e këtij kapitulli do të fokusohet, në mënyrë të veçantë, në rëndësinë e zbulimit me njerëz (HUMINT) në nivelin lokal ose të “organizimit bazë.”

3.3. Grumbullimi i informacioneve gjatë fushatës COIN

Teoria e McAdam-it e Rrjeteve Sociale Para-ekzistuese

Do të përpiqem që të spjegoj pak mënyrën dhe taktikën e mbledhjes së informacionit gjatë fushatave COIN, duke bërë pyetjen e mëposhtme: përse disa forca rebele përfitojnë nga mbështetja e “bazave të organizuara” (si të thuash për të dhëna zbulimi) në fshatrat afgane, ndërkohe që të tjerë, si ushtria afgane nuk është në gjendje të përfitojë? Përveç asaj që kemi mësuar nga eksperiencia direkt në fushat e luftimit, do të duhet që të marrim në konsideratë dhe do të analizojmë studimin e zotit *Doug McAdam*, në të cilin sipas meje do të mund të gjendet një shpjegim

në lidhje me mobilizimin e njerëzve, lëvizjeve të ndryshme të kryengritësve dhe të rrjeteve sociale.

Tek “Mobilizimi, lëvizjet dhe rrjetet sociale”, *McAdam* përmend tre doktrina bazë të cilat shpjegojnë përse njerëzit tërhiqen ndaj lëvizjeve sociale të tilla si rebelimet.

Së pari, ai deklaron se “rekrutët, në një lëvizje të caktuar, kanë prirjen të njohin të tjerë të cilët janë përfshirë tashmë në...*lidhje të mëparshme sociale*, duke inkurajuar hyrjen në këtë lëvizje (McAdams, 2003, 285).

Pika e dytë e McAdam-it është se “pjesa më e madhe e lëvizjeve sociale zhvillohet brenda kuadrove të përcaktuara lokale.... psh: udhëheqësve që njihen, kanaleve të vjetra të komunikimit, rrjeteve të besimit ndaj njëri-tjetrit” (po aty).

Së treti, “lëvizjet që shfaqen kanë prirjen të përhapen përgjatë linjave të krijuara të veprimit.”

Duke qenë se një rebelim është beteja për kontrollin mbi territorin dhe popullatën, unë besoj se teoria e *McAdam-it* zbatohet siç duhet në të dyja llojet e rebelimeve (që nënkupton lëvizjet e Talebanëve dhe të al-Qaedës) si dhe në lëvizjen kundërebelse të qeverisë së Afganistanit. Doktrina e *McAdam-it* bën shumë të qartë se forcat efektive vendase COIN duhet të kenë mundësi të hyjnë dhe të operojnë në rrjetet para-ekzistuese sociale, brenda komuniteteve në të cilët veprojnë. Për më tepër, forcat më të mira vendase kryengritëse, janë ato të cilat kanë mundësi të hyjnë në fshatrat e lokalizuara afgane, duke rekrutuar njerëz nga popullata vendase.

Siç e kam theksuar dhe më lart, mendoj se lufta aktuale në Afganistan do të fitohet ose do të humbasë, nëse do të kemi kontroll brenda fshatrave afgane, veçanërisht atyre të kufirit të paqëndrueshëm afgano-pakistanez. Kështu që forca jonë vendase e “përpjekjes kryesore” kundër kryengritëse, duhet të ketë mundësinë e hyrjes në rrjetet sociale para-ekzistuese brenda këtyre fshatrave. Ne pranojmë se kjo mund të realizohet lehtësisht prej forcave të xhandarmërisë paraushtarake, e cila është kryesisht e rekrutuar nga popullata vendase, jeton brenda popullatës vendase dhe mund të operojë brenda një fshati afgan me mundësi të plotë hyrjeje në nivelin-bazë të rrjeteve sociale dhe të ndërveprimit për të cilat flet *McAdam*.

Mbledhja e informacioneve të zbulimit të “organizimit bazë”

Problemi me mbledhjen e informacioneve të zbulimit gjatë fushatave COIN, është se rebelët fillimisht kanë përparësi tepër të lartë *asimetrike* informacioni. Ndryshe nga mentaliteti konvencional i antirebelimeve, kryengritësit jetojnë në popullatë dhe kanë aftësi të identifikojnë qartësisht armikun e tyre. Kryengritësit ia njohin fytyrën armikut të tyre, ku jeton dhe ku vepron. Për më tepër, kryengritësit kanë njohuri superiore të terrenit vendas. Ata mund të godasin kundërshtarët e tyre dhe pastaj të fshihen në popullatë për t'u rigrupuar, planizuar operacione të tjera dhe presin për një mundësi tjetër për të sulmuar përsëri. Guerilasit e zgjuar do të luftojnë vetëm në kushtet kur mendojnë se kanë përparësi mbi armikun e tyre. Rrjedhimisht, forcat konvencionale kundër rebelimeve e shohin veten në një vakum informacioni, pasi kanë mungesë të mbështetjes popullore. Sidoqoftë, FS dhe bashkëpunëtorët vendas të tyre të xhandarmarisë, e kanë aftësinë të infiltrojnë brenda tyre për të grumbulluar informacione zbulimi, në favor të forcave tona. Duke operuar *nga, me dhe përmes* vendasve, këto forca (FS & XH) mund të fitojnë besimin dhe kredibilitetin e nevojshëm, në mënyrë që popullata vendase t'ju ofrojë informacion në lidhje me rebelimet. Forcat e xhandarmarisë ofrojnë mbrojtje të pandërprerë 24 orëshe për popullatën vendase dhe mund të parandalojnë që kryengritësit të ndëshkojnë informatorët e qeverisë. Një forcë e xhandarmarisë “popullore”, e informuar me të dhëna dhe informacione zbulimi, mundet që të vendosë në shënjestër dhe të destabilizojë rrjetin që mbështet kryengritësit. Unë besoj shumë se krijimi i rrjeteve të informacionit në nivelin e “bazave të organizuara” (që do të thotë në fshatrat afgane) është elementi më i rëndësishëm për të fituar ndaj rebelimit.

Çështjet e Brendshme (CA), Operacionet Psikologjike (PSYOPS) dhe Mbështetja e Afërt Ajrore (CAS)

Integrimi i Çështjeve të Brendshme (CA), Operacioneve Psikologjike (PSYOPS) dhe Mbështetjes së Afërt Ajrore (CAS) në nivelin më të ulët taktik, janë njësitë më të rëndësishme për modelin tonë për luftën jokonvencionale (UË).

Së pari, siç vura në dukje në diskutimin e mësipërm, të gjitha këto nivele n/

repartesh mbështetëse duhet të zbresin poshtë deri në nivelin AOB, në nivel kompanie, ose edhe në atë të grupit special, sipas nevojës.

Së dyti, personeli i grupit special duhet të punojë *“dorë-për-dorë”* me bashkëpunëtorët etyretë CA/PSYOPS. Pasi trupat e xhandarmërisë afgane kanë siguruar fshatin, çështjet e brendshme duhet të paraqiten atje për të filluar implementimin e projekteve të zhvillimit të infrastrukturës, hapjes së shkollave, qendrave shëndetësore së bashku me mjekët e grupit special dhe projekte zhvillimore bujqësore, për t’i larguar fshatarat nga të mbjellat e drogës. Me analogjinë e vjetër *“kulaçi dhe kërbaçi”*, njësia e çështjeve të brendshme janë *“kulaçi”* dhe xhandarmaria afgane është *“kërbaçi”*. Eksperienca e fituar nga misionet “Eagle 1-7” si dhe duke i shtuar dhe informacionet e fituara nga terreni duke pyetur kolegët tanë të FS të NATO-s për rreth 10 vite, tregon se teknika më e mirë është ajo që thjesht të mundëson të pyesësh fshatarët se për shembull çfarë kanë nevojë? Shembujt e projekteve infrastrukturore mund të përfshijnë pusët e ujit, ndërtesat e shkollave, shtrimin e rrugëve, ndërtimin e xhamive, etj. Një nga projektet më të suksesshme të “Eagle 1-6” ishte ndërtimi i shkollës dhe xhamisë në Taktah Pol, ndërtimit të shkollës në Dubarai, përmirësimi i infrastrukturës dhe puseve në Budurzai, Dubaray, Shadizi, Lakaray, ndihma për implementimin e shtimit të të mbjellave në zonën e Damanit me mbjelljen e drithërave, shalqirit, duhanit, shëgëve dhe mollëve, hapja e qendrës shëndetësore në Spin Buldak dhe dhënia e ndihmës së parë nga mjekët e grupeve speciale të drejtuesit të Shuras në Loy Karay, Shir Kalay. Një nga arritjet më të rëndësishme në këtë drejtim, ishte kthimi i njërit nga komandantët e Talebanëve të Sharabakut, Muhhamad Shah-ut në një nga informatorët tanë (i cili ishte në gjendje shumë të rëndë shëndetësore pa mjekime dhe ilaçe, të cilit i’u dha ndihma e parë nga ndihmës mjeku i grupit të dytë special). Kapaciteti i FS është i madh në Aftësitë Mjekësore (MEDCAP) i cili përfshin paraqitjen e doktorëve të FS, asistentëve të mjekëve dhe mjekëve në fshatra për të ofruar kujdes mjekësor. Në këto fshatra nuk ka asnjë asistencë shëndetësore në dispozicion të popullatës. Projektet e çështjeve të brendshme shtojnë apelin e pranisë së qeverisë së Afganistanit në fshatra dhe ata ndërtojnë lidhjen e besimit ndërmjet popullsisë vendase dhe trupave të xhandarmarisë dhe qeverisë së Afganistanit.

Për më tepër, projektet e njësive të çështjeve të brendshme duhet të sigurojnë punësimin e popullsisë vendase dhe të sjellë investime për përmirësimin e jetës së

popullsisë, ku shumë nga paratë e nevojshme për ekonominë vendase janë vendimtare. Çështjet e brendshme kanë potencialin e njëjës prej mjeteve më të fuqishme në nivelin e komandantëve të grupeve speciale. Është e rëndësishme që: *Njësia e Çështjeve të brendshme* është efektive vetëm në fshatrat të cilat mund të konsiderohen “të sigurta” nga trupat vendase të xhandarmarisë. Njësitë e Çështjeve të Brendshme (CA) të cilat kryejnë projekte në zonat e pasigurta, nuk do të krijojnë rezultate pozitive dhe mund të shfrytëzohen shumë mirë nga armiku. Produkti plotësues i projekteve të tyre, të implementuara me sukses në fshatrat afgane, është një lidhje e fortë e besimit ndërmjet FS, xhandarmarisë dhe banorëve vendas. Projektet e CA të cilat përmirësojnë jetën e popullsisë së fshatrave afgane (që realizohen nëpërmjet krijimit të vendeve të punës të cilat nxisin ekonominë vendase) do të krijojnë ndjesinë e investimit dhe të pranisë së vazhdueshme të forcave të qeverisë afgane. Për më tepër, shtimi i lidhjeve të besimit ndërmjet popullatës vendase dhe FS/xhandarmarisë do të rezultojë në grumbullimin e një sasive shumë të madhe dhe të rëndësishme të informacioneve të zbulimit nga popullata vendase.

3.4. Metodologjia e kontrollit të zonave të operacionit

Kjo pjesë e këtij kapitulli do të përshkruajë metodologjinë se si mund të merret kontrolli mbi zonat e operacioneve të “ashtuquajtura” rebele. Këtë diskutim jam munduar ta ndaj në katër pjesë: krijimi i kontrollit në nivel-fshati, ndikimi i qeverisë së Afganistanit, teknika e “ndalimit të dritës” dhe konceptit “njolla e vajit”.

Krijimi i kontrollit në nivel-fshati

Unë besoj fuqimisht se lufta kundër rebelimit në Afganistan do të fitohet ose do të humbasë në qoftë se humbasim kontrollin e fshatrave. Rrjedhimisht, vendosja e kontrollit të qeverisë së Afganistanit mbi popullatën e fshatrave afgane, është një detyrë kyçe thelbësore e misionit të FS dhe bashkëpunëtorëve të tyre të ngushtë të xhandarmarisë.

Hapi i parë për vendosjen e kontrollit në fshat është kryerja e një *vlerësimi të hollësishëm të zonës* ku ndodhet fshati. Kjo është një teknikë e zakonshme e cila fillimisht planifikohet nga FS, që përfshin përcaktimin e “shtrirjes së territorit” gjeografik, social, politik, ushtarak dhe ekonomik përpara dhe forcat tona të fillojnë të

dislokohen brenda saj, në këtë zonë operacionale. Nga përditësimi konstant, vlerësimet mbi zonën zakonisht referohen si “dokumentacione të sakta”. Grupi special mund të përdorë metoda të shumta të provuara për të paraqitur tablonë e informacioneve të zbulimit në fshatra; më e mira dhe më e sakta që përfitohet janë intervistat e individëve të ndryshëm nga fshati, të cilët dëshirojnë të flasin për objektiva të caktuara. Liderët e fshatrave, tregtarët vendorë, shitësit e fshatarët, janë disa prej kontakteve të para për të filluar grumbullimin e informacionit. Grupet speciale duhet të përdorin sa më mirë këta individë kyç, si pjesëtarët e parë të rrjetit të tyre të “organizimit bazë” brenda fshatit që të fillojnë të ngrejne rrjetin e zbulimit dhe të targetimit. FS dhe trupat fshatare të xhandarmarisë mund të fillojnë të kryejnë gjithashtu edhe patrullime me profil të ulët brenda fshatit, për të marrë një tablo të qartë të situatës dhe për të vendosur kontakt parësor me udhëheqësit vendas. Mbase një nga sfidat më të mëdha të FS është mbledhja e raporteve me *mullain* e zonës, kryetarin e bashkisë, më të vjetrin e fisit dhe me çdo “njeri të madh” dhe kjo duhet të provohet përpara lëvizjes së një force më të madhe me trupa brenda, të koordinuar nga qeveria e Afganistanit për në fshatin e vënë në objektiv.

Një nga teknikat më efektive për takime të tilla, është marrja me vete nga ana e FS e një pale të tretë ndërmjetësuese që është e njohur për të dyja grupet dhe që do të ndihmojë për ta bërë më të lehtë takimin. Një nga teknikat që sygjeroj unë, bazuar dhe nga eksperiencia jonë e fituar nga disa misione në Afganistan, por dhe e FS Amerikane dhe Angleze është dhe përdorimi i “*mullait të lëvizshëm*”. Në këtë metodë, FS do të arrijnë brenda në fshat me një patrullë të madhe së bashku me një njësi të ushtrisë afgane dhe me *mullain* e tyre, shok të pjesëtarëve që përfaqësojnë qeverinë e Afganistanit. Atëherë “*mullai*” që përfaqëson qeverinë e Afganistanit, do të lehtësojë takimin ndërmjet drejtuesve vendorë, të cilëve zakonisht i’u bën menjëherë përshtypje edukimi i *mullait* tonë, krahasuar me atë të *mullait* të fshatit të tyre. Për më tepër, krijohet dhe një përshtypje e mirë për përfaqësuesit e ushtrisë afgane, të cilët janë myslimanë të mirë përderisa udhëtojnë me *mullain* e tyre dhe për këtë arsye, sulmohen më rrallë (Bragg, 2006). Pasi të jetë vendosur raporti me udhëheqësit e fshatit, FS dhe trupat e xhandarmarisë duhet të hyjnë fizikisht në fshat dhe të marrin një kompleks të mbrojtur në kuptimin një “*shtëpie* të sigurt”. Në disa raste, kur ka prani të dukshme të armikut në fshat, sigurimi i tyre duhet të paraprihet nga një operacion i kombinuar lëvizje-për-kontakt i FS dhe trupave të ushtrisë afgane, nëpër gjithë fshatin dhe rrethinat e zonës

së operacionit me forcën e xhandarmërisë vendore. Çelësi i këtij procesi është se kjo forcë e kombinuar, i bën me dije fshatit se nuk kanë për t'u larguar pas operacionit, rrjedhimisht nuk do të lejojnë rikthimin e Talebanëve në fshat.

Prioriteti i parë i FS dhe trupave afgane, pas marrjes nën kontroll të zonës, është përmirësimi i sigurisë vendore. Kjo mund të arrihet:

Së pari, duke kryer patrullime me FS dhe trupa vendore, duke organizuar pika-kontrolli në vende të ndryshme, atje ku ata hyjnë dhe dalin dhe të kombinuara me misione të *“zbulimit special dhe goditjeve direkte”* për të eliminuar kërcënimet e rebelëve.

Së dyti, FS dhe trupat vendore duhet të punojnë në mënyrë të vazhdueshme për të zgjeruar rrjetin e tyre lokal të zbulimit. Kjo do të thotë që të dalin jashtë dhe të takojnë njerëz, të fl me ta, të zënë miq dhe të rekrutojnë ata që kanë vullnetin për të ndihmuar trupat afgane për rrjetin e zbulimit të *“organizimit bazë”* të FS dhe xhandarmarisë.

Së treti, FS dhe trupat vendore duhet të rekrutojnë dhe të trajnojnë një Forcë Vetëmbrojtëse të fshatit (SDF). Forcat Vetëmbrojtëse të fshatit funksionojnë si forca ndihmëse të xhandarmarisë, të cilat mund të ofrojnë fuqi njerëzore shtesë për mbrojtje statike, pika-kontrolli, patrullime bazë dhe misione të ruajtjes së lagjeve. Për më tepër, anëtarët e këtyre forcave, të rekrutuar nga komuniteti vendas, mund të bëhen shumë të dobishëm me aftësitë e tyre për të mbledhur të dhëna zbulimi, për shkak të mundësisë së afrimit të tyre në rrjetet sociale paraekzistuese në fshat. Përfundimisht, me vendosjen e sigurisë bazë, FS duhet të vënë në përdorim aspektin e *“kulaçit”* të modelit tonë jokonvencional kundër kryengritës dhe të fillojnë projektet e zhvillimit me Çështjet Civile (CA). Projektet e CA ofrojnë mjete pune për bujqësinë, ku FS/forcat vendore të sigurisë i dhurojnë ato për të shtrirë ndikimin e tyre në ekonominë vendase dhe më e rëndësishmja, fitojnë mbështetjen e tregtarëve vendas dhe pronarëve të bizneseve. Projektet e CA do të fuqizojnë më tej lidhjet ndërmjet FS/forcave vendore të sigurisë dhe udhëheqësve lokalë, duke i shkëputur ata nga ndikimi i rebelëve dhe duke nxitur rritjen e ekonomisë lokale.

Një shënim që mendoj se është shumë i rëndësishëm për t'u theksuar është: përse i përket kontrollit vendor, procesi i përshkruar më sipër mund të zgjasë për shumë muaj, madje edhe vite, për të vendosur ndikimin afatgjatë në një fshat që më parë ishte neutral ose kundërshtar. Kjo kërkon që dhe pse njësitë e FS të ISAF-it (RSM) apo të misionëve *“Eagle”* duhet që me shumë kujdes dhe profesionalizëm, të gjithë rrjetin e

inteligjencës dhe informatorët e tyre të ngritur gjatë kohës së tyre në mision, tua kalojnë misioneve pas ardhëse. Kjo do të sjellë kursim kohe dhe burimesh financiare, rritjen e besueshmërisë nga ana e partnerëve amerikanë dhe në të njëjtën kohë do të rrisë kundërveprimin ndaj grupeve terroriste që veprojnë në zonën e tyre operacionale (Demiraj, 2013, 113).

Ndikimi i qeverisë së Afganistanit (GOA)

FS duhet të vendosin dhe të punojnë vazhdimisht për të forcuar lidhjet formale dhe jo formale ndërmjet qeverisë afgane dhe fshatit afgan në të cilin ndodhen këto forca të FS dhe trupave vendore. Kjo fillimisht ka për të qenë e vështirë, veçanërisht në fshatrat e “kontestuar” me pak ose aspak prani të qeverisë afgane (GOA). Forcat Speciale dhe trupat vendore duhet të bëjnë të mundur një takim fillestar ndërmjet politikanëve vendas të GOA (guvernatorët e provincës, ministrat e provincës, etj.) dhe udhëheqjes së fshatit. Qëllimi i këtij procesi është ndërtimi i një marrëdhënieje pozitive bashkëpunimi ndërmjet të gjitha palëve (FS, CF, GOA dhe fshatit) dhe vendosja më tej e legjitimitetit të FS dhe Trupave afgane të sigurisë si agentë të qeverisë afgane. Pikat kyçe të cilat duhet t’i bëhen të qarta fshatit, mund përfshijnë:

- Një forcë e kombinuar e FS dhe Trupave afgane të sigurisë do të jetojë në fshat dhe do të operojnë në zonë, derisa zona të qetësohet. Në këtë pikë, trupat e xhandartmarisë do të marrin fshatin nën kontroll.
- FS dhe Trupat afgane të sigurisë janë forca legjitime e sanksionuar e qeverisë afgane. Të gjitha veprimet e tyre janë të miratuara nga qeveria.
- Misioni i tyre është të ç’rrënjosë rebelimin nëpërmjet drejtësisë, ndershmërisë dhe nëse është e nevojshme edhe nëpërmjet përdorimit të forcës. Ata do të mbrojnë popullatën lokale nga rebelët.
- Për vendasit do të ofrohen projektet e bashkisë, investimet lokale, zhvillimi dhe asistencë mjekësore, nëse ata bashkëpunojnë me këto forca.
- Pritet që fshatarët të marrin pjesë në Forcën e Vetëmbrojtjes. Nga fshatarët pritet gjithashtu që të ofrojnë informacione për FS dhe Trupat afgane të sigurisë.
- Është në interes të fshatarëve që të asistojnë këto forca, pasi do të rezultojnë në siguri, stabilitet dhe prosperitet për fshatrat, fiset dhe qeverinë e Afganistanit.

Fshatarët e Afganistanit duhet të kuptojnë se FS dhe Trupat afgane të sigurisë operojnë me autoritetin e të vetmes qeverisje legjitime në Afganistan, të qeverisë së Afganistanit (GOA). Nga ana e tyre, këto forca duhet të punojnë pa u lodhur për të eliminuar çdo dyshim se qeveria afgane, nuk mund të ofrojë siguri dhe stabilitet për fshatrat e Afganistanit.

Neutralizimi i kryekomandantëve

Një nga konceptet e thella të *Forcës së Xhandarmërisë Afgane* (XH-CF) është aftësia e tyre për të neutralizuar grupet negative brenda shoqërisë vendase. Në Afganistan, kryekomandantët dhe militantët e tyre, kanë pasur një kontroll të fuqishëm mbi shumë fshatra. Kjo është jo produktive për misionin e xhandarmarisë. Trupat e xhandarmarisë duhet të jetë mbrojtësi i vetëm i popullatës, në nivel lokal. Në mënyrë që një trupë e tillë të jetë efektive, banorët vendas duhet të vënë në dyshim rolin mbrojtës të kryekomandantëve, ta shohin atë si të papërshtatshëm, ilegjitim dhe të vjetëruar. Mund të merren në konsideratë tre rrugë në lidhje me militantët kryekomandantë:

1. Asimilimi,
2. Largimi,
3. Ç'rrenjosja.

Mënyra më e preferuar është asimilimi i militantëve të kryekomandantëve në forcën e xhandarmarisë, pasi ata aktualisht kanë njohurinë bazë në lidhje me kontrollin e popullatës, janë të pajisur dhe të familjarizuar me përdorimin e armëve dhe më e rëndësishmja, janë jashtëzakonisht të lidhur me rrjetet sociale paraekzistuese të fshatrave. Këto rrjete sociale mund të ofrojnë zbulimin thelbësor të nevojshëm për të vënë në shënjestër rebelët.

Nëse militantët e kryekomandantëve nuk dëshirojnë të shërbejnë si ndihmës të *Forcës së Xhandarmërisë Afgane* (Xh-CF), atëherë ata duhet të ndërmarrin veprime për t'i zhvendosur militantët nga popullata vendase në largësi të tilla ku këta, ose nuk janë të nevojshëm, ose nuk mund të mbështeten nga popullata vendase. Forcat e xhandarmarisë duhet të provojnë se është forcë legjitime, se është forcë mbrojtëse e mbështetur në ligj për popullatën dhe se duhet që në mënyrë të vazhdueshme të

demonstrojë se militantët e kryekomandantëve janë më shumë pengesa e “botës së vjetër” për sigurinë dhe stabilitetin, sesa një aset që punon për ta. Me fjalë të tjera, këto trupa duhet të zëvendësojnë rolin e kryekomandantëve dhe militantëve të tyre. Nëse kjo (XH) kontrollon në mënyrë efektive popullatën, militantët nuk do të kenë më rol dhe do të armiqësohen me popullatën, duke u bërë rrjedhimisht të padëshiruar.

Së fundi, mundësia që militantët e kryekomandantëve të bashkohen me rebelët është një realitet konstant. Nëse militantët bëhen kërcënim, atëherë forcat e xhandarmarisë do t’i vënë ata në shënjestër si elementë rebelë. Forcat e xhandarmarisë duhet të përdorin të gjitha asetet e tyre për të ç’rrënjosur (larguar) militantë të tillë. Mbështetja popullore do të zhvendoset nga kryekomandantët dhe rebelët për tek forcat e xhandarmërisë dhe tek qeverisja qendrore afgane, vetëm atëherë kur këto forca të ofrojnë sigurinë për njerëzit të cilët banojnë në fshatra të sigurt dhe të stabilizuar.

Përfundime

Përfundimet e mëposhtme përfaqësojnë më së miri “thelbin” e fushatës jokonvencionale kundër kryengritëse:

Së pari, popullata e Afganistanit kryengritëse kontrollon nivelin strategjik; “*operationet pastro dhe largo*” nuk e realizojnë përgjithësisht këtë.

Së dyti, forcat paraushtarake të xhandarmërisë dhe forcat vendase të vetëmbrojtjes janë më efektive se trupat e trajnuara konvencionale dhe të organizuara, ANA dhe ANP.

Së treti, mbledhja e zbulimit “në bazë fshatrash” në nivel lokal është thelbësore për misionin dhe realizimin e tij deri në nivel strategjik.

Së fundi, FS duhet të jetë “forca kryesore” në vend të forcave konvencionale e veprimit të Aleancës në Afganistan.

KAPITULLI IV

FORCAT SPECIALE, PJESË E KOALICIONIT NË MISIONE BASHKËKOHORE

4.1. Angazhimi i Aleancës, misioni, përbërja, natyra e Forcave Speciale

“Unë do të dëshiroja që të koordinoja dhe sinkronizoja të gjithë aktorët e FS brenda Kabulit me qëllim përdorimin e tyre në mënyrë sa më efektive”.

Gjeneral Stanley McChrystal

Ish Komandant i ISAF-it

“Jawbreaker”

Forcat e para amerikane filluan operacionet brenda Afganistanit 15 ditë pas sulmit të 11 Shtatorit (Neville, 2008, 6). Një grup i vogël, nën emrin e koduar “*Jawbreaker*”, u infiltrua fshehtësisht nga ish baza ajrore sovjetike e *Karshi-Khandabad* (K2) në Uzbekistan, ku një prani elitë e FS Amerikane ishte ngritur me shpejtësi dhe ishte ulur në luginën e *Panjshir*-it mbi një helikopter MI-17, të ndërtuar nga rusët, por nën drejtimin e CIA-s, në darkën e 26 Shtatorit të vitit 2001. Të 8 anëtarët ishin pjesë e grupit special të CIA-s, nga *Divizioni i Aktiviteteve Speciale* (SAD) dhe nga *Qendra Kundër Terrorizmit* (CTC), ose siç njihen ndryshe nga njerëzit e FS, nën akronimin (*Other Government Agency*, OGA). Me përbërje nga ish operatorë të FS, ekspertë ndërlidhjeje dhe gjuhe, grupi solli me vete mjete komunikimi satelitore që ju mundësoi atyre “raportet e vërteta të përditshme të inteligjencës” direkt nga terreni, komunikimin dhe raportimin direkt në Shtabin e *Langleyt* (CIA-s) dhe CENTCOM-it, komandës ushtarake përgjegjëse për Operacionin “*Enduring Freedom*” (OEF), operacionin e ardhshëm të ushtrisë amerikane dhe të koalicionit të NATO-s në Afganistan. “*Jawbreaker*” kishte me vete dhe një sasi parash prej 3 milion dollarësh *cash*, me prerje 100-she, me anën e të cilave

do t'i bënin të mundur Aleancës së Veriut zgjerimin e bashkëpunimit me NATO-n në operacionin OEF.

Grupi “*Jawbreaker*” mundësoi infiltrimin e grupit të parë të *Forcave Speciale Amerikane* me komandantët e Aleancës së Veriut, të cilët i asistuan me avionin Komandës Qëndrore (CENTCOM) me informacionet dhe koordinatat për objektivat me rëndësi ajrore, sigurimin e aftësive për operacionet e *Kërkim-Shpëtimit në Luftim* (CSAR) dhe vlerësimin e dëmeve nga bombardimet për fushatën ajrore në vazhdimësi.

4.1.1. Operacioni Enduring Freedom, (OEF)


Operacioni “*Enduring Freedom*” filloi zyrtarisht mbrëmjen e 6 Tetorit të vitit 2001 me operacionin “*Crescent Wind*” të fushatës ajrore të koalicionit kundër objektivave Talebane të komandim-kontrollit dhe të mbrojtjes së tyre ajrore. Shumica e raketave kundërajrore Talebane SAM SA-2 dhe SA-3 së bashku me radarët dhe njësitë e tyre të komandimit dhe flotën e tyre të vogël ajrore të MIG-21 dhe SU-22, pothuajse u shkatërruan krejtësisht që në natën e parë. Duke marrë në konsideratë rrezikun e rrëzimit të avionëve në lartësi jo shumë të madhe, u përdor një strategji e re për përdorimin e tyre dhe vëmendja kryesore u përqëndrua në goditjen e infrastrukturës së Talebanëve, objektivave të drejtimit të trupave dhe të objekteve të al-Qaedës.

Këto objektiva u shkatërruan krejtësisht nga *Forcat Ajrore Amerikane* dhe avionët e *Forcave Mbretërore Angleze*, që përfshinin avionët e distancave strategjike si B-52H, B-1B dhe AC-130 të cilët vepronin nga baza ajrore K2 e Uzbekistanit dhe nga Pakistani. Në këtë mënyrë u hap dhe rruga për dislokimin e trupave nga toka. Struktura e *Forcave të Operacioneve Speciale* në operacionin “*Enduring Freedom*” ishte si më poshtë vijon: Nën komandën e përgjithshme të Gjeneralit *Tommy Franks*, komandant i forcave të koalicionit, CENTCOM, katër *Task Forca* kryesore u dedikuan për OEF: *Task Forca e Kombinuar e Përbashkët e Operacioneve Speciale* (CJSOTF), *Task Forca e Kombinuar e Përbashkët Malore* (CJTF-Mountain), *Task Forca Kundërterrorizmit e Përbashkët e Ndëragjensive* (JITF-CT) dhe *Task Force e Përbashkët e Operacioneve Civilo-Ushtarake* (CJCMOTF).

Task Forca e Kombinuar e Përbashkët e Operacioneve Speciale (CJSOTF) përbëhej nga tre *Task Forca* që vareshin prej saj: *Task Forca e Përbashkët e Operacioneve*

Speciale-Veriut (JSOTF-North), Task Forca e Përbashkët e Operacioneve Speciale-Jugut (JSOTF-South), Task Forca K-Bar dhe Task Forca top sekret Sword (më vonë Task Force 11)(Neville, 2008, 7).

STRUKTURA E FORCAVE TE OPERACIONEVE SPECIALE NE OPERACIONIN“ENDURING FREEDOM”



Skicë 4-1. FS të NATO-s që vepronin në Afganistan në vitin 2001

Task Forca Dageer

Task Forca e Përbashkët e Operacioneve Speciale të Veriut (JSOTF-North), e drejtuar nga Kolonel John Mulholland, u formua nga Grupi 5-të i FS Amerikane dhe me mbështetje ajrore të integruar nga Regjimenti i Aviacionit i 160-të i Operacioneve Speciale (SOAR). Task Forca Dageer u krijua me qëllim kryerjen e operacioneve speciale në Veri të Afganistanit dhe me detyrë infiltrimin e grupeve speciale, këshillimin dhe mbështetjen e komandantëve të Aleancës së Veriut. Këto grupe speciale, të përbërë nga 12 vetë dhe me mbështetjen ajrore nga grupet e Taktikave Speciale të Forcave Ajrore, punuan në bashkëpunim me asetet e CIA-s, të cilët tashmë vepronin në terren. Detyra kryesore e këtyre grupeve speciale ishte kryerja e një nga detyrat kryesore të tyre, misionit të stërvitjes së ushtrive të tjera (FID), infiltrimin e forcave guerile nga jashtë Afganistanit, rritjen e kapaciteteve të tyre operacionale, këshillimin dhe drejtimin direkt të tyre në operacione. Meqenëse në përbërje të grupit special prej 12 vetësh secili ka specialitetin e tij, duke filluar me operacionet, zbulimin, hedhjen në erë dhe përdorimin e eksplozivave, ndërlidhjen, armët, ndihmën e shpejtë, një

Task Force K-Bar

www.iranica.com

LEGEND

- International Boundary
- - - Province Boundary

Harta 4.1. Harta e politike e Afganistanit

Task Force Sword

TF Sword/TF 11 ka qenë *Komanda e Bashkuar e Operacioneve Speciale* (JSOC), e quajtur forcë “ndjekjeje-asgjësimi”, me misionin e vetëm kapjen ose asgjësimin e liderëve më të rëndësishëm (HVTs) të al-Qaedës dhe Talebanëve. *Task Force Sword* përbëhej nga 2 skuadronet operatorësh të *Njësisë së Misioneve Speciale* (SMU) nga *Delta Forces*³(CAG) të *Grupit të 6-të Seal Team* (DEVGRU), të mbështetur nga grupe sigurimi *Renxhërs* dhe nga specialistë zbulimi të CIA-s dhe të NSA-së.

CAG-Detashmenti i 1-rë i Operacioneve të FS –Delta është i modeluar sipas organizimit të SAS-it anglez dhe misioni i tyre parësor është *Goditja Direkte*, Çlirim Pengjesh dhe *Zbulimi Special*. Të 3-ja Skuadronet (A, B dhe C) secili janë të ndarë në 3 toga, dy të parat të specializuara për *Goditje Direkte* dhe tjetri për *Zbulim Special*.

Njësia DEVGRU është Grupi 6 i Navy Seals, i cili fillimisht u krijua si një njësi antiterrorizmi, ekuivalent me *Delta Forcën* e Ushtrisë Amerikane dhe detyrat e saj janë të njëjta me ato të FS të Deltës: dy grupe të specializuara për *Goditje Direkte* dhe një për *Zbulim Special*.

Grey Fox ishte njësia më sekrete e reparteve të *Komandës së Bashkuar të Operacioneve Speciale* (JSOC), e cila është e stërvitur dhe e pajisur me mjetet më të sofistikuar në botë për grumbullimin me luftim të zbulimit për këto reparte, përmes metodave elektronike (ELINT) sinjaleve (SIGINT) dhe metodës më tradicionale me njerëz (HUMINT). Ajo ka një eksperiencë të madhe gjatë misioneve të ndryshme për kapjen e *Objektivave të Rëndësishme* (HVT) në Ballkan, Somali dhe në Kolumbi.

Forcat e koalicionit të cilat qenë të atashuara në *TF Sword* mbështetën kryesisht operacione specifike. *FS Angleze*, në mënyrë të veçantë SBS, ishin kryesisht në mbështetje të misioneve me kohë të gjatë. Në fillim të operacioneve, vetëm *FS Amerikane* dhe *FS Angleze* kanë luajtur rol kryesor. Forcat e tjera të koalicionit kanë kryer vetëm misionet *Zbulimi Special* dhe të *Kontrollit të Zonave Sensitive* (SSE) (Chant, 2012, 161-162).

Task Forca e Përbashkët e Luftimit Malor (CJTF-Mountain)

Task Forca e Përbashkët e Luftimit Malor ndahej në tre *Task Forca* të tjera si psh: TF-64 me përbërje nga SAS-i Australian, TF-58 nga *Korpusi i Marinës* së SHBA,

TF Jakana, një grup luftimi me 1700 persona dhe me Njësia 45 Komando i të *Marinës Mbretërore*.


Operacionet e Forcave Speciale në Afganistan, Tetor-dhjetor 2001

Grupet e Forcave Speciale (ODA-s)

Gjatë ecurisë së sulmeve ajrore, *Task Force (TF) Dagger* po planifikonte infiltrimin e grupeve të para në Afganistan, nëpërmjet K2 (Mali i dytë në botë pas Everestit për nga lartësia). Aviatorët e Batalionit të 2-të '*Nightstalkers*' - emërtim i *Regjimentit të 160-të Operacioneve Speciale Ajrore*-ishin në pritje të një moti më të mirë dhe mbanin në gatishmëri helikopterët MH-47E (*Chinook*) dhe MH-60L (*Black Hawk*, i modifikuar për aksione direkte) për të operuar me lehtësi në malet e *Hindu Kush*-it.

Pas dy javë bombardimesh ajrore, 2 grupet e para të Forcave Speciale u infiltruan në Afganistan natën dhe në orët e para të 19-20 Tetorit të vitit 2001. Grupi i parë special që u infiltrua ishte (ODA) 555, i përbërë nga 12 vetë. Ky grup u bashkua me "*Jawbreaker-in*" në Luginën *Panjshir*-it dhe u dërgua në një shtëpi të sigurtë për të takuar përfaqësues të *Fahim Khan*-it, që ishte zëvendësi i *Masud*-it, si komandat i Aleancës së Veriut. Ky grup filloi të operonte përkrah forcave të *Khan*-it që ditën e nesërme.

Moti atë natë ishte tepër i rrezikshëm për dy helikopterët MH-60L, të cilët ishin shoqërues të helikopterëve MH-47E që mbanin 12 veta të grupit special 595. Ata u detyruan të kthehen në pikën e nisjes në K2. Shkaqet për kthim ishin lartësia 5000 m e maleve dhe mundësia e krijimit të akullit në helikat e helikopterëve. Pavarësisht këtyre vështirësive, ekuipazhi i MH-47E ishte në gjendje të përfundonte misionin dhe bëri të mundur zbarkimin e grupit special 595, rreth orës lokale 0200 AM në luginën *Dari-a-Souf*, në Jug të qytetit të *Mazar-e-Sherif*-it. Ky grup special u bashkua, në zonën e zbarkimit, me luftëtarët e komandantit etnik uzbek Gjeneral *Abdur Rashid Dostum*, që ishte komandanti i njësisë më të madhe të forcave të Aleancës së Veriut. Gjeneral *Dostum*-i zotëronte një kontroll të fortë rreth qytetit të *Mazar-e-Sherif* dhe ishte gjithashtu dhe një politikan i zgjuar. Ai kishte krijuar më parë aleanca, por edhe i kishte tradhtuar ato, si me sovjetikët, me qeverinë kukull të tyre në Kabul, por dhe me Talebanët.



Harta 4.2. Drejtimet kryesore të hyrjes së FS Amerikane në Afganistan, në vitin 2001

Sulmet në Kandahar

Në të njëjtën kohë, në Jug të Afganistanit, po zhvillohej një operacion tjetër special i rëndësishëm. Rreth 200 *Renxhërs* të *Batalionit të 3-të të Regjimentit të 75-të të Renxhërs-ave*, bashkë me parashutistë të *Skudriljes së 23-të të Taktikave Speciale*, kryen një infiltrim me hedhje me parashuta mbi një zonë në Jug-perëndim të Kandaharit, duke përdorur avionë MC-130P (avion ushtarak i serisë *Talon*, që përdoret nga *Forcat Ajrore të SHBA-së*) nën komandën e Kolonel Frank J. Kisnerit.

Të paraprirë nga një grup i vogël inteligjence, *Renxhërs*-at hasën shumë pak rezistencë nga Talebanët. Ata qenë në gjendje të siguronin shumë shpejt objektivin e koduar me emrin “*RHINO*”. Hedhja me parashutë u filmua dhe u paraqit në televizion nga Pentagoni, për të treguar se forcat amerikane ishin në gjendje të vepronin në çdo

zonë të Afganistanit-një mesazh psikologjik për Talebanët. Misioni i *Renxhërs-ave* shërbeu për sigurimin e zonës nga *Marinsat*, për krijimin e *Bazës Operacionale të Përparuar "RHINO"*. Gjatë këtij operacioni nuk kishte të plagosur, por dy *Renxhër*-sa humbën jetën në një aksident ajror, të shkaktoar nga një stuhi rëre dhe jo nga armiku.

Në të njëjtën kohë, një tjetër mision po zhvillohej në afërsi të Kandaharit. Duke qenë se ky mision është akoma i klasifikuar, nuk mund të përmenden shumë detaje, por mund të thuhet se objektivi i këtij misioni ishte kapja ose vrasja e udhëheqësve talebanë. Misioni nisi nga aeroplanmbajtësja *Kitty Hawk*, që shërbente si bazë lundruese e FS në Oqeanin Indian. Njësitë e terrenit u morën nga *Grupi i Aplikimeve Luftarake* (CAG ose Forcat *Delta*) të *Komandës së Përbashkët të Operacioneve Speciale* (JSOC) dhe të mbështetur gjithashtu nga *Skuadrilja e 23-të e Taktive Speciale Ajrore*. Objektivi kryesor në Kandahar ishte një nga rezidencat e *Mullah Omar*-it. Megjithëse *Mullah Omar*-i nuk u gjend në rezidencë, u grumbullua informacion i rëndësishëm pas goditjes. Gjatë kohës që *Forcat Delta* po tërhiqeshin nga objektivi, ranë në kontakt me zjarrin e disa forcave talebane me armatim të lehtë dhe granatëhedhës.

Operatorët e *Delta* Forcës u përgjigjen me zjarr dhe devijuan kontaktin me armikun me anë të ndihmës së një avioni luftarak AC-130. Forcat *Delta* ishin në gjendje të shkëpusin kontaktin dhe të tërhiqeshin me ndihmën e helikopterëve të *Regjimentit të 160-të Operacioneve Speciale Ajrore* (160th SOAR). Në raportin e misionit, thuhet se nuk kishte shumë të plagosur, por sipas thashethemeve, rastet e plagosjeve ishin më shumë nga ç'pretendohej. Forcat *Delta* kishin planifikuar të linin mbrapa një grup për *Zbulim Special*, por meqenëse kishin goditje të vazhdueshme nga Talebanët, kjo gjë nuk u bë e mundur. Një provë që tregon ashpërsinë e luftimit me Talebanët, është një video e tyre, e cila tregon një gomë të shkëputur nga një helikopter që po ndihmonte në tërheqjen e Forcave *Delta*. Kuptohet, Talebanët e përdorën atë gomë për propagandë, duke pretenduar se është pjesë e një helikopteri amerikan, të rrëzuar nga forcat e tyre. (Neville, 2008, 14).

Aleanca e Veriut

Gjatë kohës kur *Task Forca* (TF) *Sword* po kryente goditjet në Kandahar, grupi special 595 po forconte lidhjet me Gjeneral *Dostum*-in në Veri. Grupi ishte ndarë në dy nëngrupe: *Alfa* dhe *Bravo*. Nëngrupi *Alfa* po lëvizte drejt vendkomandës së Gjeneral *Dostum*-it, për të planifikuar sulmin e *Mazar-e-Sherif*-it. Ndërsa nëngrupi *Bravo* lëvizi

në drejtim të maleve *Alma Tak*, për t'u përgatitur për pastrimin e luginës *Dari-a-Souf*.

Në datën 20 Tetor 2001, grupi vuri në përdorim të parin JDAM (Joint Direct Attack Munition) ose '*bombë e zgjuar*' nga një avion B-52H. Gjeneral *Dostum*-i u impresionua tej mase duke komentuar "Ju bëtë të mundur shfaqjen e një avioni që bombardon, Gjeneral *Dostum*-i është tepër i kënaqur". *Dostum*-i shumë shpejt filloi të tallej me Talebanët nëpërmjet komunikimit në radio, një aspekt i veçantë i luftës midis Talebaneve dhe Aleancës së Veriut, por edhe një shembull konkret i luftës psikologjike: ***"Unë që po flas jam Gjeneral Dostum. Unë jam këtu dhe kam marrë amerikanët me vete këtu kundër jush....!"***

Ushtria e SHBA-së zhvillonte operacione psikologjike (PSYOPS) me anë të avionëve EC-130E që transmetonin sinjale radioje në dialektet *Dari* dhe *Pashtun*. Avionë të tjerë hidhnin fletushka ku thuhej se Talebanët dhe al-Qaeda janë kriminelë si dhe fletushka të tjera ku reklamohej një çmim prej 25 milion dollarësh për kokën e *Osama bin Ladenit*.

Nëngrupi *Bravo* i grupit special 595 po koordinonte goditjet ajrore në zonën e tyre, duke prerë linjat e komunikimit dhe të përforcimit të Talebaneve. Suksesi i goditjeve ajrore bëhej i qartë edhe më tepër, pasi forcat Talebane po tërhiqeshin në një rreth më të ngushtë në drejtim të qytetit të *Mazar-e-Sherif*-it. Forcat e Gjeneral *Dostum*-it dhe nëngrupi *Alfa* i grupit special 595 vazhdonin sulmin drejt qytetit dhe ndalonin, me raste, për të dhënë udhëzime për sulme të mëtejshme ajrore.

Në rrafshnaltën *Shomali*, grupi special 555 dhe një grup tjetër me forcat e *Fahim Khan*-it kërkuan goditje ajrore në pozicionet transhé të Talebanëve, në Jug-lindje të bazës ajrore të *Bagram*-it. Grupi special vendosi një pikë vrojtimi në një nga kullat e kontrollit ajror, duke e përdorur atë si një bazë për shënjesin *lazer* të FS AN/PEQ-1 SOFLAM dhe shënjoi dy bomba 6800 kg (BLU-82 *Daisy Cutters*), të cilat shkatërruan mbrojtjen e Talebanëve.

Në datën 5 Nëntor 2001, përparimi i Gjeneral *Dostum*-it dhe forcave të tij u ndalua në fshatin e *Bai Becheit*, në luginën tepër të rëndësishme të *Dari-a-Souf*, ku dy sulme të forcave të Aleancës së Veriut ishin shtyrë nga forcat Talebane. Gjatë kohës që grupi special 595 po përgatiste goditjet ajrore, Gjeneral *Dostum*-i po përgatiste njerëzit e tij për një sulm ballor menjëherë mbas sulmit ajror. Ky sulm nuk u koordinua mirë dhe 250 kalorës uzbekë sulmuan, në të njëjtën kohë kur bombarduesi B-52 u

afrua për të bombarduar pozicionet Talebane. Një nga operatorët e grupit special 595 e përmend këtë moment në librin *“War made new”* të *Max Boot-it* ku thuhet “Tre apo katër bomba goditën qendrën e pozicionit të mbrojtur Taleban. Menjëherë pasi bombat shpërthyen, kalorësit uzbekë kaluan përmes pozicionit armik, duke i kapur ata në befasi. Armiku ishte tepër i çoroditur. Në të njëjtën kohë, shikoja se si formacioni i kalorësve çau mes përmes zonës së shpërthimit. Ishte pamja më e bukur që kisha parë ndonjëherë. Të gjithë ishim të gëzuar. Aksioni nuk ishte koordinuar mirë, por nuk do të harrohet asnjëherë” (Mullholland, 2001). Kishte raste kur shkactohej dhe ndonjë problem politik, në rastet kur sulmet ajrore amerikane nuk planifikoheshin në kohën e duhur dhe jo me shumë precizion nga zjarri i avionëve amerikanë. Kjo ndikonte keq në miqësinë midis Gjeneral *Dostum*-t dhe amerikanëve, një marrëdhënie tepër e vyer për qëllimet e amerikanëve në Afganistan. Fatmirësisht, fati erdhi në ndihmë dhe sulmi ballor pati sukses për thyerjen e radhëve të armikut.

Grupe të tjera speciale po infiltroheshin njëri pas tjetrit në intervale të rregullta. Në datën 23 Tetor, grupi special 585 u infiltrova në afërsi të *Konduz-it* për të ndihmuar komandantin *Burillah Khan*. Në datën 2 Nëntor, grupi special 553, i përbërë nga 10 vetë, u infiltrova në luginën *Bamian* me forcat e Gjeneral *Kareem Kahlili*-t dhe grupi special 534 u infiltrova në luginën *Dari-a-Balkh* për të mbështetur Gjeneral *Mohammed Atta*, një shok i Gjeneral *Dostum*-it dhe kryetar i milicisë së *Jaamat-e-Islamit*. Një operator i grupit special 534 kujton: “Grupi ishte në gjendje të infiltrohej në Veri të Afganistanit me *Chinook*, mbrëmjen e datës 2 Nëntor, pas disa ditësh me mot të keq. Në qoftë se infiltrimi me helikopter do të dështonte, ishte planifikuar që të infiltroheshim me parashuta, ditën e nesërme”. Përveç grupit special prej 12 vetash dhe 2 grupeve të *Kontrollit Luftarak të Forcave Ajrore* ishin të bashkangjitur edhe 3 oficerë të një agjencie tjetër. Ky grup i agjencisë tjetër përbëhej nga një oficer që njihte dialektin *Dari*, një oficer i *Seals* dhe një ish-oficer i FS. I gjithë grupi u takua me forcat e Gjeneral *Atta*-s dhe një oficeri tjetër që ishte infiltroar përpara dy javësh dhe kishte punuar me Gjeneral *Dostum*-in. Ky oficer mori nën komandë grupin e agjencisë, kurse pjesa tjetër e grupit dhe grupi special 595 qëndruan me gjeneral *Dostum*-in. Njohja e gjuhës ruse e komandantit të njërit nga grupet speciale, i erdhi në ndihmë kur mbërritën në zonën “RON”. Kur grupi u nda, përkthyesi kryesor midis grupit dhe Gjeneral *Atta*-s, ishte oficeri njohës i dialektit *Dari*.

Grupet speciale 586 dhe 594 erdhën në Afganistan në datën 8 Nëntor nëpërmjet helikopterëve MH-47 dhe nga helikopterë Mi-17 të CIA-s, në kufirin Afgano-taxhik. Grupi special 586 u vendos në *Konduz* me forcat e Gjeneral *Daoud Khan*-it, kurse grupi special 594 u vendos në *Panjshir*, për t'i ardhur në ndihmë grupit special 555.

E gjithë fushata zgjati më pak se 2 muaj, 49 ditë në total, duke filluar nga infiltrimi i grupit special të parë, deri në rënien e Kandaharit. Kjo u bë e mundur nga vetëm 100 operatorë të forcave speciale dhe 100 agjentë të tjerë, të mbështetur nga forcat aleate të Aleancës Veriore (Neville, 2008, 18).

Operacionet në Tora Bora

Pas rënies së Kabulit, elementë të al-Qaedës, përfshirë edhe bin Ladenin dhe fi të tjera, u tërhoqën në qytetin Lindor të *Xhalalabad*-it, kryeqyteti i provincës së *Nangarhar*-it. *Xhalalabad*-i ishte shumë afër *Tora Borës*, e cila ishte qendra e një sistemi të tërë shpellash dhe mbrojtjeje, e ndërtuar nga muxhahedinët gjatë luftës kundër sovjetikëve. *Tora Bora* gjendet në *Malet e Bardha*, që janë rreth 15 km larg kufi me Pakistanin. Zona ishte shumë e njohur nga bin Ladeni, pasi kishte qëndruar atje me muxhahedinët, gjatë viteve 1980. Ai e dinte që sistemi i shpellave do të siguronte një mbrojtje të mirë. Një sistem të tillë forcat sovjetike nuk ishin kurrë në gjendje ta pushtonin.

Informacionet që vinin nga agjensitë e zbulimit, raportonin se figura të rëndësishme të al-Qaedës po lëviznin për strehim nga *Xhalalabadi* në drejtim të *Tora Borës*. Për shkak të kundërshtimeve të shumta për të përdorur forca të rregullta për një sulm në *Tora-Bora*, u vendos që forcat speciale, të mbështetura nga milicia lokale, të kryenin një sulm të tillë. *Grupi special 572* dhe një grup i vogël operatorësh këshillonin vazhdimisht dy komandantët, *Hazrat Aliun* dhe *Mohhamed Zamanin*, të cilët nuk shkonin mirë me njëri-tjetrin. Rreth 2500-3000 milicë afganë u rekrutuan nga CIA, për të izoluar dhe shkatërruar elementë të al-Qaedës, të fshehur në *Tora Bora*.

Lideri i një grupi të CIA-s kërkoi që *Renxhërs*-at e *Batalionit të 3-të* të bllokonin rrugëkalimet që mund të përdoreshin për tërheqje nga *Tora Bora*, por komandanti i *Komandës së Përbashkët të Operacioneve Speciale* (JSOC) e refuzoi këtë kërkesë. Mbështetja logjistike, veçanërisht përdorimi i helikopterëve, do të kishte qenë tepër e vështirë, edhe pse lideri i "*Jawbreakerit*" dhe Gjenerali i *Marinsave James Mattis*, e

dinin se përdorimi i *Renxhërs*-ave do të kishte sjellë sukses. Por duhet patur parasysh se FS në bashkëpunim me milicinë afgane, kishin qenë shumë të suksesshme deri në momentin e operacionit të *Tora Borë*-s.

Në fillim të sulmit, *Grupi Special 572* kërkoi goditje ajrore me B-52H, gjatë kohës kur forcat afgane sulmonin pozicionet e al-Qaedës (Neville, 2008, 161). Forcat afgane, herë fitonin territor, herë e lëshonin atë. Në një pikë, *Grupi Special 572* u detyrua të tërhiqej pasi forcat afgane humbën entuziazmin për të vazhduar sulmin.

Duke parë këtë situatë, *Komanda e Përbashkët e FS* shtoi për ndihmë rreth 40 operatorë të *Delta Forcës* nga *Skudroni B*, të cilët arritën në *Tora Bora*. Grupe të vogla të tyre morën komandimin taktik nga CIA dhe iu bashkëngjitën komandantëve të forcave afgane. Forcat afgane filluan të përparojnë nën drejtimin e grupeve speciale, operatorëve të *Deltës* dhe anëtarëve të CIA-s, por çuditërisht në datën 12 Dhjetor *Mohammed Zamani*, filloi të negocionte një armëpushim me forcat e al-Qaedës, duke iu dhënë mundësi një numri armik prej më shumë se 1000 vetash, përfshirë dhe anëtarëve të Brigadës 055, të largoheshin gjatë natës në drejtim të Pakistanit (Chant, 2012, 160). Në disa raste është raportuar se agjentë të filtruar nga CIA kanë ndihmuar forcat e al-Qaedës, përfshirë dhe bin Ladenin, që të largoheshin për në Pakistan (Neville, 2008, 20). Një thashethem tregonte se një shumë prej 6 milionë dollarësh i është dhënë *Hazrat Aliut* për të udhëhequr lidërsipin e al-Qaedës në arratisje dhe shpëtim. *Gary Berntsen*, drejtuesi i grupit të CIA-s në *Tora Bora*, beson që dy grupe të mëdha të al-Qaedës janë larguar në këtë kohë: njëri grup me rreth 135 vetë është drejtuar nga Lindja në Pakistan, kurse Bin Ladeni me 200 xhihadistë Sauditë dhe Jemenas mori shtegun e mbuluar nga bora përmes *Parachinarit*.

Në datën 17 Dhjetor, beteja po merrte fund. Sipas raporteve, shumë pjesëtarë të al-Qaedës ishin vrarë dhe rreth 60 prej tyre ishin kapur në *Tora Bora*. Në anën tjetër të kufirit, zbuluesit Pakistanezë të ISI-t, të ndihmuar nga *Komanda e Përbashkët e Operacioneve Speciale* (JSOC) dhe CIA kanë kapur rreth 300 luftëtarë armiq. *Grupi Special 561* është infiltruar në datën 20 Dhjetor për të ndihmuar *Grupin Special 572* që të kryente kontrole dhe pastrime të sistemeve të shpellave dhe të marrë kampione të ADN-së nga trupat e pajetë të forcave të al-Qaedës.

Operacioni “ANAKONDA” 2002¹¹

Në muajin Shkurt të vitit 2002, një grup analistësh inteligjence të FS për *Task Forcën Bowie*, identifikuan struktura në produktet e zbulimit, që i çoi në përfundimin që të besonin se forca të mbijetuara të al-Qaedës po mblidheshin në Luginën e poshtme të *Shah-e-Khotit*, 90 km në Jug të *Gardezit*. Lugina e poshtme e *Shah-e-Khotit* ndodhet në kufi me *Territoret Fisnore të Pakistanit*, brenda së cilës shumë luftëtarë të al-Qaedës besohet se ishin larguar dhe kishin shpëtuar gjatë betejës së *Tora Borës* (Neville, 2008, 166). Përveç këtyre dhe specialistë të *Task Forcës Dagger* dhe të CIA-s që po bënin të njëjtat lidhje. Analistët e *Task Forcës Bowie*, të mbështetur me HUMINT nga anëtarë të CIA-s dhe SIGINT nga NSA, dyshonin se rreth 150-200 luftëtarë të al-Qaedës ishin duke u fshehur në luginë dhe me mundësi të mëdha të pranisë së drejtuesve kryesorë. Menjëherë një operacion i rëndësishëm që njihet ndryshe me emrin operacioni “Anakonda”, filloi të planëzohet. Fillimisht dy grupe nga *Delta Force* dhe një grup nga DEVGRU (Grupi 6 Seals) u infiltruan në disa vende rreth operacionit me mision *Zbulimi Special* që të siguronin informacion të përditësuar për planëzuesit si me foto dhe filmime nga aktiviteti i përditshëm (Chant, 2012, 166). Grupi i Seals zbuloi një pozicion të al-Qaedës, të mbrojtur me mitralozë 12,7 mm, afër vendit të zbulimit special.

Plani përfshinte *Task Force Hammerin* dhe *Task Force Anvil*, një grup të milicisë afgane, të drejtuar nga 3 grupe speciale (394, 372 dhe 594) dhe të mbështetur dhe nga një patrullë e SAS-it australian. *Task Force* duhej të futej në Luginën e poshtme të *Shah-e-Khotit*, në mënyrë që t’i shtynte ata që fshiheshin atje jashtë në fshatrat e vegjël, ndërsa *Task Forca Anvil* do të vepronte si forcë bllokuese që të mos i lejonte të arratiseshin. Disa grupe të SAS-it Australian nga TF-64 dhe të forcave speciale të koalicionit do të organizonin një perimetër të jashtëm me disa pika të zbulimit special për të thirrur mbështetje ajrore për ndonjë forcë në tërheqje të al-Qaedës.

4.1.2. E ardhmja e ISAF-it dhe e FS-ve

Francezët tërhoqën kontingjentet e tyre të Komandës së SOF, në Veri të provincës *Nangarhar*, nga OEF-ja, në fillim të vitit 2007, pas zgjedhjes së presidentit Nikola Sarkozy, me idenë se ditët e kontributit të forcave Franceze, në misionin e

ISAF-it po mbaronin. Norvegjia vazhdoi të kishte praninë e saj, por grupi prej 150 trupash është i kufizuar të vepronte në mbështetje të ANA, në zonën e Kabulit. Gjermania gjithashtu tërhoqi kontingjentin e saj KSK nga OEF, duke i ripozicionuar dhe vendosur përkrah forcave Gjermane të ISAF-it në *Mazar-e-Sharif*, një lëvizje jo popullore me forcat e KSK-së, të cilët kishin ndërtuar një marrëdhënie të shkëlqyer me kolegët e tyre FOS të NATO-s. Në përdorimet operacionale nga vendet anëtare të NATO-s, kufizimet sa erdhën dhe u bënë më të shpeshta, pavarësisht thirrjeve të vazhdueshme nga amerikanët dhe anglezët që kufizime të tilla në mbështetje të ISAF-it, mund të kishin efekte drastike në përfundimin e luftës në Afganistan.

Disa grupe të SAS-it të Australisë nga TF-64, së bashku me SOTG Polake në Jug të Afganistanit dhe SOTG Rumune, vazhduan me sukses operacionet dhe ishin të gatshëm për çdo goditje të al-Qaeda.

Pjesëmarrja e FS në Afganistan, në vitin 2011.

Nga datë 7 Tetor 2010-7 Tetor 2011, komandant i FS në Afganistan ka qenë Gjeneral Brigade i ushtrisë angleze, *Mans Lance* dhe njëkohësisht ish-komandant i SAS-it. Gjatë kohës që ai mori komandën janë zhvilluar shumë operacione të suksesshme si psh: vrasja e bin Ladenit, si dhe shumë operacione të tjera.

Pjesëmarrja me FS sipas shteteve është si më poshtë vijon:

- Britania 704 persona
- Polonia 186 persona
- USA 164 persona
- Italia 164 persona
- Gjermania 121 persona
- Sllovakia 20 persona
- Australia 324 persona
- Zelanda e Re 40 persona
- Lituania 64 persona
- Rumania 56 persona
- Hungaria 18 persona

- Franca 23 persona
 - Çekia 97 persona
 - Danimarka 2 persona
 - Suedia 41 persona
 - Shqipëria 45 persona
- Gjithsej 1983 personel.**

Të dhëna për operacionet speciale të kryera nga data 7 Tetor 2010-7 Tetor 2011 të FS të NATO-s.

- Operacione 4056.
- Operacione me Policinë Afgane 764.
- Objektiva të vrarë Talebanë 851 vetë.
- Të arrestuar 2708 vetë.
- Drogë e sekuestruar 89 ton (me vlerë 560 milion dollarë).
- Eksplozivë dhe materiale MSHI 65 ton.
- Të vrarë nga FS 8 vetë (3 australianë, 1 anglez, 1 amerikan, 1 francez, 2 rumunë).
- Të plagosur 91 persona.

16 shtete kishin dislokuar TF në Afganistan.

Të dhëna për operacionet e FS në vitin 2011-2013 ishin:

Në datën 7 Tetor 2011- 7 Tetor 2012 komandën e FS e mori Gjeneral Brigade Mark Smethurst i SAS-it të ushtrisë Australiane (raporti në datën 16 Nëntor 2011) (Demiraj, 2001).

- Operacione 238 copë.
- Operacione me Policinë Afgane 45 copë.
- Objektiva të vrarë 82 vetë.
- Të arrestuar 702 vetë.
- Drogë e sekuestruar 47 ton (me vlerë 430 milion dollarë).

- Operacione pezull TBD 9 copë.

Në mes të vitit 2011 u krijua *Special Operations Joint Task Force-Afganistan* (SOJTF-A) e drejtuar nga Gjeneral Major *Tonny Thomas* US Army SF, nën komandën e të cilit vepruan 2257 trupa, 19 Kompani Speciale të Provincave Afgane (policie) me personel 4400 operatorësh dhe 19 reparte të Inteligjencës dhe të Zbulimit Afgan. Kjo komandë përbëhej nga 22 shtete dhe ndahej në 6 SOTF me 65 grupe speciale dhe reparte të mbështetjes së luftimit (5500 trupa në total) (Demiraj, 2001).

Rezultatet e mëposhtme janë realizuar vetëm për 90 ditë shtrirje kohe.

- Operacione popullsie 4230 copë.
- Operacione kinetike 1966 copë.
- Operacione natën 1966 copë.
- Arrestime personash drejtues 1294.
- Terroristë të vrarë në operacione 1016 persona.
- Terroristë të kapur në operacione 2207 persona.

Sasia e përgjithshme e komandove Afgane që vepronin në ushtrinë afgane është 8725 persona.

Nga ana e TF 3-10 SOF në Afganistan janë kryer 5003 operacione.

Gjatë operacioneve “HAYMAKER” janë realizuar:

- Sulme (DA) 58 copë.
- Terroristë të vrarë 166 persona.
- Terroristë të arrestuar 65 persona.
- Jack Pots 36 të arrestuar.

Rezultatet e arritura në këto operacione llogariten të jenë të njëjta me ato që janë arritur në 3 vjet të marra së bashku.

Në takimin e komandantëve të FS të NATO-s në Litvius të Lituanisë në datën 2-5 Tetor 2012, Gjeneral Brigade *Mark Smethurst* (COM ISAFSOF) raportoi se

“afganët në bazë të vlerësimeve që kemi bërë do të mund të marrin vetë në dorë sigurinë e vendit në fund të vitit 2016 dhe fillin të vitit 2017.” Gjë e cila në fakt nuk ka ndodhur akoma dhe sot.

Pjesëmarrja me FS sipas shteteve ishte 18 shtete dhe ndaheshin si më poshtë vijon:¹

- Britania 707 (110 FS persona, pjesa tjetër ishin mbështetje me luftim, CSS).
- Polonia 182 (60 FS).
- USA 169 (70 FS).
- Italia 165 (55 FS).
- Gjermania 125 (46 FS).
- Sllovakia 20 (12 FS).
- Sllovenia 4
- Australia 308 (110 FS).
- Norvegjia 35 (12 FS).
- Zelanda e Re 2
- Lituania 74 (24 FS).
- Rumania 73 (36 FS).
- Hungaria 17 (6 FS).
- Franca 146 persona.
- Danimarka 47 (12 FS).
- Suedia 20 (6 FS).
- Estonia 1 person.
- Latvia 12 persona.
- Finlanda 5 persona.
- Shqipëria 50 (40 FS ne kishim vetëm 10 operatorë për mbështetje me luftim, CSS).

Gjithsej afërsisht 2060 persona (ISASOF).

Të dhëna për Operacionet Speciale të kryera nga data 1 Tetor 2011-5 Tetor 2012 të FS të NATO-s (ISAFSOF):²¹

1. Br Smethurst COMISAFSOF, NATO SOF meeting- Monx - The future of SOF ISAF missions in Afghanistan 16 november 2001.

- Operacione 4265.
- Operacione me Policinë Afgane 59 % të drejtuara nga afganët.
- Objektiva të vrarë 968 vetë.
- Objektiva të plagosur 112 vetë.
- Të arrestuar 2716 vetë.
- Jak Pots të kapur 320 vetë.
- Drogë e sekuestruar 91 ton (me vlerë 595 milion dollarë).
- Eksplozivë dhe materiale MSHI 112,2 tonë.
- Efektiva afganë që kanë marrë pjesë në operacione 5552 vetë (Komando).
- Të vrarë nga trupat e FS të NATO-s 7 (1 shqiptar Kapiten Feti Vogli, 4 anglezë, 1 amerikan dhe 1 australian) dhe 55 të plagosur.
- Të vrarë nga FS Afgane 32 dhe të plagosur 96 vetë.

Komanda e FS të NATO-s nga Tetori i vitit 2012 për një vit i kaloi një gjenerali të FS të ushtrisë Angleze (SBS).

U krijua Shkolla e FS të Policisë Afgane (SPTC-Wardak) në të cilën për 1 vit janë stërvitur 696 studentë. Në fillim të vitit 2013 nga ana e MM shqiptare u dërguan atje si instruktorë dhe 5 persona nga BFS.

- Ajo që do të theksohet këtu është sasia e operacioneve që kanë kryer FS të Policisë Afgane.

Plani ishte që FS të vazhdonin të veprojnë në terren deri në vitin 2020 me një Gjeneral me 3 yje në krye.

Detyrat kryesore ishin:

1. Ngritja dhe rritja e kapaciteteve të Komandës së Forcave të Operacioneve Speciale të ushtrisë afgane me një Gjeneral Major në krye.
2. Rritja e kapaciteteve për stërvitje të Shkollës së Trajnimeve Speciale të policisë Afgane në Wardak (SPTC), Afganistan.
3. Ndërtimi dhe zhvillimi i kapaciteteve të qëndrueshme të FS të policisë afgane.

4. Zhvillimi dhe rritja e kapaciteteve të zbulimit të ushtrisë dhe të policisë afgane.
5. Rritja e kapaciteteve të komandim-kontrollit të FS të policisë.
6. Qëndrueshmëria e këtyre institucioneve gjatë viteve në vazhdim²³.

4.2. Një analizë e angazhimit të FS shqiptare në Afganistan.

Shqipëria është tani një anëtare mjaft e vlefshme e NATO-s, pjesëmarrëse e suksesshme në Forcën Ndërkombëtare të Sigurisë në Afganistan me Forcat e saj Speciale, ndaj më lejoni të shpreh ngushëllimet e mia për humbjen e parë të një ushtaraku shqiptar atje. SHBA-të kanë qenë miku dhe partneri juaj dhe për këtë jemi shumë krenarë. Jam shumë mirënjohëse për këtë partneritet dhe për miqësinë tonë historike, ashtu siç jam mirënjohëse për kontributet që mijëra shqiptarë kanë dhënë për vendin tim, gjithashtu shpreh vlerësimet më të mira për forcat tuaja speciale, punën e tyre të mirë në komandën e ISAF Afganistan, gjithashtu falënderoj qeverinë e Shqipërisë për mbështetjen e vazhdueshme ndaj SHBA-së për vendosjen e stabilitetit dhe të paqes kudo në botë²⁴.

HILLARY RODHAM CLINTON

SEKRETARE E SHTETIT

18 NËNTOR 2012

Aktiviteti dhe detyrat e kryera nga kontingjentet “Eagle” në zonën e operacionit, në Kandahar, Afganistan

Misioni:

FS Shqiptare, të partnerizuara me Batalionin 1-38 CAV, 2-38 CAV dhe Forcat Afgane Kombëtare të Sigurisë ABP-4, nga data 01 Gusht 2010 deri në vitin 2014, me qëllim krijimin e një mjedisi të sigurt, mundësimin e një paqeje të qëndrueshme dhe një qeverisjeje të besueshme dhe të lidhur me popullin, do të kryente operacione

kapjeje ose asgjësimi kundër drejtuesve Talebanë dhe mbështetësve të tyre, vendasve dhe prodhuesve të EID-ve si dhe operacione zbulimi me njerëz e mjete në zonën e operacionale GRYPHON dhe SABER.¹

Synimi i Komandantit të kontingjentit:


Kryerja me profesionalizëm të lartë dhe me sukses të plotë i të gjitha detyrave të ngarkuara nga instancat eprorë, krijimi i një mjedisi të sigurt për një paqe të qëndrueshme dhe një qeverisje të besueshme të lidhur me popullin afgan, duke siguruar në radhë të parë jetën e efektivit me të gjitha mjetet e vëna në dispozicion dhe me të gjitha mënyrat e lejuara ligjore. Vendosija e një marrëdhënie të shkëlqyer me njësinë partnere amerikane, mbështetja me të gjitha mundësitë, ekspertizën dhe kapacitetin e kontigjenteve të komandantit të TF dhe krijimi i një rrjeti zbulimi sa më të gjerë dhe të sigurt, në mënyrë që t'i shërbente njësive amerikane dhe kontigjenteve të tjera të BFS në vazhdimësi.

Detyrat e kontingjentit:

- Sigurimi i jetës së personelit, mjeteve që përdoren gjatë operacioneve, armatimit e pajisjeve të tyre 100% gjatë gjithë kohës.
- Kryerja e detyrës me përkushtimin më të lartë dhe mos neglizhimi i saj në asnjë aspekt dhe moment.
- Kryerja e operacioneve të zbulimit të terrenit brenda zonës së operacioneve të Batalionin 1-38 CAV, 2-38 CAV, etj në çdo aspekt, nëpërmjet kryerjes së zbulimit dhe vëzhgimit special, duke u fokusuar në zbulimin me njerëz dhe me SIGINT.
- Grumbullimi, përpunimi, analizimi dhe raportimi çdo ditë tek S2 i 1-38 dhe 2-38 dhe G2 i Brigadës 525 dhe 504 BDE, i informacioneve të grumbulluara mbi veprimtarinë e armikut nga ana e patrullave, misioneve tona disa ditore në terren, duke bashkëvepruar me profesionalizëm me Batalionin 1-38, 2-38, etj dhe me të gjitha agjensitë amerikane të sigurisë që ndodhen në zonën tonë operacionale.


1. 1-38 CAV SQDN CDR OPOR 123, gusht 2010, Kandahar.

- Ngritja e rrjetit të zbulimit dhe informacionit në zonën tonë operacionale në mënyrë që të mbështesë sa më shumë që të jetë e mundur procesin e targetimit të HVT nga ana jonë dhe shkëmbimi i këtij informacioni me partnerët tanë.
- Mbështetja për rritjen e sigurisë, duke bashkëpunuar me Forcat e Sigurisë Afgane, nëpërmjet zbulimit dhe ndërprerja e lëvizjeve të elementëve terroristë dhe kriminale në zonën e operacioneve të CTF Lightning.
- Rritja dhe forcimi i bashkëpunimit me Forcat e Sigurisë Afgane, ANP, ABP, AHP, qeverinë vendore duke i ndihmuar për rritjen e mëtijshme të nivelit të tyre profesional, nëpërmjet stërvitjeve të vazhdueshme të efektivëve të tyre nga instruktorët tanë dhe mbështetja me pajisje logjistike.



Skicë 4-2. Organizimi për detyrë i Batalionit 1-38 të Br 525 në Afganistan

- Mbështetja e mirë qeverisjes dhe zhvillimit, brenda mundësive operacionale, duke lehtësuar qeverisjen lokale, zhvillimin dhe implementimin e ligjit në zonën e operacioneve duke mbështetur projekte të ndryshme si: ndërtimi i puseve, shkollave, xhamive, riparimi dhe ndërtimi i rrugëve, dhënia e asistencës mjekësore nga ana e mjekëve tanë dhe shpërndarja e ilaçeve të ndryshme, mbështetje financiare për projekte bujqësie, etj.
- Sigurimi i lirisë së lëvizjes në autostradën Nr. 4, goditja, kapja dhe asgjësimi i liderëve Talebanë dhe aktivitetet e tyre të paligjshme brenda Zonës së Operacionit “GRYPHON” dhe “SABER”.



Skicë 4-3. Organizimi për detyrë i Forcave Speciale BOS në Afganistan

- Kryerja e operacioneve të informimit në nivel taktik për rritjen e reputacionit të Qeverisjes Vendore në zonën e përgjegjësisë, si dhe rritja e besueshmërisë dhe influencës së Komandës Rajonale Jugore të ISAF-it.

Disa nga detyrat luftarake të realizuara gjatë misioneve

Kontingjenti i Batalionit të Forcave Speciale “Eagle” ka marrë pjesë dhe ka kryer me sukses një sasi të madhe dhe shumë të rrezikshme detyrash dhe operacionesh, duke marrë vlerësime maksimale nga drejtuesit më të lartë politikë dhe ushtarakë të qeverisë shqiptare, amerikane dhe NATOs, për profesionalizmin, përgatitjen e lartë, dedikimin dhe performancën gjatë realizimit të detyrave të dhëna. Janë marrë me qindra urdhëra operacionalë (OPORD & FRAGO), ku pas marrjes së tyre, është bërë një planëzim i hollësishëm për realizimin me sukses të tyre. Më poshtë po pasqyrojmë disa nga operacionet më të rëndësishmet në të cilat Kontingjenti “Eagle 1-6” ka marrë pjesë dhe realizuar me sukses në zonën e saj operacionale:


a. Operacioni “ALL-IN”

Operacioni “ALL-IN”, është zhvilluar ndërmjet datave 15.08.2010-05.10.2010, në mbështetje të zgjedhjeve parlamentare të zhvilluara në Afganistan.

Detyrat: Grumbullim informacioni, zbulim dhe vëzhgim special për të parandaluar afrimin dhe depërtimin e Talebanëve në rajonet ku zhvilloheshin votimet, goditje direkte personash ose objektivash dhe asgjësimi i tyre, ngritje pikash kontrolli me qëllim kapjen e drejtuesve Talebanë, kamikazëve që lëviznin në autostradën 4 dhe kontrollin e të gjitha mjeteve që kalonin në të, sigurim kontakti me drejtuesit vendorë të zonës, popullsinë dhe përfaqësuesit e policisë afgane në zonë.

Gjatë këtij operacioni nga efektivat e grupeve speciale u kryen 630 orë shërbim në terren si dhe 2100 km rrugë tokësore për kryerjen e detyrës luftarake në një zonë të pashkelur më parë nga forcat e koalicionit. Gjithashtu u kontrolluan 324 automjete, 987 persona nga këto 27 veta të dyshuar si bashkëpunëtorë të Talebanëve.

Ky operacion u zhvillua kryesisht në terrene shkretëtire dhe malore, përfundimi me sukses i të cilit dha një ndihmesë të madhe për zhvillimin me sukses të zgjedhjeve parlamentare duke shmangur sulmet e shumta që ndodhnin më parë në zonën e përgjegjësisë TF Stryker së Br 525. Informacionet e mbledhura me sukses gjatë zhvillimit të këtij janë grumbulluar, analizuar, përpunuar dhe shpërndarë nga S2 i batalionit 1-38 CAV.



Skicë 4-4. Zona e operacionit dhe detyrat e realizuara gjatë operacionit “ALL IN” në Afganistan

b. Operacioni “DESERT VIPER”


Operacioni “DESERT VIPER”, u zhvillua ndërmjet datave 09.10.2010-30.10.2010. Ky operacion u planifikua dhe u zhvillua si një operacion mbështetës i fazës së 3-të B të Operacionit “PASTRIMI” të ISAF në zonën Zharay Panjway.¹ Zona e Zharay Panjwayt ishte një zonë shkretëtire e cila ishte krejtësisht jashtë kontrollit të forcave të ISAF-it. Në mënyrë graduale u planifikuan operacione të cilat kishin si qëllim që të kontrollonin mjetet dhe njerëzit që kalonin dhe vepronin atje dhe të pengonin kalimin e terroristëve dhe të materialeve luftarake që futeshin nga Pakistanin në Afganistan.

Detyrat: Patrullim i vazhdueshëm skematik i zonës së operacionit që ndodhej në kufirin Verior të zonës tonë, ndalimin e objektivave të përcaktuara nga asetet e zbulim vëzhgimit të Br 525, pengimin e depërtimit të elementeve terroristë për të kaluar në Pakistan ose anasjelltas, grumbullim informacioni, zbulim dhe vëzhgim special, goditje direkte personash ose asgjësim të tyre, kontroll objektsh, pika kontrolli me qëllim kapjen e drejtuesve talebanë dhe kontrollin e të gjitha mjeteve që kalojnë në autostradën 4, sigurimi i kontakteve me drejtuesit vendorë të zonës, popullsinë dhe përfaqësuesit e policisë afgane në zonë. Gjatë këtij operacioni nga efektivat e grupeve speciale janë bërë 380 orë shërbim në terren si dhe 2150 km rrugë tokësore për kryerjen e kësaj detyre luftarake. Gjithashtu u kontrolluan 218 automjete, 674 persona, nga këto 18 veta Talebanë.

Ky operacion përfundoi me sukses, duke rritur ndjeshëm kapacitetet dhe aftësitë e kontingjentit tonë në kryerjen e detyrave 72 orësh pa ndërprerje e për më tepër rriti dhe përmirësoi ndjeshëm ndërveprueshmërinë me strukturat e Batalionit 1-38 CAV. Ajo që vlen të përmendet është që ky ishte një operacion shumë i suksesshëm në të cilën FS shqiptare kontrolluan për herë të parë një kompleks shpellash në të cilat nuk ishte futur asnjë efektiv i koalicionit, duke bërë të mundur që të kapeshin një sasi shumë e madhe eksplozivash dhe materialesh të tjera luftarake, të cilat përdorreshin nga Talebanët dhe bashkëpunëtorët e tyre kundër nesh. Arritje tjetër e rëndësishme ishte se i dërgohej terroristëve mesazhi që nuk do të kishin më liri veprimi dhe lëvizjeje në zonën e tyre të veprimit. Në përfundim të operacionit u vlerësua lart roli dhe kontributi

1. 32 1-38 CAV SQDN CDR OPOR 147, Oct 2010, Kandahar.


i FS shqiptare në këtë operacion nga Gjeneral Major Terry, komandant i Komandës Jugore Afganistan.



Skicë 4-5. Detyrat e realizuara gjatë operacionit “DESERT VIPER” në Afganistan.

c. Operacioni “MOUNTAIN RUN”

Operacioni “MOUNTAIN RUN”, u zhvillua ndërmjet datave 30.10.2010-04.12.2010 në një zonë ku asnjë forcë nuk ishte futur që nga koha e Sovjetikëve dhe që konceptohej si një zonë tepër e rrezikshme dhe me shumë elementë të rrezikshëm Talebanë.¹ Gjatë këtij operacioni u vranë një numër i konsiderueshëm Talebanësh.



Skicë 4-6. Detyrat e realizuara gjatë operacionit “MOUNTAIN RUN “ në Afganistan

1. 35 1-38 CAV SQDN CDR OPOR 151, Oct 2010, Kandahar.

Detyrat: Izolimi i elementëve rebelë nga popullsia lokale, forcimi i bashkëpunimit dhe bashkëveprimit me policinë afgane, sigurimi dhe shkëmbimi i informacioneve të zonave e vendeve ku ishin vendosur minat surprizë, mbështetje mjekësore për Policinë Kufitare Afgane (ABP), grumbullim informacioni, zbulim dhe vëzhgim special, krijimi i një mjedisi të sigurt për vendosjen e një pike kontrolli të përhershme në këtë zonë nga policia afgane me qëllim kapjen e drejtuesve Talebanë. Gjatë këtij operacioni nga efektivat e grupeve speciale janë bërë 560 orë shërbim në terren si dhe 5764 km rrugë tokësore për kryerjen e detyrave luftarake. Nga ana jonë dhe ky operacion ndikoi ndjeshëm në rritjen e kapaciteve operacionale duke bërë të mundur përdorimin e pajisjeve të reja të zbulimit dhe përdorimin e snajperave në distanca të largta deri në 1300 m për asgjësimin e terroristëve. Po kështu u kontrolluan 168 automjete, 478 persona nga këto 43 veta të dyshuar si bashkëpunëtorë të Talebanëve.¹

Ky operacion u organizua dhe u zhvillua në mbështetje të veprimeve të policisë kufi Afgane me qëllim vendosjen e autoritetit të tyre në zonën MULAJAT dhe për të zgjeruar rajonet e kontrolluara nga qeveria afgane. Rajoni ku u zhvillua ky operacion, Mali Adi Gharit dhe Qafa Mazgaray Ghar-it në të cilën gjenden një numër i madh shpellash që përdoren për strehim nga grupet e Talebanëve, prej vitesh konsiderohej si “ qie” i sigurt i tyre dhe ishte totalisht jashtë kontrollit të autoriteteve Afgane. Kontingjenti “Eagle 1” ka vepruar në një zonë të paskelur më parë. Veprimet janë kryer në zonën *Mali Adi Gharit -Mulayat*, e cila përshkohet nga autostrada A-4, është rruga kryesore e furnizimit nga Pakistani në Kabul. Kjo zonë është shumë e vështirë nga pikëpamja e rrezikshmërisë, si dhe shumë e rëndësishme për përdorim nga të dy palët për transport. Kjo zonë njihet si zona e Talebanëve aq më tepër që ndodhet në kufi Afgano-Pakistanez. Terreni ishte tepër malor, në të cilën gjendeshin shumë shpella të cilat shfrytëzoheshin nga Talebanët për strehim, vendpushim dhe planifi sulmesh, në rastet kur autostrada kontrollohej nga forcat e koalicionit. Ky operacion përfundoi me sukses duke forcuar e rritur më tej frymën e bashkëpunimit me policinë dhe me popullsinë lokale dhe krijoi burime të sigurta informacioni tepër të nevojshme për forcat tona.² Ka qënë operacioni më i suksesshëm i gjithë misioneve Eagle.

1. Raport i komandantit të misionit “Eagle” në Kandahar dërguar KFT, tetor 2010.

2. Raport i komandantit të misionit “Eagle” në Kandahar dërguar KFT, tetor 2010.

d. Operacioni “COPPERHEAD”

Operacioni “COPPERHEAD”, u zhvillua ndërmjet datave 07.12.2010-10.01.2011.¹

Detyra: - Kryerja e operacioneve të partnerizuara e të vazhdueshme duke krijuar Qendra Operacionale (QO) të përbashkëta me Policinë Kufitare Afgane (ABP), brenda Zonës Operacionale për të rritur e zhvilluar aftësitë vepruese të policisë (ANP) në kryerjen e detyrave të tyre.

- Ngritja e një rrjeti të besueshëm informacioni brenda zonës së përgjegjësisë mbi veprimtarinë e Talebanëve, grumbullimi dhe analizimi i tyre në Fussion Cell.
- Përdorimi i aseteve xheniere për ngritjen e infrastrukturës së nevojshme për jetesë e punë në QO të përbashkët të Batalionit 1-38 dhe policisë (ABP).²
- Sigurim dhe ruajtje e pandërprerë e QO të përbashkët.
- Trajnimi dhe përgatitja e policisë (ANP) në ndihmën e parë mjekësore, përgatitje për qitje, organizimi i PK, mënyra e kryerjes së kontrollit të mjeteve, etj.
- Grumbullim informacioni, zbulim dhe vëzhgim special, goditje direkt personash ose asgjësim të tyre, kontroll objektsh, pika kontrolli me qëllim kapjen e drejtuesve Talebanë. Kontroll i të gjitha mjeteve që kalonin në autostradën 4, sigurim kontakti me drejtuesit vendorë të zonës, popullsinë dhe përfaqësuesit e policisë afgane në zonë.

Gjatë këtij operacioni nga efektivat e grupeve speciale u realizuan 706 orë shërbim në terren si dhe 2838 km rrugë tokësore për kryerjen e detyrave luftarake, u kontrolluan 175 automjete, 386 persona nga këto 32 veta të dyshuar si bashkëpunëtorë të Talebanëve.³

Vlen për t’u përmendur se ky operacion u krye në zbatim të detyrave që rrjedhin nga Udhëzimi Kundër Rebelëve (COIN) i Komandantit të ISAF, **Gjeneral David**

1. 525 BDE CDR OPOR 74, Dec 2010, Kandahar.

2. Po aty.

3. Raport i komandantit të misionit “Eagle” në Kandahar dërguar KFT, janar 2011.

H. Petraeus, “Jeto midis njerëzve!”,”Siguro dhe shërbeji popullsisë!” “Ndhmo afganët të ndërtojnë një qeveri të përgjegjshme!” , “Partner me Forcat Kombëtare të Sigurisë Afgane (ANSF), “Konsultohu dhe ndërto marrëdhënie, por jo vetëm me ata që na ndjekin ne!”,”Bëhu një mik i mirë i tyre!”.

Gjatë zbatimit të këtij operacioni, nga ana e kontingjentit tonë u ndërtua dhe një shkollë në qendrën e banuar Takh Tahpol si dhe u kryen një numër i konsiderueshëm misionesh ndihme mjekësore për banorët e rajonit, duke rritur frymën e bashkëpunimit me popullsinë vendase dhe pushtetin lokal.

e. Operacioni “LONG DECEMBER”¹

Operacioni “LONG DECEMBER”, ka fi në datën 10.01.2010-28.01.2011 nga efektivat e grupit të 1^{re} dhe të 2^{te} special. Ky u operacion u planëzua dhe u zbatua në zbatim të detyrës së Komandantit të Br 525 për ndryshimin e zonës së operacionit të Batalionit 1-38 “GRYPHON” dhe bashkëpunimin me Batalionin 4/2, në ZO “SABER” kryesisht në rajonin e Damanit. Zona e Damanit ishte një zonë shumë problematike se ishte krejtësisht e mbjellë me drogë dhe ishte nën kontrollin e Talebanëve. Këtu drejtonte një komandant policie shumë i korruptuar që quhej Sahip Khan. Gjendja e situatës së përgjithshme në Zonën e re Operacionale “SABER” përshkruhet në Skicën 3.8 Detyrat: Njohja e Zonës së re Operacionale, ngritja dhe vendosja e kontakteve me autoritetet lokale dhe Policinë e Autostradave Afgane (AHP), ruajtja e efektshmërisë së bashkëpunimit me Forcat e Sigurisë Afgane, rritjen e kapaciteteve të këtyre forcave nëpërmjet trajnimeve të ndryshme, grumbullim informacioni, zbulim dhe vëzhgim special, goditje direkte personash ose asgjësim të tyre, kontroll objektsh, pika kontrolli me qëllim kapjen e drejtuesve talebanë dhe kontrollin e të gjitha mjeteve që kalojnë, sigurim kontakti me drejtuesit vendor të zonës, popullsinë dhe përfaqësuesit e policisë afgane në zonë. Gjatë këtij operacioni nga efektivat e grupeve speciale janë bërë 410 orë shërbim në terren si dhe 1378 km rrugë tokësore për kryerjen e detyrës luftarake. U realizua kontrolli i 92 automjeteve, 235 personave nga të cilët 12 veta të dyshuar si bashkëpunëtorë të talebanëve. Gjatë këtij operacioni të gjitha informacionet që janë mbledhur,

1. 1-38 CAV SQDN CDR OPOR 158, Jan 2011, Kandahar.

grumbulluar, analizuar, përpunuar dhe shpërndarë i janë dorëzuar S2 të batalionit 1-38 CAV dhe G2 të 525 BDE.

f. Operacioni “ROBAT 2011”

Operacioni “ROBAT 2011”, është zhvilluar ndërmjet datave 29.01.2010-05.02.2011 në një zonë të re operacionale për FS Shqiptare, të cilat vazhduan të operojnë në mënyrë autonome atje brenda zonës “SABER” deri në Janar të vitit 2013.

Detyra: Njohja e komandantëve të grupeve speciale dhe bashkëpunimi i tyre me komandantët e kompanive të Alfa, Bravo, Charly dhe të kolegëve të Bat-4/2, përmes njohjes të detyrave të precizuara për secilin specialist, duke fi nga komandantët e grupeve, specialistët e operacioneve, zbulimit, armatimit, ndërlidhjes, snajperistët, xhenios, shëndetësisë dhe bërja e provave të detajuara përpara çdo dalje në detyrë. Grumbullim informacioni, zbulim dhe vëzhgim special, goditje direkt personash ose asgjësim i tyre, kontroll objektesh, pika kontrolli me qëllim kapjen e drejtuesve Talebanë dhe kontrollin e të gjitha mjeteve që kalojnë, sigurim kontakti me drejtuesit vendorë të zonës, popullsinë dhe përfaqësuesit e policisë afgane në zonë. Gjatë këtij operacioni, i cili është realizuar me sukses të plotë nga efektivat e grupeve speciale janë bërë 252 orë shërbim në terren si dhe 2159 km rrugë tokësore për kryerjen e detyrës luftarake. Në këtë operacion janë kontrolluar 107 automjete, 298 persona nga këto 14 veta të dyshuar si bashkëpunëtorët të Talebanëve. Në këtë operacion u bë e mundur edhe ndalimi 2 mjeteve kamikaze.

Në këtë fazë të operacionit janë mbajtur parasysh detyrat e vëna të cilat rrjedhin nga Udhëzimi Kundër Rebelimit (COIN) i Komandantit të ISAF-it, Gjeneral *David H. Petraeus*, “**Ruaj çfarë është siguruar**”, “**Ruaj vazhdimësi gjatë ndërrimit të njësive.**” Nga dita e parë, fillo të ndërtosh informacionin që do t’u japësh vartësve tuaj. Shkëmbe informacion dhe mirëkuptim në muajt para ndërrimit. Përpiqu të mbash tempin operacional dhe marrëdhëniet lokale gjatë fazës së ndërrimit dhe shmang dhënien e pushimit për rebelët dhe aktorët e dëmshëm gjatë fazës së dorëzimit.

Mbrojtja e bazës së Spin Boldak, Operacioni “Thunderstorm”, Shtator-dhjetor 2012

Gjatë verës së vitit 2012 qindra luftëtarë Talebanë ndodheshin në luginën thellësisht të kultivuar me lëndë narkotike dhe me një rëndësi strategjike e cila shtrihej deri në periferitë Perëndimore të zonës së Kandaharit. Prej zonës së quajtur Daman (zonë në të cilën ra dëshmor Kapiten Feti Vogli), Talebanët planëzuan që të kryenin një ofensivë kryesore në qendrën e Kandaharit.

Në Shtator të 2012, një forcë shumëkombëshe e drejtuar nga amerikanët me rreth 1400 trupa kryesisht amerikanë, anglezë dhe forca speciale shqiptare, rrethuan luginën dhe avancuan në disa drejtime. Talebanët tentuan t'i kundërvihen sulmit dhe e mbajtën luginën duke përdorur taktika konvencionale ushtarake.

Ata luftuan nga ndërtesa të fortifikuara, hendeklidhjet, pozicionet të hapura vetë në majat e kodrave dhe duke përdorur për maskim fushat me marijuhanë, vreshtat e rrushit, kanalet e ujitjes dhe tunelet. Kryengritësit realizuan prita dhe kundërsulme në mënyrë shumë të kujdesshme. Më në fund, të detyruar nga artileria dhe mbështetja ajrore e koalicionit, talebanët mundën të kryenin një tërheqje taktike të disiplinuar.

Dy javë më vonë, Talebanët duke u fshehur në popullsinë vendase u infiltruan përsëri në luginë dhe filluan taktikat guerrile duke përfshirë minat surprisë, sulmet vetëvrasëse dhe prita të vogla *godit-dhe-largohu*. Në Dhjetor, forcat e koalicionit rifilluan një operacion të dytë pastrimi duke i detyruar kryengritësit të largohen më një rezistencë minimale. Kryengritësit vazhdojnë dhe sot e kësaj dite të operojnë në zonën e Damanit.

Përgatitja për Operacionin “Thunderstorm”, i cili nisi më 2 Shtator 2012, përbëhej nga skuadroni 252 i forcave amerikane i mbështetur nga FS shqiptare me 3 ODA (grupe speciale), 1 Royal Komando Marines Coy dhe forcat afgane të batalionit të 3-të të Brigadës Kufi Afganë nën komandën e N/Kolonel Haxhi Xhanan (total 1400). Qëllimi i këtij operacioni ishte për të pastruar, kontrolluar, kapur ose vrarë rreth 1000 forca Talebane të cilët po përgatiteshin për një sulm drejt Kandaharit.

Gjatë verës së 2012 grupe të mëdha kryengritësish kishin kryer në mënyrë të përsëritshme sulme mbi forcat e koalicionit duke u përpjekur të merrnin nën

kontroll zonën e mbjellë me lëndë narkotike të Damanit, si dhe për të hyrë në luginën e Panxhait. Lugina njihej si një zonë kundër qeveritare për arsye se ekzistonte pjesërisht një lidhje me Talebanët dhe pjesërisht sepse prej shumë kohësh 3 stacionet e policisë së autostradës, përkatësisht stacionet 1, 2 dhe 3 ishin në mënyrë sistematike të përfshirë në korrupsione dhe skandale në bashkëpunim me shefin e tyre Kapiten *Sahip Khan*.

Plani i koalicionit ishte që të rrethohej lugina, marrja e pozicioneve në pikat më të larta, më pas bombardimi i pozicioneve të kryengritësve me artileri dhe mjete ajrore dhe më vonë avancimi në brendësi me trupa në terren. Ushtarët e batalionit kufitar afgan dhe këshilluesit e tyre amerikanë sulmuan nga Veriu, ndërkohë që FS shqiptare dhe amerikane do të avanconin nga Jugu. Marinsat Britanikë dhe forcat amerikane patrullonin në vazhdimësi perimetrin e jashtëm, për kapjen e kryengritësve që tentonin të arratiseshin. Skuadroni 252 i forcave amerikane lëvizi në qendër të Damanit, drejt Panzhait dhe ndaloi në një fshat të quajtur Pashmul.

Guvernatori i provincës foli rreth operacionit në radio më 30 Gusht 2012. Gjatë kësaj kohe, avionët e koalicionit hodhën pamfleta të cilat këshillonin civilët që të qëndronin larg luftimeve. Talebanët gjithashtu lajmëruan popullsinë lokale për luftimet që do të kryheshin. Mijëra civilë, kryesisht burra të vjetër, gra dhe fëmijë u larguan nga lugina ndërkohë që forcat e koalicionit u futën në luginë. Shumica e burrave që ishin në moshën për të luftuar qëndruan në zonën e luftimit.

Kryengritësit u përgatitën që ta mbronin luginën si një ushtri konvencionale. Ata grumbulluan armë, minuan rrugët dhe rrugicat, përgatitën prita dhe ngritën pozicione mbrojtëse të maskuara. Shumica e tyre u fshehën në luginë në shtëpitë e braktisura nga fshatarët. Këto shtëpi ishin të rrethuara me mure balte dhe një trashësi muri aq sa për t'i mbrojtur nga plumbat. Të mbjellat e larta me marijuhanë, vreshtat me rrush dhe pemët e larta siguronin maskim. Kryengritësit lëviznin pa u parë duke përdorur shumë kanale vaditëse, si dhe një rrjet tunelesh të fshehtë. Ata bënë një vendosje të kujdesshme të mitralozave dhe pikave të vëzhgimit në majat e kodrave dhe të maleve.

Pesha e kontributeve të Shqipërisë në operacionin e NATO-s “Operation Enduring Freedom” ISAF në Afganistan ka ardhur duke u rritur nga vitit në vit pas anëtarësimit të Shqipërisë në NATO. Si pasojë e këtij kontributi është rritur jo

vetëm numri i trupave pjesëmarrëse në operacion, por dhe llojshmëria e cilësia e operacioneve duke përmendur: misionet luftarake, misionet mbështetëse, misionet trajnuese, këshilluese dhe pjesëmarrjen në shtabe të ndryshme. Tabela refl rritjen e peshës specifi sipas vlerësimeve të NATO-s, progresivisht me reduktimin e shpenzimeve përkatëse. Viti 2013 padyshim shënon vlerësimin më të madh për Shqipërinë me një pikavarazh prej 600 pikësh. Rritja më e ndjeshme e kontributeve nga viti 2009 në vitin 2010, lidhet me fillimin e misioneve luftarake nga Forcat Speciale të FA në Afganistan.

Tabela 4.1

Pesha e kontributeve të FA të RSH në ISAF gjatë viteve 2009-2013.

Viti	Nr i personelit në misione	Kosto financiare (Lekë)	Kontributi relativ Pikët sipas standarteve ponderuese të NATO-s
2009	424	812.379.000	392
2010	540	1.034.207 .000	500
2011	666	1.409.169.000	579
2012	580	1 .148.309.300	557
2013 (Parashikim)	318	795.597.500	600

Tabela e mëposhtme tregon peshën specifike të misioneve të ndryshme në Operacionin e ISAF-it sipas mekanizmit të ponderimit të NATO-s. Tabela tregon se pesha specifike e një efektivit special, vlerësohet me trefishin e pikëve në raport me një efektiv konvencional që kryen detyra brënda në bazë. Kjo tregon se angazhi i forcave speciale në misione luftarake në Operacionin e ISAF-it ka rritur ndjeshëm kontributin e Shqipërisë në kuadër të operacioneve të NATO-s duke bërë që Sekretari i Përgjithshëm i NATO-s Zoti Rasmussen të konstatonte që Shqipëria ishte një ndër 5 vendet model në raport me kontributin për frymë në Aleancë (Rasmussen, 2013).

Tabela 4.2

Pesha e kontributeve në Operacionin ISAF për vitin 2013,

Misioni	Personeli	Pesha Specifike	Pikët
Kontribute Aktuale			
Shtabe	13	1	13
Trupa	107	1	107
NTM-A	5	2	10
Forca Speciale	50	3	150
Trajnues të Forcave Speciale	5	10	50
OMLT/MAT-A	20	10	160 (Limit standard për Ekip)
POMLT	1 PU	10	10
Ekip Mjekësor	10	10	100
Totali	211		600 Pikë

Tabelë 4.3

Tabelë përmbledhëse e operacioneve të kryera nga misionet Eagle në Kandahar,
Afganistan

Emri i Operacionit	Terreni	Detyrat	Distanca	Orë Shërbimi	Kontroll Mjetesh	Kontroll Fshatrash	Kontroll Personash	Arres-time
1. ALL-IN	SHK	PSD, SR, DA	2110 KM	630	224	7	987	27
2. DESERT VI-PER	SHK	SR,DA	2150 KM	380	218	11	674	18
3. MOUNTAIN-RUN	MAL	SR, DA	5764 KM	560	168	29	478	43
4. COPPERHEAD	SHK	MA, SR, PSD	2838 KM	706	175	13	386	32
5. LONG 6. DECEMBER	SHK MAL	SR, DA, MA	1378 KM	410	92	7	235	12
7. ROBAT-2011	SHK	SR,DA	2159 KM	252	107	14	298	14
8. THUNDER-STORM	SHK MAL	SR,DA	2400 KM	348	75	3	162	63
9. COY CHAR-LIE	SHK	DA	980 KM	210	21	2	84	7
10. OTAL	----	-----	19779 KM	3496	1080	86	3304	216

Konkluzione:

1. Punimi nuk mëton që të krijojë një teori të re për Forcat e Operacioneve Speciale, por merr në shqyrtim të hollësishëm literaturën teorike ekzistuese të Operacioneve Speciale, nxjerr hipoteza nga kjo teori dhe i teston ato, duke përdorur si rast studimor “Operacionin Enduring Freedom” në Afganistan. Hipoteza që nxjerrim nga teoria e Operacioneve Speciale është se: Forcat Speciale janë trupat më efektive në luftën e Gjeneratës së IV-rt (asimetrike) për shkak të strukturës, trajnimit, pajisjeve dhe misioneve për të cilat ato janë krijuar dhe përdorur. Kjo hipotezë vërtetohet në këtë punim që merr në shqyrtim operacionin më kompleks, më të vështirë dhe më të gjatë që Forcat Speciale të Aleancës kanë realizuar në historinë e tyre. Në pikëpamje sasiore, kjo vërtetohet nga fakti se numri i përgjithshëm i Forcave Speciale të angazhuara në “Operacionin Enduring Freedom” në Afganistan, përbënte vetëm 2% të numrit të përgjithshëm të trupave të dislokuara, të cilat kryenin 92% të numrit të përgjithshëm të operacioneve luftarake. Në pikëpamje cilësore/operacionale, kjo pjesë e trupave realizonte operacionet më të vështira në teatrin luftarak si: Zbulim Special (ZS), Goditje Direkte (GD), Stërvitje të Ushtrisë dhe Forcave Speciale Afgane (FID) dhe Operacione për Çlirimin e Pengjeve dhe Kapëse Vrasëse (HR/KKM). Në pikëpamje të vlerësimit të efektshmërisë së Forcave Speciale Shqiptare në teatrin e operacioneve në Afganistan, mekanizmi matës që mëton të provojë hipotezën tone, është sistemi i ponderimit të peshës relative së secilës njësi.
2. Luftimet e mësipërme paraqesin disa nga rastet kur kryengritësit kanë kryer një mbrojtje konvencionale në një shkallë të lartë. Ato luftonin nga pozicione të fshehura dhe sulmonin konvojet që afroheshin. Gjatë kohës që kryenin këto veprime, lajmëronin popullsinë civile që të largoheshin.
3. Kryengritësit fillimisht besuan që mund ta mbanin luginën kundër një ofensive të madhe të koalicionit. Për këtë qëllim përdorën një sasi të konsiderueshme njerëzish dhe ruajtën një sasi të madhe armësh dhe municioni brenda zonës. Terreni i cili ishte i përbërë nga pemë të larta, fusha me marijuhanës, vreshta të shumta , tuneleve nëntokësore, kanaleve ujitëse dhe rrugëve dytësore, i

favorizonte shumë kryengritësit.

4. Pas disa ditësh bombardimi të rëndë me artileri dhe aviacion, kryengritësit u tërhoqën në mënyrë të organizuar e të disiplinuar duke marrë me vete të vrarët dhe të plagosurit.
5. Luftimet gjatë këtij operacioni demonstuan se kur një qëndresë e fortë e kryengritësve planëzohet dhe realizohet, një forcë aleate, edhe pse a pakët në numër, duhet të qëndrojë në zonë me qëllim që të sigurojë rindërtimin e zonës. Forcat e koalicionit u përpoqën të ndërtojnë një rrugë përmes luginës, por nuk kishin forca të mjaftueshme për të ngritur postobloqe dhe për të patrulluar zonën. Kryengritësit me shpejtësi rifuteshin në zonë, rivendosnin kontrollin mbi popullsinë dhe realizonin një fushatë të vazhdueshme me prita të vogla kamikaze dhe sulme me IED.

KAPITULLI V

FORCAT SPECIALE SHQIPTARE- NJË STRUKTURË E ORGANIZUAR PËR MISIONE TË VËSHTIRA

5.1. Të përgjithshme

FS duhet të jenë në vartësi operacionale të Shefit të Shtabit të Përgjithshëm të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë, po kështu edhe nën komandën e një komandanti luftarak rajonal të Aleancës, kur janë të dislokuar në një teatër operacional. Kontrolli operacional i FS mund të ushtrohet nga komandanti i tyre ose nga Komandanti i Forcës së Bashkuar (JFC). Komandantët që urdhërojnë autoritetet komanduese mbi FS, duhet të kenë gjithmonë parasysh:

- Të sigurojnë një zinxhir komandimi të qartë dhe lehtësisht të kuptueshëm.
- Të shmangin ndryshimin e vazhdueshëm të kontrolleve të operacioneve ndërmjet komandantëve të ndryshëm.
- Të sigurojnë eksperiencën dhe njohuritë e mjaftueshme për shtabin e këtyre forcave në mënyrë që ky shtab të jetë i aftë të planëzojë, të kryejë dhe të mbështesë operacionet speciale.
- Të integrojnë FS në procesin e targetimit, planizimit dhe të ekzekutimit.
- Të përshtasë kapacitetet e FS me kërkesat e misionëve dhe detyrave (Demiraj, 2012).

FS janë më efektive kur janë të integruara plotësisht në fushatën e planizimit (në kohë lufte ose në operacione luftarake pas luftës)³. Integrimi efektiv i FS varet nga një strukturë e fortë e Komandim-kontrollit, e cila ka kapacitetet e dhënies të aftësive që këto forca të operojnë (1) njëanshmërisht, (2) të pavarura si pjesë e gjithë ekspeditës ushtarake ose (3) në mbështetje të ndonjë komandanti konvencional. Ekzekutimi me sukses i një Operacioni Special kërkon qendërzim, përgjegjëshmëri të shpejtë dhe zinxhir të shkurtër komandimi. Mundësitë e kufizuara në lidhje me shumicën e operacionëve speciale si dhe natyra e tyre e ndjeshme për një pjesë akoma

më të madhe të këtyre operacioneve, kërkojnë një strukturë komandim-kontrolli (C2) që është mbi të gjithë, e që mund t'ju përgjigjet lehtë, me saktësi dhe shpejtësi nevojave të njërive speciale të angazhuara në detyra. Gjithashtu mund të krijohet një strukturë komandim-kontrolli, vetëm për një operacion ose mision specifik.

Ministri i Mbrojtjes ka të drejtën të përcaktojë komandantin luftarak (autoritetin komandues) nëpërmjet autoritetit si drejtuesi më i lartë politik i Ministrisë së Mbrojtjes. Të gjitha FS që ndodhen në territorin e Republikës së Shqipërisë duhet të jenë nën komandën e Shefit të Shtabit të Përgjithshëm. FS që janë në zona të rrezikshme për zgjidhje detyrash, mund të jenë nën komandën e komandantit luftarak, që është njëkohësisht edhe Komandanti Luftarak Rajonal. Ky komandant mund të ushtrojë të drejtën e komandim-kontrollit nëpërmjet një Komande të Bashkuar, me komponentë shërbimesh dhe funksionesh të ndryshme vartëse.

FS mund të caktohen nën komandën e një komandanti të caktuar brenda Forcës së Bashkuar. Kudo që të caktohen FS, **është jetësore koordinimi** ndërmjet gjithë komponentëve të Forcës të Bashkuar nëpërmjet përfaqësuesve të tyre, **me qëllim parandalimin e vëllavrasjes dhe përdorimin sa më efektiv të tyre (FS).**

5.2. Organizimi dhe funksionimi i FS

“Cilësitë, të cilat zakonisht e bëjnë një ushtri të frikshme, janë zakonet e rregullit për një kohë të gjatë, saktësia e lartë e disiplinës dhe besimi i madh tek komandanti i tyre.”

Samuel Johnson, 1709-1784

Komandim-Kontrolli i FS në teatrin e luftimit

Normalisht, komandim-kontrolli i FS duhet të ekzekutohet brenda zinxhirit komandues të tyre. Komandim-kontrolli (C2) i FS për operacionet psikologjike (PSYOP) dhe marrëdhëniet civilo-ushtarake (CA), bazuar në rolin unik të tyre në arenën e luftimit, diskutohen veçantë nga komandim-kontrolli i FS të tjera. **Krijimi i strukturave të organizuara të komandim-kontrollit për FS duhet të varet nga objektiva specifike, nevojat e sigurisë dhe mjedisi operacional.** Komandim-kontrolli i tyre ekzekutohet nëpërmjet një ose më shumë strukturave si më poshtë vijon:

Komanda e Përbashkët e Operacioneve Speciale në arenën luftarake (CJSOF)¹.

- Për të krijuar unifikimin e komandimit të nevojshëm, çdo komandant luftarak në teatrë **krijon një komandë vartëse që shërben si pjesë funksionale e Operacioneve Speciale** për arenën e luftimit. Komanda e Operacioneve Speciale në teatrin e luftimit kryen masivisht misione unike të përshtatura me kapacitetet e FS, të cilat janë të një rëndësie strategjike dhe operacionale për komandantët luftarakë në terren. Komandanti i Komandës së Operacioneve Speciale (SOC), normalisht ushtron kontrollin e operacioneve për të gjitha njësitë speciale të dhëna në mbështetje ose në organikë në teatrin e luftimit (NSOTF-A). **Komandanti i kësaj komande ka dy role kryesore:**


Komandim-Kontrolli Operacional i FS

- **Komandanti i FS të ushtrisë sonë** është komandanti brenda Task Forcës të Bashkuar (JTF) përgjegjës për rekomandime në lidhje me punën që kryejnë FS shqiptare, për planëzimin dhe koordinimin e operacioneve speciale të tyre. Ai duhet të përmbushë me sukses të gjitha misionet operacionale që do t'i caktohen. **Komandanti i Forcës së Bashkuar të Komponentit Komandues të Operacioneve Speciale (JFSOC)** normalisht do të jetë komandant me të drejta të plota për FS dhe për komandim-kontrollin e tyre dhe njëkohësisht do të jetë dhe komandant i të gjitha FS shqiptare që ai ka si pjesë e forcave të tij.
- **Task Forca për Operacionet Speciale Joint.** Sipas rekomandimeve të komandantit të operacioneve speciale në teatrin e luftimit, komandanti i Forcës të Bashkuar mund të krijojë një Task Forcë për Operacionet Speciale Joint (JSOTF). **Një JSOTF është një shtab i përkohshëm për FS të përbashkëta, i krijuar për të kontrolluar FS më shumë se në një shërbim, gjatë operacioneve specifike në arenën e luftimit ose gjatë përmbushjes të një misioni specifik.** Krijimi i një JSOTF është i përshtatshëm kur **nevojat e**

¹ 5 Joint Pub 3-05, Doctrine for Special Ops, 17 April 1998, fq. III-3.

komandim-kontrollit të FS kalojnë kapacitetet e shtabit të komandës së operacioneve speciale (SOC). Një Task Forcë për operacionet speciale *Joint* (JSOTF) normalisht formohet rreth elementëve të komandës së operacioneve speciale (SOC) ose nga një njësi speciale ekzistuese me shtim nga shërbimet e tjera të FS.

- **Komponenti Komandues i Operacioneve Speciale të Forcës të Bashkuar (JFSOC ose komandanti i JSOTF)¹** do të kontrollojë FS të caktuara nga KFB në mbështetje të operacioneve të veçanta, si çdo forcë tjetër konvencionale. Komandanti i Komponentëve të Operacioneve Speciale të Forcës të Bashkuar (JFSOCC) ose JSOTF mund të ushtrojë komandim-kontroll mbi FS të përcaktuara nëpërmjet një numri të caktuar organizatash, (shiko skemën 4-1) në rastin e ushtrisë shqiptare, që duhet të jetë nën vartësinë e Shefit të Shtabit të Përgjithshëm të FA.



Skema 5.1 Shembull i zinxhirit komandues të FS në SHP. Propozuar nga grupi i punës për FS në MM në vitin 2012

1. Joint Pub 3-05, Doctrine for Special Ops, 17 April 1998, fq. III-

- **Komandim-Kontrolli i Operacioneve Psikologjike (PSYOP) dhe Marrëdhënieve Civilo-Ushtarake (CA)** (Demiraj, 2012).

Meqenëse këto operacione janë pjesë e operacioneve të FS, marrëdhëniet e komandim-kontrollit të tyre si të: operacioneve psikologjike dhe marrëdhënieve civilo-ushtarake, janë formatuar të mbështesin **edhe FS, edhe forcat konvencionale**.

- Fusha e gjerë e aktiviteteve të operacioneve psikologjike, të kryera nëpërmjet niveleve strategjike, operacionale dhe taktike me kërkesa për t'u integruar plotësisht me aktivitetet e agjencive ndërkombëtare si edhe me forcat konvencionale, **jep të drejtë që marrëdhëniet e operacioneve psikologjike të jenë të veçanta nga operacionet speciale të tjera. Fokusimi i operacioneve psikologjike është shumë më i gjerë** se sa ato aktivitete që ndiqen në arenën e luftimit nga komanda e operacioneve speciale dhe komandim-kontrolli i tyre duhet të jetë i organizuar në atë mënyrë që të lejojë akses drejtpërdrejt Shtabit të Përgjithshëm dhe integrim të plotë me të gjitha nivelet. Komandim-kontrolli i forcave për operacionet psikologjike normalisht ushtrohet nga krijimi i një **Task Force për Operacionet Psikologjike të Përbashkëta** e varur drejtpërdrejt nga Forca e Bashkuar.

4.3. Përgatitja për angazhim në operacionet speciale.

FS Shqiptare që nga muaji Gushti i vitit 2010-Mars 2014, ishin të angazhuara në misione luftimi direkte në mbështetje të ushtrisë amerikane në zonat Jugore të Afganistanit. Me qëllim realizimin me sukses të këtyre misioneve, nga ana jonë iu kushtua një rëndësi e madhe të gjithë spektrumit të përgatitjes së këtyre forcave. Programi i stërvitjes ka qënë i ndërtuar mbi bazën e Listës Themelore të Detyrave (LTHD) që këto efektiva do të kryenin në ato terrene dhe duke patur gjithmonë parasysh dhe TTP-të e kundërshtarit, të cilat kanë qënë objekt i studimit të hollësishëm nga ana jonë dhe i stërvitjes në vazhdimësi kundër këtyre TTP-ve, me qëllim që i gjithë efektivi të njihet nga afër me këto detyra. Këto stërvitje janë zhvilluar dhe zhvillohen me qëllim përgatitjen dhe certifikimin e efektivit të BFS për misione luftarake para nisjes në detyrë. Nëpërmjet kryerjes së këtyre stërvitjeve, synohej rritja e aftësive

individuale dhe kolektive, qofshin ato taktike, teknike, fizike, psikologjike, si dhe operimi në shtabe multinacionale. Stërvitja përbëhet nga 3 faza¹:

Faza individuale: Gjatë kësaj faze rëndësi e madhe i kushtohet rritjes së aftësive sipas specialitetit si psh: Për specialistët e operacioneve: rritja e aftësive të tyre në lidhje me drejtimin e grupit special në kushte dhe situata të ndryshme luftarake, rritja e nivelit të planizimit në nivel grupi special dhe kompanie, kontrolli i personelit dhe pajimeve para detyrës, gjendjes së tyre pas kthimit nga detyra, mbajtja nën kontroll të vazhdueshëm e disiplinës brenda grupit dhe eliminimi i mangësive të konstatuara më parë. Për specialistët e zbulimit: rritja e aftësive të tyre në përdorimin e pajisjeve speciale të zbulimit special, mirëmbajtja e tyre, mbajtja gjatë gjithë kohës e përditësuar mbi rrjetin e informatorëve, situatës së zbulimit, analizimit dhe vlerësimit të informacioneve që grumbulloheshin çdo ditë në fushëbetejë dhe pjesëmarrja e tyre në procesin e targetimit, informimit në vazhdimësi të grupit me të rehat e fundit që kishin lidhje me situatën e sigurisë, etj. Për specialistët e Armatimit: njohja sa më mirë e pajisjeve dhe armatimit special të grupit, gjendjes së tyre, mirëmbajtja, pjesët rezervë, lloji i municionit dhe çdo gjë që kishte lidhje me punën e tyre, bërja e provave në terren për të parë saktësinë, besueshmërinë, ditën, natën, mjetet e tyre optike, silenciatorët, dylbitë dhe kamerat termale, etj. Marrja e masave për përdorimin e këtij armatimi sa më mirë të jetë e mundur, në mënyrë që të bënte të mundur mbështetjen sa më mirë të grupit special, gjatë detyrave luftarake në mision. Për specialistët e ndihmës së shpejtë: rritja e aftësive të dhënies së ndihmës së shpejtë, përdorimi sa më mirë i materialeve dhe ilaçeve, medikamenteve mjekësore, rritja e kapaciteteve të përdorimit të tyre, etj. Për specialistët e eksplozivave dhe të xhenios: marrja e masave për rritjen e nivelit teknik të përdorimit të ngarkesave për detyra të ndryshme, rritja e sigurisë gjatë përdorimit të tyre, sigurimi i të gjitha materialeve që duheshin me vete në mision dhe kontrolli i gjendjes së tyre teknike dhe sigurisë së tyre, etj. Për specialistët e ndërlidhjes: kontrolli i gjendjes teknike të pajisjeve speciale të ndërlidhjes si psh: laptopëve, celularëve satelitorë, radiove, baterive dhe pajisjeve të tyre, kodeve të çelësave të kriptimit, gjendja teknike e UAV-ve, radiot individuale, radiot e mjeteve dhe ndërrimi i vazhdueshëm i çelësave të kriptimit për OPSEC, etj. Përveç këtyre specialiteteve duhet bërë dhe kontrolli i njohurive për procesin e planizimit nga ana e drejtuesve të grupeve dhe të kompanive, detyrat e ndryshme speciale, ligjshmërisë

1. Urdhër Komandanti të BFS nr. 236, datë 09.11.2012 dhe program stërvitor i "Eagle VI"

dhe drejtimit të brendshëm. Këto do të gërshetoheshin ndërmjet mësimave teorike, stërvitjes taktike në terren në kushte sa më të njëjta me ato të misionit, përgatitjes së vazhdueshme bazë fizike dhe testeve për nivelin e njohjes së detyrave nga të gjithë nivelet e njësive të efektivit të SOLTG-së. Në fund synohej që operatori special të ishte operacional, i përgatitur institucionalisht dhe i gatshëm për vetëzhvillim¹.

Faza e njësive të vogla: Gjatë kësaj faze rëndësi e madhe i kushtohej rritjes së aftësive të të vepruarit në bazë nëngrupi, (6 persona) dhe grupi (12 persona). Kjo fazë kishte si qëllim kompaktësimin e grupeve dhe të nëngrupeve në kryerjen e detyrave të zbulimit special (SR), gjatë kryerjes së misionëve të goditjeve direkte (DA), gjatë kryerjes së operacioneve speciale dhe gjatë detyrave të shoqërimit të personaliteteve ushtarake dhe civile (PSD). Qëllimi ishte kompaktësimi i veprimeve në bazë grupi dhe i kushtohej rëndësi rritjes së nivelit të kapaciteteve operacionale dhe të zbatimit sipas standarteve të NATO-s të të gjithë fazave të ekzekutimit në nivel grupi. I gjithë procesi i stërvitjes zhvillohej në gjuhën angleze, në mënyrë që të rrisë nivelin e bashkëveprimit me partnerët tanë kur të dislokohehim në Afganistan. Rëndësi e madhe i kushtohej dhe procedurave të evakuimit mjekësor, duke përdorur të njëjtat procedura me amerikanët siç është psh: 9 linjat e MEDVAC-ut dhe rritjes së kapaciteteve për thirrjen e mbështetjes me zjarr nga ajri (CAS).


Faza kolektive: Gjatë kësaj faze rëndësi e madhe i kushtohej rritjes së aftësive të të vepruarit në bazë kompanie e FS dhe e të gjithë njësive të atashuara pranë SOLTG-së (CS & CSS). Të gjithë efektivit ju kërkua që aftësitë e fi në të dy fazat e para, do të avancoheshin me ndërthurjen e elementëve në një operacion të përbashkët JOINT/COMBINED. Që një grup i FS të jetë i suksesshëm në kryerjen e detyrës së tij, duhet të mbështetet nga shërbime të specialiteteve të degëve të ndryshme të CJSOCC të partnerëve apo të aleatëve me të cilët bashkëveprojnë. Këtu mund të përfshihen elementë nga forcat ajrore, shërbimet e inteligjencës, toga apo kompani Komando, etj për detyrat e ndërhyrjes së shpejtë (QRF) apo CASEVAC dhe ndonjëherë edhe shërbime sigurie civile apo paramilitare, siç ishin forca të ndryshme policie afgane.

E gjithë stërvitja kolektive mbaronte me një stërvitje që quhej “Eagle Sage” e

1.FM 7-1 ose FM 25-101, “Battle focused training” HQ Department of the Army, Viti 2003, faqe 1-2, 1-5.

cila konsistonte në 3 ditë zgjidhje detyrash pa ndërprerje që nga SR, DA dhe SSE, ku gjatë gjithë kohës efektiv monitorohej nga afër nga shtabi i FS dhe ku do të duhej që të zgjidhin detyra të ndryshme të dhëna në kohë të ndryshme.

Pas realizimit me sukses të të treja fazave të stërvitjes atëherë realizohej dhe certifikimi i njesisë i cili konsiderohej i gatshëm (Combat Ready) për dislokim.



Skema 5.2. Modeli i përgatitjes së Operatorëve të Forcave Speciale

Rëndësi të veçantë do t'i kushtohej dhe përgatitjes së drejtuesve duke filluar nga nivelet e nëngrupeve, grupeve, kompanive dhe shtabit të FS, (SOTU, SOLTG).

Seksioni i operacioneve në bashkëpunim me shtabin e kompanisë dhe specialistët e fushave të ndryshme janë ata që duhet të ndërtojnë, planëzojnë dhe ekzekutojnë stërvitjen e FS. Mbështetur në praktikat ekzistuese, plani i stërvitjes duhet të ndërtohet duke mbajtur gjithmonë parasysh mësimet e nxjerra dhe duke e përshtatur atë vazhdimisht me kërkesat operacionale. Drejtuesit e këtyre stërvitjeve duhet të tregojnë kujdes dhe të synojnë në rritjen e aftësive dhe jo në stanagizimin e tyre. Sipas meje mënyra më efektive për të arritur këtë, është që stërvitja të ngrihet në formë modulare. Kjo nënkupton që çdo modul të funksionojë si i veçantë në dhënien e njohurive dhe aftësive taktike e teknike. Si i tillë, moduli është më i thjeshtë për t'iu përshtatur ndryshimeve dhe zhvillimeve të fundit në fushëbetejë. Duke i bërë këto module përgjegjësi individuale të personave të caktuar apo seksioneve specifike,

moduli ka më shumë gjasa të përshtatet me mësimet e nxjerra jo vetëm nëpër misione, por edhe gjatë stërvitjes.

Pjesëmarrës në këto stërvitje janë pjesëtarët e kompanive të aksioneve direkte, alpine, parashutiste dhe të zhytjes së luftimit, grupet operacionale, shtabi i kompanisë si dhe efektivat e kompanive mbështetëse qofshin këto forca komando apo këmbësorie. Duke përsëritur atë çka u përmend dhe më lart, sipas gjykimit tim, në stërvitje duhet të marrin pjesë jo vetëm trupat operacionale, por edhe ato të mbështetjes luftarake (CS) dhe logjistike (CSS).

“Stërvitu si do të luftosh dhe lufto si stërvitesh”¹. Kjo ka qënë gjithmonë motoja ime si komandant që nga dita e parë që mora përgjegjësinë e komandimit të FS shqiptare në Janar të vitit 2007-Nëntor 2013.

Shpesh vështirësitë më të mëdha në operacionet luftarake të FS, qëndrojnë në vështirësinë e gjetjes së gjuhës së përbashkët me specialitetet e tjera që nuk janë apo nuk njohin doktrinën e FS. Ky ka qënë dhe arsyeja që na bëri që për herë të parë të botonim Doktrinën e FOS të Republikës së Shqipërisë në Dhjetor të vitit 2013, me qëllim standartizimin e misioneve dhe të detyrave të FOS shqiptare. Duke i angazhuar këto forca që në fazat e para të stërvitjes, operatori special arrin të krijojë një ide më të mirë për kapacitetet, mënyrën dhe kohën që i duhet specialiteteve të tjera për të realizuar një detyrë apo për të mbështetur operacionin në bazë të kërkesave operacionale.

Armatimi dhe pajisjet që përdoren për stërvitjet e paradislokimit duhet të jenë standarde sipas TOP-it të njësisë që merr pjesë në operacion. Sipas LTHDM dhe të kërkesave të moduleve të stërvitjes, do të bëhet dhe ndarja specifike e armatimit apo pajisjeve. E rëndësishme në këtë fazë është që i gjithë efektivi të njohë dhe të dijë të përdorë në mënyrë taktike çdo pajisje dhe armatim që zakonisht i rezervohet specialistëve të fushave të ndryshme.

Faza e përgatitjes individuale

Kjo fazë do të ketë si qëllim rritjen e aftësive individuale fizike dhe psikologjike të efektivit dhe përvetësimin nga ana e tyre e detyrave ushtarake në betejë. Ajo përbëhet nga ana teorike, taktike dhe përgatitja fizike.

Së pari: Teoria në vetvete përmban tema si Operacionet Speciale. Këto duhet të jenë gjithëpërfshirëse dhe të përmbajnë pjesë nga zbulimi special, zbulimi me burime njerëzore HUMINT, trajnimi i strukturave të sigurisë të vendit pritës (FID), detyra

1. Shprehje popullore e Forcave të Armatosura të Mbretërisë së Bashkuar.

drejtpërdrejt në terrene urbane, rurale, alpine dhe malore, analiza dhe kontrolli i Zonave/ hapësirave Sensitive (SSE), armatimi dhe pajisjet speciale, përgatitja e specialistëve në fushat përkatëse, Procesi i Planëzimit/ Procesi i Vendimmarrjes Ushtarake dhe tema të tjera, të cilat vendosen në varësi të kërkesave të njësisë speciale. Ashtu siç e kemi theksuar dhe pak më lart në këtë kapitull, faza individuale e stërvitjes duhet të përfshijë edhe ligjshmëri, duke u përqëndruar kryesisht në ligjet dhe urdhëresat e brendshme dhe ndërkombëtare (ROE), që ekzistojnë dhe të cilave u nënshtrohen trupat tona gjatë kryerjes së detyrave luftarake në kuadrin e mbështetjes së detyrave të aleancës. Nuk duhet harruar gjithashtu dhe Drejtimi i Brendshëm, i cili plotëson karakterin e operatorit special me traditat vlerat dhe normat kulturore të njësisë dhe atdheut, por dhe i jep atij një vështrim më të gjerë mbi vendet ku ai do të operojë¹.

Në bazën e njësisë speciale është gjithmonë individi.

“Zinxhiri është i fortë sa ç’është dhe hallka më e dobët e tij.”²

Individit duhet t’i jepen njohuritë, aftësitë dhe gjithçka i nevojitet që ai të kompletohet institucionalisht dhe taktikisht në realizimin me sukses të detyrave të grupeve speciale.

Së dyti: faza individuale e stërvitjes përpara dislokimit duhet t’i kushtojë rëndësi të veçantë Mësimeve Taktike. Njohja dhe përvetësimi i këtyre aftësive kryhet me anë të praktikës. Në to përfshihen ndihma e parë në fushëbetejë, temë kjo që u rezervohet të gjithë operatorëve specialë, me qëllim që të gjithë të jenë të aftë të veprojnë në rastin e përplasjes me një rrezik mjekësor. Më pas siç e kemi theksuar dhe pak më lart në këtë kapitull, kryhet stërvitja e specialiteteve, që përfshin detyrat e specialistëve të armatimit, të ndërlidhjes, të xhenios, mjekësisë, zbulimit dhe të operacioneve. Pasi kjo të jetë kryer, stërvitja individuale kalon në fazën e taktikës, e cila përfshin tema si: traversa individuale, taktikat e luftimit special në zona rurale, taktikat e luftimit special në zona malore dhe shpella, taktikat e luftimit special në qendra të banuara, qitje taktike me armë dhe distanca të ndryshme sipas taktikave të luftimit special në terrene të ndryshme. Sërish këto module janë subjekt i përshtatjes së vazhdueshme sipas mësimeve të nxjerra në mision apo gjatë stërvitjes si dhe nevojat specifike të detyrës.

1.Special Operations Forces Study Guide. Special Operations Forces Element. Ft Leavenworth, Kansas, 2003, Kap. II, seksioni A.

2.Shprehje popullore e Forcave të Armatosura të Shteteve të Bashkuara

Së treti: vëmendje e veçantë i kushtohet dhe përgatitjes bazë fizike. Kjo në vetvete nuk nënkupton vetëm përgatitjen rutinë (vrapime dhe ushtrime force), por duhet të përqëndrohet edhe në kalitjen e shkathtësisë fizike me anë të ushtrimeve atletike, përgatitjes fizike speciale ushtarake, si dhe lojëra kolektive që mundësojnë më tej punën në grup.

Një mendje e shëndoshë, në trup të shëndoshë!

Faza e Përgatitjes së Njësive të Vogla

Faza tjetër e stërvitjes për dislokimin në mision ndiqet nga Faza e Përgatitjes së Njësive të Vogla. Kjo ka si qëllim rritjen e aftësive të nëngrupeve, grupeve dhe shtabit të SOTG-së, përvetësimin nga ana e tyre të detyrave luftarake në betejë. Gjithashtu, edhe kjo fazë përfshin mësimet teorike, aplikimin e tyre praktik në taktikat luftarake si dhe në skenarë të cilat operatorët do t'ju duhet ti zgjidhin praktikisht në fushë betejë si dhe ruhej vazhdimësia e përgatitjes bazë fizike. Teoria dhe praktika këtu ndërthuren me njëra tjetrën, duke i dhënë njësive speciale mësimet e nevojshme për zgjedhjen e detyrave në nivelin e grupit special dhe të 3 grupeve së bashku me shtabin e tyre. Temat përfshijnë detyrat e specialistëve të grupeve në operacionet speciale, procesin e planizimit dhe vendimmarrjes ushtarake, operacionet speciale në nivel grupi për detyra si zbulim special, goditje direkte, mision të Asistencës Ushtarake, detyra zbulimi me burime njerëzore (HUMINT), trajnimi i strukturave të sigurisë së vendit pritës (FID), detyra drejtpërdrejt në terrene urbane, rurale, malore, kontrolli i Hapësirave Sensitive (SSE), QRF dhe CASEVAC dhe veprime kundër pajisjeve shpërthyes të improvizuara. Në këtë fazë rëndësi do t'i kushtohet jo vetëm mësimi të teknikave dhe procedurave të suksesshme, por edhe përshtatjes së tyre sipas aftësive dhe nevojave të njësisë.

Aspekt tjetër i rëndësishëm i stërvitjes kolektive është edhe realizimi i detyrave të drejtpërdrejta, traversave taktike, ikjes dhe shpëtimit, mbijetesës dhe mbijetesës luftarake (në rastin e kapjes rob), operacionet e transportueshme nga ajri, patrullimi luftarak dhe pikat e kontrollit. Këto tema duhet të përfshijnë jo vetëm punën në grup të FS tona, por edhe teknikat e veprimit me ushtritë e tjera të vendeve aleate.

Nga kjo fazë duhet të arrihet që grupet të jenë të afta të kryejnë me sukses detyra të ndryshme të caktuara dhe shtabi së bashku me elementët e tjerë mbështetës, të jenë të përgatitur të ofrojnë një mbështetje të plotë e të qartë njësive gjatë planizimit dhe kryerjes së detyrave.

Faza e Përgatitjes Kolektive

Së fundi, stërvitja e njësive përpara dislokimit përmban fazën e përgatitjes kolektive. Kjo fazë mbledh bashkë të gjithë elementët përbërës të një SOLTG-je siç janë grupet dhe shtabet operative, shtabet dhe njësitë e tjera mbështetëse. Thelbi i kësaj stërvitjeje është zgjidhja e detyrave komplekse në një fushëbetejë, ku FS nuk janë të vetmet që operojnë, por ato ndeshen dhe ndihmohen edhe nga njësi të tjera të vendit tonë apo vendeve të tjera aleate (Demiraj, 2009, 17). Qëllimi qëndron në rritjen e aftësive kolektive për zhvillimin e operacioneve speciale, përvetësimin nga ana e efektivit të detyrave ushtarake në betejë dhe praktikimi i teknikave dhe procedurave për punën në ambiente multinacionale (COMBINED). Thelbi i kësaj faze qëndron në zhvillimin e stërvitjeve komplekse, të përbëra nga skenarë të posaçëm dhe gjithëpërfshirës në fushat e funksionimit efi të qendrave operacionale C4I, ruajtjen e ritmit të betejës, zgjidhja e detyrave speciale me përfshirjen e të gjithë elementëve përbërës të një SOTG-je, administrimi i burimeve, procedurat standarde të veprimit/ protokoll veprimi emergjent, etj. E rëndësishme është që realizimi i detyrave dhe plotësimi i tyre me brifi apo procedurat përkatëse, të kryhet nga vetë pjesëtarët e njësive speciale dhe të mbikëqyret nga specialistët e fushave të ndryshme për përputhje me urdhëresat, rregulloret dhe ligjet në fuqi. Sërish këtu nuk duhet harruar që t'i kushtohet rëndësi përshtatjes së tyre me nevojat e njësisë dhe zhvillimit të fushëbetejës.

Në përballje me sfidat operacionale.

Si përmbledhje, stërvitja e njësive speciale përpara dislokimit përbëhet nga tre faza. Ajo individuale, e njësive të vogla dhe faza kolektive. Të tre këto faza planëzohen dhe zhvillohen nën parimin e modularitetit për të mundësuar një stërvitje sa më të kohës, që i përshtatet ndryshimit të fushëbetejës dhe mësimave të nxjerra (QAM – KDS, 2011, 115-118). Duke u nisur nga parimi se në thelb të njësisë së FS qëndron individi, kjo stërvitje duhet t'i japë operatorit special një formim të qëndrueshëm që ai të jetë operacional, institucional dhe në kërkim të vetëzhvillimit mbi bazën e vlerave ushtarake dhe kulturore kombëtare të

etikës, principeve, standardeve dhe kulturës ushtarake, të cilat vazhdimisht qëndrojnë nën tryshninë e vlerësimit dhe përmirësimit (18 SOTG - NATO SOCC, 2009, Q-1).

Përfundime.

FS duhet të jenë në vartësi operacionale të SHSHP të FA të Republikës së Shqipërisë. Kontrolli operacional i FS mund të ushtrohet nga komandanti i tyre ose nga Komandanti i Forcës Tokësore. Komandantët që urdhërojnë autoritetet komanduese mbi FS, duhet të kenë gjithmonë parasysh:

- Të sigurojnë një zinxhir komandimi të qartë dhe lehtësisht të kuptueshëm.
- Të shmangin ndryshimin e vazhdueshëm të kontrolleve të operacioneve ndërmjet komandantëve të ndryshëm.
- Të sigurojnë eksperiencën dhe njohuritë e mjaftueshme për shtabin e këtyre forcave në mënyrë që ky shtab të jetë i aftë të planëzojë, të kryejë dhe të mbështesë operacionet speciale.
- Të integrojnë FS në procesin e targetimit, planizimit dhe të ekzekutimit.
- Të përshtatë kapacitetet e FS me kërkesat e misionëve dhe detyrave.

Normalisht, komandim-kontrolli i FS duhet të ekzekutohet brenda zinxhirit komandues të tyre. Komandim-kontrolli (C2) i FS për operacionet psikologjike (PSYOP) dhe marrëdhëniet civilo-ushtarake (CA), bazuar në rolin unik të tyre në arenën e luftimit, diskutohen veçantë nga komandim-kontrolli i FS të tjera. Krijimi i strukturave të organizuara të komandim-kontrollit për FS duhet të varet nga objektiva specifike, nevojat e sigurisë dhe mjedisi operacional ku ata janë të dislokuar. Që nga muaji Gusht i vitit 2010 e deri në Mars 2014, FS Shqiptare janë angazhuar në misione luftimi direkte në mbështetje të ushtrisë amerikane në zonat Jugore të Afganistanit. Me qëllim realizimin me sukses të këtyre misionëve, nga ana jonë i është kushtuar një rëndësi e madhe të gjithë spektrumit të përgatitjes së këtyre forcave. Nëpërmjet kryerjes së këtyre stërvitjeve, synohet rritja e aftësive individuale dhe kolektive, qofshin ato taktike, teknike, fizike, psikologjike, si dhe operimi në shtabe multinacionale. Stërvitja përbëhet nga 3 faza:

Faza e përgatitjes individuale

Kjo fazë kishte si qëllim rritjen e aftësive individuale fizike dhe psikologjike të efektivit dhe përvetësimin nga ana e tyre e detyrave ushtarake në betejë. Ajo përbëhej nga ana teorike, taktike dhe përgatitja fizike.

Së pari: Teoria në vetvete përmban tema si Operacionet Speciale. Këto duhet të jenë gjithëpërfshirëse dhe të përmbajnë pjesë nga zbulimi special, zbulimi me burime njerëzore HUMINT, trajnimi i strukturave të sigurisë të vendit pritës (FID), detyra drejtpërdrejt në terrene urbane, rurale, alpine dhe malore, analiza dhe kontroll i Zonave/ hapësirave Sensitive (SSE), armatimi dhe pajisjet speciale, përgatitja e specialistëve në fushat përkatëse, Procesi i Planëzimit/ Procesi i Vendimmarrjes Ushtarake dhe tema të tjera, të cilat vendosen në varësi të kërkesave të njësisë speciale. Në bazën e njësisë speciale është gjithmonë individi.

Së dyti: Faza individuale e stërvitjes përpara dislokimit duhet t'i kushtonte një rëndësi të veçantë Mësimeve Taktike. Njohja dhe përvetësimi i këtyre aftësive kryhet me anë të praktikës. Në to përfshihen ndihma e parë në fushëbetejë, temë kjo që u rezervohej të gjithë operatorëve specialë, me qëllim që të gjithë të jenë të aftë të veprojnë në rastin e plagosjeve të ndryshme në fushëbetejë. Më pas siç e kemi theksuar më lart, kryhej stërvitja e specialistëve, që përfshinte detyrat e specialistëve të armatimit, të ndërlidhjes, të xhenios, mjekësisë, zbulimit dhe të operacioneve. Pasi kjo të jetë kryer, stërvitja individuale kalon në fazën e taktikës, e cila përfshin tema si: traversa individuale, taktikat e luftimit special në zona rurale, taktikat e luftimit special në malore dhe shpella, taktikat e luftimit special në qendra të banuara, qitje taktike me armë dhe distanca të ndryshme sipas taktikave të luftimit special në terrene të ndryshme. Sërish këto module janë subjekt i përshtatjes së vazhdueshme sipas mësimeve të nxjerra në mision apo gjatë stërvitjes si dhe nevojat specifike të detyrës.

Së treti: Vëmendje e veçantë i kushtohet dhe përgatitjes bazë fizike. Kjo në vetvete nuk nënkuptonte vetëm përgatitjen rutinë (vrapime dhe ushtrime force), por duhet të përqëndrohej edhe në kalitjen e shkathhtësisë fizike me anë të ushtrimeve atletike, përgatitjes fizike speciale ushtarake, si dhe lojëra kolektive që mundësojnë më tej punën në grup. Një mendje e shëndoshë, në trup të shëndoshë!


KAPITULLI VI

TAKTIKAT E LUFTIMIT – VËSHTRIM ANALITIK DHE PERSPEKTIVË

6.1. Forcat speciale në lloje të ndryshme luftimi

Misionet kryesore të Operacioneve Speciale

Siç është theksuar dhe në Doktrinën e FS të NATO-s, SHBA-së dhe të FOS të Shqipërisë të botuar nga SHP në vitin 2013, FS janë krijuar për të kryer nëntë misione kryesore të operacioneve speciale, të cilat janë të pasqyruara në figurën 6.1 mëposhtme.



Skica 6.1. Misionet themelore që kryejnë FS

Goditje të direkte. (DA)

Janë goditje me kohë të shkurtër dhe veprime sulmuese të tjera në shkallë të vogël, **të kryera nga FS** ose njësi të afta të kryejnë operacione speciale për të kapur, shkatërruar, zënë rob, rimarrë ose shkaktuar dëmtime në personel, materiale e pajisje të përcaktuara. Në kryerjen e këtyre operacioneve, këto forca (FOS) ose njësi janë të afta të kryejnë operacione speciale, por mund të kryejnë dhe sulme, prita, apo veprime të sulmeve të drejtpërdrejta; vendosjen e minave ose municioneve të tjera; kryerjen e sulmeve në distanca të largëta nga ajri duke përdorur teknika HALO, HAHO, nga toka dhe nga platformat detare; duke dhënë koordinatat përfundimtare për raketat e drejtuara të distancave të largëta me precizion, të cilat lëshohen nga platformat detare, nga toka ose avionët, gjithashtu kryejnë operacione sabotazhi të pavarura dhe operacione kundër mjeteve detare.

Zbulimi Special (SR)

Zbulim Special quhen misionet e zbulimit dhe të vëzhgimit që kryhen nga FOS për të mbledhur apo verifikuar me vrojtim pamor ose me mjete të tjera speciale, metoda të tjera grumbullimi informacionin në lidhje me aftësitë, qëllimet dhe aktivitetin e armikut aktual ose të mundshëm, si dhe të sigurojë të dhëna për një pjesë të veçantë zone në lidhje me karakteristikat meteorologjike, hidrografike ose gjeografike. Ai përfshin përcaktimin e objektivave, vlerësimin e zonës dhe zbulimin mbas goditjes (Demiraj, 2012, 21-22).

Stërvitje të ushtrive të huaja (FID)

Bëhet fjalë për pjesëmarrjen e një qeverie me anë të agjencive civile apo ekupeve ushtarake të efektivëve të FOS në ndonjë program trajnimi të ndërmarrë nga një qeveri tjetër, për të mbrojtur dhe çliruar shoqërinë e saj nga përmbysja, moszbatimi i ligjit dhe kryengritja.

Kontributi kryesor i FOS-it në një aktivitet ndër-agjensish është të organizojë, stërvisë, këshillojë dhe ndihmojë forcat ushtarake dhe paraushtarake të shtetit pritës (HN). Qëllimi është që t'i bëjë këto forca më të afta që të ruajnë stabilitetin e brendshëm

të vendit pritës, të përballojnë përmbysjen e pushtetit dhe dhunën në vendin e tyre si dhe të gjejnë shkaqet e destabilitetit. Stabiliteti i brendshëm është baza për suksesin në ndërtimin e një vendi. Misionet e suksesshme FID mund të çojnë në suksese operationale ose strategjike për politikën e jashtme të vendit tonë. Në aktivitetet FID përfshihen, si më poshtë vijon:

Lufta Jo konvencionale (UW)

Kjo lloj lufte është një spektër i gjerë i operacioneve ushtarake dhe paraushtarake, zakonisht me kohëzgjatje të madhe, kryesisht e kryer nga forcat vendëse ose të pastërvitura, të cilat janë të organizuara, stërvitura, të pajisura, mbështetura dhe drejtuar në shkallë të ndryshme nga një burim i huaj. Ajo përfshin luftën guerile dhe operacione të drejtpërdrejta sulmuese, të fshehta, të maskuara dhe pak të dukshme, gjithashtu dhe aktivitetet indirekte të përmbysjes së pushtetit, sabotimit, inteligjencës dhe arratisjes e shpëtimit (E&E) (Demiraj, 2012, 24).

Lufta Guerile: është operacioni ushtarak dhe paraushtarak i kryer nga forca të parregullta, kryesisht vendase në zonat e armikut ose armiqësore. **Ajo është dukshëm një aspekt ushtarak i një kryengritjeje ose i një rezistence tjetër të armatosur.** Forcat guerile kryesisht përdorin taktikat e sulmeve dhe pritave kundër pikave më të dobëta të armikut (DSO – JP, 1998, 2-7)

Subversioni: është një aktivitet i përcaktuar për të sabotuar forcën politike, psikologjike, ekonomike, ushtarake ose moralin e një regjimi apo kombi të caktuar. Natyra e fshehtë e përmbysjes së pushtetit, bën që elementët e padukshëm “nën rrogë” të kryejnë pjesën më të madhe të aktivitetit.

Sabotimet: janë akte me qëllim që të dëmtojnë, ndërhyjnë ose të pengojnë mbrojtjen kombëtare të një vendi të caktuar, duke shkatërruar, dëmtuar me dashje apo duke u përpjekur për të shkatërruar mbrojtjen kombëtare, materiale luftarake, godinat, pajisjet, duke përfshirë burimet njerëzore dhe natyrore. Sabotazhi në mënyrë të zgjedhur pengon, shkatërron ose neutralizon aftësitë e armikut me një shpenzim minimal të fuqisë njerëzore apo materiale.

Lufta kundër terrorizmit (CT)

Veprimet në këto lloj operacionesh përfshijnë masat antiterrorizëm (AT, masat mbrojtëse që merren për të reduktuar dobësitë kundrejt akteve terroriste) dhe masat kundër terrorizmit (CT, masat sulmuese që merren për të parandaluar apo për t'iu kundërvënë terrorizmit dhe gjithë rrezikut të prezencës së tij).

Në aktivitetet për luftën kundër terrorizmit përfshihen, si më poshtë vijon:

Rimarrja e pengjeve ose materialeve sensitive nga organizatat terroriste: janë operacionet që kryhen për të marrë pengjet ose materialet sensitive nga kontrolli terrorist, që kërkojnë ndërhyrje të shpejta, shokuese, të befasishme dhe goditje të forta e të sakta. **Siguria e jetës së pengjeve dhe parandalimi i shkatërrimit** të materialeve sensitive, është një kërkesë themelore e kërkesave të misionit.

Sulmet në infrastrukturën terroriste: janë goditjet me përparësi të kryera kundër organizatave terroriste me **objektiv shkatërrimin**, ç'organizimin ose ç'armatimin e organizatave terroriste përpara se ato të mund të godasin objektiva me interes kombëtar dhe strategjik.

Reduktimi i dobësive ndaj terrorizmit: është përgjigja ndaj kërkesave të shërbimeve inteligjente dhe agjencive të tjera qeveritare për stërvitjen se si të reduktojnë dobësitë ndaj terrorizmit dhe kërcënimeve të tjera armiqësore. Kjo gjithashtu përfshin **vlerësimin, nëse sistemet ekzistuese të sigurisë fizike janë të mjaftueshme apo jo** dhe të aktiviteve mbrojtëse që kryhen për të siguruar sigurinë fizike të personave të rëndësishëm (VIP) (Demiraj, 2012, 25-26).

Operacionet Psikologjike (PSYOP)

Janë operacione të planëzuara për t'i dhënë informacion dhe disa tregues të zgjedhur, një audience të huaj, për të influencuar ndjenjat, motivet, arsyetimin objektiv dhe përfundimisht sjelljen e qeverive të huaja, organizatave, grupeve e individëve. Qëllimi i Operacioneve Psikologjike është të nxisë ose përforcojë

sjelljen dhe qëndrimin e të huajve në favor të objektivave të origjinës (tonat). Si përforcues forcash, Operacionet Psikologjike janë **një nga armët më efektive në dispozicion të një komandanti.** Ato mund të reduktojnë viktimat në të dyja krahët duke ulur moralin dhe efektivitetin luftarak të armikut, duke krijuar mosmarrëveshje dhe mospëlqim brenda radhëve të tyre, duke inkurajuar dorëzimin dhe dezertimin, ose përhapin rezistencë, nxitje brenda popullsisë civile për të munguar mbështetja për një regjim armiqësor (DSO – JP, 1998, 9).

FOS kryejnë Operacione Psikologjike në nivel strategjik, operacional dhe taktik. Duke patur avantazh nga aftësitë gjuhësore dhe kulturore, njohuri të thella për zonën dhe kuptimin e operacioneve ndër-agjencinore, njësitë e FOS-it i ofrojnë komandantëve një aftësi në shkallë të gjerë të operacioneve psikologjike për ta përdorur në mënyrë të pavarur ose në mbështetje të një fushate më të gjerë se teatri luftarak. Këto aftësi përfshijnë si më poshtë vijon:

Marrëdhëniet civilo-ushtarake (CA)

Marrëdhëniet civilo-ushtarake janë aktivitetet e një komandanti që krijojnë, mbajnë, influencojnë dhe shfrytëzojnë marrëdhëniet ndërmjet forcave ushtarake dhe autoriteteve civile, të dyjave qeveritare dhe jo qeveritare dhe të popullsisë civile, në një zonë operacioni miqësore, neutrale ose armiqësore, me qëllim që të ndihmojë operacionet ushtarake dhe të konsolidojë objektivat operacionalë. Punët Civile (CA) mund të përfshijnë kryerjen nga ana e forcave ushtarake të aktiviteteve dhe funksioneve që janë normalisht përgjegjësi e qeverisjes lokale. Këto aktivitete mund të ndodhin para, gjatë ose dhe pas operacioneve të tjera ushtarake. Ato gjithashtu mund të ndodhin kur urdhërohen edhe në mungesë të operacioneve të tjera luftarake.

Kundër përhapjes (CP) së Armëve të dëmtimit në masë (WMD)

Kundërpërhapja i referohet veprimeve që ndërmerren për të kapur, shkatërruar, shndërruar në siguri, ose rimarrë armët e dëmtimit në masë (WMD). Objektivi madhor i politikave të Ministrisë të Mbrojtjes është që të parandalojë përvetësimin e ADM-ve (WMD) dhe raketave (mbrojtja parandaluese); t'i kapë ato dhe të pengojë përdorimin e

tyre dhe sistemeve të shpërndarjes; të përgatisë forcat ushtarake për të vepruar kundër rrezeve që shfaqin ato dhe sistemet e tyre të shpërndarjes.

Operacionet e Informacionit (OI)

Operacionet e informimit (OI), përfshijnë veprimet që merren për të ndikuar në informacionin dhe sistemet e informacionit të kundërshtarit, ndërsa mbrojmë informacionin dhe sistemet tona të informacionit. OI aplikohen gjatë të gjitha fazave të operacionit dhe shkallës së operacioneve ushtarake dhe në të gjitha nivelet e luftës. Luftë informative janë operacionet e informacionit që kryhen në kohë krize apo konflikti (përfshirë dhe luftën) për të arritur ose ndihmuar objektiva specifike mbi një kundërshtar specifik apo disa kundërshtarë. Aktivitetet e OI mbrojtëse kryhen vazhdimisht dhe janë pjesë e pandarë e përdorimit të forcave në të gjitha shkallët e operacioneve ushtarake. OI mund të përfshijnë çështje të përbëra politike dhe ligjore, që kërkojnë mbikëqyrje të kujdesshme, koordinim dhe aprovim në nivel kombëtar (DSO – JP, 1998, 10).

6.2. Lidershipi në luftim

Sfidat e drejtuesit gjatë misionit

Komunikimi me familjen në atdhe dhe siguria operationale (OPSEC)

Kërkesa për informacion është e lartë. Të plotësosh kushtet e kësaj nevojë të fokusuar në mënyrë operationale dhe në bazë të sigurisë operationale (OPSEC) është sfidë e veçantë dhe aspak e lehtë për kushtet tona. Operatorët e FS duhet të jenë të disiplinuar për të ndjekur rregulloret në fuqi, kur komunikojnë me familjet e tyre dhe kur përdorin adresa të rrjeteve sociale, pasi vetë qenia e tyre në njësi elitë të cilat kryejnë detyra me rëndësi operationale dhe strategjike, kërkon një ruajtje me rigorozitet të natyrës së misioneve, kohës, vendit, objektivave, etj të cilat jo vetëm që mund të rrezikojnë jetën e operatorëve, por mund të kenë gjithashtu dhe implikime shumë të mëdha politike deri për politikën e jashtme të RSH. Në shumicën e rasteve, ushtarakët në mision për shkak të neglizhencës, mund të përcjellin nëpërmjet rrjeteve sociale të komunikimit informacione në lidhje me vendndodhjen e tyre, detyrat që kanë kryer dhe do të kryejnë. Liderët e drejtpërdrejtë duhet të jenë gjithmonë të siguruar që

efektivi është i njohur me rregullat e komunikimit dhe përdorimit të rrjeteve sociale, me qëllim mbrojtjen e informacionit dhe rritjen e sigurisë operative (OPSEC).

Prezenca e liderit në fushëbetejë

Një lider duhet të drejtojë në fushëbetejë për të parë, komunikuar dhe drejtuar vartësit e tij duke fituar një kuptim më të mirë të kushteve në të cilat ata operojnë. Prezenca e liderit (komandantit) në operacionet luftarake speciale, motivon moralisht ushtarakët në mision. Kjo rrit besimin që vartësit kanë te liderët e tyre dhe gjejnë motivimin e duhur për ta realizuar me sa më shumë sukses detyrat e ngarkuara. Gjetja e kohës për të kryer qarkullimin në fushëbetejë, drejtuar dhe komanduar sa më shumë që të jetë e mundur operacione të tilla, do të jetë sfidë. Liderët jo gjithmonë do të kenë kohë për të qenë prezent në çdo operacion. Në varësi të axhendës së tyre, liderët ushtarakë duhet të vendosin prioritetet, përse i përket pjesëmarrjes në operacione me njësitë vartëse. Duke patur një kohë të gjatë rreth 16 vite në ambientin e operacioneve speciale brënda dhe jashtë vendit do të theksoja si shumë të suksesshëm disa drejtues që njihen sot në të gjithë botën si: Gjeneral Stanley McCrystal, Gjeneral David Petraeus, ADM William McRaven, LTG John Mullen, LTG Frank Kisner, LTG Tova, MG Reepass, ADM Sean Pybus, etj të cilët kanë qënë shembull në drejtimin e misioneve të tyre nga niveli strategjik për amerikanët. Koha të cilën këta drejtues e kanë kaluar duke drejtuar misionet drejtpërdrejt në terren, kanë bërë të mundur rritjen e motivimit tek efektivi, por jo vetëm kaq dhe rritjen dukshëm të suksesit për realizimin e misioneve.

Vetëkënaqësia

Misionet apo detyrat e tejzgjatura nuk krijojnë mundësi për argëtim, në shumicën e rasteve krijojnë një ndjenjë sigurie false tek njësitë apo operatorët gjatë misionit. Kjo lloj ndjenje shkaktohet nga disa shkaqe, por në thelb vetëkënaqësia mund të përkufizohet si ndjenjë vetëbesimi apo sigurie e pajustificueshme, pasi anashkalohen apo neglizhohen mangësi dhe rreziqe të cilat në pamje të parë nuk konsiderohen si të tilla. Kjo paraqet një rrezik të madh, pasi operatorët në mision, humbin fokusin dhe përqëndrimin dhe ekspozohen ndaj rrezikut të papritur i cili mund të ketë pajoja të rënda për individin ose për njësinë pjesë e së cilës ai është. Për të parandaluar këto raste, drejtuesit duhet të ndërmarrin hapa të rëndësishëm, disa nga të cilat renditen si më poshtë vijon:

1. Sigurimi për zbatimin e rregullave me precedencë.
 2. Rrotacioni i detyrave për njësi të ndryshme të realizohet duke dorëzuar të gjitha detajet që kanë lidhje me sigurinë në operacion.
 3. Kryerja e vazhdueshme e stërvitjes edhe gjatë kohës së qëndrimit në mision.
 4. Shpjegimi qartë dhe vazhdueshëm i qëllimit të misionit dhe arsyeja përse njësia ndodhet në mision, detyrimet ligjore.
 5. Mos neglizhimi i përgatitjes fizike, si një element i cili mban lart përgatitjen dhe moralin e efektivit.
 6. Përcaktimi qartë i objektivave afatgjatë, afatmesëm dhe afatshkurtër.
 7. Marrja e masave për sigurimin e pushimit të nevojshëm nga vartësit dhe angazhimi i tyre në aktivitete jo ushtarake, kur janë pa angazhime detyrash.
 8. Përfshirja e të gjithë operatorëve në procesin e planizimit dhe analizave të detyrave.
 9. Kryerja e stërvitjes për të papriturën dhe të mësuarit nga gabimet dhe mësimet e nxjerra.
 10. Eliminimi i të gjitha mangësive të cilat u identifikuan në misionin paraardhës.
 11. Zbatimi me rikorozitet i procedurave standarte të veprimit (SOP).
 12. Kryerja e provave praktike para kryerjes së çdo operacioni special në detyrë dhe kontrolli i detajuar i njohurive mbi detyrën dhe i çdo pajisjeje që do të përdoret në mision.
- 1 3. Njohja nga ana e drejtuesit të misionit i gjendje morale, psikologjike, etj për çdo operator efektiv i misionit.
- Çfarë e bën efektiv drejtuesin gjatë misionit

Aftësitë komunikuese

Një lider duhet të komunikojë efektivisht me vartësit e tij, të jetojë me to dhe ti dëgjojë me kujdes, për tu siguruar që qëllimi dhe misioni janë kuptuar drejt. Sipas gjykimit dhe eksperiencës, time aftësitë si figura morale, personaliteti, dinjiteti, komunikimi i duhur dhe mënyra e të shprehurit, aftësitë e drejtimit të misioneve, përgatitja taktike, teknike, profesionale e lidhur ngushtë me detyrat e operacioneve

speciale (si hedhjet me parashutë me efektivin, zhytjet në thellësitë e detit, qëndrimi i tij në çdo stërvitje me efektivin në borë e në shi, vrapimi së bashku me efektivin, etj) qëndrimi pranë vartësve për t'i zgjidhur sa më shumë problemet e tyre, të luftuarit për t'i pajisur, stërvitur, trajtuar dhe shkolluar sa më mirë, të dëgjuarit dhe të respektuarit në rastet kur ata propozojnë çështje të ndryshme në lidhje me stërvitjen dhe realizimin e detyrave, të qëndruarit sa më shumë të jetë e mundur në krye të operacioneve, etj, mendoj se janë disa nga cilësitë të cilat e bëjnë drejtuesin të respektuar para operatorëve. Një lider duhet gjithashtu të komunikojë me shtabin lart dhe të mbështesë njësitë që kanë nën komandë, për ta siguruar njësinë e tij se është duke marrë atë që nevojitet. Liderët marrin vendime dhe i marrin këto vendime sipas informacioneve që kanë siguruar për ta, vartësit e tyre. Informacioni duhet të jetë i kohës, i vlefshëm dhe i detajuar, në mënyrë që të lejojë marrjen e vendimeve të duhura dhe të mundësojë realizimin e misionit në mënyrë sa më të sigurtë që të jetë e mundur.

Të drejtosh me shembullin personal

Një lider duhet të jetë kompetent me operatorët e tij. Ai duhet të tregojë e të performojë në maksimum në mënyrën e sjelljes se çfarë ai pret nga vartësit e tij. Ai duhet të përcaktojë se cili është pozicioni më i mirë i komandimit dhe personave në detyrë dhe vendosjen e tij atje ku duhet. Prezenca e tij në detyra, sipas meje e rrit ndjeshëm moralin e vartësve të tij, por në të njëjtën mënyrë bën që të rritet së tepërmi siguria në operacion, pasi eksperiencia e një lideri të suksesshëm ndikon ndjeshëm në mos bërjen e gabimeve. Në rastet kur lideri merr pjesë në operacion, tregon para vartësve të tij që ai nuk i shmanget përgjegjësisë dhe rrezikut, të cilat në misionet luftarake (shmangiet) kanë patur raste që kanë ndikuar negativisht, në njësi të cilat kanë qënë elitë dhe në nivel botëror.

Zhvillimi dhe besimi i vartësve

Një lider i mirë i kontrollon dhe i zhvillon aftësitë e vartësit të tij në atë nivel që mund ta zëvendësojnë pozicionin e tij nëse i kërkohet. Ai duhet t'i trajnojë ata dhe t'i sigurojë atyre mundësinë për të realizuar çdo lloj stërvitje dhe njohur mirë çdo lloj pajisjeje në kohë paqeje, të cilën më vonë do të duhet ta përdorin në terrenet operacionale, që në luftë ata të jenë me besim të plotë në kryerjen e detyrave të tyre (Demiraj, 2009, 78).

Kontrolli vazhdueshëm i njohurive, testimeve të herëpashershme, të qëndruarit pranë në stërvitje, ndikojnë drejtpërdrejtë në njohjen e kapaciteteve operacionale dhe të gjendjes fizike dhe teknike të pajisjeve të misionit të efektivit.

Streset e luftës, shkaqet dhe masat që duhen marrë

FS janë forca elitare të cilat gjithmonë thirren për të kryer detyra dhe misione tepër të vështira si brenda ashtu edhe jashtë vendit. Me shumë rëndësi janë misionet luftarake që FS shqiptare kanë kryer në Afganistan. Në shumicën e rasteve detyrat taktike dhe operacionale që kryhen nga operatorët, nëngrupet apo grupet speciale janë të një shkalle rrezikshmërie tepër të lartë. Edhe pse të përgatitur, të mirë pajisur, të stërvitur dhe me eksperiencë për të përballuar sfidat e detyrave dhe të misioneve speciale, operatorët specialë janë gjithmonë të rrezikuar ndaj streseve të luftës. Faktorët që ndikojnë në shkaktimin e këtyre streseve mund të kategorizohen si faktorë të brendshëm dhe të jashtëm. Disa nga këto faktorë janë si më poshtë:¹

- a. Kohëzgjatja 6-mujore deri në 1 vit i misioneve luftarake.
- b. Ridërgimi në misione apo detyra, duke mos lënë kohë të mjaftueshme për pushim.
- c. Fjetja gjatë misioneve më pak se 6 orë në ditë.
- d. Zgjatja e detyrave deri në 3 ditë.
- e. Përjetimi i vdekjes së një kolegu në operacion ose detyrë luftarake.
- f. Humbja e jetës së një familjari apo të afërmi gjatë kohës kur je në mision.
- g. Dëmtime serioze fizike.
- h. Pamundësia për të komunikuar me familjen në atdhe.
- i. Probleme financiare dhe personale në familje.
- j. Mungesa e besimit tek kolegët e nëngrupit apo grupit.
- k. Mangësia e kohezionit në grup.

Prezenca e këtyre faktorëve nuk do të thotë që individ i është detyrimisht i prekur nga stresi, por ekziston mundësia apo rreziku që ky individ të preket. Në këto rrethana një lider i FS duhet të jetë në gjendje të dallojë shenjat dhe të parandalojë dëmtimet serioze nga streset e luftës. Disa nga streset e luftës janë si më poshtë vijon:

1. US Department of the Army, Filed manual FM 6 – 22.5, Combat Stress, 23 june 2000, 12.

Lodhja fizike dhe mendore

Shenjat që lidhen me këtë stres mund të jenë: ngathtësi në veprime, vështirësi në përcaktimin e prioritetëve, vështirësi për të kryer detyra rutinë, shqetësime të panevojshme apo të tepërta për probleme të vogla, vështirësi për t'u fokusuar në detyra të ndryshme, humbja e iniciativës për shkak të lodhjes, mosha e madhe dhe koha e gjatë e të qëndruarit të personit në të njëjtën njësi, etj.

Tensione muskulare

Të punuarit për një kohë të konsiderueshme në FS e ekspozon operatorin special që të punojë nën lodhje dhe stres të vazhdueshëm, të cilat pas një periudhe kohe fillojnë dhe japin shenjat e para. Hedhjet me parashutë të rumbullakët (statike), zhytjet në thellësi të mëdha dhe në ujëra të ftohta pa mbikqyrjen e mjekut zhytës, stërvitjet alpine në terrene arktiku për kohë të gjatë dhe çdo vit nga një muaj, vrapimet e gjatë me ngarkesë të përditshme, mbajtja për një kohë të gjatë të peshave gjatë misionëve, etj, krijojnë dëmtime serioze në organizmin e operatorëve specialë. Disa nga shenjat dalluese që lidhen me këtë stres janë: dhimbje koke, gjymtyrësh apo shpine të vazhdueshme, paaftësia për të pushuar, dridhje trupore të pakontrolluara gjatë dyluftimeve, shqetësime të vazhdueshme pagjumësie natën, etj.

Sistemi i tretjes

Shenjat dalluese që kanë të bëjnë me këtë stres janë: përzierje stomaku, të vjella të vazhdueshme dhe humbja e oreksit. Humbja e oreksit është një problem serioz në qoftë se shikohet një humbje e shpejtë e peshës apo nëse individi nuk konsumon një dietë të balancuar për të mbajtur një trup dhe mendje të shëndoshë për operacione të tejzgjatura. Për këtë qëllim liderit të misionit, i del detyrë që çdo ditë të informohet nga mjeku i misionit në lidhje me gjendjen fizike të efektivit dhe problemet që shfaqin ata si pasojë e misionëve të zgjatura dhe marrjen e masave për eliminimin e tyre.

***Sistemi i frymëmarrjes dhe i qarkullimit të gjakut*¹**

Disa nga shenjat dalluese janë: rrahje të shpejta e të pakontrolluara të zemrës,

1. US Department of the Army, Filed manual FM 6 – 22.5, Combat Stress, 23 june 2000, fq.

hiperventilimi, e cila ka të bëjë me djersitje të tepërta, frymëmarrje të shkurtra e të shpeshta, marrje mendsh si dhe dridhje të pakontrolluara të duarve.

Shqetësime me fjetjen

Disa nga shenjat dalluese që kanë të bëjnë me këtë stres janë: vështirësi për të rënë në gjumë, kjo ndodh kur individi është angazhuar në detyra me kohë të gjatë dhe nuk mund të flejë edhe kur ka mundësi për të bërë një gjë të tillë. Por edhe nëse fle, ai çohet vazhdimisht nga gjumi dhe ka vështirësi për të rënë përsëri në gjumë. Një tjetër shenjë dalluese janë ëndrrat dhe makthet e vazhdueshme të individit pas detyrave apo operacioneve gjatë të cilave ka patur të vrarë apo të plagosur.

Ankthi

Frika ndaj vdekjes, dëmtimit apo dhimbjes shkaktojnë momente ankthi, të cilat mund të jenë të rrezikshme si për individin, ashtu dhe për grupin special ku ky individ bën pjesë. Në rastin më ekstrem kjo ndjenjë shfaqet kur individi përjeton vdekjen e një kolegu në luftë. Individi mund të humbë besimin në vetvete, ndihet i rrezikuar apo i paafte për të kryer detyrën e caktuar.

Liderët e FS duhet të jenë gjithmonë vigjilentë për të dalluar simptomat e streseve dhe duhet të jenë të mirëpërgatitur për të parandaluar streset e luftës dhe për të ulur mundësitë që këto strese të shndërrohen në probleme serioze apo të përhershme. Disa nga hapat që duhet të ndërmerren për të parandaluar streset e luftës mund të jenë, si më poshtë vijon:

Stërvitje e vazhdueshme dhe sa më reale

Historia e FS në mbarë botën ka dëshmuar se sa më e vështirë dhe sa më reale me zonën ku do të operohet është stërvitja që bëhet, aq më të përgatitur, vetëbesues dhe rezistues ndaj streseve të luftës do të jenë operatorët e FS (McRaven, 1997, 131). Një stërvitje e përafërt me realitetin apo ambientin, ku njësia speciale do të dislokohej, do të krijojë një ndjenjë vetëbesimi mbi aftësitë personale të çdo pjesëtari të FS. Në të njëjtën kohë kjo do të rrisë edhe besimin që vartësit kanë mbi eprorët dhe liderët e tyre.

Për ti shërbyer këtij qëllimi pas vitit 2007 e në vazhdim deri në fund të 2013 në BFS u krijua një frymë e re për modernizimin e tij për herë të parë në historinë e tij në

drejtim të armatimit dhe municionit, pajisjeve të zbulimit, ndërlidhjes dhe komunikimit, pajisjeve alpine, zhytjes nënujore, pajisjeve speciale, optike, 10 skafeve të shpejtë për operacione në ujë, pajisjeve moderne për ndihmën e shpejtë, krijimi i një strukture që e kishin zili shumë nga vendet e rajonit, ngritja për herë të parë e kabineteve për snajperat, operacionet speciale në avionë, trena, autobuzë, të mbijetesës, alpinizimit, eksplozivave, zhytjes së luftimit, parashutizmit, ndihmës së shpejtë, zbulimit, etj, 2 kabinete anglishteje, bibliotekë me ambiente për studim, muzeumi i repartit me 15 vite histori të tij, ngritja e një infrastrukture moderne stërvitore me ndërtimin e poligonit të Luftës për Qendrat e Banuara, poligoni për luftën në shpella në të cilën stërvitja bëhet me fishekë luftarakë, poligonin e qitjes me snajpera deri në 1400 m largësi, blerja e setit të pajisjeve speciale për efektivin special krejtësisht i njëjtë me atë amerikan, ndërtimi i “Killing House” ku aplikohen teknikat e pastrimit të dhomave, hapjet me eksplozivë dhe sigurimi i afrimit dhe hyrjeve në banesë me mbështetje nga snajperat, infiltrimet me helikopter me teknikën Fast rope, ndërtimi i poligonit të eksplozivave dhe shpërthimeve surprizë, vendosjes së anijes për bordingje në cep të pishinës, sallat operacionale për çdo kompani me stardartet e FS amerikane, botimet i manualeve të ndryshme për çdo specialitet për mbështetjen e procesit stërvitor, botimet e katalogëve në anglisht për FS shqiptare të cilat u shpërndanë në të gjithë botën për pasqyrimin e misionëve tona, ndërtimi i programeve krejtësisht të reja dhe bashkëkohore si ai i kursit të zhytjes së luftimit, kursit operacioneve speciale, kursin bazë dhe të avancuar të alpinizmit, kursin e luftës në terrene alpine, kursin bazë dhe të avancuar të zbulimit, kursi i targetimit, kursi i eksplorimit të celularëve, kursi i eksportimit të kompjuterave, kursi i luftës kundër terrorizmit, kursi i planizimit të SOCC, kursi i shtabit të SOCC, kursi dy javor i luftës në shpella me fishekë luftarakë, kursi i Luftës Asimetrike, kursi i mbështetjes të FS nga ajri me helikopterë, etj, rritja e numrit të stërvitjeve gati 400 % më shumë se më parë, akomodimi i njësive speciale angleze, amerikane, hollandeze, kroate, të FYROM-it dhe turke, fillimi i bashkëpunimit për herë të parë me anglezët, grekët, polakët, hollandezët, etj dhe më e rëndësishme pjesëmarrja për herë të parë në misione të drejtpërdrejta luftarake të efektivëve të BFS.

Të gjitha këto bënë që nga ana jonë si drejtues të FS të na rriste përgjegjësinë për rritjen e nivelit të kapaciteteve dhe aftësive luftarake të efektivit duke shfrytëzuar të gjitha sa thamë më sipër dhe nga ana e operatorëve, të rritej kërkesa e llogarisë duke kërkuar stërvitje me standarte të larta të njëjta me natyrën e shërbimeve dhe të misionëve që ata do të kryenin në dislokim.

Rritja e kohezionit të njësisë apo të grupit special

Çdo lider ushtarak e di shumë mirë që një njësi me kohezion, e disiplinuar, e pajisur mirë, e paguar mirë, që punon në kushte të mira jetese, e stërvitur mirë, është tepër e efektshme në kryerjen e operacionet luftarake. Njësitë apo grupet me një nivel të lartë të besimit reciprok, besnikërisë dhe krenarisë janë më pak të rrezikuara ndaj streseve të luftës. Vëmendje e veçantë duhet t'i kushtohet pjesëtarëve të rinj të grupit të cilët nuk kanë eksperiencën e duhur. Ata janë më të rrezikuar ndaj streseve të luftës, prandaj çdo lider duhet të bëjë përpjekje maksimale që të krijojë kushte të favorshme që ata të familjarizohen sa më shpejt me pjesëtarët e tjerë të grupit, duke i vënë në patronazh operatorët më me eksperiencë luftarake, të cilët t'i ndihmojnë në drejtim të kapjes së ritmit të luftimit (McRaven, 1997, 131).

Marrja e masave për sigurimin dhe çlodhjen e nevojshme për efektivin

Shumica e individëve nuk punojnë në mënyrë të efektshme nëse kanë më pak se 6-8 orë gjumë në ditë. Mungesa e gjumit apo pushimi jo i mjaftueshëm për funksionimin normal të mendjes dhe trupit, mund të ndikojë negativisht në performancën e individit gjatë operacioneve. Në këto situata, operatorët mund të marrin vendime jo të drejta, kanë refleksa të ngadalta dhe janë më tepër të ekspozuar ndaj streseve të luftës. Lideri i FS duhet të sigurohet që çdo pjesëtar i njësisë, nëngrupit apo grupit special pushon minimalisht 6 orë në ditë. Nëse kjo kohë është e pamundur që të arrihet, atëherë liderët duhet të përcaktojnë orare fjetjeje për çdo pjesëtar të njësisë, si dhe duhet të planifikojnë për orare pushimi shtesë (McRaven, 1997, 25-35). Ka raste kur si pasojë e planizimeve të paparashikuara, njësi të FS të dalin në detyra të cilat janë me kohë të gjata në terren. Lideri i FS duhet të jetë shumë i kujdesshëm në procesin e planifikimit, pasi është shumë e rëndësishme që gjatë kohës në dislokim, të bëhet një raport shumë i drejtë i ndarjes së ngarkesave dhe orareve në shërbim brenda njësive, në mënyrë që t'i mundësohet koha e mjaftueshme për t'u rigjeneruar asaj njësie që kthehet nga misione të tilla.

Dhënia e informacionit të nevojshëm vartësve

Një shprehje amerikane thotë: “*Information is motivation – Informacioni është motivim*”. Kur efektivi është në dijeni të asaj që pritët të ndodhë, atëherë ata do të jenë

të parapërgatitur për atë që do të ndodhë dhe do të jenë më pak të rrezikuar ndaj ndonjë të papriture apo streseve të luftës. Një lider i mirë duhet të shpërndajë në kohën e duhur informacionin e nevojshëm vartësve të tij. Për ta shpjeguar më me detaje këtë shprehje, do të thosha që një nga aspektet më të rëndësishme që ne si drejtues trupash në luftim kemi patur gjatë kohës së dislokimit, ishte ngritja e një sistemi informacioni dhe inteligjence sa më mirë dhe real që të ishte e mundur, duke e përditësuar në vazhdimësi në mënyrë që para çdo daljeje në detyrë, efektiviteti të ishte sa më mirë i informuar në lidhje me terrenin ku do të vepronin, karakteristikat e tij, avantazhet disavantazhet, kufizimet, rrjetin e Talebanëve që vepronin në atë zonë, mënyrat e operimit të tyre duke studiuar me detaje të gjitha TTP-të e tyre, pajisjet që ata përdornin dhe se si i përdornin, fshatrat dhe familjet e fiset që i mbështesnin, linjat e komunikimit dhe të furnizimit, etj. Kjo rriti ndjeshëm besimin tek efektiviteti dhe cilësinë e sigurisë e operacioneve.

Kryerja e analizave pas kryerjes së detyrës (AAR)

Analiza pas çdo detyre apo operacioni është metoda më e mirë për të dhënë dhe shpërndarë informacionin pas çdo aksioni apo angazhimi të rëndësishëm. Kjo bëhet me qëllim që të nxirren mësimet e duhura e të përmirësohen veprimet në operacionet pasardhëse. Diskutimi i hapur gjatë këtyre analizave do të jetë tepër i frytshëm, do të heqë barrën e fajësisë, si dhe do të shërbejë për të forcuar më tej besimin në vetvete dhe tek pjesëtarët e tjerë të grupit.

Për ta argumentuar pak nga eksperiencia jonë në Afganistan, pas kthimit nga çdo detyrë në mënyrë të veçantë çdo grup bënte deri në detaje analizën pas kthimit nga misioni, duke analizuar të gjitha anët e mira dhe negative të cilat u reflektuan gjatë misionit, shkakët e mos realizimit dhe detyrat për sejcilin për eliminimin e tyre. Jo vetëm kaq por caktohej një afat i shpejtë dhe nëse duhej, përgatitej direkt një SOP-i e re me qëllim që t'i përshtatej situatës në terren.

Për ta argumentuar nga praktika jonë: *Në një rast shkuam në një detyrë në fshatin Badurzai, para daljes në detyrë kishim ndarë sektorët e përgjegjësisë dhe të hapjes së zjarrit për sejcilin mitralier, ku në rastet kur rreziku vinte në atë drejtim, ai do të ishte përgjegjës për të hapur zjarr dhe për të neutralizuar rrezikun andej. Para daljes në detyrë pyeta një për një mitralierët për gjendjen e armatimit dhe të mitrolozëve 12.7mm në veçanti dhe përgjigja ishte që janë në rregull. Kur u futëm në fshat çdo gjë dukej në rregull, por kur vazhduam të futeshim më thellë hasëm në një situatë në*

të cilën makina që ndodhej në drejtimin orës 9-të duhet të hapte zjarr dhe mitralozi nuk funksionoi se nuk ishte i papastruar. Situatës ja dolëm me sukses, pasi grupi i operatorëve nuk kishte dalë nga makina dhe zjarri i mitralozit tjetër që ndodhej i pozicionuar në drejtimin e orës 12-të hapi zjarr duke eliminuar kërcënimin. Ajo që dua të theksoj nga kjo ngjarje është se asnjëherë nuk dilnim më nga baza, pa i kontrolluar dhe me një të qëlluar mitralozët, automatikët dhe pistoletat për të parë gjendjen e tyre teknike dhe kurrë nuk futeshim në dhomat tona pas kthimit nga detyra, pa i pastruar me kujdes të gjitha armet një e nga një dhe duke i kontrolluar dhe vetë nga ana jonë. Shembuj si këto ka me shumicë nga eksperiencia jonë.

Mbajtja e efektivit në formë fizike të mirë

Një përgatitje fizike e mirë e efektivit të FS është një faktor që ndikon pozitivisht në kryerjen me sukses të detyrave speciale. Në të njëjtën kohë, do të reduktojë mundësitë dhe shanset që operatori i FS të ndikohet nga streset e luftës. Duke qenë në një formë fizike tepër të mirë, kapaciteti i individit për të përballuar streset në çfarëdo lloj situatash do të jetë më i lartë.¹

Disa teknika për menaxhimin e streseve në luftim janë:

1. Të sigurojë që janë bërë të gjitha përpjekjet për mirëqenien e ushtarakëve që ke në vartësi.
2. Rritja e besimit në vetvete dhe e besimit mbi pjesëtarët e njësisë, liderët dhe pajisjet luftarake.
3. Lideri duhet të jetë i vendosur dhe i sigurt; ai duhet të demonstrojë kompetencë dhe udhëheqje të drejtë me shembullin e tij personal në luftim.
4. Të sigurojë pushim të mjaftueshëm për vartësit, veçanërisht gjatë operacioneve të vazhdueshme.
5. T'i sigurojë gjumë dhe pushim për personelin që është përgjegjës për zbatimin e detyrave.
6. Të vendosë objektiva realiste për zhvillimin dhe përmirësimin progresiv të pjesëtarëve të njësisë apo vartësve.
7. Të monitorojë rregullisht arritjet e këtyre objektivave.
8. Të kuptojë që intensiteti dhe kohëzgjatja e detyrave ndikojnë drejtpërdrejt në streset e luftës.

1. US Department of the Army, Filed manual FM 6 – 22.5, Combat Stress, 2000, fq. 40-45

9. Të njohë e të kuptojë që individët apo njësitë reagojnë në mënyra të ndryshme përballë streseve të njëjta.
10. Të njohë dhe të dallojë shenjat e streseve të luftës.
11. Të kuptojë që frika është një pjesë normale e streseve të luftës.
12. Të jetë i vetëdijshëm për burimet e streseve të luftës siç janë: problemet në familje, problemet financiare të çdo ushtaraku që në rastin tonë janë të shumta.
13. Të sigurojë shpërndarje të pandërprerë të informacionit në të gjitha hallkat e komandimit.
14. Të praktikojë kontroll të streseve nëpërmjet stërvitjes, caktim detyrash në mënyrë të drejtë pa i dhënë dikujt më tepër apo më pak.
15. Të tregohet vigjilent ndaj shenjave të streseve si dhe ndaj rënies së kapacitetit për të përballuar streset për çdo individ apo vartës.¹

Si minimizohet frika gjatë misionit?

Liderët ushtarakë të FS duhet të kuptojnë se rreziku dhe frika do të jenë gjithmonë pjesë e punës së tyre, sidomos në angazhimet dhe misionet luftarake jashtë vendit (McRaven, 1997). Metoda më e mirë për të minimizuar frikën nuk është mohimi i efekte vetë saj, por t'i njohësh e t'i pranosh ato, si dhe të përballesh drejtpërdrejt me to. Frika minimizohet ose kapërcehet duke kuptuar situatën dhe duke vepruar me largpamësi për t'u përballur me të. Liderët e FS duhet të kuptojnë që frika shfaqet në momentet e zmbrapsjes apo humbjeve të betejës në dyluftim, në rastet kur njësia nuk e përmbush detyrën me sukses apo në rastet ekstreme kur ka të plagosur apo humbje jetësh të pjesëtarëve të njësisë gjatë operacioneve. Ushtarakët, që përjetojnë plagosjen apo vdekjen e një shoku gjatë një dyluftimi, fillojnë të bëhen më të vetëdijshëm ndaj faktit që një ditë edhe ata vetë mund të plagosen apo të vriten.

Lidershipi në luftë është një formë tjetër lidershipi, ku lideri duhet të njohë rrënjësisht veten e tij, përgjegjësitë që ka, ushtarakët në vartësi të tij dhe fuqinë luftarake që ka në dorë. Liderët e drejtpërdrejtë që janë pjesë e misioneve direkt në terren, duhet të jenë takticienë të fortë, të jenë në gjendje të marrin vendime të shpejta e të drejta, si dhe të jenë në gjendje të drejtojnë e të motivojnë vartësit e tyre në situata

1. US Department of the Army, Field manual FM 22-51, Leaders Manual For Combat Stress Control, 1994, fq. 17-25.

të vështira. Vetë liderët duhet të jenë në gjendje për të kryer çdo detyrë luftarake dhe të marrin çdo vendim të drejtë në mes të zhurmave, shpërthimeve dhe konfuzioneve të luftës. Ata duhet të dinë si të motivojnë vartësit e tyre përballë çdo vështirësie. Kur vartësit i shikojnë këto cilësi te lideri, atëherë ata do të ndihen më të sigurt në vetvete dhe tek liderët e tyre.

Cilësitë që e bëjnë një ushtarak të aftë për të përballur efektet e frikës dhe për të përmbushur detyrat luftarake me sukses janë: parapërgatitja e mirë, planëzimi i mirë dhe stërvitja rigoroze. Stërvitja realiste e zhvilluar në ambiente të ngjashme me ambientin ku njësia do të dislokohejt është burimi i parë për të rritur nivelin e vetëbesimit dhe nivelin e gatishmërisë së ushtarakut. Në të njëjtën kohë, cilësitë si aftësia drejtuese, vetëbesimi, shkathtësia dhe kurajo, janë cilësitë që një lider i drejtpërdrejtë duhet t'i zotërojë në mënyrë që njësia, grupi dhe nëngrupi të jetë në gjendje të përballojnë situatat më të vështira në dyluftim.

Cilat janë situatat më të vështira dhe çfarë duhet të bëjnë drejtuesit në këto lloj situatash?

Situata më e vështirë për një lider në mision është humbja e jetës së një vartësi ose disave prej tyre gjatë një detyre operacionale. Kjo vështirësi është një vështirësi e dyfishtë. Fillimisht, vështirësia e parë gjendet në faktin nëse lideri i drejtpërdrejtë është në gjendje të menaxhojë situatën, nëse ka humbje jete për të zvogëluar mundësitë që pjesëtarët e tjerë të dëmtohen apo vriten për shkak të kaosit, rrëmujës apo emergjencës së krijuar.

Vështirësia tjetër vjen në çastet kur pasi ka ndodhur fatkeqësia dhe njësia është kthyer në bazë për t'u rikuperuar dhe për të marrë detyrë tjetër. Përjetimi i plagosjes apo vdekjes së një kolegu në operacion shkakton pasoja psikologjike tek të gjithë pjesëtarët e njësisë. Kur përjetojnë diçka të tillë, çdokush është i vetëdijshtëm tashmë për mundësitë e plagosjes apo humbjes së jetës në çdo operacion jashtë bazës. Kjo ndjenjë do të ulë gatishmërinë e efektivit dhe në të njëjtën kohë do të rrisë ndjenjën e frikës tek çdo individ. Është përgjegjësia morale e liderit që të motivojë vartësit e tij në mënyrë që detyrat në vazhdim të kryhen me sukses, me qëllim përmbushjen e misionit të caktuar.

Një situatë të tillë kaluan në datën 20 shkurt 2012 dhe efektivët e misionit "Eagle-4" ditën të cilën Kapiten Feti Vogli u qëllua pabesisht nga një ofi afgan, ku pasi i bënë të gjitha nderimet e përcjelljes nga ana e personelit atje, efektivat

e BFS në mision të drejtuar nga komandanti i misionit u mobilizuan deri në ditën e fundit të qëndrimit në Spin Buldok, duke realizuar me shumë sukses të gjitha detyrat.

6.3. Taktika të reja – Sfida të reja “*Mësimet e Nxjerra-Lessons Learned*” nga misionet “EAGLE 1-7” në Kandahar, 2010-1014

Të kuptuarit e Mjedisit Rrethues

Gjatë kryerjes së operacioneve në Afganistan, **dështimi për të njohur, vërtetuar dhe përcaktuar me saktësi mjedisin operacional, çoi në një mos përshtatje ndërmjet forcave, aftësive, misioneve dhe synimeve.** Mjedisi operacional përfizon jo vetëm kërcënimin, por gjithashtu edhe elementet fizike, informuese, sociale, kulturore, të besimit dhe ato ekonomike të mjedisit.¹ Secila prej këtyre elementeve ishte e rëndësishme në të kuptuarit e shkakut të zanafillës së konfliktit, krijimit të një trajtimi të duhur dhe të parashikimit të efekteve të urdhrave shtesë.

Të kuptuarit plotësisht i mjedisit operativ shpesh është vështirësuar nga fokusimi mbi informacionin për kundërshtarin tradicional dhe veprimet për mbledhjen e të dhënave të zbulimit. Ky fokusim ndikoi efektivitetin në reagimin asimetrik dhe kërcënimet e çrregullta nga kryengritjet dhe në zbutjen e ndikimit terrorist dhe kriminal. Për më tepër, numri i ulët i personelit që merrej me zbulimin me njerëz (HUMINT), përkthyesit e nevojshëm për grumbullimin e informacionit kritik nga popullata dhe mungesa e përpunimit dhe shkrirjes së këtij zbulimi me burimet e tjera, e rënduan situatën për të kuptuar realisht siç duhej problemin. Kapacitetet, llojet dhe platformat e tjera të zbulimit, provuan se ishin të vlefshme, por në sasi të pamjaftueshme, megjithëse numri i tyre u shtua me shpejtësi në Afganistan vitet e fundit, pasi u kuptua vlera e tyre. Në mënyrë të ngjashme, u krijuan dhe u përhapën sasia e aseteve që siguronin inteligjencë, vëzhgim dhe rikonicion (ISR).

Duke qenë se përpjekjet e zbulimit tradicional kishin prirjen të fokusoheshin mbi grupet dhe veprimet e armikut, ata shpesh e anashkaluan informacionin “e rëndësishëm” në lidhje me popullatën, i cili ishte i domosdoshëm për suksesin në fushatat me

1. Ambienti operacional është përkufizuar me detaje në Joint Pub 2-01.3, “Joint Intelligence Preparation of the Operational Environment,” 16 Qershor 2009.

qendër popullatën, të tilla si operacionet kundër kryengritjeve (COIN). Komandantët lokalë kishin nevojë për informacion rreth identiteteve etnike dhe fisnore, besimit, kulturës, politikës dhe ekonomisë. Produkti i zbulimit ofronte informacione në lidhje me veprimet e armikut, por ishte i pamjaftueshëm për informacionet e tjera që nevojiteshin në nivel lokal. Për më tepër, nuk kishte një prioritet të paracaktuar të kërkesave të zbulimit (PRI-ve) ose lista-kontrolli të tjera apo shabllone, të cilat mund të shërbenin si vlerësime të përafërta të urdhrave parësorë në lidhje me atë që duhet të dinin njësitë rreth luftës së ç'rregullt. Si rezultat, proceset për përfundimin e informacionit mbi çështjet “e bardha”, të qendëruara tek popullata kishin prirjen të bazoheshin mbi studimin e gjetjeve dhe nuk pasqyroheshin në mënyrë të vazhdueshme tek njësitë për t’i ndjekur.

Në mënyrë të ngjashme, operacionet për asistencë njerëzore dhe ndihmë gjatë katastrofave (HADR), për të pasur sukses, u mbështetën mbi informacionin në lidhje me mjedisin. Vlerësimet fillestare brenda afatit kohor ishin kritike për një reagim efektiv. Këto vlerësime u përdorën për të përcaktuar kërkesat e komandim-kontrollit, për llogaritjen e dëmeve (duke përfshirë edhe gjendjen kritike të infrastrukturës), përmasën dhe llojin e njësive që duheshin për reagimin ushtarak dhe përparësitë e tyre të shpërndarjes. Në katastrofat natyrore, këto vlerësime shpesh ishin të vështira për t’u arritur për shkak të aseteve të kufizuara në dispozicion.

Më vonë, pas fillimit të Operacionit Enduring Freedom në Afganistan, forcat e ISAF-it mësuën që t’i tejkalonin sfidat e përmendura më lart dhe gradualisht krijuan mjete inovative, jokonvencionale dhe organizime të duhura për të krijuar një kuptueshmëri më të mirë mbi mjedisin operacional. Këto mjete përfshinin ndërveprimin drejtpërdrejt me popullatën vendase nëpërmjet patrullimit, *Shuras* (këshillet konsultuese ose asambltë – me prejardhje nga kurani) dhe përfshirjen e udhëheqësve kryesorë në to (KLE); krijimin e shkrirjes së celulave, të cilat bashkonin informacionin nga operacionet dhe zbulimi; përdorimin e oficerëve ndërlidhës për të lehtësuar komunikimin dhe koordinimin; praktikimin dhe analizimin e nyjeve të rrjeteve shumëburimëshe për të drejtuar veprimet. Këto përpjekje u mbështetën nga udhëheqësit dhe organizatat duke marrë përsipër rrezikun e klasifikimit të ulët të informacionit, për ta përdorur më mirë së bashku me forcat e përgjithshme të sigurisë afgane, partnerët ndërmjet agjencive, forcat vendase, organizatat jo qeveritare (NGO). Ky informacion në mënyrë kolektive informonte mbi një grup të gjerë aktiviteteve, duke përfshirë vënien në targetim të objektivave me vlerë të lartë (HVT), takimet midis udhëheqësve

të lartë, zhvillimin e kapaciteteve të vendasve dhe zbatimin e ligjit, bashkërendimin për çështjet e sigurisë, bërjen të mundur dhe vënien efektive në objektivat e organizatave dhe burimeve armike si dhe trajtimin e shkaqeve që fshiheshin pas kryengritjeve ose terrorizmit.

Në mënyrë të ngjashme, shumë udhëheqës të lartë të aleancës, u mbështetën mbi shumë burime për të njohur mjedisin operacional, duke informuar adoptimin e përjasjes së tyre të përgjithshme. Këto burime përfshinin koordinimin ndërmjet agjencive, koalicionit dhe partnerët në vendin pritës; grupet e specialistëve dhe akademikët; këshilltarët civilë të vendit pritës; entitetet tregtare dhe organizatat jo qeveritare (NGO-të). Ekspertët mund të ofronin një shikim të thellë në çështjet vendore, shpjegimin e motivimeve dhe ndihmë në konsekuencën e menaxhimit. Disa kishin gjithashtu, edhe njohje dhe kontakte vendase të cilat ndihmonin në koordinimin me vendin pritës.

Eksperienca ishte një tjetër element kyç në arritjen e një kuptimi të saktë të mjedisit. Në zonat ku forcat e ISAF-it nuk kishin zbarkuar në numër të madh dhe kishte një prezencë të hershme mjaft modeste, shtonte ndërgjegjësimin e situatës dhe thellonte marrëdhëniet. Marrëdhëniet bashkëpunuese me forcat vendase me nivelet e shumta të komandimit, siguruan shkëmbim të informacionit, i cili ndikoi në kuptimin e operacioneve terroriste dhe rebele, si dhe në shtimin e pranisë të forcave aleate për sinergji në mbështetjen e qëllimeve të përbashkëta.

Vizioni për të ardhmen

Zhvillimi i kërkesave në të ardhmen: Duke pasur parasysh decentralizimin në rritje dhe bashkimin e operacioneve, zhvillimi i një strategjie për t'iu përshtatur më mirë kërkesave të inteligjencës, vëzhgimit dhe rikonicionit (ISR) dhe informacionit të forcave ushtarake.

Promovimi i grumbullimit (bashkimit): Ndjekja e politikave dhe zgjidhjeve të teknologjisë së informacionit (IT) për të promovuar grumbullimin ose bashkimin e informacionit dhe propagandimin në mbështetje të operacioneve, reduktimin, ndarjen në dhomëza, kanalizime të zbulimit dhe informacionit përmes koordinimit së agjencive dhe ndërmjet shteteve partnere.

Rishikimi i politikave të klasifikimit: Riekzaminimi i politikave të klasifikimit për të ruajtur sigurinë e nevojshme të operacioneve (OPSEC), por për të reduktuar

klasifikimin e panevojshëm të informacionit dhe për të promovuar shkëmbimin e informacionit dhe të kuptuarën e përbashkët të mjedisit operacional.

Përmirësimi i mbështetjes me mjete inteligjence, vëzhgimi dhe rikonicioni (ISR) për operacionet: Shtimi i mundësisë hyrëse tek platformat ekspedituese të ISR-së dhe përmirësimi i trajnimit të personelit mbi kapacitetet me inteligjencë, vëzhgim dhe rikonicion në dispozicion për operacionet (psh: për të bërë të mundur drejtimin e përmirësuar të operacioneve të drejtuara nga zbulimi, ose bërjen të mundur të vlerësimit të shpejtë në mbështetjen e operacioneve HADR).

Ndërtimi i marrëdhënieve: Sjellja e ekspertëve nga të gjitha fushat: ushtarakë, ndër-agjencitë e tjera, shërbimet sekrete kombëtare, shërbimet sekrete të ushtrisë, agjensitë e ligjit, drogës, armëve, alkolit, byrosë së hetimit, etj, organizatat joqeveritare, grupet e specialistëve dhe akademitë, sektori privat, vendasit dhe përmirësimi i mprehtësisë dhe ekspertizës së tyre për të informuar, bashkëvepruar dhe krijuar rrugëdalje.

Përmirësimi i aftësive të gjuhës dhe kulturës: Shtrirja dhe stimulimi për trajnimin gjuhësor dhe kulturor.

Shtimi i pranisë pararojë: Kultivimi dhe shtimi i marrëdhënies dhe ekspertizës në mjedisin operacional që rezulton nga prania e ushtrisë dhe elementeve të tjera ndër-agjenci.

Planifikimi gjithëpërfshirës: Kryerja, përmirësimi dhe përditësimi i planifikimit të fushatave, duke zbatuar skicimin operacional, i cili të reflektojë të kuptuarin e mjedisit, të përshkruajë problemin dhe të kuadrojë një trajtim për të arritur objektivat strategjike.

Përshtatja me ambientin operacional

Përshtatja është një pjesë themelore e profesionit të ushtarakut dhe operacioneve ushtarake. Në të njëjtën kohë, përshtatja duhet të balancohet me kërkesat për të stërvitur trupat në përshtatje me pajisjen e forcave, në mënyrë që të ruhet përshtatja dhe rreziku që vjen si pasojë e pjesëmarrjes në misione, në nivele që kanë mundësi të menaxhohen. Pajisjet e përshtatura për luftën konvencionale nuk ishin gjithnjë të përshtatshme për operacionet kundër kryengritëse ose ato të stabilitetit, duke rezultuar në shumë nevoja urgjente operationale, duke ngritur zërin për kapacitetet e kërkuara.

Sfida e planifikimit u përshtat me përhapjen e gjerë dhe shpesh me adaptimin e suksesshëm në të gjitha nivelet. Forcat në terren mësuan nga sfidat dhe përshtatën qasjet e tyre për të korrigjuar gabimet, duke krijuar:

- Organizime të reja.
- Taktika, Teknika dhe Procedura (TTP) të reja.
- Veprime më praktike për të realizuar aksionet e ndryshme.
- Procedura Standarte të Operimit që nuk janë përdorur më parë.

Ndërkohë, kjo përshtatje ka treguar që është jo vetëm e suksesshme, por edhe e kushtueshme në termat e kohës dhe burimeve të shpenzuara për ta realizuar atë.

Forcat tona përshtatën gjithashtu TTP-të për të promovuar suksesin në këtë lloj mjedisi operacional. FS shqiptare përdorën taktikën: Gjej, rregullo, përfundo, shfrytëzo, analizo dhe shpërnda (F3EAD) për të planifikuar fushatën dhe operacionet kundër rebelëve. Këto taktika, teknika dhe procedura (TTP-të) provuan se ishin efektive kundër armiqve që nuk vishnin uniforma dhe fshiheshin ndërmjet popullatës. Një strukturë e re organizative, me shkrirje celulash, siguroi një strukturë institucionale, nëpërmjet të cilës mund të mësoheshin taktikat e terroristëve. Taktikat, teknikat dhe procedurat e tjera të përgatitura, përfshinin takimet midis liderve të lartë (KLE-të), kërkimin e zonave sensitive (SSE) dhe vlerësimet e dëmit të betejave (BDA) të drejtuara për të identifikuar praninë dhe shtrirjen e dëmit civil.

Sjellja në terren e pajisjeve të reja, ndihmoi që TTP-të të rinovoheshin siç përshkruhet më sipër. Për shembull, forcat tona vunë në përdorim asetet e reja të zbulimit, inteligjencës dhe të rikonicionit të vëna në dispozicion nga forcat e SHBA dhe aleatët e tyre, për të shtuar mbledhjen e të dhënave të zbulimit, për të zbuluar se ku fshiheshin, stërviteshin dhe strehoheshin terroristët ose rebelët dhe të minimizonin dëmtimin e civilëve sa më shumë që ishte e mundur gjatë përfshirjeve të tyre, të merreshin më shumë me popullatën dhe të vijonin përpjekjet e bashkëpunimit. Pajisjet e tjera u shpërndanë për të ofruar shtim të forcës mbrojtëse ndaj kërcënimeve asimetrike (psh: automjetet rezistente ndaj minave mbrojtëse, ndaj pritave (MRAPS) dhe masa mbrojtëse elektronike, Jammers, BFT, etj).

Ndërkohë që njësitë mësonin dhe përshtateshin sa më mirë me mjedisin e tyre operacional, eksperiencat e tyre, praktikat e tyre më të mira, këto mësimë nuk shkëmbeheshin gjithnjë, as në shtab dhe as me njësitë e tjera të trupave të ISAF-it. Duhet

të kishte funksionuar më mirë le të themi një qendër që analizonte dhe grumbullonte mësimet e nxjerra nga fushëbeteja, e cila pastaj t'i shpërndante ato për të gjitha njësitë që vepronin atje dhe të realizonin adoptimin në nivel taktik, i cili duhet të ishte misioni themelor. Por operacionet e përbashkëta taktike dhe leksionet e nivelit strategjik, shpesh mbeteshin të paadresuara, përveçse kur kërkoheshin në mënyrë specifike nga komandantët. Organizatat më të vogla, më të zhdërvjellëta, me burime më të mira, me eksperiencë më të mëdha të fituara nga FS, kishin prirjen të ishin më të fokusuara dhe proceset e tyre ishin të krijuara për një kthesë të shpejtë të forcave në shtab. U krijuan një sërë mekanizmash për të përmirësuar efektivitetin dhe afatet kohore të procesit të mësimave të nxjerra, duke filluar që nga misioni “Eagle 1-7”, për të furnizuar me informacion të nevojshëm dhe jetik të gjithë efektivet e BFS dhe të gjithë ushtrinë, Qendrën e Mësimeve të Nxjerra, si dhe për të ndryshuar mentalitetin e mënyrës së veprimit në Afganistan. Këto ndihmuan për të ofruar fokusim dhe shkëmbim të leksioneve për sfidat kyçe operacionale dhe për të përmirësuar në vazhdimësi programet e stërvitjes dhe pajisjen e trupave në mision.

Vizioni për të ardhmen

Planifikimi për përshtatje: Sfida e vazhdueshme e supozimeve dhe kërkesave; vendosja e mekanizmave në vend për t'u përshtatur sa më shpejt sipas terrenit.

Mbështetja e drejtuesve të aftë: Krijimi dhe promovimi i drejtuesve të cilët mbeten elastikë, venë në pikëpyetje ekzistencën e paradigmave, marrin parasysh rrezikun dhe ushqejnë bashkëpunimin midis organizatave të ndryshme.

Përvetësimi i përshtatjes së suksesshme: Identifikimi i shembujve më të mirë të adaptimit përgjatë dekadës së fundit dhe përfshirja e tyre në doktrinë, organizim, trajnim, armatim, udhëheqje, edukim, personel dhe shërbime (DOTMLPF).

Mbështetja e rëndësisë së doktrinave: Sigurimi që doktrina mbetet e lidhur me çështjet e sigurisë, shtimi i njohurive dhe përdorimi i parimeve të saj përmes trajnimit dhe edukimit.

Zgjerimi i grupeve të zgjidhjes: Krijimi i kapaciteteve të rrjeteve për të shtuar përshtatjen në terren; përfshirja e eksperiencës dhe koncepteve në zgjidhjen e problemeve të ndjeshme në kohë.

Dhënia energji procesit të përvetësimit të eksperiencave të fituara: Manda-

tim, kodifikim dhe ekzekutim i një procesi standart, për të mbledhur eksperiencat nga operacionet aktuale; shpërndarja e shpejtë dhe përfshirja e këtyre eksperiencave, vënia e tyre në dispozicion për audiencën në mbarë forcat, të cilat do të duhet të angazhohen në misionin e ISAF-it në të ardhmen.

Integrimi i FS shqiptare – me Forcat Konvencionale

Operacionet e shumta, të njëkohshme dhe në shkallë të gjerë që u ekzekutuan në mjedise dinamike, kërkuan integrimin e FS shqiptare dhe Forcave Konvencionale amerikane, duke krijuar efektin e shumëfishimit të forcës për të dy njësitë. Marrëdhënia ndërmjet operatorëve të FS shqiptare dhe Forcave Konvencionale amerikane u bë shumë e ngushtë me kalimin e kohës:

- Fillimisht FS shqiptare dhe Forcat Konvencionale amerikane nuk ishin të koordinuara mirë dhe disa herë punonin për qëllime të kundërta.
- Përpjekjet në vazhdimësi për të integruar kapacitetet e FS shqiptare dhe Forcave Konvencionale amerikane, provuan të ishin shumë të suksesshme, duke krijuar planifikime për taktikat e ndryshme kundër të njëjtave objektiva armike.
- Integrimi i FS shqiptare-Forcave Konvencionale amerikane ishte gjithashtu kritik për zhvillimin në shkallë të gjerë të forcave vendase të sigurisë në Afganistan, veçanërisht me policinë dhe ushtrinë afgane, me personelin e tyre dhe për rritjen e burimeve të tyre.
- Stërvitja të cilën njësitë e FS shqiptare u bënë forcave amerikane, na mundësoi që të rritej ndjeshëm niveli operacional i forcave amerikane dhe që dhe ata të përdornin të njëjtat TTP me tonat, duke bërë të mundur që të arriheshin më shumë rezultate pozitive në terrenin ku ishte zona jonë operationale.

Ndërkohë që FS shqiptare dhe Forcave Konvencionale amerikane fillimisht patën eksperiencë mosmarrëveshje të vogla ndërmjet tyre gjatë operimit së bashku për sa i përket komandim-kontrollit, nëpërmjet bashkëpunimit të përbashkët dhe eksperiencës ata krijuan mjete për integrimin efektiv të cilat shtonin ndjeshëm kapacitetet e tyre kundër Talebanëve në zonën e tyre operationale.

Në Afganistanin e pas vitit 2003, operacionet e FS nuk ishin gjithnjë të koordinuara mirë me Forcat Konvencionale të ISAF-it. Kjo çoi në situata të tilla ku Forcave Konvencionale të ISAF-it, si zotërues të fushës së betejës (BSO), u lireshin për të menaxhuar urdhrat e dorës së dytë duke ndikuar në operacionet e gjurmimit të FS.

Forcave Konvencionale të ISAF-it u ankuan në lidhje me mosmarrjen e informacionit për operacionet që përgatiteshin, për mosmarrjen e të dhënave të zbulimit që vinin nga operacionet e FS dhe përçarjen e dukshme në hapësirën e tyre të betejës, e si pasojë të atyre operacioneve. Ankesa të njëjta Forcat Konvencionale të ISAF-it bënë përsëri në Afganistan pas vitit 2010. Për forcat e Përbashkëta të Operacioneve Speciale të Taks Forcës (CJSOTF) në Afganistan, një faktor i koordinimit të dobët ishte Komanda e Shtabit të Operacioneve Speciale (TSOC), e cila nuk ishte e aftë të ofronte përfaqësime efektive në nivele të larta. Kjo u adresua më vonë në Afganistan, nëpërmjet krijimit të një komande me oficerë të lartë në shtab, Komanda e Forcave të Bashkuara të Operacioneve Speciale – Afganistan (NSOCC-A), për integrimin më të mirë të aktiviteteve të FOS-it në një fushatë të përgjithshme strategjike, nën drejtimin e një gjenerali me 2 yje.

Me kalimin e kohës, elementët e FS shqiptare dhe Forcave Konvencionale të SHBA-së punuan për t'u integruar dhe për të përfunduar nga kapacitetet e FS shqiptare dhe ato të Forcave Konvencionale të ISAF-it. Për ta realizuar me sukses, FS shqiptare krijuan disa celula në zonën e tyre operacionale, duke i siguruar gjithmonë në kohë informacione shumë të rëndësishme kolegëve amerikanë për planëzimin e operacioneve të ndryshme. Këto celula të bashkuara bënë të mundur shtrirjen e grupit të përgjithshëm të objektivave që mund të vepronin një grup që ishte tepër i madh për t'i bërë ballë një forcë e vetme, si dhe një taktikë sinergjike për luftimin e atyre objektivave. Në çdo mbledhje për targetimin e objektivave Talebane (HVT) në nivel komande Jugore, komandantët tanë të kontigjenteve thirrreshin dhe ju merrej mendim në lidhje me ndarjen e operacioneve, planizimin dhe se si ishte më mirë të përdoreshin sa më me efektivitet forcat dhe mjetet, në mënyrë që të realizoheshin objektivat e komandantit të komandës Jugore të Afganistanit. Integrimi i FOS dhe Forcave Konvencionale të ISAF-it në Afganistan, u përmirësuan ndjeshëm në vitet 2010 - 2014. Operacionet e FS koordinoheshin më mirë me zotëruesit e fushës së betejës (BSO-të) dhe FS ofronin mbështetjen për menaxhimin përfundimtar kur ishte e nevojshme. Në të njëjtën kohë, u shtua komunikimi në lidhje me gjetjen e objektivave dhe FS u fokusuan më së shumti mbi objektivat që pengonin lirinë e veprimit në BSO.

Foto 5.5. *Kolonel Demiraj dhe komandanti i QRF të Spin Buldokut, Kolonel*

Haji Janan, një vrasësit më të mëdhenj të talebanëve, pas një takimi të KLE-SHURAS me kontigjentin "Eagle-5" në Kandahar, Afganistan 2013

FS dhe Forcat Konvencionale të ISAF-it, kontribuan së bashku në krijimin e forcave të sigurisë vendase në Afganistan. Të gjitha forcat kaluan në një qasje partneriteti ndaj operacioneve, duke i dhënë së bashku një shtytje kapaciteteve vendore dhe duke ofruar një liri të shtuar për veprime. Forcat Konvencionale të ISAF-it u fokusuan më shumë me ushtrinë e rregullt dhe forcat policore, ndërkohë që FOS u fokusua me FS dhe komando vendase, ushtrinë dhe njësitë policore kundër terrorizmit. Përsëri, së bashku, FS dhe Forcat Konvencionale të ISAF-it u bashkuan për të përmbushur kërkesat e trajnimit dhe partneritetit, të cilat ishin përtej aftësive menaxhuese të secilës forcë në mënyrë të pavarur.

Ndërkohë që një shembull i hershëm progresi (dmth në Kabul në vitin 2005) u arrit nëpërmjet bashkëpunimit në nivel taktik, shumë nga përmirësimet e mëvonshme u udhëhoqën nga drejtuesit e lartë të FS të SHBA-ve, ndërkohë që ata theksonin rëndësinë e integritetit me Forcat Konvencionale. Krijimi i celulave të bashkuara në Afganistan përfshiu përkushtimin e personelit të FS dhe burimeve me IRS, madje dhe personeli shtesë i'u përkushtua përpjekjeve fillestare të bashkërendimit. FS përdorën gjithashtu burimet e veta për të krijuar një rrjet ndërlidhësve, për të ofruar një kanal direkt ndërmjet tyre dhe Forcave Konvencionale në mënyrë që të përmirësonin komunikimet dhe bashkëpunimin.

Vizioni për të ardhmen

Shtirja e mirëkuptimit të drejtuesve: U ofron komandantëve të FS-Forcave Konvencionale të ISAF-it një mirëkuptim të gjerë të kapaciteteve dhe kufizimeve të secilës forcë.

Krijimi i trajnimit dhe marrëdhënieve në funksion të misionit: Shfrytëzon rastet të cilat bëjnë të mundur trajnimin së bashku të FS me Forcat Konvencionale përpara dislokimit për mision duke u fokusuar në marrëdhënie të rregullta me komandat përkatëse gjatë kryerjes së operacionale speciale.

Kodifikimi i taktikave bashkëpunuese të shënjestrimit: Dokumentimi dhe ruajtja e një metodologjie për shënjestrimin në bashkëpunim FS-Forcat Konvencionale.

Përmirësimi i shpejtë i shtrirjes së kapaciteteve: Ruajtja e aftësisë së Forcave Konvencionale për rritje profesionale të shpejtë dhe shtrirjen e kapaciteteve (armët, pajisjet) për promovimin e integritit me FS.

Përmirësimi i procesit të përbashkët të plotësimit të personelit: Sigurohet që proceset e Forcave Konvencionale për plotësimin me personel janë të efikase dhe që personeli është përgatitur siç duhet.

Stërvitja e forcave të tjera (FID), një nga detyrat kryesore të Forcave Speciale

Siç e kemi theksuar dhe në kapitullin e katërt të këtij disertacioni, misioni FID bën fjalë për pjesëmarrjen e një qeverie me anë të agjencive civile apo ekipeve ushtarake të efektivëve të FOS shqiptare në programe trajnimi të ndërmarra nga qeveria jonë, për të mbrojtur dhe ndihmuar shoqërinë e saj nga përmbysja, moszbatimi i ligjit dhe kryengritja, ose psh: në rastin e Republikës së Kosovës, të ndihmojë forcat e saj të sigurisë që ti ndihmojnë në procesin e kalimit nga forcë sigurie në forca të armatosura dhe që të rrisin kapacitetet me qëllim goditjen e strukturave paralele në veri të Mitrovicës. Kontributi kryesor i FOS-it në këtë aktivitet është që të organizojë, stërvisë, këshillojë dhe ndihmojë forcat ushtarake dhe paraushtarake të shtetit pritës (Kosovës). Qëllimi është që t'i bëjë këto forca më të afta që të ruajnë stabilitetin e brendshëm të vendit të tyre, të përballojnë përmbysjen e pushtetit dhe dhunën në vendin e tyre si dhe të gjejnë shkaqet e destabilitetit. Stabiliteti i brendshëm është baza për suksesin në ndërtimin e një vendi. Misionet e suksesshme FID mund të çojnë në suksese operationale ose strategjike për politikën e jashtme të vendit tonë. Në aktivitetet FID përfshihen, si më poshtë vijon:

Ndihma dhe asistenca për ushtrinë e vendit pritës: ku futen operationet për stërvitjen e njësisë në aftësitë bazë ushtarake, këshillimin dhe asistencën për udhëheqësit e lartë ushtarakë, dhënien e trajnimeve për taktikat, teknikat dhe procedurat e kërkuara për të mbrojtur vendin pritës nga përmbysja e pushtetit, moszbatimin e ligjit, zhvillimi i veprimeve të ndryshme të destabilizimit të rendit kushtetues, zhvillimin e individëve, liderëve, ngritjen e FS të tyre dhe aftësive organizative vendore.

Siguria e popullsisë: është mbikëqyrja e operationeve taktike të kryera nga ushtria e vendit pritës për të neutralizuar dhe shkatërruar kërcënimet kryengritëse,

izolim e terroristëve nga popullsia civile dhe mbrojtjen e popullsisë civile. Si një nënndarje e FID-it, njësi të përcaktuara të FOS-it mundet gjithashtu të stërvisin forca të zgjedhura (FOS) të vendit mikpritës, për të kryer misione kundër terrorizmit.

Pjesëmarrja në operacionin ISAF, është një kontribut real për rritjen e operacionalitetit të Forcave tona Armatosura, por në veçanti të FS ku nga pjesëmarrja e tyre në operacionet luftarake të drejtuara nga NATO apo partnerët tanë amerikanë, jo vetëm që janë kontribuese për sigurinë e paqen botërore, por ajo që është më e rëndësishmja për ta, është se tashmë ato kanë marrë certifikatën e të qenit të besueshme duke përfutur dhe një përvojë të shkëlqyer në operacionet luftarake.

Një nga detyrat kryesore që kontingjentete misioneve “Eagle” kanë kryer në zonën e tyre operacionale, kanë qenë dhe mbetet përgatitja dhe dhënia e asistencës ushtarake për Forcat e Sigurisë Kombëtare Afgane (FSKA), Policinë Kufitare Afgane, Policinë e Autostradave Afgane, përgatitja e tyre në Qendrën e Stërvitjes së FS të Policisë Afgane (SPTC) në Wadak, ku operatorët tanë krahas operatorëve të FS më të mira në botë kanë dhënë mësim në kursin bazë 12 javor të FS dhe kursin e avancuar 10 javor të FS afgane, duke bërë të mundur dhënien e eksperiencës së shkëlqyer të FS shqiptare atyre afgane, duke rritur ndjeshëm kapacitetet luftarake të tyre. Ky kontribut është vlerësuar maksimalisht nga partnerët tanë dhe gjykoj që është një përvojë e mirë në kuadër edhe të kontributeve tona shtesë me FS për përgatitjen dhe dërgimin e ekipeve të Lëvizshme Stërvitore të Shtabeve të njësive Afgane OMLT (MAT) të FS që nga viti 2011 e në vazhdim në Afganistan.

Përdorimi i eksperiencës së fituar nga personeli i FS në misione luftarake, po ndikon ndjeshëm në njohjen në vazhdimësi të taktikave, teknikave, procedurave që përdor armiku kundër nesh dhe gjithashtu në stërvitjen sa më reale të personelit oficer, n/oficer para dërgimit në misione të ndryshme në kuadër të NATO-s, OKB apo BE dhe të gjithë ekipeve të OMLT së policisë.

Në këtë kuadër është parë me interes dhe krijimi i grupeve të stërvitjes së lëvizshme (MTT) për të trajnuar dhe efektiva të tjerë të strukturave të tjera ushtarake. Po kështu do të ishte mjaft frytdhënëse përdorimi i këtyre grupeve trajnuese të lëvizshme (GTL) në kurset që zhvillohen në Institucionet e KDS, si në Shkollën e Trupës, ANO, QSI në Bonavi, për të gjithë personelin oficerë dhe n/oficerë që janë pjesë e këtyre kurseve, për një afat të caktuar kohor dhe në përshtatje të programeve të kurseve. Ky

do të ishte një mision me shumë vlerë për shkak se FOS jo vetëm që **stërvitin vetveten** me aftësi të dobishme për operacione të ndryshme luftarake, por ato trajnojnë dhe japin një stërvitje të avancuar për përgatitjen e oficerëve e nënoficerëve të strukturave tona ushtarake.

Me qëllim realizimin sa më mirë të misioneve FID prej vitit 2011 e në vazhdim, instruktorë të ndryshëm të BFS filluan të marrin pjesë dhe të drejtojnë kursin bazë dhe të avancuar të operacioneve speciale, kursin e luftimit të afërt, kursin e snajperit, alpinizmit, luftës në qendra të banuara, luftës në shpella, në repartin tonë, etj duke drejtuar gjithashtu stërvitje dhe kurse të ndryshme dhe në batalionin e Poshnjes, në batalionin alpin të Vau të Dejës, në batalionin e dytë të këmbësores, Batalionin e Policisë Ushtarake duke stërvitur snajperat e tyre dhe për shoqërim, drejtuar kursin Komando me batalionin Komando , etj.

Prej vitit 2011 e në vazhdim një rëndësi të madhe ka marrë dhe fillimi i bashkëpunimit me Komandot e Marinës Mbretërore Angleze me brigadën 4/5 Royal Commando Marines, ku çdo vit kemi zhvilluar nga 3 muaj stërvitje me to, duke i ndihmuar në mënyrë të veçantë në luftën në shpella dhe në qendra rurale dhe duke spjeguar teknikat e fundit të përdorimit të eksplozivave gjatë kryerjes së operacioneve speciale në qendrat e banuara afgane, veçoritë e luftimit kundër talebanëve të mbështetura në mësimet e fundit të nxjerra nga misionet tona, duke stërvitur snajperat e tyre për operacione në distanca më të mëdha se 1200 m, etj por dhe duke marrë njohuri më të avancuara nga ana e anglezëve rreth planizimit të misioneve si pjesë e shtabeve të ISAF-it. Gjithashtu një rol të madh kanë luajtur në ndihmën tonë dhe ekipi i lëvizshëm trajnues i GDFS MTT i cili prej 5 vitesh ka bërë një punë të shkëlqyer sidomos në rritjen e kapaciteteve në drejtim të specialiteteve duke rritur ndjeshëm nivelin e snajperistëve, xhenierëve dhe të mjekëve të grupit, kurse stërvitjet e përbashkëta me FS amerikane dhe grupet Navy Seals kanë ndikur shumë në drejtim të planizimit dhe ekzekutimit të misioneve të goditjeve direkte dhe zbulimit special.

Pajisja e FS me armatim dhe pajisje bashkëkohore mbi bazën e nevojave dhe kërkesave të listës themelore të detyrave, misionit dhe të mjedisit operacional, për realizimin me sukses të detyrave (Direktiva e MM, 2011).

Kryerja me sukses e operacioneve speciale në Afganistan, kundër Talebanëve dhe të grupeve terroriste, qëndron në aftësimin e stërvitjes individuale dhe të taktikave

të njësisve të vogla, të cilat janë të specializuara në disa lloje misionesh dhe detyrash, luftës jo konvencionale, kontrollit të zonave sensitive dhe grumbullimin e evidencave të aplikuara në mënyrë të adoptuar, të improvizuar, të përshtatur dhe me besim në vetvete. Përdorimi i grupeve speciale të tilla të vogla, me aftësi unike dhe të larta operacionale, krijojnë mundësi për të vepruar për një kohë të caktuar pa mbështetje, pra përdorimi i reparteve të FS në ditët e sotme, po merr një rëndësi të veçantë në luftën asimetrike (sipas konceptit të NATO-s “*Smart Defense*”).

Parë në këtë këndvështrim, nuk besoj që është e mjaftueshme vetëm përgatitja e këtyre forcave, e cila realisht është një proces i gjatë, i ngarkuar dhe shumë i kushtueshëm, por këto FS **në mënyrë të vazhdueshme kërkojnë përdorim të saktë, nga distanca të largëta, në kushtet e befasisë ekstreme dhe të zgjedhur** të zjarrit të armëve. Sigurisht që kjo kërkon kompletimin e tyre me armatim, municion, pajisje dhe mjete shumë më të avancuara se repartet e tjera të ushtrisë.

Misionet ku angazhohen FS tona janë operacione dhe misione luftimi në zonat më të vështira të globit. Përveç kësaj, ato zhvillohen kryesisht në ambiente publike, qendra të banuara, në autobus, avion, makina, anije, aeroporte dhe në distancë të afërt me popullsinë civile, në terrene ekstreme alpine, arktiku, shkretëtirash dhe xhungle. Këto misione kërkojnë armatim të kalibrave të ndryshme, precizionit të lartë, manovrueshmëri dhe fuqi të madhe zjarri, asgjësim nga distanca të mëdha pa u dekonspiruar, (të pajisura me silenciator), dylbi nate, taktike dhe infrared. Kjo bën të domosdoshme kompletimin e të gjithë personelit të BFS me armatim pistoletë të kalibrave 9X19 mm me që është dhe më i lirë dhe shumë i përdorshëm si psh: Glock-17, HK USP-SD 9x19mm, Sig Sauer 250 Tactical 9x19mm, Sig Sauer 226 Combat 9x19mm, të kalibrit 45 Auto si psh: HK Mark-23, HK P-12, Glock-21, FN Tactical 45 Auto ose Beretta Special Duty, për operacionet speciale dhe të shoqërimit të personaliteteve automatikët HK MP7-A1SF kalibër 4.6x30 mm, FN M 90 kalibër 5.7 mm, HK MP5-A5, HK MP5-SD6, HK MP5K-PDW, HK-UMP A1 kalibër 9x19 mm, automatikët 5.56 mm si psh: HK 416 me tytë 10 inç ose 14 inç me granatë hedhës, FN Herstal 5.56mm 10-12 inç, Beretta ARX 160 A2 SF 12 inç me granatë hedhës, HK G-36C HK G36-K me granatë hedhës ose automatikët me kalibër më të madh HK 417 me tytë 16-20 inç të cilat mund të përdoren dhe si armë për distanca më të largëta deri 800 m, HK G-28 308 Win mag, mitralozat e lehtë HK MG-4 kalibër

56 mm, HK MG-5 7,62 mm, mitralozin e rëndë FN kalibër 5.56 mm dhe FN-50 Browning, mitrolozin e rëndë HK 40 x 46 mm me granata, armët snajper Sako-22 dhe 42, Sako M-10 kalibër 308 win mag, 300 winmag dhe 338 Lapua ose Accuracy International G22 kalibër 300 win mag dhe AW 338 Lapua të cilat mund ti mbështesin operacionet speciale nga distanca 1200-1700 m. I gjithë arsenali i armatimit të FS duhet të jetë me sasinë e duhur të krëhërave rrezervë 4 për çdo pistoletë, 10 për çdo automatik, 6 për çdo snajper, 4 kaseta rrezervë për çdo mitroloz, 2 tyta rrezervë, dylbi EOTec, shënjestra taktike, elektrikë taktikë, doreza taktike, infrared laser, dylbi nate, silenciatorë, etj, vegla pastrimi, pjesë rrezervë, kuti transporti taktike, çantë terreni për transport, rrypat dhe aksesoret e duhura për t'u përdorur në terren, jelekët taktikë dhe këllëfat e duhur që të mundësojnë vendosje të sigurtë dhe dalje të shpejtë, kamera termale, të disponueshme dhe nga FS të vendeve të NATO-s dhe vendeve të tjera partnere (Kontingjentet e FARSH në Afganistan, 2011, 11).

Gjatë gjashtë viteve nga viti 2008-2013 është bërë një punë e kujdesshme dhe shumë frytdhënëse për kompletimin dhe pajisjen e BOS me armatim dhe pajisje bashkëkohore, por jo në sasinë dhe llojshmërinë e duhur, të cilat po i përgjigjen më së miri natyrës së detyrave të tyre në Afganistan, Irak dhe Siri në të ardhmen. Padyshim që kjo ka rritur aftësitë e FS tona, kapaciteteve dhe sigurinë e jetës gjatë kryerjes së operacioneve.

Pjesëmarrja e Kontingjenteve “Eagle 1-7” në operacione të mirëfillta luftimi në terren, krijoi mundësinë edhe të testimeve të këtyre armatimeve dhe pajisjeve në fushën e betejës, të cilat rezultojnë shumë pozitive, duke u kthyer në një pikë referimi të modernizimit të këtyre trupave në të ardhmen dhe që sipas gjykimit tim do të siguronte:

- Standardizimin e armatimit sipas kërkesave operacionale të NATO-s.
- Pjesëmarrjen aktive me struktura të ndërveprueshme me ato të NATO-s, BE dhe UN, në operacionet luftarake dhe speciale.
- Rritjen e kapaciteteve dhe aftësive operacionale në përputhje me misionin e BFS.
- Ndërveprueshmëri të plotë të FS tona me ato të vendeve anëtare të NATO-s, në misione luftarake e jo luftarake.
- Rritjen e manovrueshmërisë dhe autonomisë në operacionet brenda dhe jashtë vendit, futjen në përdorim për herë të parë të armatimit me kalibër 7,62 x

51 mm, 8.6 mm, 5.56 mm, 9x19 mm, 4.6 x30 mm, 45 Auto, etj, sigurimin e municioneve rezervë nga çdo vend anëtar i NATO-s, në zonën e operacionit.

- Rritjen e saktësisë dhe fuqisë së zjarrit për t'ju përshtatur kohës në luftën kundër terrorizmit, i cili zhvillohet në ambiente publike dhe qendra të banuara. Këto lloj detyrash kërkojnë padyshim armatim të precizionit të lartë.
- Zvogëlimin e kalibrit, e cila sjell rritjen e sasisë të municionit që një ushtarak mund të mbajë **me vete gjatë një operacioni**.
- Manovrueshmëri më të mirë, garantimin e një volumi më të madh zjarri, peshë më të vogël tek efektivat gjatë plotësimit të detyrave të FS.
- Eliminimin e zjarrit vdekjeprurës duke rritur karakterin human në operacionet paqeruajtëse dhe luftarake.
- Rritjen e distancave në të cilat mund të asgjësohen kundërshtarët tanë (deri 1700 m), duke rritur ndjeshëm sigurinë e trupave tona, pasi armët e kundërshtarit nuk mund të përdoren në distanca të tilla.

Nisur nga përvoja e deritanishme personale duke qënë pjesë e drejtimit të trupave në misione luftarake dhe antiterroriste në 18 vitet e fundit, si dhe duke u mbështetur në kërkesat specifike të pjesëmarrjes së trupave tona në operacionet në Afganistan, del e nevojshme vazhdimi i modernizimit të armatimit e pajisjeve të FS, duke mos u mjaftuar vetëm me pajisjen dhe sigurimin e një pjese të vogël armatimesh në FS, por plotësimin e TOP-it të BFS me materiale dhe pajisje speciale. **Për t'iu përgjigjur më së miri detyrave specifike që realizojnë FS**, e veçanërisht mbas ratifikimit të STANAG 2523 “**Allied Joint Doctrine for Special Operations AJP-3.5**” si dhe të botimit për herë të parë të **Doktrinë së FOS Shqiptare në vitin 2013, është e domosdoshme një vëmendje më e madhe në drejtim të modernizimit të armatimit dhe pajisjeve të FS që tani ka ndaluar krejtësisht**. Armatimi i ri kërkon padyshim plotësimin me të gjithë aksesoret e domosdoshme si pajisjet laser, shënjestrat dhe pajisjet optike për ditën dhe natën, elektrikët taktikë, silenciatorët, doreza taktike për armën, të cilat montohen në armët e reja që janë blerë, duke bërë të mundur garantimin e suksesit të operacioneve speciale, rritjen e efektivitetit dhe padyshim uljen e dëmtimeve dhe humbjeve në radhët e FS.

Përvoja e misionëve ‘Eagle’ na tregoi se pajisja e FS me helmeta të zakonshme,

nuk është rezultative dhe nuk i përgjigjet natyrës së detyrave të FS. Kjo kërkon padyshim pajisjen e tyre me helmeta balistike, me mundësi vendosjeje dylbi nate dhe elektrike apo edhe të sistemit të komunikimit brenda grupit, etj.

Një element shumë i rëndësishëm dhe që do të rriste kapacitetet vepruese natën të FS është pajisja e tyre me kamerat termale statike kolektive dhe ato individuale taktike, të cilat bazohen në zbulimin e energjisë termike të qenieve të gjalla. Operacionet natën të zhvilluara në zonën e operacionit, në kushtet e mungesës së hënës, na mësojnë se përdorimi i dylbive të shikimit natën nuk është produktiv gjatë vrojtimit në distanca të mëdha, pasi këto pajisje kërkojnë patjetër një burim drite (të hënës). Pra kërkojnë dylbi nate të gjeneratës së Tretë, **të cilat i plotësojnë këto kushte. Në vitin 2013, BFS mori në inventarin e saj dhe dylbi nate për snajperat Sako të cilat pa dyshim që do të rrisin kapacitetet dhe nivelin e gjatë kryerjes së operacioneve.**

Armë të llojeve të ndryshme, jo sipas parimit: “një person, një armë!” por sipas parimit që veprojnë sot të gjitha FS të NATO-s një armë sipas llojit të misionit.

Në varësi të misionit apo detyrës, grupeve speciale u caktohet armatim individual dhe organik. Kjo do të thotë që për një detyrë të caktuar, një special do marrë me vete apo do të përdorë një lloj arme dhe për një detyrë tjetër, një lloj arme tjetër, që i përgjigjet atij misioni. Këto rregulla duhet të jenë të përcaktuara në procedurat standarde të veprimit dhe saktësohen në procesin e planëzimit të detyrës nga vetë grupet speciale, ku një nga hapat më vete është zgjedhja dhe caktimi i armatimit për detyrë. Kjo zgjedhje e armatimit bëhet edhe mbi bazën e disa faktorëve të tjerë si: rëndësia e misionit (shumica e misioneve të FS janë misione të nivelit taktik por që kanë rëndësi të nivelit strategjik) objekti mbi të cilin kryhet misioni, terreni ku do të veprohet dhe koha.

Kështu psh: për të realizuar me sukses një operacion të çlirimit të pengjeve në avion, nuk mund të përdoren armë me kalibër të madh, por armë automatike HKMP5A5 ose HKUMP kalibër 9x19 mm pasi kërkohet precizion i lartë, fuqi shpuese jo shumë e madhe, ose në godinë psh: për arsye të rikoshetimit, lëndëve djegëse, sigurisë, etj; për operacione speciale që kërkojnë infiltrimin nga deti kërkohen armë të cilat kanë qëndrueshmëri ndaj kripës së detit dhe forcë shpuese të madhe nën ujë si psh: HK MP7-A1, HK MP5N, HK-G36CN, HK Mark-23, Beretta ARX-160A2, FN 5.7 mm, të cilat janë shumë të operueshme nën ujë dhe që mundësojnë vendosjen e të gjitha

aksesoreve për të realizuar operacionet speciale në anije dhe tragete, misionet në lartësitë e mëdha në malet e Afganistanit kërkojnë armë që të dëmtojnë kundërshtaritn nga distanca të mëdha, si psh: Sako-42, AW 338 Lapua, HK-416,417, HK-G28 me tytë të gjatë, etj; *për hapjen e dyerve do të duhet të përdoret shotgani Super Bennelli*, etj. Në këtë drejtim në BFS është bërë një punë e mirë por ngelet problem siç e kam theksuar dhe më lart plotësimi i TOP-it.

Parimi i 20% të pajisjeve rezervë për të parashikuar humbjet dhe dëmtimet

Nisur nga larmia e detyrave që kryejnë FS në mision, operacionet në kushte të vështira terreni dhe moti, shtrirja kohore e misionit, largësisë së zonës së operacionit, mund të shkaktohen defekte teknike gjatë përdorimit të pajisjeve apo dhe armatimit, ku mundësitë për riparimin e këtyre defekteve mund të jenë të limituara. Po kështu mund të ndodhin dhe humbje të pajisjeve nga vetë natyra e misionit, terrenit apo dhe shkaqeve të natyrave të ndryshme. Deri tani mbështetja logjistike e trupave në mision, duke përfshirë dhe pjesën e ndërrimit për armatimin që ata kanë në përdorim, është siguruar nga partnerët tanë, në përbërje të të cilëve trupat tona kryejnë detyrat. FS tona kanë në përdorim dhe armatim që nuk njihet apo përdoret nga aleatët si në rastin e mitralozit 12.7 mm “Dishka”, të cilave po t’u shtojmë dhe mundësitë e pakta të mbështetjes logjistike strategjike që kemi aktualisht për forcat gjatë kryerjes së misionit, lind si domosdoshmëri zbatimi i parimit të krijimit të vazhdimësisë së furnizimit duke planëzuar dhe i pajisur që në nisje forcat me 20% të pajisjeve si rezervë përdorimi. Për sa i përket pjesës tjetër të llojit të armatimit që përdorim atje në dislokim, është zbatuar parimi i rezervës për armët automatikë dhe pistoleta. Problem shumë i madh ngelet akoma mos plotësimi i trupave në mision me mitrolozin e lehtë dhe të rëndë të kalibrave të NATO-s (HK MG-4 5.56mm, HK MG-5 7.62mm dhe FN H 7.62 mm) pasi mos kompletimi me to, dëmton seriozisht dhe në një shkallë jo të vogël fuqinë e zjarrit të grupit në detyrë dhe jetën e tyre.

Një problem tjetër dhe aspak më i parëndësishëm është dhe mos kompletimi i armëve me dylbi nate. Asnjë nga armët tona në mision nuk ka dylbi nate (përveç snajperave), bile dhe dylbitë EOT-c që kemi në përdorim në detyrë, nuk funksionojnë siç duhet, pasi kushtet në të cilat ato kanë qënë magazinuar nga Brigada Logjistike, nuk kanë qënë të mira dhe drita e tyre nuk funksionon ditën, gjë që e vendos operatorin

e FS në rrezik të drejtpërdrejtë në detyrë. Asnjë nga armët nuk është e pajisur me silenciator gjë e cila e bën të pamundur elementin surprizë, një nga elementet më të rëndësishme të cilat mundësojnë sukses gjatë kryerjes së operacioneve speciale. Po ashtu armët automatike dhe pistoletat nuk janë të pajisura me elektrikë taktikë apo me infrared, në një kohë që shumica e detyrave që ata kryejnë në Afganistan realizohet natën dhe në vende ku kontrollohen shpella në kushtet e errësirës së plotë, pajisje të cilat mos kompletimi me to e rrezikon së tepërmi jetën e tyre dhe realizimin me sukses të detyrës.

Në këtë drejtim mund të veçojmë si shembull të mirë armatimin Snajper që BFS ka në përdorim, si : Sako 22-42, Sako MI-10, HK-417, HK PSG-1, të cilat janë blerë të gjitha me silenciatorë, distancë matës, erë matës, dylbi shumë të fuqishme vëzhguesi, kompjuter për përcaktimin e të dhënave të ndryshme, municion shumë të saktë, kostume maskimi për çdo lloj terreni dhe së fundmi në Nëntor 2013 dhe me dylbi nate të sofistikuara që i plotësojnë 100% kërkesat operacionale.

Stërvitja e trupave me armatim dhe pajisje në përdorim, gjatë fazës së përgatitjes para dislokimit

Nga eksperiencia e kryerjes së misioneve të deritanishme të kontingjenteve të FA në përbërje të NATO-s, dhe veçanërisht të misionive “Eagle”, del si element i domosdoshëm përgatitja e trupave me armatimin dhe pajisjet që ata do të përdorin në mision, që në fazën përgatitore para dislokimit, pasi dërgimi dhe realizimi i misionit do të bëhet me këto pajisje dhe armatim. Gjatë realizimit të programit të fazës përgatitore për në mision, është e domosdoshme përgatitja për qitje taktike e personelit me armatimin personal e special që do të ketë me vete në mision, pasi gjatë kësaj faze bëhet jo vetëm përshtatja dhe njohja e këtij armatimi, por edhe veçoritë dhe karakteristikat teknike të përdorimit të tyre duke rritur shkallën e besimit të efektivave me pajisjet dhe armatimin që ato kanë në përdorim. Në këtë kuadër gjykoj se sasia e municionit që miratohet nga eprorët tanë në KFT dhe SHP është krejtësisht e pamjaftueshme, pasi sipas rregullit të NATO-s për stërvitjen paradislokuese sejcili nga operatorët duhet së paku të realizojë minimalisht 1500 fishekë qitje me automatikun, 500 fishekë me pistoletën dhe 300 fishekë qitje me snajperin e tij personal.

Organizimi i ndërlidhjes në mision të kontingjenteve “EAGLE”

Operacionet speciale shpesh herë kryhen në distanca të mëdha nga bazat e tyre, **gjë që kërkojnë sisteme të sofistikuar dhe të sigurta të komunikimit** dhe mjete për infiltrimin, mbështetjen dhe eksfiltrimin (daljen) për t’u kthyer nga zonat e ndjeshme të armikut me rëndësi të madhe politike dhe ushtarake. Masat për funksionimin normal të komunikimit kanë rëndësi të jashtëzakonshme sidomos gjatë zhvillimit të operacioneve luftarake të përbashkëta. Komunikimi me radio, si edhe nëpërmjet rrjeteve të tjera të komunikimit ushtarak, duhet të jetë mënyra kryesore gjatë zhvillimit të operacioneve për komandim-kontrollin (C2) (Kontingjentet e FARSH në Afganistan, 2011, 15).

Nisur nga natyra e misionit, detyrat që kanë realizuar kontingjentet “Eagle” strukturat e ndërlidhjes si J6 në SHP, të G6 në FT, ato të S6 në BFS, u angazhuan për mbështetjen e konjektivit me sisteme ndërlidhje në mënyrë të vazhdueshme e të pandërprerë midis QBO-s/SHPFA/MM, qendrën e ndërlidhjes së operacioneve të BFS dhe Komandantit të FS pjesëmarrëse në mision, në mënyrat e komunikimit, foni dhe transmetim të dhënash në mënyrë të klasifikuar, pasi ka qenë hera e parë që është vendosur komunikimi i sigurt me çelësa kriptimi.

Duhet theksuar se ky lloj komunikimi nuk ka asnjë kosto ekonomike satelitore dhe me anë të tij mund të transmetosh në çdo kohë dhe në çdo orë. Por nga ana tjetër të gjitha pajisjet e ndërlidhjes që kishim ne në përdorim, nuk na mundësonin kriptimin, e cila mundësohej nga kolegët amerikanë. Mendoj që ka ardhur koha që të mendohet për blerjen e këtyre çelësave të cilat mundësojnë sigurinë e komunikimit në operacion.

Për të rritur shkallën e ndërveprueshmërisë gjatë kryerjes së veprimeve taktike brenda grupit dhe realizimin me sukses të detyrave speciale si: goditje objekti, zbulim special, kontroll banesash, kontrole në shpella etj, kontingjenti ynë që ishte në mision, u pajis me radio *Harris RF-7800*, të cilat janë shumë moderne dhe bashkëkohore, kishin kufje, të pajisura me GPS për të gjetur vendndodhjen e saktë të çdo operatori në çdo moment, kanë mikrofoni, si dhe u kompletuan dhe me “*Push To Talk*” (PTT)³⁸, e cila bën të mundur komunikimin pa shtypur ganxhën e radios, por me anë të wirellessit që montohet tek arma ose mund të mbahet në çdo lloj pozicioni pa penguar veprimet që mund të bëhen me armën.

Fatkeqësisht këto radio dhe sot e kësaj dite nuk i përdorin dot, pasi është e pamundur përdorimi i tyre nga modeli i vjetër i helmetave të cilat ne kemi në përdorim.

Prej 3 vitesh kam kërkuar personalisht blerjen e 50 helmetave të reja me prerje që mundësojnë vendosjen dhe përdorimin e këtyre radiove, kamerave dhe të elektrikëve.

Rishikim i procedurave ligjore për sigurimin e jetës për kohën e dorëzimit të detyrës ndërmjet kontingjenteve dhe për shpërblimin në rastet kur personeli i misionit humb jetën ose plagoset gjatë misionit.

Gjatë kryerjes së misionit nga kontingjentet “Eagle” të BFS në Afganistan, u konstatua se personelit që kryen detyra luftarake u bëhet sigurim jete për një periudhë kohore vetëm për 6-muaj.

Por misioni mund të zgjasë 6-7 muaj, kohë kjo që nevojitet për dorëzimin dhe marrjen e detyrave ndërmjet kontingjenteve dorëzuese dhe marrëse (periudha 1-2 javore e familjarizimit), në rastet kur nuk sigurohet mjeti ajror për transportin strategjik, për arsye sigurie, kohe, rrethanash të ndryshme dhe pikërisht për këtë periudhë kohore, personelit nuk i bëhet sigurimi i jetës, gjë e cila sipas gjykimit tim duhet të korrigjohet urgjentisht dhe të jenë të siguruar të gjithë personat të cilët janë të dislokuar në çdo moment (Kontingjentet e FARSH në Afganistan, 2011, 18).

Për këtë qëllim lindi si domosdoshmëri sigurimi i jetës të personelit edhe për kohën që qëndrojnë gjatë dorëzimit të detyrës (periudha 1-2 javore e familjarizimit) ndërmjet kontingjenteve.

Asnjë nga operatorët të cilët marrin pjesë në luftim nuk janë të kënaqur nga sasia e parave që përfiton një operator, i cili humb jetën në misione të tilla. (Kjo gjë u vërejt në kohën kur Kapiten Feti Vogli ra në krye të detyrës dhe asnjë person qoftë familjar por dhe operator nga BFS, nuk ishte i kënaqur nga ai shpërblim, përkundrazi shumë të pamotivuar). Për këtë qëllim ghykoj që duhet urgjentisht që të bëhen rishikime ligjore për sigurimin e jetës dhe për shpërblimin në rastet kur ndonjë pjesëtar i efektivit në mision humb jetën ose plagoset. Duhet marrë si shembull sigurimi i jetës së personelit të dërguar në mision nga shtetet e tjera të NATO-s, që në gjykimin tim duhet të jetë të paktën dhe 100% më i lartë se ai aktual krahasuar me atë që është në fuqi tani nga MM.

Domosdoshmëria e ngritjes së strukturave për rehabilitimin psikologjik të pjesëmarrësve në misione para dhe pas kthimit, përkujdesja sociale ndaj familjeve të tyre gjatë kohës së kryerjes së misionit

Në Direktivën e Mbrojtjes të nxjerrë nga MM në vitin 2011 theksohet: Rehabilitimi Psikologjik, veçanërisht i ushtarakëve në mision luftimi, përkujdesja

sociale ndaj familjeve të tyre, duhet të përbëjnë një projekt të diferencuar të skemës së përkujdesjes sociale. Brenda muajit mars të vitit 2011 është punuar projekti për ngritjen dhe funksionimin e një qendre rehabilitimi dhe këshillimi psiko-social për ushtarakët në mision (Direktiva e Mbrojtjes, MM, 2011).

Misionet jashtë vendit, nisur nga shtrirja në kohë, shumëllojshmëria e stërvitjeve dhe e detyrave që kryhen para dhe gjatë misionit, ndikojnë ndjeshëm në gjendjen psikologjike të personelit, qoftë të vetë personit pjesëmarrës, por veçanërisht tek familjarët që ky person lë pas. Ndaj është e domosdoshme që krahas përgatitjes profesionale që padyshim ndikon ndjeshëm në realizimin me sukses të detyrave në mision, po aq e domosdoshme është përgatitja psikologjike e këtij personeli para nisjes për mision, gjatë kryerjes, por edhe pas përfundimit të këtij misioni.

Nga ana tjetër, do të ishte më e arsyeshme që edhe familjarët e ushtarakëve në mision të angazhoheshin në një grup (ose këshill familjar) për të mundësuar në krijimin e një sistemi komunikimi ndërmjet familjarëve të ushtarakëve, zinxhirit të komandimit, autoriteteve dhe institucioneve vendore. Qëllimi kryesor do të ishte inkurajimi dhe mbështetja nëpërmjet familjarëve të ushtarakëve, duke mundësuar shkëmbimin e informacionit dhe mbështetjen reciproke.

Për sa më sipër, nisur dhe nga procedurat që ndjekin vendet e NATO-s, anëtarë të së cilës jemi dhe ne, sugjerojmë përgatitjen dhe hartimin e një formulari (e cila tashmë është bërë), i cili duhet të plotësohet nga ushtaraku para se të nisët në mision. Ky formular mund të përmbajë këshilla dhe detyrime të strukturave të FA për përkujdesjen familjare të ushtarakëve pjesëmarrës në misione, të tilla si:

- Plotësimi i formularit nga vetë ushtaraku, firmosja prej tij dhe nga komandanti, për çdo rubrikë që mund të ketë formulari.
- Informacion mbi gjendjen familjare, personat në ngarkim, mosha, statusi dhe aftësitë fizike të tyre.
- Informacion mbi mundësitë e përkujdesjes së familjareve të tij kur ai ndodhet në mision, në përputhje me ligjet dhe aktet e tjera administrative në fuqi.
- Përfitimet ekonomike, financiare dhe të drejtat për familjarët e tij, kur është në mision.
- Ky akt mund të firmoset edhe nga familjari kryesor dhe kryetari i grupit të familjarëve.

Gjykoj që jo vetëm kaq, por duhet të ngrihet një qendër e specializuar rehabilitimi me psikologë me eksperiencë **në drejtim, të cilët do të duhet që të fillojnë të krijojnë programe të cilat ndihmojnë në rehabilitimin e personelit i cili kthehet nga misionet luftarake me probleme psikologjike. Raste të tilla të kthimit të personelit tashmë kanë filluar të shfaqen dhe aktualisht në FA në dijeninë time nuk ka njerëz të specializuar në këtë fushë. Po të kishte patur një qendër të tillë, ndofta nuk do të kishim patur humbjen e kolegut tonë nga BFS operatorit të shkëlqyer MB.**

Praktikat kundër mjeteve shpërthyese të improvizuara (KMSHI)

Krahas të gjithë TTP të strukturave terroriste, talebanëve dhe armëve që ata përdorin kundër trupave tona në operacionet në Afganistan, sipas të gjitha statistikave dëmet më të mëdha në njerëz dhe teknikë vijnë nga përdorimi i KMSHI-ve. Informacioni në këtë pjesë të kapitullit freskon, ndan dhe përditëson informacione për njësitë dhe ushtarakët tanë që do të marrin pjesë në misionin e ISAF-it, mbi TTP-të kundër mjeteve shpërthyese të improvizuara (KMSHI), praktikat më të mira nga Operacioni *Enduring Freedom* (OEF) që po vazhdon në Afganistan, operacion në të cilin edhe Forcat tona Speciale po japin kontributet e tyre të jashtëzakonshme. Ky informacion mund të përdoret përveç këtij disertacioni dhe gjatë trajnimeve para dislokimit nga qendrat e stërvitjes luftarake, trajnuesit e qendrave të stërvitjes dhe në linjat e trajnimit për kundër mjeteve shpërthyese të improvizuara KMSHI.

Informacionet nga teatri i Afganistanit vërtetojnë se operacionet e suksesshme COIN në bashkëpunim me popullsinë afgane janë thelbësore për luftën KMSHI. Forcat e koalicionit, në përbërje të të cilit veprojnë dhe kontingjentet tona, duhet të sigurojnë ndihmë nga popullsia lokale për tu lajmëruar nga ata (në këtë drejtim rrjeti i informacionit që u ngrit në zonën e operacionit nga kontigjenti “**Eagle-1**” ishte një shembull që për shumë kohë përmendej nga eprorët e ushtrisë amerikane) për të gjetur mjetet shpërthyese të improvizuara (MSHI) dhe të sulmojnë rrjetet e rebelëve në prodhimin dhe ndërtimin e MSHI-ve.

Taktikat, Teknikat dhe Procedurat (TTP) e armikut

TTP e armikut përfshijnë:

- **Rritja e avantazhit të pengesave natyrore dhe të ndërtuara nga njeriu.** Terreni është shumë kufizues në disa zona të Afganistanit. Kanalet vaditëse, kanalet e tjera dhe hendeqet janë të shumta, ndaj operacionet në këmbë janë të nevojshme për shkak të mundësive të kufizuara për përdorimin e automjeteve. Forcat talebane dhe kundërshtarë, përdorin terrenin ndërmjet tyre dhe forcave të koalicionit. Ata lëvizin vazhdimisht lart e poshtë duke përdorur terrenin për mburojë dhe fshehje. Forcat armike përdorin terrenin e kanalizuar për të rritur efektin e MSHI, duke drejtuar forcat koalicionit në zona vdekjeprurëse.
- **Vlerësimi dhe synimi i forcave tona.** Rebelët mund të dallojnë njësitë e forcave tona, forcën, synimet dhe dallimet midis këmbësorisë, marinsave, apo FS. Forcat rebele mund të lejojnë këto lloj njësish të kalojnë e të presin për objektiva më të dobëta siç janë kolonat e furnizimit dhe pastaj të planifikojnë goditjen e tyre.
- **Ripërdorimi i zonave të pritave/MSHI dhe sulmet e koordinuara me prita dhe armë.** Rebelët përdorin zonat e suksesshme të mëparshme për sulmet MSHI dhe pritat. Po të studiosh me kujdes vëndet që kanë sjellë humbjen më të madhe të forcave dhe mjeteve të koalicionit në Afganistan, janë vendet në të cilat janë sulmuar më shumë ushtria sovjetike, gjatë konfliktit të gjatë të viteve 1979-1989 në Afganistan. Këto zona nuk kërkojnë zbulim të madh dhe kanë pika vrojtimi të mira, rrugë largimi dhe pengesa ndërmjet zonës së mjeteve të shpërthimit dhe pikës së inicimit (shpërthimit). Pengesat në zonë gjithashtu mund të lehtësojnë largimin e tyre. Rebelët zakonisht e shoqërojnë një sulm me mjete shpërthimi me zjarrin e armëve të lehta ose granatëhedhësve (RPG) brenda distancave nga 50-300 metrave, duke krijuar një pritë më komplekse. Një mjet shpërthimi kur aktivizohet, zakonisht inicion fillimin e hapjes së zjarrit në pritë. Rebelët luftojnë jo me kohë të madhe dhe gjatë konfuzionit fillestar të sulmit mundësojnë dëme të konsiderueshme, megjithëse përpiqen të ruajnë superioritet lokal. Ata shkëpusin kontaktin nëpërmjet rrugëve të largimit të planifikuara që më parë, në këmbë (shtigje të fshehta, shtretërve të lumenjve, kanaleve vaditës ose kanaleve). Shumica e sulmeve të rebelëve kanë patur një plan ikjeje të shpejtë. Ka patur relativisht pak sulme me kontakt të gjatë.

Rekomandime / Sugjerime

Zbulim, vëzhgim dhe përnjohje

Përderisa rebelët përdorin zonat e mëparshme të suksesshme të pritave dhe të mjeteve shpërthyesë të improvizuara (MSHI), drejtuesit duhet të kryejnë me kujdes zbulimin, vëzhgimin dhe përnjohjen e zonës së tyre të operacionit. Ata duhet të kenë harta ose makete të terrenit që tregojnë vendet e mëparshme të pritave dhe të mjeteve shpërthyesë të improvizuara për një periudhë jo më pak se një vit. Të preferueshme janë të dhënat historike për më tepër se një vit. Zakonisht ata përdorin vende pritash kundër forcave të koalicionit, të cilat i kanë përdorur kundër forcave sovjetike gjatë operacioneve të tyre në Afganistan siç theksova dhe më lart. Seksionet e zbulimit të kontigjenteve tona, brigadës/batalionit amerikan dhe nënrepartëve të tjera të ISAF-it, duhet të grumbullojnë një listë reference të plotë të zonave të pritave dhe MSHI-ve për zonën e tyre të operacionit. Anëtarët e patrullës duhet të njohin zonat e pritave dhe të mjeteve shpërthyesë të improvizuara në rrugëkalimin e tyre të patrullimit. Asetet e zbulimit, vëzhgimit, përnjohjes, duhet të koordinohen për rrugëkalimin e patrullës përpara çdo patrulle, duke i kushtuar vëmendje të veçantë për zonat e pritave dhe të MSHI-ve të mëparshme apo të mundshme.

Ajo që unë kam patur parasysh personalisht gjatë dislokimit dhe që nuk e kam neglizhuar kurrë si drejtues i misioneve luftarake në Afganistan, ka qenë studimi me shumë kujdes i zonave nga kalonin makinat tona, pasi ato ishin të pablindura dhe gabimi më i vogël kushtonte humbjen e të paktën 5 operatorëve. Ngritja e rrjetit të informacionit dhe shfrytëzimi në maksimum i informacionit në zonën ku vepronim, duke marrë telefonata nga agjentët tanë direkt në terren, se ku një natë më parë talebanët kishin vendosur minat surprizë, e rriti ndjeshëm sigurinë tonë. Në të gjitha rastet, jo vetëm vinim në dijeni palën amerikane për vendndodhjen e tyre por dhe studionin me vëmendje teknikën e përdorur nga terroristët gjatë vendosjes së tyre. Kishte raste të cilat ato viheshin në përdorim me telekomandë nga distanca të konsiderueshme me celular, pastaj më vonë pasi filloi përdorimi i **Jammers** kryesisht me shtypje, zgjatja e linjës së ngarkesës së parë e cila ishte më e dobët se ngarkesa e dytë dhe kur kalonte **mine rollersi** ajo nuk plaste, kur kalonte mjeti dhe kur goma shkelte mbi të (ngarkesën) ngarkesa shpërthente dhe e bënte mjetin copë copë. Pas vitit 2013 filluan të përdornin ngarkesa eksplozive të infektuara me mikrobën e SIDA-s, më pas duke përdorur mina të vëna në veprim në mënyrë magnetike, ku vendosja e tyre afër dyerve të shtëpive bënte të mundur shpërthimin kur patrullat kalonin midis tyre. Një taktikë tjetër ishte

dhe vendosja e eksplozivave sipër mureve, që në rast se hypnin mbi mur për tu futur në ndonjë kompleks banimi trupat e koalicionit, ajo shpërthente dhe i dëmtonte. Përveç këtyre talebanët vendosnin mjete shpërthyes në të gjitha vendet që ata mendonin se mund ti shfrytëzonin kundër forcave tona. Brenda dhomave në pragun e derës, sidomos në vendet ku ata kishin “punishtet” për prodhimin e bombave artizanale, të lidhura me armë dhe sende të tjera që tërhiqnin vëmendjen. Minonin të gjitha rrugët që të çonin drejt këtyre objekteve dhe i markonin me shenjë që i dinin vetëm vetë, të cilat jua tregonin dhe fëmijëve. Për tju shmangur këtyre TTP-ve ne filluam për herë të parë duke mos përdorur kurrë hyrjen nga dyert ose në oborret e objekteve që kishim në kërkim, por nga ana e jashme e banesave (ana e jashtme e mureve) duke bërë hapjen me eksploziv dhe futjen brenda, duke krijuar kështu elementin surprizë dhe duke mos i dhënë kohë terroristëve, të reagonin kundër nesh. Gjithashtu një pikë shumë e rëndësishme që na çoi drejt suksesit, ishte “skanimi dhe kontrolli i imtësishëm” që i bënim rrugëve mbi të cilat ecnim dhe bashkëpunimi me fshatarët e zonave ku vepronim nëpërmjet informatorëve tanë.

Stërvitu, kupto dhe praktiko kundërrebelimin!

Në Manualin e Luftimit FM 3-24.2 të ushtrisë amerikane, “Taktikat në kundërrebelim” (*Tactics in Counterinsurgency*) citohet: “*Patrullimi energjik në një zonë u zvogëlon rebelëve lirinë e lëvizjes, prish operacionet, dobëson ndikimin e tyre në popullsinë lokale*” (*Tactics in Counterinsurgency FM 3-24.2, 2005, 17*). Ushtarët, në interes të kryerjes së detyrave, dalin dhe lëvizin nëpër popull. Ata duhet ta dinë dhe njohin çfarë duket normale në zonën e tyre të patrullimit. Ky rebelim që po ndodh në Afganistan është rebklim rural. Usharakët në Jug të Afganistanit kalojnë një pjesë të mirë të kohës duke patrulluar në terren. Grupet e ndryshme kryejnë zakonisht tre herë në javë patrullime, dy deri tre ditë, duke ndryshuar oraret e patrullimit për të mos vendosur gjëra shabllone sidomos në drejtim të zgjedhjes së rrugëkalimeve për tju shmangur vendosjes së minave. Gjatë kohës që ata janë duke “vrapuar ose luftuar” në të njëjtën kohë marrin pjesë dhe në mbledhjet *shura*, (termi islamik i takimeve) pijnë çaj, hanë mish dhe së bashku me liderët e komuniteteve, etj.

Afganët kanë qënë historikisht një shoqëri realiste, e ndjeshme dhe praktike. Ata nuk do ta kenë të lehtë që të zgjedhin se me cilin krah do të partnerizohen, derisa të jenë të qartë se cili krah do të jetë fituesi, rebelët apo forcat e koalicionit. Afganëve nuk iu

bën përshtypje rritja e sasisë së forcave. Ata shohin vetëm veprat dhe jo premtimet dhe janë shumë materialistë. Ndërtimi i një fryme besimi me popullsinë lokale, bën që më tepër njerëz të tregojnë vendet e vendosjes së minave surprizë dhe të japin informacion për rrjetet lokale të ndërtimit të tyre. Afganët gjithashtu shqetësohen për sigurinë e familjeve të tyre. Mbas 30 vjet luftërash të dhunshme, tendenca e afganëve është të besojnë tek cilido që ofron siguri, pavarësisht nëse është taleban, forcë koalicioni apo Qeveri e Republikës Islamike të Afganistanit.

FS shqiptare dhe amerikane në Jug të Afganistanit kanë arritur një sukses të dallueshëm nëpërmjet parimeve të zbatuara mirë të kundërrebelimit. Parimi i tyre i operimit është që çdo operator është një kundërrebelues, secili kupton dhe praktikon kundërrebelimin. Një pjesë e mirë e gjetjes dhe e zbulimit të MSHI-ve vjen nga popullsia lokale. Kjo ka ardhur kryesisht për shkak të respektit të fituar duke ofruar siguri të popullsisë, duke zbatuar projekte të ndryshme në ndihmë të tyre, duke dhënë materiale për shkollat, mbjedhjet e tokave të tyre, duke siguruar ndihmë të shpejtë, etj. Ndërsa numri i MSHI të vendosura në Afganistan është rritur dukshëm vitet e fundit si pasojë e kësaj është rritur dhe numri i të vrarëve nga forcat e koalicionit, përqindja e MSHI të gjetura nga popullsia lokale është rritur atje ku forcat e koalicionit kryejnë operacione të mira kundërrebelimit dhe kanë bashkëpunim të mirë (si në rastin tonë në qytetin e Spin Buldokut ku që kur FS tona morën qytetin nën kontroll, siguria është rritur rreth 300%). Patrullimet me këmbë, një nga karakteristikat kryesore të veprimit nga efektivat e kontingjentëve “Eagle”, raportojnë një numër më të madh të MSHI-ve të gjetura dhe pastruara në krahasim me patrullimet me mjete (kjo nuk përfshin patrullimet e mjeteve të pastrimit të rrugëve EOD).

Shfrytëzo gabimet e rebelëve!

Trupat e koalicionit duhet të shfrytëzojnë gabimet e rebelëve duke vepruar si më poshtë vijon:

- Të shfrytëzojnë në favor të tyre mosmarrëveshjet, diferencat dhe ndarjet fisnore ndërmjet udhëheqësve rebelë.
- Të përdorin informacionin e nxjerrë nga rebelët, për dëmet në të vrarë e të plagosur nga mjetet e shpërthimit, me qëllim që të jenë të parët për t'i komunikuar të vërtetën popullsisë lokale.

Stërvitja para daljes në detyrë

Stërvitja para daljes në detyrë gjykoj që është një faktor shumë i rëndësishëm për rritjen e aftësive të efektivit për të përballuar operacionin luftarak (betejën). Stërvitja e mirë para daljes në detyrë e ndihmon efektivin tuaj për të ripërsëritur detyrimet e sejcilit në rast se..... në postin e tij luftarak.

Stërvitja para daljes në detyrë:

- Është mundësia për të kontrolluar aftësitë luftarake të sejcilit individ, grupit tuaj, n/repartit, etj.
- Është stërvitja e trurit për reagimin konkret në situata kritike për trupat që e kanë për herë të parë eksperiencën në luftime.
- Lejon efektivin të solidarizohet si ekip.

Në vijim do të mundohem të shpjegoj të gjithë elementët e stërvitjes para daljes në detyrë:

- a) Drejtimi i njësive të vogla.
- b) Kontrolli i imtësishëm i njohurive për detyrë, i pajisjeve dhe gatishmërisë së armatimit.
- c) Operacionet në kushte të veçanta terreni dhe moti, operacionet në shpella.
- d) Operacionet në lartësi të mëdha.
- e) Operacionet në mot të ftohtë.
- f) Veprimet mbi mjete të blinduara.
- g) Reagimi ndaj mjeteve shpërthyes të improvizuara.
- h) Reagimi ndaj sulmeve si prita ose sulme indirekte, etj.

Lidershipi i njësive të vogla

Drejtimesit dhe operatorët e FS janë të adaptueshëm dhe fleksibël, me një eksperiencë në shkallë të gjerë të aftësive, janë më të suksesshëm në një mjedis kundërrrebelues, që në Afganistan zhvillohet vazhdimisht. Komandantët kreativë kanë iniciativë, krijojnë e ndërtojnë marrëdhënie të mira me vendasit dhe janë të aftë të përshtatin operacionet me situatën lokale.

Kryekapiteri *Hall*, për eksperiencat e tij në aplikimin e COIN në Afganistan, shkruan: *“Si lider, qëllimi juaj është që të bëni një emër të mirë për vete dhe njësinë*

tuaj në komunitet, ndërsa mbani në nivele të ulëta frikën, për t'u përballur me armikun. Liderët duhet të krijojnë drejtësi dhe besim nëpërmjet fjalëve të tyre, premtimeve dhe veprimeve". Ai jep konkluzionet e tij në lidhshpë me njësisë së vogël në një përmbledhje të quajtur "Gjërat e mprehta që njerëzit kanë thënë ndërsa janë në Afganistan, pjesa I-rë (Smart Things People Have Said While in Afghanistan - part 1).

Operacionet në kushte të veçanta terreni dhe moti, operacionet në shpella

Terreni brenda zonës së operacionit të kontingjenteve "Eagle" ka qenë një zonë shumë e vështirë nga pikëpamja e rrezikshmërisë dhe ka patur një rëndësi të madhe për sa i përket përdorimit të linjave të komunikimit dhe transportit. Ajo është një zonë e cila karakterizohet nga dy lloje të ndryshme terrenesh , shumë shkretëtiror dhe shumë malor. Zona e Regestanit dhe e Arghandabit ku ndodhen distrikti Takto-Pol, Daman, Spin Buldok, Ragestan, Shorabak, në kufi me Pakistanin me një gjatësi rreth 83 km dhe zona e Adi Garit, Mulayatit, Low Karizit, Lakarayit, Loy Kalayt, Shah Kalayt, etj krejtësisht malore dhe e pakalueshme në dimër përsëri në kufi me Pakistanin me një gjatësi rreth 70 km, ku për sejcilin terren duheshin marrë masa në vartësi të detyrës. Ajo që është e rëndësishme për tu theksuar, është se terreni në të cilat trupat tona kanë operuar, kanë qënë zona të pashkelura më parë nga forcat e koalicionit, si edhe në rajone që prej vitesh konsideroheshin si "qiell" i sigurt i talebanëve dhe ishin totalisht nën kontrollin e talebanëve. Mjafton të kujtojmë veprimet e kryera në zonën e komplekseve të shpellave të Maleve të Adi Gharit-Mulayat-shpellat e Zharay-Ponzhayt, e cila përshkohet nga autostrada A-4, rruga kryesore e furnizimit nga Karachi-Pakistan drejt Kabulit. Kjo zonë njihej si zona e talebanëve dhe për më tepër që është në kufirin afgano-pakistanez. Terreni është tepër malor, me shumë shpella, të cilat shfrytëzoheshin nga talebanët për transportimin e pajisjeve luftarake nga Pakistani, strehim, vendpushim në rastet kur autostrada kontrollohej nga forcat e koalicionit. Vetëm gjatë misionit "Eagle-1" efektivet e kontigjentit tanë kanë kontrolluar mbi 200 shpella duke grumbulluar mbi 12.000 kg materiale eksploziva, armë dhe pajisje në përdorim të terroristëve dhe qindra kg drogë e kapur dhe më pas e asgjësuar.

Gjatë operacioneve asimetrike të aleancës në Afganistan, sidomos në terrene malore, kundërshtarët përdorin gjerësisht shpellat, të cilat mundësojnë vende të sigurta për planifikimin e sulmeve, ruajtjen e materialeve luftarake, ruajtjen e forcave dhe

mjeteve nga goditjet ajrore dhe të artilerisë. Nënrepartet që veprojnë në këto terrene kundër talebanëve, duhet të kenë një përgatitje të plotë mbi teknikat e kontrollit, pastrimit eksplorimit dhe të luftës në shpella, pasi ato përbëjnë një pengesë të rrezikshme dhe serioze në operacionet aktuale. Normalisht, pasi nënrepartet të kenë kontrolluar këto shpella, do të kalohet në fazën tjetër atë të shkatërrimit ose të mbylljes me anë të shpërthimit me eksplozivë, duke bllokuar hyrjet për mos përdorimin e tyre nga kundërshtarët. FS tona kanë qenë shumë të suksesshme dhe kanë treguar profesionalizëm në veprimet e tyre në këto terrene, kjo, falë përgatitjes serioze që kanë bërë gjatë fazës paradisllokuese për operacionet në shpella.

Një ndihmesë të madhe në këtë drejtim ka dhënë dhe ndërtimi i poligonit të shpellave në Zall-herr në vitin 2010 i përbërë nga 4 tunele rreth 100 të gjatë të lidhura në fund nga një tunel tjetër 110 m i gjatë, të gjitha me mundësi qitjeje reale me automatik dhe pistoletë duke vendosur brenda saj 36 objektiva “armikë”. Përveç kësaj gjatë gjithë gjatësisë së saj janë të vendosura “Mina surprizë”, mundësi zbritjeje me litar, përdorim eksplozivash për hapjen e dyerve dhe mbështetje me snajper nga distanca deri 900 m. Stërvitje të ndryshme janë realizuar dhe në Kukës në kompleksin e shpellave afër Morinës, duke realizuar stërvitje krejtësisht të njëjta me ato në Afganistan me infiltrimin natën të grupeve të zbulimit special, snajperave, infiltrimin me 3 helikopterë të grupeve të sulmit ditën në kushte reale dhe duke stimuluar vendosje minash surprizë përgjatë gjithë gjatësisë së shpellave, etj. Nga viti 2012-2013 grupe të ndryshme nga Komandot e Marinës Mbretërore Angleze janë stërvitur me ne dhe nga ne, në drejtim të luftës në shpella duke marrë pjesë në kursin 2 javor të luftës në shpella me efektivët e BFS.

Konsiderata taktike të operacioneve në shpella:

- Së pari çdo person i cili do të marrë pjesë në kryerjen e kontrollit të shpellave në mision, duhet të ketë mbaruar kursin 2 javor të luftës në shpella që bëhet në BFS. Përveç kësaj, ai duhet të ketë stërvitje të vazhdueshme në këtë drejtim duke ndjekur të gjithë stërvitjen para dislokuese që bëhet para nisjes në mision. Një grup special i stërvitur dhe pajisur mirë, është baza për operacionet kundër shpellave, personeli i patrajnuar mund të mos jetë në gjendje të operojë brenda tyre, të ketë pasoja nga minat surprizë dhe nuk mund të neutralizojë kundërshtarin nëse goditet nga armët e tij.

- Grupet e caktuara për luftën në shpella duhet të jenë të stërvitur, të pajisur dhe në gatishmëri për të dhënë ndihmë të specializuar të menjëhershme, sapo të bien në kontakt me veprimet e armikut në këto shpella.
- Grupet e sulmit në përbërje të tyre duhet të kenë 3-4 veta dhe të paktën 2-3 veta të tjerë për mbështetje.
- Anëtarët e grupeve të luftës në shpella duhet të monitorohen, pasi klaustrofobia (frika nga ambientet e mbyllura) dhe paniku mund të shkaktojnë dështimin e misionit të grupeve ose dëmtimin dhe asgjësimin e anëtarëve të grupit.
- Ata ndërsa ecin në thellësi të shpellës, duhet të kontrollojnë për mina surprizë, pajisje të tjera të cilat mund të jenë materiale luftarake në përdorim të armikut. Zakonisht në shpella ka depozita armësh ose tuba ajrimi.
- Gjatë përparimit në thellësi të tyre, grupet e kontrollit të tyre duhet të mbajnë komunikim të vazhdueshëm me pjesën tjetër jashtë, të transmetojnë në mënyrë të vazhdueshme çdo hollësi që ka lidhje me atë që shohin, formën, drejtimin, nga hyrja e saj, etj. Specialisti i zbulimit i grupit grumbullon dhe bën kontrollin e saj për çdo rast dhe bën dizenjimin ose hartën e shpellës së zbuluar.⁵¹
- Gjatë kontrollit dhe avancimit në thellësi të saj, grupet duhet të jenë të stërvitur për kontrollin e zonave sensitive (SSE) dhe grumbullimin e provave.

Siguria e vendit gjatë kryerjes së operacioneve speciale në shpella:

- Gjëja e parë që duhet të bëni është që të shfrytëzoni çdo të dhënë nga zbulimi në lidhje me historinë e përdorimit të atyre shpellave gjatë kohës së pushtimit Sovjetik.
- Merrni të gjitha masat që i gjithë personeli i përfshirë në këtë operacion, ka njohuri mbi zonën, pajisjet, armatimin dhe stërvitjen e duhur.
- Mundohuni që të grumbulloni informacion të freskët në lidhje me aktivitetin, organizatën, qëllimin e përdorimit të këtij kompleksi, skemën e futjes ose skica nga persona, të cilët dikur kanë qënë pjesë e saj, me qëllim që të shmangen sa më shumë të papriturat.
- Dislokoni grupe snajperash dhe vëzhguesish, që cilët të mbajnë nën kontroll të paktën 24 orë përpara dhe të monitorojnë çdo veprim që ndodh në zonë dhe më e rëndësishmja të mbështesin të gjitha veprimet në rastet kur grupet e sulmit dhe kërkimit në shpella të fillojnë afrimin për tu futur brenda.

- Vendosni një zonë të sigurtë/mbrojtëse 360° në afërsi të shpellës për të mbrojtur grupet e kontrollit dhe luftës në shpella.
- Prezenca e shpellave, brenda apo pranë zonës së veprimit, paraqet një kërcënim të vazhdueshëm ndaj gjithë personelit në zonë. Kurrë mos e konsideroni një zonë që ka shpella, si tërësisht të pastër dhe të sigurtë.
- Gjatë kohës që kryeni afrimin, kontrolloni për lëvizje njerëzish në afërsi të tyre, nëse bëjnë lëvizje të dyshimta, përdorim celulari, radioje, turbani (shalli afgan) si tundje në ajër e cila zakonisht tregon shenjë e afrimit të armikut, prezencë toke të punuar, tela, mbeturina, etj.
- Përpara hyrjes në shpella, kontrolloni me kujdes hyrjen për praninë e minave surprizë ose vendosjen e MSHI-ve. **Kujdes nga surprizat e ndryshme.**

Operacionet në lartësi të mëdha

Ushtarakët që dërgohen me mision në Afganistan duhet të kuptojnë që aktiviteti i tyre në lartësi të mëdha shoqërohet me probleme shëndetësore, të cilat ndoshta nuk i kanë hasur më parë. Operimi në lartësi të mëdha rrit kërkesat për më shumë energji në masën pothuajse 50% dhe shoqërohet me temperatura shumë të ulëta dhe rritje të aktiviteteve të tjera fizike, që potencialisht mund të rendisin kryerjen e misionit të ngarkuar në plan të dytë, pas mbijetesës së tyre në terrene të tilla. Ky aktivitet i rritur fizik mund të absorbohet vetëm nëpërmjet përshtatjes me klimën, stërvitjes, aftësive speciale, si dhe përdorimit të mjeteve të destinuara për këto kushte. Nga eksperiencia jonë në Afganistan, gjatë realizimit të misionëve të cilat në disa raste shkonin dhe deri në 3 ditë pa u kthyer në bazë, arritëm të mësonim se të vepruarit në terrene alpine ishte shumë i vështirë për arsye të peshës shumë të madhe që shkonte deri në 90 kg, kohës së ftohtë, terreni shumë i thyer, rrezikshmëria ndaj minave dhe pritave të mundshme dhe largësia nga baza operationale.

Peshat e mëdha.

Kryerja e operacioneve speciale në terrene malore dhe me kohë të gjatë, kërkon një përgatitje të lartë fizike e cila në repartet e FOS-it është një proces

i vazhdueshëm dhe i përditshëm, por jo vetëm kaq, kërkon një planizim të hollësishëm të njohjes, gatishmërisë dhe të paisjeve që mundësojnë realizimin e këtyre operacioneve.

Çdo pjesëtar i cili merr pjesë në operacione të tilla ka me vete jelekun e sulmit i cili përmban: 9 krëhëra automatiku, 4 krëhëra pistolete, dy granata tymuese, dy granata stun, 3 litra uje në Camel Back, kutinë individuale të ndihmës së shpejtë, dylbitë e natës, thikën, 2 pllaka antiplumb, radion dhe kufjet, pranga plastike, pistoletën me elektrik dhe automatikun, të cilat shkojnë rreth 25-28 kg. Gjatë kryerjes së operacioneve në lartësi të mëdha dhe sidomos gjatë dimrit të acartë afgan, në misionet e gjata 3 ditore duheshin me vete dhe pajisje të tjera shtesë, të cilat mundësonin mbijetesën e operatorëve tanë. Pajisja me çantat 120 litërshe për herë të parë i BFS pas vitit 2008, mundësoi që çdo operator të kishte mundësi të mbante: dyshekun alpin me tre shtresa, shtrojen e dyshekut, 24 shishe ujë 1/2kg, 3 racione ushqimi të paketuara, 300 fishekë 5.56 mm, 50 fishekë 9x19 mm, çdo person 200 fishekë 5.56 mm mitralozi rezervë për mitralierin, që në rast se binim në kontakt me armikun të kishin mundësi të zgjasnin luftimin sa më shumë që të mundnin deri në ardhjen CAS-it dhe MEDEVAC-ut, mbanim një sasi municioni rezervë për snajperët dhe mitralierin po ashtu, 3 shtresa veshjeje nga kompleti me 7 shtresa veshjeje për të ftohtin e natës, dylbi nate ose termale, distancëmatës, pajisje zbulimi për përdorim natën, bateri rezervë për radiot dhe dylbitë e armës, çantë të ndihmës së shpejtë, etj të cilat shkonin të paktën 60 kg në disa raste dhe më shumë. Vetëkuptohet lëvizja në terrene të tilla, është ekstremisht e vështirë pasi pesha shkon mbi 90 kg, shtoi kësaj dhe rrezishmërinë e goditjes nga armiku ose të shkeljes së minave, të ftohtit që në disa raste shkonte dhe -20°C. Me qëllim përballimin e operacioneve të tilla nga ana e shtabit të BFS-së u morën masa që stërvitjet të zhvilloheshin në terrene të njëjta si psh: në zonën e Bizës, me ngarkesa të njëjta peshash dhe distancash dhe njëkohësisht dhe duke testuar dhe të gjitha pajisjet të cilat do të përdoreshin në terren. U realizua për çdo efektiv misionesh, përshtatja me temperaturat dhe lartësitë, masa të cilat treguan që kur trupat tona u dislokuan në Afganistan të vepronin shkëlqyer.

Sëmundjet e lartësive të mëdha

Sëmundjet e menjëhershme të maleve mund të fillojnë në lartësinë rreth 2500 metra e lart. Simptomat më të shpeshta janë:

- Dhembje koke dhe marrje mendsh.

- Shqetësime të gjumit.
- Lodhje, debulesë, etj.

Humbja e peshës në lartësi të mëdha

Humbja e peshës është karakteristikë e operacioneve në lartësitë e mëdha. Në vitin 1994, humbja mesatare e peshës për FS, që ushqeheshin me racionet e ushqimit pakistanez dhe punonin me shkollën Malore të Lartësive të Mëdha, ishte 10-12 kg në muaj. Të vepruarit në lartësi të mëdha kërkon më shumë energji dhe ushtarakët detyrimisht do të kenë humbje peshe. Për këtë arsye, pesha duhet kontrolluar herë pas here, me qëllim që të mos përbëjë shqetësim. Humbja e peshës ndikon në lodhjen e shpejtë, humbjen e fuqisë dhe ndryshimet psikologjike, të cilat varfërojnë kapacitetet mendore dhe si rrjedhim, vendimmarrjen e drejtë gjatë luftimit.

Operacionet në mot të ftohtë

Për të fituar në mot të ftohtë, ushtarakët duhet të tejkalojnë edhe një armik më shumë: ambientin me temperatura të ulta tepër ekstreme. Kjo nënkupton mbrojtjen nga hipotermia dhe morthi. Nëse këto sëmundje përparojnë më tej, ato mund të shndërrohen deri vdekjeprurëse për ushtarakët, sidomos hipotermia, si dhe ulin aftësinë luftarake të repartit/njesisë në një mot të tillë. Raste të tilla të vdekjes së FS gjatë operacioneve kemi dhe nga reparti më elitë i botës në atë kohë, SAS-i anglez, operatorë të cilit gjatë kryerjes së detyrave për gjetjen e vendndodhjeve të raketave irakene Skud⁵⁶ të Sadam Hyseinit, gjetën vdekjen nga Hipotermia, ose të FS pakistaneze të cilat dhe pse të stërvitur për kryerjen e operacioneve në lartësi të mëdha gjetën vdekjen nga i ftohti në vitin 2009-2010 gjatë konfliktit në Kashmir, konflikt i cili ka kushtuar humbjen e jetëve të qindrave luftëtarëve pakistanezë dhe Indianë nga i ftohti (Rayan, 2005, 78).

Katër kërkesat bazë për mbijetesën në ambiente të ftohta janë: ngrohtësia, ushqimi, uji dhe streha.

Sistemi i veshjeve për mot të ftohtë

Liderët duhet të kuptojnë parimet e dizenjimit të sistemit të veshjeve për mot të ftohtë: izolimin, shtresat dhe ventilimin.

- Për herë të parë në historinë e ushtrisë shqiptare në vitin 2011, pas kthimit nga misioni “Eagle-1” pas shumë kërkesave nga Afganistani dhe kërkesave në vazhdimësi nga ana e MM (Zoti Armen Imami) dhe e SHSHP (Gjeneral Xhemal Gjunksi) të asaj kohe, na u mundësua futja në normë dhe në TOP të BFS, kompletimi me sistemin e veshjeve me shtatë shtresa për të gjithë personat të cilët shkonin në mision luftarak në Afganistan, kompletim i cili ndikoi drejtëpërdrejtë në përmirësimin e kushteve të shërbimit dhe të jetesës në operacion.
- Izolimi lejon krijimin e një mikroklike rreth trupit nëpërmjet së cilës mund të mbahet nën kontroll apo rregullohet sasia e nxehtësisë së trupit të individit që humbet në ambient. Duke ndryshuar sasinë e izolimit, një operator, mund të rregullojë sasinë e humbur të nxehtësisë apo atë që mbetet.
- Shumë shtresa veshjesh mundësojnë më shumë izolim dhe fleksibilitet, sesa një veshje e trashë, edhe nëse trashësia e kësaj veshjeje është e njëjtë me trashësinë e disa veshjeve të marra së bashku. Duke shtuar ose hequr shtresa të veshjeve (izolimit), operatori mund të rregullojë sasinë e humbur të nxehtësisë apo atë që mbetet.
- Ventilimi i ndihmon të mbajnë një mikroklimë të rehatshme rreth trupit, si dhe të kontrollojë temperaturën e trupit. Nëpërmjet ventilimit, operatori mund të lëshojë nxehtësinë e tepërt dhe të minimizojë djersitjen, e cila duke avulluar më vonë, mund të ulë temperaturën e trupit.

Ka katër këshilla që duhen aplikuar dhe që zbatojnë parimet e sistemit të veshjeve për mot të ftohtë:

- **Mbaji pastër rrobat.** Pislëku dhe ndotja, bllokojnë hapësirat ajrore në veshje dhe reduktojnë efektet izoluese të tyre. Veshjet e pista janë veshje të ftohta.
- **Evito mbi nxehjen.** Përzgjidh veshjet që janë të nevojshme për të qenë komfort ose edhe pak freskët. Liderët duhet të sigurohen që ushtarakët e tyre nuk janë veshur shumë trashë për punën që do të kryejnë.
- **Mbaj veshje të bollshme.** Të gjitha pjesët e uniformës për mot të ftohtë janë të përmasave që lejojnë veshjen e një numri të caktuar veshjesh të brendshme. Kjo nënkupton për shembull, që xhaketa mund të duket shumë e madhe kur vishet pa një numër të caktuar veshjesh të brendshme. Nëse uniforma nuk është e bollshme izolimi do të reduktohet në mënyrë thelbësore.

- **Mbaj veshjet të thata.** Është tepër e rëndësishme që të gjitha veshjet e brendshme të jenë të thata, sepse veshjet e lagura lejojnë që të largohet nxehtësia trupore, duke prishur mikroklimën e krijuar rreth trupit dhe e bëjnë të vështirë të rregullohet temperatura e trupit. Lagështira hyn në veshje edhe nga dëbora apo ngricat që depërtojnë nga jashtë ose nga djersitja. Liderët duhet të sigurohen që ushtarakët të shkundin dëborën dhe copat e akujve nga veshjet e tyre, përpara se të hyjnë në ambiente apo mjete të ngrohta.

Veprimet mbi mjete të blinduara

Operacionet në Afganistan kryesisht kryen mbi mjete. Ato janë të rrezikshme veçanërisht për arsyen se numri më i madh i të vrarëve rreth 90%, ka ndodhur për shkak të MSHI-ve ose minave surprizë, të cilat vendosen nga Talebanët. Arsye tjetër është dhe terreni shumë i vështirë me relief ekstrem dhe me rrugë të limituara për mjetet. Që në momentin e parë që jemi dislokuar në Prill të vitit 2010, kaluam programin e stërvitjes se si të vepronim kur makina rrëzohej, shpërthente, shkatërrohej dhe se si i duhej dhënë ndihma e parë shokëve të makinave të tjera. Ushtarakët që kanë vepruar dhe kryejnë detyra në Afganistan, duhet të jenë të vetëdijshëm se përdorimi i rripave të sigurimit dhe sistemit të mbajtjes së armëve është shumë i rëndësishëm për sigurinë e tyre. Një ushtarak i siguarur dhe i lidhur me rrip sigurimi, mund t'i shpëtojë një përmbysjeje të mundshme të mjetit. Komandantët e nënrepartëve duhet të sigurojnë mbrojtjen dhe sigurimin e efektivit në të gjitha aspektet gjatë operacioneve mbi mjete.

Fatkeqësisht efektivat e misionit “Eagle-1” ishin të vetmet trupa të ISAF-it të cilat vepruan për rreth 7 muaj, mbi mjete krejtësisht të pablinduara nga poshtë “Homwee”, shtuar kësaj dhe efektivat e “Eagle-2” vetëm në muajin e parë, por megjithë 19.779 km e përshkuara gjatë kryerjes së detyrave ngjatë misionit, fatmirësisht nuk hasëm asnjë MSHI, gjë e cila do të kishte sjellë vdekjen e menjëherëshme të të gjithë efektivit (Kontigjentet e FARSH në Afganistan, 2011, 65-67).

Operacione të tilla janë kritike dhe kërkojnë planëzim dhe zhvillim të saktë të patrullimeve dhe operacioneve me mjete. Çdo operator, që lëviz apo largohet nga një zonë e sigurt, duhet të jetë i përgatitur për operacionet e kundërgoditjes, të shpëtimit dhe të evakuimit, duhet të njohë me detaje të gjithë elementët shtesë që ka në dispozicion, ku janë të vendosur dhe si të kontaktojnë me ta.⁵⁹ Të jenë në gjendje që brenda një kohe

të shkurtër të thërrasë mbështetje nga ajri (CAS) dhe evakuim mjekësor (MEDEVAC). Gjatë kohës së misionit “Eagle-1-7” u punuan dhe u ndërtuan procedura standarte (SOP) për detyrat e mëposhtme.

1. Përgatitja për detyrë për operacione me kohë të gjatë.
2. Reagimi ndaj pritave të ndryshme dhe zjarrit me armë të lehta.
3. Reagimi ndaj pritës së afërt dhe dalja prej saj.
4. Reagimi ndaj pritës së largët.
5. Reagimi ndaj zjarrit indirekt.
6. Shkëputja e kontaktit dhe thirrja e CAS dhe MEDEVAC-ut.
7. Zbritja nga mjetet dhe zhvillimi e sigurimi i KLE.
8. Siguria në vendndalesë dhe gjatë kontrollit të shtëpive.
9. Kryerja e operacioneve speciale në male.
10. Dhënia e ndihmës së shpejtë në fushëbetejë.
11. Kryerja e operacioneve të kërkimit në shpella.
12. Veprimet për shoqërim personalitetesh të larta në zona lufte.
13. Stërvitje e ushtrisë dhe policisë Afgane.
14. Kryerja e detyrave për zbulim special në thellësi të zonës së armikut me pajisje të fundit të zbulimit dhe ngritja e rrjeteve të Inteligjencës.
15. Përdorimi i teknikave të fundit të përdorimit të eksplozivave dhe ç’aktivizimin e MSHI-ve, etj.

Reagimi ndaj mjeteve shpërthyes të improvizuara

Gjatë lëvizjes në këmbë apo me mjete, patrulla duhet të kryejë këto veprime:

1. Patrulla reagon ndaj mjeteve shpërthyes të improvizuara (MSHI), të njohura ose të dyshuara përpara se të shpërthejë, duke përdorur metodën e 5 C-ve: identifikoj (*check*), konfirmoj (*confirm*), pastro zonën (*clear*), krijo një kordon sigurie (*cordon*), kontrollo situatën (*sitcon*) (US Army Asymmetric Warfare Group, 2011, 3-11).
2. Ndërkohë që mban një distancë sigurie dhe një ruajtje 360°, grupi special konfirmon prezencën e MSHI-ve, duke përdorur mjete zbuluese që kanë në dispozicion, për ndonjë pjesë të dukshme të pajisjes shpërthyes si tela, antena

ose fije detonatori:

- a. Vëzhgojnë nga një distancë e sigurt.
- b. Vëzhgojnë zonën përreth për aktivitete të dyshimta.
3. Grupi special pastron zonën duke larguar nga personat civilë duke i lëvizur ata në zona të sigurta larg për t'i mbrojtur nga ndonjë pajisje e dytë që mund të gjendet në zonë.
4. Grupi special raporton për pajisjen e gjendur në njësitë më lart.
5. N/reparti krijon një kordon sigurie në zonë, largon civilët nga zona e rrezikut dhe siguron që mos të kalojë njeri në zonën e rrezikshme.
 - a. Operatorët i drejtojnë njerëzit larg zonës në një rreze prej 300 m.
 - b. Operatorët gjejnë dhe pastrojnë vendin, ku do ngrihet qendra e kontrollit të incidentit.
 - c. Operatorët zënë pozicion dhe kontrollojnë vazhdimisht zonën.
6. Grupi special kontrollon zonën brenda kordonit duke lejuar vetëm personat e autorizuar të hyjnë në këtë zonë.
7. N/reparti vazhdimisht kontrollon zonën për aktivitete të dyshimta.
 - a. Identifikon vëzhgimin e mundshëm të armikut ose mos kemi ndonjë pritë të ngritur të mundshme.
 - b. Pasi të jenë kryer këto veprime luftarake, jepet ndihma e parë për rastet e plagosjeve dhe bëhet evakuimi i të plagosurve apo i të rënëve në fushëbetejë.
 - c. E mban pajisjen shpërthyesë nën vëzhgim që të mos ketë ndërhyrje në të.

E shpërthen atë nga distanca dhe bën kontrollin e shpërthimit në fund, për të parë nëse pajisja është jashtë përdorimit.

Përfundime

Grupet speciale që operojnë në Afganistan janë subjekt i kontakteve konstante me forcat e kundërshtarit. Nëse zhvillohen operacione nga një Bazë e Përparuar Operacionale, në një fshat ose dhe gjatë lëvizjes, grupet speciale, si në rastin e kontingjenteve tona, duhet të jenë të gatshme për të rënë në kontakt, për t'u angazhuar në luftime, për të bllokuar e asgjësuar elementë Talebanë të rrezikshëm.

Siç është theksuar dhe në Doktrinën e FS të NATO-s, SHBA-së dhe të FOS

të Shqipërisë të botuar nga SHP i FA në vitin 2013, FS janë krijuar për të kryer nëntë misione kryesore të operacioneve speciale.

Një lider duhet të drejtojë në fushëbetejës për të parë, komunikuar dhe drejtuar vartësit e tij duke fituar një kuptim më të mirë të kushteve në të cilat ata operojnë. Prezenca e liderit (komandantit) në operacionet luftarake speciale, motivon moralisht ushtarakët në mision. Kjo rrit besimin që vartësit kanë te liderët e tyre dhe gjejnë motivimin e duhur për ta realizuar me sa më shumë sukses detyrat e ngarkuara. Gjetja e kohës për të kryer qarkullimin në fushëbetejë, drejtuar dhe komanduar sa më shumë që të jetë e mundur operacione të tilla do të jetë sfidë.

Misionet apo detyrat e tejzgjatura nuk krijojnë mundësi për argëtim, në shumicën e rasteve krijojnë një ndjenjë sigurie false tek njësitë apo operatorët gjatë misionit. Kjo lloj ndjenje shkaktohet nga disa shkaqe, por në thelb vetëkënaqësia mund të përkufizohet si ndjenjë vetëbesimi apo sigurie e pajustificueshme, pasi anashkalohen apo neglizhohen mangësi dhe rreziqe të cilat në pamje të parë nuk konsiderohen si të tilla. Kjo paraqet një rrezik të madh, pasi operatorët në mision, humbin fokusin dhe përqëndrimin dhe ekspozohen ndaj rrezikut të papritur i cili mund të ketë pajoja të rënda për individin ose për njësinë pjesë e së cilës ai është.

Një lider duhet të komunikojë efektivisht me vartësit e tij, të jetojë me to dhe t'i dëgjojë me kujdes, për t'u siguruar që qëllimi dhe misioni janë kuptuar drejt. Një lider duhet të jetë kompetent me operatorët e tij. Ai duhet të tregojë e të performojë në maksimum në mënyrën e sjelljes se çfarë ai pret nga vartësit e tij. Ai duhet të përcaktojë se cili është pozicioni më i mirë i komandimit dhe personave në detyrë dhe vendosjen e tij atje ku duhet. Prezenca e tij në detyra, sipas meje e rrit ndjeshëm moralin e vartësve të tij, por në të njëjtën mënyrë bën që të rritet së tepërmi siguria në operacion, pasi eksperiencia e një lideri të suksesshëm ndikon ndjeshëm në mos bërjen e gabimeve.

Historia e FS në mbarë botën ka dëshmuar se sa më e vështirë dhe sa më realiste me zonën ku do të operohet të jetë stërvitja që bëhet, aq më të përgatitur, vetëbesues dhe rezistues ndaj streseve të luftës do të jenë operatorët e FS. Një stërvitje e përafërt me realitetin apo ambientin, ku njësia speciale do të dislokohej, do të krijojë një ndjenjë vetëbesimi mbi aftësitë personale të çdo pjesëtari të FS. Në të njëjtën kohë kjo do të rrisë edhe besimin që vartësit kanë mbi eprorët dhe liderët e tyre.

Liderët ushtarakë të FS duhet të kuptojnë se rreziku dhe frika do të jenë gjithmonë pjesë e punës së tyre, sidomos në angazhimet dhe misionet luftarake jashtë

vendit. Metoda më e mirë për të minimizuar frikën nuk është mohimi i efekteve të saj, por t'i njohësh e t'i pranosh ato, si dhe të përballesh drejtpërdrejt me to. Frika minimizohet ose kapërcehet duke kuptuar situatën dhe duke vepruar me largpamësi për t'u përballur me të.

Situata më e vështirë për një lider në mision është humbja e jetës së një vartësi ose disave prej tyre gjatë një detyre operacionale. Kjo vështirësi është një vështirësi e dyfishtë. Fillimisht, vështirësia e parë gjendet në faktin nëse lideri i drejtpërdrejtë është në gjendje të menaxhojë situatën, nëse ka humbje jete për të zvogëluar mundësitë që pjesëtarët e tjerë të dëmtohen apo vriten për shkak të kaosit, rrëmujës apo emergjencës së krijuar.

Përshtatja është një pjesë themelore e profesionit të ushtarakut dhe operacioneve ushtarake. Në të njëjtën kohë, përshtatja duhet të balancohet me kërkesat për të stërvitur trupat në përshtatje me pajisjen e forcave, në mënyrë që të ruhet përshtatja dhe rreziku që vjen si pasojë, në nivele që kanë mundësi të menaxhohen.

Operacionet e shumta, të njëkohshme dhe në shkallë të gjerë që u ekzekutuan në mjedise dinamike, kërkuan integrimin e FS shqiptare dhe Forcave Konvencionale amerikane, duke krijuar efektin e shumëfishimit të forcës për të dy njësitë. Marrëdhënia ndërmjet operatorëve të FS shqiptare dhe Forcave Konvencionale amerikane u bë shumë e ngushtë me kalimin e kohës.

Siç e kemi theksuar dhe në kapitullin e katërt të këtij disertacioni, misioni FID bën fjalë për pjesëmarrjen e një qeverie me anë të agjencive civile apo ekupeve ushtarake të efektivëve të FOS shqiptare në programe trajnimi të ndërmarra nga qeveria jonë, për të mbrojtur dhe ndihmuar shoqërinë e saj nga përmbysja, moszbatimi i ligjit dhe kryengritja.

Kryerja me sukses e operacioneve speciale në Afganistan, kundër Talebanëve dhe të grupeve terroriste, qëndron në aftësimin e stërvitjes individuale dhe të taktikave të njësive të vogla, të cilat janë të specializuara në disa lloje misionesh dhe detyrash, luftës jo konvencionale, kontrollit të zonave sensitive dhe grumbullimin e evidencave të aplikuara në mënyrë të adoptuar, të improvizuar, të përshtatur dhe me besim në vetvete.

Këto misione kërkojnë armatim të kalibrave të ndryshme, precizionit të lartë, manovrueshmëri dhe fuqi të madhe zjarri, asgjësim nga distanca të mëdha pa u dekonspiruar, (të pajisura me silenciator), dylbi nate, taktike dhe infrared.

Në varësi të misionit apo detyrës, grupeve speciale u caktohet armatim

individual dhe organik. Kjo do të thotë që për një detyrë të caktuar, një operator do marrë me vete apo do të përdorë një lloj arme dhe për një detyrë tjetër, një lloj arme tjetër që i përgjigjet atij misioni. Këto rregulla duhet të jenë të përcaktuara në procedurat standarde të veprimit dhe saktësohen në procesin e planëzimit të detyrës nga vetë grupet speciale, ku një nga hapat më vete është zgjedhja dhe caktimi i armatimit për detyrë.

Operacionet speciale shpesh herë kryhen në distanca të mëdha nga bazat e tyre, gjë që kërkon sisteme të sofistikuar dhe të sigurta të komunikimit dhe mjete për infiltrimin, mbështetjen dhe eksfiltrimin (daljen) për t'u kthyer nga zonat e ndjeshme të armikut me rëndësi të madhe politike dhe ushtarake.

Por misioni mund të zgjasë 6-12 muaj, kohë kjo që nevojitet për dorëzimin dhe marrjen e detyrave ndërmjet kontingjenteve dorëzuese dhe marrëse (periudha 2-3 javore e familjarizimit), personelit nuk u bëhet sigurimi i jetës, gjë e cila sipas gjykitimit tim duhet të korrigjohet urgjentisht dhe të jenë të siguar të gjithë personat të cilët janë të dislokuar në çdo moment.

Krahas të gjithë TTP-ve të strukturave terroriste, Talebanëve dhe armëve që ata përdorin kundër trupave tona, në operacionet në Afganistan sipas të gjitha statistikave, dëmet më të mëdha në njerëz dhe teknikë vijnë nga përdorimi i KMSHI-ve.

Rebelët përdorin zonat e suksesshme të mëparshme për sulmet me MSHI dhe pritrat. Po të studiosh me kujdes vëndet që kanë sjellë humbjen më të madhe të forcave dhe mjeteve të koalicionit në Afganistan, janë vëndet në të cilat janë sulmuar më shumë ushtria sovjetike gjatë konfliktit të gjatë të viteve 1979-1989 në Afganistan.

Stërvitja para daljes në detyrë gjykoj që është një faktor shumë i rëndësishëm për pritjen e aftësive të efektivit për të përballuar operacionin luftarak (betejën). Stërvitja e mirë para daljes në detyrë e ndihmon efektivin tuaj për të ripërsëritur detyrimet e sejcilit në rast se..... në postin e tij luftarak.

Së pari çdo person i cili do të marrë pjesë në kryerjen e kontrollit të shpellave në mision, duhet të ketë mbaruar kursin 2 javor të luftës në shpella që bëhet në BFS. Përveç kësaj ai duhet të ketë stërvitje të vazhdueshme në këtë drejtim duke ndjekur të gjithë stërvitjen para dislokuese që bëhet para nisjes në mision.

Kryerja e operacioneve speciale në terrene malore dhe me kohë të gjatë, kërkon një përgatitje të lartë fizike, e cila në repartet FOS është një proces i vazhdueshëm dhe i përditshëm, por jo vetëm kaq, kërkon një planizim të hollësishëm të njohjes, gatishmërisë dhe të pasjisjeve që mundësojnë realizimin e këtyre operacioneve.

KAPITULLI VII

FORCAT SPECIALE - FORMACIONE PËRHERË NË VETËZHVILLIM

7.1. Forcat Speciale nën një perspektivë të re - Koncepti i ri Strategjik i NATO-s

E tashmja dhe e ardhmja e ambientit të sigurisë dhe këndvështrimi i NATO-s për Forcat e Operacioneve Speciale (FOS). Koncepti i ri strategjik i NATO-s

Eksperienca e viteve të fundit në Afganistan, Irak dhe Siri përforcon të vërtetën se lufta po ndryshon nga dita në ditë. Terroristët, fanatikët dhe fundamentalistët në Lindjen e Mesme, duke përdorur teknika fleksibël sulmi, stërvitore dhe rekrutimi të cilat përshkruhen në këtë libër janë adaptuar dhe kanë adaptuar një metodë lufte e cila mundohet të evitojë superioritetin teknik dhe teknologjik të Perëndimit, duke na u kundërvënë me taktika të cilat përdorin mashtrimin, terrorin të përziera me durimin dhe një dëshirë të madhe për të vdekur. Kjo qasje i lejon më të dobët që të përballet me më të fortin dhe që po tregon se është efikase kundër ushtrive tona të NATO-s.

Terrorizmi është djallëzor. Për të fituar një luftë globale mbi Terrorin, Amerika, NATO duhet fillimisht të llogarisë mirë çdo kundërpërgjigje të sajën. Nëse ushtarakët projektojnë shumë forcë, thjesht do t'i fryjnë më shumë "zjarrit". Një mision i tillë (kundër ISIS, al-Nusras, al-Qaeda, Boko Haram-it, Al-Shabaab-it, etj) krijon një problem të vërtetë për Ushtrinë dhe Marinsat Amerikanë. Ata zakonisht kanë drejtuar një fuqi zjarri shumë të madhe kundër armikut dhe pikave të tij të forta. Në gjuhën e përditshme të zhvillimit taktik ata kanë qenë duke zhvilluar Luftën e Gjeneratës së II-të. Gjenerata e III-të e luftës, përfshin anashkalimin e pikave të forta të armikut në mënyrë që thjesht të shkohet drejt qendrës së tij të gravitetit (shtabeve, komandave, depove të furnizimit, aerodromeve, armëve kundërajrore, etj). Me struktura mw adekuate tw forcave speciale, agjensive tw inteligjencws, stërvitje më realiste, me zbulim elektronik dhe bomba të zgjuara, NATO thjesht ka adoptuar një version me teknologji më të avancuar të versionit të Gjeneratës së II-të të Luftimit. Ndërsa kundërshtarët e

saj, kanë dalë me një lloj luftimi, i cili shfrytëzon ngurtësinë e qasjes burokratike nga lart-poshtë. E quajtur Lufta e Gjeneratës së IV-rt, kjo formë e re konflikti kryhet në mënyrë të menjëhershme në zonat e luftimit, taktikat e saj, politikë, media, ekonomi, infrastrukturë, fenë dhe në Psikologji. Ata të cilët do të përpiqeshin ti kundërviheshin Luftës së Gjeneratës së IV-rt me një kundërpërgjigje të Luftës së Gjeneratës së II-të, thjesht do ti hapnin vetes një gropë më të thellë, duke copëtuar në mënyrë të vazhdueshme si infrastrukturën vendore dhe mbështetjen nga popullsia vendase (Poole, 2009, xv).

A. Bazuar në të gjitha këndvështrimet e institucioneve të sigurisë dhe mbrojtjes në të gjithë botën, trendin e sotëm në të gjitha shtetet anëtare të NATO-s, dalim në konkluzionin se ambienti i sigurisë cilësohet si “progresivisht kompleks dhe i paparashikueshëm”, ku në të ardhmen kërcënime të çrregullta “shumë më të ndryshme, më pak të dukshme e të parashikueshme” krijojnë një gjendje konflikti me nivel të ulët por të vazhdueshëm. Një grup i zgjedhur zyrtarësh të mbrojtjes kanë kapur esencën e këtij ambienti të pritshëm të sigurisë në publikimin e tyre të titulluar *“ToWards a Grand Strategy for an Uncertain World-Renewing Transatlantic Partners”*.

Në këtë publikim citohet: *“Duke jetuar në një situatë pasigurie e të konfrontuar me një gamë të gjerë rreziqesh e kërcënimesh shumëfytërëshe e shumëdimensionale, duhet të jemi të përgatitur të reagojmë ndaj të papriturave në një kohë shumë të shkurtër dhe njëkohësisht të punojmë më shumë për të parandaluar emergjencën e konfrontimeve të reja”* (Renewing Transatlantic Partners, 2004).

B. Udhëzimi Politik i NATO-s (*Comprehensive Political Guidance, Latvia, Riga*) parashtrohet pritshmëritë që vijojnë për të ardhmen: “Ky ambient vazhdon të ndryshojë; ai është dhe do të jetë kompleks e global dhe subjekt i zhvillimeve të paparashikueshme në të ardhmen. Një shqetësim tjetër i NATO-s është terrorizmi, dëmi e pasiguria që ngjallin akte të tilla”.

Për këtë ambient strategjik, NATO ka identifikuar një numër fushash e kapacitetesh në mënyrë që të rrisë aftësinë e saj për t’u përballuar me këto sfida. Bazuar në kontekstin e mësipërm, FOS janë identifikuar si një nga kapacitetet e NATO-s më të përshtatshme për të përmbushur këto nevoja. Një nga kapacitetet e cilësuara nga NATO është: *“...aftësia për të përshtatur shpejt dhe me efektivitet qëndrueshmërinë e forcës dhe përgjigjet ushtarake me rrethanat e paparashikueshme. Kjo kërkon një aftësi*

efektive për të analizuar ambientin dhe parashikuar kërkesat e mundshme, një nivel të lartë gatishmërie për forcat tona dhe fleksibilitetin e nevojshëm për t'iu përgjigjur çdo ndryshimi të mundshëm të kërkesave” (NATO - CPG, 2006). Një shqetësim tjetër i NATO-s është terrorizmi dhe dëmi e pasiguria që ngjallin akte të tilla.

Në të gjithë kontekstin e mësipërm kuptohet qartë se FOS janë të përshtatshme për të përmbushur këto nevoja, pasi ato janë të formuara në grupe të vetëmbështetura, që ofrojnë një forcë maksimalisht fleksibël e aftë për të vepruar në çdo lloj skenari të ndryshueshëm. Një fokus i veçantë i NATO-s është parashikimi dhe vlerësimi i kërcënimeve, rreziqeve dhe sfidave. Kjo kërkesë përputhet plotësisht me një nga detyrat bazë të FS, konkretisht, me “zbulimin dhe vëzhgimin special”, ku FS mund të sigurojnë identifikim dhe vlerësim të hershëm të një krize apo vlerësim kërcënimi, si pjesë e aktiviteteve angazhuese në kohë paqeje si dhe vlerësim objektivash gjatë operacioneve të mëdha luftarake (NATO - AJDSO, Draft, 2009). Në rrezën e operacioneve ushtarake, FOS i ofrojnë vendimmarrësve më të lartë sidomos atyre politikë “ndjeshmërinë e prekjes së mollëzave të gishtave”, duke i informuar mbi vendimet e tyre strategjike apo operacionale.

NATO e ka kuptuar rëndësinë e FOS në arritjen e suksesit në operacione dhe, po t'i referohemi ngritjes dhe funksionimit/transformimit me një shpejtësi të pashembullt të Komandës së FS të NATO-s (NSHQ), do të kuptojmë se cila është e ardhmja e FS për vendet e NATO-s. Gjithashtu, kemi kuptuar se nuk ekziston një rrugë e shkurtër për të krijuar FS në momentin që godet kriza, por ato zhvillohen dhe mbështeten rregullisht që në kohë paqeje.

Po të marrim parasysh aspektin ekonomik të ngritjes dhe funksionimit të FS, shumë shpejt do të arrinim në përfundimin se shpenzimet që kërkohen, janë shumë modeste, krahasuar me përfitimin që vjen nga mbajtja dhe mbështetja e këtyre forcave. Për analogji po marrim si krahasim koston e një avioni *Eurofighter-1*, e cila është 77 milion euro apo të një helikopteri NH-90, që është 16 milion euro. Një investim prej 13 milion euro do të kompletonte plotësisht një SOTG (*Special Operations Task Group*) prej 110 vetash, me të gjitha pajisjet e nevojshme si: armatimin, automjetet, ndërlidhjen, kompjuterët, mjetet e shikimit natën/ditën, në nivelin më të lartë të sotëm, etj.

Rëndësia e FOS në mbrojtjen kombëtare dhe kolektive

FOS “po luajnë një rol gjithnjë e më të rëndësishëm në mjedisin asimetrik dhe janë forca shumë të përshtatshme për të ndihmuar në bllokimin e kërcënimeve ndaj NATO-s siç janë format e shumta të Terrorizmit” (MC 437/1, 2006, 3).

Ndërkohë që kontributet e FOS në mbrojtjen kombëtare dhe atë kolektive nuk mund të shërbejnë si një zëvendësim për kërkesën për të ruajtur aftësinë për të aplikuar forcë ushtarake dërrmuese për të arritur qëllimet përfundimtare, FOS ofrojnë një alternativë ose strategji mbështetëse që me mjeshtëri sjell një seri goditjesh të fuqishme dhe decizive, kundër pikave kritike të përzgjedhura me kujdes. Kjo strategji mund të përdoret direkt ose indirekt për të arritur rezultate strategjike. FOS, në thelb, ofron aftësi asimetrike ofensive dhe mbrojtëse. Në këtë mënyrë, FOS u sigurojnë udhëheqësve politikë dhe ushtarakë të lartë, opsione me qëllim që ata të ruajnë lirinë e veprimit, ndërkohë që në të njëjtën kohë bëjnë ekonomizimin e forcës dhe angazhimin e nevojshëm të burimeve në dispozicion. E ashtuquajtura “*Letra e Bardhë në Mbrojtje*”, e publikuar së fundmi në Francë, në mënyrë të posaçme afirmoi rëndësinë jetike për të rritur një liri të tillë veprimi duke e deklaruar atë një nga bërthamat e strategjisë ushtarake të re të Francës.

Përdorimi i FOS në një strategji të tillë nuk është e kufizuar vetëm në pjesën e fundit të spektrit të konfliktit. Angazhimi i FOS mbetet i zbatueshëm në të gjithë gamën e operacioneve ushtarake: nga mbrojtja dhe diplomacia gjatë kohës së paqes, deri në zhvillimin e operacioneve luftarake të mëdha. Megjithatë, FOS zotërojnë aftësi unike për të kryer detyra sidomos në mjedise ku forcat konvencionale janë relativisht në një disavantazh strategjik apo operacional në kohë paqe, konflikti apo lufte. Mjediset aktuale dhe ato në të ardhmen, që priten të jenë të mbushur me pasiguri e paqartësi, janë pikërisht mjediset për të cilat FOS janë idealisht të përshtatshme.

Udhëzimi Gjithëpërfshirës Politik (CPG) i NATO-s u bën jehonë këtyre gjykimave të përbashkëta të së ardhmes: “Ky mjedis vazhdon të ndryshojë, ai është dhe do të jetë kompleks, global dhe subjekt i zhvillimeve të paparashikueshme” (LTG Frank Kisner, NSHQ CDR, SOF, Rome, 2012). FOS sigurojnë një instrument në thelb të shkathët e të përshtatshëm për këtë mjedis operacional të paqartë dhe dinamik, duke lejuar institucionet e mbrojtjes kombëtare dhe kolektive të ruajnë lirinë e veprimit, ndërsa bëjnë ekonomizim të forcës. Në mesin e këtij mje-

disi strategjik, NATO ka identifikuar një numër zonash aftësie, zona të synuara për përmirësim specifik për të rritur aftësinë e saj për t'u përballur me këto sfida.

Një nga aftësitë e dëshiruara që kërkohen nga NATO është:

“ ... aftësia për të përshtatur pozicionimin e forcave dhe përgjigjes ushtarake me shpejtësi dhe në mënyrë efektive ndaj rrethanave të paparashikuara. Kjo kërkon, *inter alia*, një kapacitet efektiv për të analizuar mjedisin, të parashikojë kërkesat e mundshme, një nivel i lartë i gatishmërisë për forcat tona, si dhe fleksibilitetin e nevojshëm për t'iu përgjigjur ndryshimeve të papritura në kërkesa” (LTG Frank Kisner, NSHQ CDR, SOF, Rome, 2012).

SOF janë të përshtatshme për të përmbushur këtë nevojë, ndërkohë që formohen grupe të vetëqëndrueshme, me një forcë jashtëzakonisht fleksibël, të aftë për të vepruar në skenare të paqarta dhe që ndryshojnë me shpejtësi. FOS janë forca të një gatishmërie të lartë, që mund të organizohen për detyrë menjëherë dhe të dislokohen me shpejtësi, për t'iu dhënë përgjigje të përshtatshme situatave të ndryshme që mund të krijohen. Një fushë e veçantë që NATO ka në fokus, ka të bëjë me aftësinë për të parashikuar dhe vlerësuar kërcënimet, rreziqet dhe sfidat.

Po në këtë mënyrë, Letra e Bardhë e Mbrojtjes Franceze dhe Sigurisë Kombëtare theksoi “njohurinë dhe pritshmërinë”, si një nga pesë funksionet themelore strategjike. Në një mjedis të pasigurt, aftësia për “pritshmëri strategjike” mund të ofrojë mundësinë për të parandaluar konfliktin në zhvillim dhe për t'iu përgjigjur me gatishmëri, nëse këto përpjekje dështojnë. Kjo aftësi (zbulimi special) është e natyrshme dhe detyrë funksionale për FOS të NATO-s. Këto forca mund të sigurojnë identifikim dhe vlerësim të hershëm të një krize apo kërcënimi, si pjesë e një aktiviteti angazhimi në kohë paqeje apo vlerësim objektiv gjatë operacioneve luftarake të mëdha. Përgjatë gamës së operacioneve ushtarake, FOS u sigurojnë vendimmarrësve të lartë “*finger-spitzengefühl*” në terren, “ndjeshmërinë në mollëzat e gishtave,” për t'i informuar mbi vendimet e tyre operacionale dhe strategjike. FOS rëndom dhe instinktivisht vëzhgojnë e vlerësojnë situatën lokale; pasi raportojnë këto vlerësime me shpejtësi, ndërsa pozicionohen për të ofruar opsione jokonvencionale për të zgjidhur situata të paqarta.

NATO-ja gjithnjë e më shumë po e njeh rëndësinë e “aftësisë për të penguar, ndaluar, ruajtur dhe për t'iu mbrojtur kundër terrorizmit”, në mënyrë që të kontribuojë

në mbrojtjen e popullatës, territorit, infrastrukturës kritike dhe forcave të Aleancës. Një implikim i qenësishëm i kësaj kërkeje, është aftësia për t'u përballur me këto kërcënime të mundshme përtej kufijve duke kryer operacione jashtë zone.

FOS ofrojnë një aftësi shumë të veçantë, të përshtatshme për t'u përballur me këtë sfidë, e cila është "Mbështetja Kundër Aktiviteteve Kërcënuese të Parregullta". Kundër-terrorizmi (CT) është një ombrellë kryesore e masave ofensive për uljen e cënueshmërisë së interesave të forcave aleate, forcave të tyre, individëve dhe zonave të ekspozuara ndaj terrorizmit. Operacionet kundër kryengritësve (COIN) janë operacione ushtarake, veprime politike, psikologjike dhe qytetare që merren për të mposhtur një kryengritje.

Kundërterrorizmi dhe COIN nuk janë misione ekskluzive për FOS të NATO-s, por ato në mënyrë efektive, mund të kryejnë operacione diplomatike, ekonomike, informative dhe ushtarake që aplikohen në një rol COIN-i.

Një kërcënim i parregullt, nga vetë natyra e tij, zakonisht do të përfshijë FOS të NATO-s duke kryer aktivitete kundërterroriste (CT) brenda operacioneve COIN përgjatë vazhdueshmërisë operacionale (LTG Frank Kisner, NSHQ CDR, SOF, 2011).

Koncepti i ri strategjik i NATO-s për FOS

Në Janar të vitit 2008, Qendra Koordinuese e Operacioneve Speciale (NSCC) të NATO-s ndërmori një studim të FOS të NATO-s, për shqyrtimin e prirjeve dhe praktikave më të mira në të gjithë komunitetin e Operacioneve Speciale. Studimi i publikuar në Dhjetor të vitit 2008 mblodhi një shumëllojshmëri të dhënash nga intervistat në komunitetin e Operacioneve Speciale, duke përfshirë edhe ato nga vendet jo evropiane, si dhe nga studimet e disa rasteve historike. Studimi kishte për qëllim grumbullimin e informacionit për të gjetur se cila ishte metoda më e mirë e përdorimit të FS në terrenet e Afganistanit, etj, pajisjet, teknikat dhe taktikat e tyre të luftimit, për të përfunduar esencën e atij informacioni dhe për të zhvilluar një grafi planifi mbi përgatitjen dhe dislokimin e tyre. Ideja ishte për të siguruar kështu një program të qartë i cili të ishte i përqëndruar në thelbin e produktit që të siguronte një FOS të shkathët dhe dinamik për NATO-n. Studimi kishte për qëllim të mblidhte informacion të gjerë mbi atë që FOS mund të ofronte më së miri në shkallë kombëtare, në mënyrë që të mundësonte zhvillimin e një aftësie të klasit botëror të

FOS për NATO-n nëpërmjet shkëmbimit të informacioneve, duke mos shkaktuar dështime gjatë operacioneve.

Si rezultat, konceptet që dolën nga kryerja e studimit fillestar të FOS të NATO-s, mbetën të shëndosha e të zbatueshme për FOS të NATO-s për afro katër vjet. Afërsisht katër vjet nga kryerja e studimit fillestar të FOS të NATO-s, konceptet që dolën, si rezultat mbeten të shëndosha, relevante e të zbatueshme për FOS të NATO-s. Në fakt, evolucioni brenda komunitetit të Operacioneve Speciale në katër vitet e fundit ka shërbyer për të përforcuar më tej gjetjet. Rastësisht gjatë atyre viteve, FOS kanë rritur praninë e tyre në ISAF me 600% (NATO, NSCC, Special Operations Forces Study, 2008).

FOS ndërkombëtare që operojnë në Afganistan janë të bashkuar nën urdhrat e një komandanti të vetëm, i cili raporton drejtpërdrejt tek komandanti i ISAF-it (COMISAF). Kjo komandë e vetme ka mundur një rritje dramatike në sinkronizim, ndarjen e inteligjencës së limituar të inteligjencës, mbikëqyrjes dhe zbulimit (ISR), aviacionit si dhe të sinergjisë mes njësive afgane, ndërsa vazhdonte ndërrimi i mandateve të NATO-s dhe të atyre kombëtare.

Një nga vëzhgimet më të rëndësishme të bëra në këtë disertacion, është nevoja për një entitet të fuqizuar me autoritetin e nevojshëm dhe me akses rutinor tek vendimmarrësit e lartë për të siguruar mbikëqyrje të komandës së Operacioneve Speciale dhe që s'bie ndesh me institucionet e mbrojtjes të kombeve të ndryshme (NATO, NSCC, Special Operations Forces Study, 2012). Një numër i madh mësimesh të nxjerra dhe në disa raste, dështimet katastrofike buronin nga mungesa e një orkestrimi afatgjatë dhe me kohë të plotë të FOS-it nga një njësi, element apo komandë e caktuar. Pra, është shumë e rëndësishme ta shikosh këtë “mësim të nxjerrë”, në formën e një detyrë organizative kombëtare.

Njësitë e FOS-it kërkojnë gjithashtu edhe një organizatë të veçantë të dedikuar për të ofruar administrim të arsyeshëm të Operacioneve të Bashkuara Speciale dhe FOS. Shumë vende e dinë se FOS kontribuojnë me aftësitë e specializuara për sigurinë kombëtare, paralel me aftësitë e shërbimeve të tjera ushtarake dhe kanë vendosur mekanizmat e duhura për të siguruar administrim të përshtatshëm dhe drejtim specifik për to... Përgjatë rrjedhës së këtij disertacioni, kam vënë re se përfaqësuesit e të gjitha kombet të

intervistuar, theksuan nevojën për njësi operacionesh speciale për të siguruar një administrim të kujdesshëm, autoritet dhe drejtim mbi të gjitha aspektet e operacioneve të bashkuara speciale dhe FOS (NATO, AJDSO, AJP, Draft, 2009, 1-2).

Përmes komunitetit FOS të Aleatëve të NATO-s dhe Partnerëve, ne vazhdojmë të shikojmë konfigurim kombëtar në rritje, që përforcon rëndësinë qendrore të këtij parimi me efekte shumë pozitive në koherencë, efektivitet dhe efikasitet të tyre.

Derisa studimi i FOS të NATO-s të përcaktojë disa konfigurime të mundshme për këtë organizatë, FOS që të ushtrojë kujdestari në bazë të modeleve të ndryshme kombëtare të hasur, mbetet e qartë se nuk ka asnjë formulë të saktë apo recetë që të jetë e zbatueshme në çdo komb.

Ndërsa eksploronin mbikëqyrësin optimal apo strukturën menaxhuese për operacionet e përbashkëta speciale dhe FOS, ekipet e studimit shqyrtuan modele të ndryshme organizative kombëtare dhe kanë konstatuar se asnjë model i vetëm nuk ishte i zbatueshëm në të gjitha vendet anëtare të NATO-s dhe atyre partnere. Një sygjërim të tillë një ekip i drejtuar nga vetë komandanti i NSHQ Gjeneral Lejtant Frank J Kisner zhvilloi dhe në komandën e FS shqiptare për një javë nga data 21-25 Maj në vitin 2011 në Zall-herr me një ekip prej 6 vetësh, duke dhënë dhe rekomandimet konkrete për zhvillimin e kësaj komande, por që fatkeqsisht nuk u zbatuan kurrë dhe sot e kësaj dite.

Megjithatë, të gjitha organizatat e tilla kombëtare duhet të përmbushin tre role të përbashkëta. Në nivelin strategjik, një organizatë të operacioneve speciale duhet t'i jepen kompetenca për të ushtruar masa koordinuese, mbikëqyrje dhe drejtim për të integruar elementët e ndryshëm të FOS-it; të këshillojë dhe informojë mbi përdorimin e përshtatshëm të tyre; të krijojnë një strategji të burimeve që lidh së bashku politikën, doktrinën, organizimin, stërvitjen, edukimin dhe të prokurimit për të ekzekutuar operacione me efektivitet në këtë fushë. Natyrisht, kapaciteti i FOS-it dhe niveli i ambicies të çdo kombi janë të ndryshëm dhe si rezultat, zgjidhje të përshtatura veçanërisht për çdo rrethanë unike janë të nevojshme. Megjithatë, ka prova se është e dobishme për kombet që të konsiderojnë më shumë “interesat kombëtare”, ndërsa vlerësojnë synimet e tyre për Organizimin për Detyrë të FOS. Çdo komb anëtar me FOS, duhet të

përcaktojnë se cila organizatë kombëtare e operacioneve speciale i përshtatet më të mirë kërkesave të saj kombëtare për FOS-in.

Ekipi i studimit vërejti një gamë organizatash kombëtare të operacioneve speciale, të kombeve anëtare ose jo të NATO-s, ku kapen praktikat më të mira për çdo fazë zhvillimi të FOS. Rezultati ishin tre modele nga të cilat vendet anëtare të NATO-s mund të zgjedhin në varësi të kërkesave të tyre kombëtare dhe të fazës së zhvillimit në të cilën ndodhet FOS-it e tyre: një Komandë Ushtarake Kombëtare (në nivel Force); Komponent Komandimi (nivel Brigade); ose një Njësi Ushtarake (nivel Regjimenti) (NATO, NSCC, Special Operations Forces Study, 2012).

Disa vëzhgime kyçe të FOS -it, të bëra në studimin e FOS-it të NATO-s, janë të rëndësishme për t'i nxjerrë në pah dhe për t'i përforcuar. E para është rëndësia qëndrore e besimit dhe themeli i marrëdhënieve të FOS -it të Aleatëve të NATO-s dhe atyre partnere.

“Si rezultat, suksesi i deritanishëm i FOS -it të NATO-s varet mbi marrëdhëniet personale të zhvilluara në komunitet. Pengesat burokratike, politikat dhe axhendat në përgjithësi janë vendosur mënyrë kur FOS punojnë së bashku në terren në nivel taktik, ku kërcënimi është i afërt dhe suksesi i misionit varet nga bashkëpunimi i ngushtë midis njëri-tjetrit. Kjo përpjekje bashkëpunuese dhe këto marrëdhënie duhet të përsëriten lart, mes të drejtuesve më të vjetër të FOS -it, për të forcuar dhe më tej rrjetin e familjes së FOS-it të NATO-s” (NATO, NSCC, Special Operations Forces Study, 2012, 13).

Ne vazhdojmë të shikojmë marrëdhëniet mes anëtarëve të Aleatëve të NATO-s dhe të Rrjetit Bashkëpunues të Partnerëve FOS si qendër të gravitetit. Në fakt, Aleanca ka theksuar rëndësinë e një Rrjeti Bashkëpunimi me një komunikatë të kohëve të fundit mbi zbatimin e “Iniciativës së Forcës së Lidhur - Rekomandimet për të rritur FOS –in”.

Këto marrëdhënie janë përforcuar dukshëm gjatë këtyre viteve të fundit nga përpjekjet e kombinuara në Afganistan në një shumëllojshmëri të ndërveprimeve në një mori disiplinash dhe zonash funksionale mes aleatëve të NATO-s dhe FOS partnere, që përfshijnë trajnim dhe edukim specifik të FOS, aviacion, mjekësi, inteligjencë

dhe masat kundër ADM. Një tjetër gjetje nga studimi i FOS-it të NATO-s, përfshin një rekomandim për të përforcuar marrëdhëniet e FOS përmes një ndërveprimi rutinë mes grupeve të ndryshme të FOS të NATO-s. Në mënyrë që të sigurojnë një kornizë për zhvillimin dhe rritjen e këtyre marrëdhënieve, *FOS të NATO-s duhet të lëvizin përtej marrëdhënieve bilaterale të rastit dhe ushtrimeve të mëdha ndërkombëtare*. Partneritetet e formalizuara mes të njëjësive të ndryshme të FOS të NATO-s janë të detyruara të grupojnë aftësi plotësuese për t'u trajnuar me një dividend të mëvonshëm në kuptimin e një gjenerimi force, rotacionet e Forcës Reaguese të NATO-s dhe operacionet jashtë zonës.

Partneritetet ad-hoc të rastit nuk mund të ndërtojnë nivelin e besimit dypalësh që është i nevojshëm për ndërveprim më të mirë në fushën e betejës. Partneritetet e rregulluara me kujdes të FOS të kombeve të ndryshme të NATO-s, të arritura me hulumtime adekuate, negocime dhe analizë, do të krijojnë një strukturë që të gjenerojë Task Forcën e Operacioneve Speciale (SOTG) që të përdoren nga ana e NATO-s (LTG Frank Kisner, NSHQ CDR, SOF, Mons, 2011).

Ne e kemi parë këtë të marrë formë, gjatë viteve të fundit me rrjetet emergjente të bashkëpunimit midis anëtarëve të NATO-s dhe Rrjetit Bashkëpunues Partner i Forcave të Operacioneve Speciale. Ata operojnë në mënyrë të vazhdueshme së bashku në Afganistan, me një sistem rotacioni, me të njëjtën njësi partnere afgane, ose sinergjie në rritje dhe ndërveprimi i zakonshëm midis komunitetit të Operacioneve të Speciale të Evropës Veriore. Në fakt, realizimi i këtij bashkëpunimi është gjithnjë një temë e rëndësishme diskutimi mes komandantëve, në mundësitë e mëdha për t'i siguruar NATO-s një Komponent Komande të Operacioneve Speciale (SOCC) të dislokueshëm, tek kërkimi përtej Afganistanit duke u fokusuar tek çështjet në rajon për një vëmendje dhe bashkëpunim më të madh të FOS-it.

Katër vjet pas përfundimit të këtij studimi, një ekzaminim gjeo-strategjik i mjedisit operacional vazhdon të vërtetojë vëzhgimin se “përbërësi kritik për të optimizuar FOS është një organizatë e operacioneve speciale kombëtare, e dedikuar që të sigurojë kujdestari koherente dhe afatgjatë, autoritet dhe drejtim mbi të gjitha aspektet e Operacioneve Speciale” (NATO, NSCC, Special Operations Forces Study, 2012).

Eksperiencia e vendeve anëtare të NATO-s në drejtim të Forcave Speciale

Të gjitha vendet anëtare të NATO-s kanë ngritur kapacitete SOTG (përveç nesh) dhe 7 prej tyre kanë SOCC më vete dhe për më tepër kryejnë operacione në interes të Komandës së FS në Afgansitan (ISAFSOF-it). Këto vende kanë adoptuar me shpejtësi rekomandimet e ekspertëve të NSHQ dhe për një periudhë shumë të shkurtër, kanë reformuar forcat e tyre speciale, si nga pikëpamja strukturore, ashtu dhe nga ajo e teknikës së pajisjeve, duke i sjellë në nivelin e kërkuar të ndërveprueshmërisë me njëri-tjetrin.

Në varësi të madhësisë së FS dhe eksperiencave kombëtare, vende të ndryshme të NATO-s i kanë modeluar ato në nivel komande (10 vende nga 16 të studiuara), ose në nivel komponenti (7 vende). E përbashkëta e të gjitha organizimeve strukturore të këtyre forcave është akses i tyre i drejtpërdrejtë tek lidershipi i lartë politik dhe ushtarak për komandim-kontrollin dhe drejtimin operacional. Një tipar tjetër i përbashkët është ekzistenca e një zyre përfaqësie e SOF në Shtabin e Përgjithshëm të Forcave të Armatosura. Kjo zyrë këshillon vendimmarrësit e niveleve të larta politiko-ushtarake për misione specifike me ndjeshmëri të lartë politike, si brenda dhe jashtë vendit.

7.2. Forcat Speciale nën reformën e Forcave të Armatosura, vendi dhe roli i tyre si prioritet

Politika e mbrojtjes në thelb ka mbrojtjen e interesave jetësore të vendit si: mbrojtjen e sovranitetit, të pavarësisë, të integritetit territorial, të rendit kushtetues dhe të jetës së qytetarëve shqiptarë. Ajo e realizon këtë nëpërmjet mbajtjes së Forcave të Armatosura dhe përdorimit të burimeve të vendit për mbrojtje.

Duke u nisur nga rreziqet dhe kërcënimet, politika e mbrojtjes përcakton si objektiva kryesore:

- Mbrojtjen e pavarësisë, e sovranitetit e të integritetit territorial të vendit, të jetës së qytetarëve tanë dhe ndihmesën për paqen e stabilitetin në rajon.
- Zhvillimin e kapaciteteve të mjaftueshme mbrojtëse për të mënjanuar një sulm të armatosur apo agresion ushtarak kundër Republikës së Shqipërisë, si dhe nxitjen e bashkëpunimit e të proceseve integruese.
- Rivendosjen e integritetit territorial, nëse preket, nëpërmjet krijimit të kushteve të përshtatshme për rimarrjen e territorit të kapur nga armiku.

Kapacitetet tona ushtarake duhet të sigurojnë forcën e mjaftueshme për mbrojtjen e vendit. Ato duhet të bindin çdo agresor të mundshëm se nuk është e leverdisshme të sulmohet Shqipërinë, pasi dëmet do të jenë më të mëdha se fitimet. Për të qenë sa më efikase dhe në mënyrë që të arrihen këto objektiva në kohë, janë ndërmarrë disa reforma dhe ristrukturime të analizuara për Forcat e Armatosura (Ligji 8571 dt. 27.01.2000, “Koncepti i Mbrojtjes”, pika 19).

Forcat Tokësore përbëhen nga tri kategori trupash: të luftimit, të mbështetjes së luftimit dhe të mbështetjes.

Në trupat e luftimit përfshihen: Forcat Speciale, Komandot, Këmbësoria, Këmbësoria e Mekanizuar dhe Batalioni Logjistik.

Në trupat e mbështetjes së luftimit përfshihen: Zbulimi, Artileria Kundërajrore, Artileria Fushore, Xhenio, Komunikimi, Policia Ushtarake dhe Mbrojtja nga Armët e Dëmtimit në Masë.

Në trupat e mbështetjes përfshihen: Transporti, Shëndetësia, Municionet, Personeli, Riparimet dhe Mirëmbajtja, Intendenca, Karburantet dhe shërbimet e tjera.

Kuptohet që prioriteti kryesor janë trupat e luftimit dhe konkretisht FS. FS të veçanta në llojin e tyre pasi vetë misioni i tyre është mjaft i veçantë dhe specifik. Në Forcat e Armatosura janë ndërmarrë një sërë reformash që synojnë rritjen e kapaciteteve dhe potencialeve të FS për të performuar në mënyrë sa më dinjitoze. Investimet duhet të synojnë në përfundimin e projekteve të nisura për modernizimin e BFS, të projektit të mbështetjes logjistike dhe vendosjes, përdorimit me efikasitet të investimeve të tjera të bëra në vite.

1. Bazuar në dokumentet e sigurisë e të mbrojtjes, pothuajse të të gjitha vendeve anëtare të NATO-s, theksohet se mjedisi i sotëm i sigurisë karakterizohet nga kërcënime të çrregullta “shumë më të ndryshme, më pak të dukshme dhe të paparashikueshme.” Për këtë ambient strategjik, NATO ka identifikuar një numër fushash e kapacitetesh për t’u përmirësuar në mënyrë që të rrisë aftësinë e saj për t’u përballuar me këto sfida. Një nga kapacitetet e cilësuara nga NATO për përballimin e këtyre kërcënimeve janë qartësisht FS. Nëse i referohemi ngritjes dhe funksionimit me shpejtësi të madhe të Komandës së FS të NATO-s, NSHQ dhe rolit që ajo po luan në operacionin e ISAF-it, do të kuptojmë se kush është e ardhmja e FOS për vendet e NATO-s.

2. Nëse i referohemi gjithashtu ndryshimeve strukturore që kanë pësuar FA të vendeve të NATO-s, do të shohim qartë një tendencë të dukshme në drejtim të fokusimit dhe investimit për rritjen e kapaciteteve të FOS. Reduktime të ndjeshme të njësive dhe të kapaciteteve për luftë konvencionale, Forcave Tokësore, Ajrore dhe Detare dhe ruajtje apo përmirësim i dukshëm i kapaciteteve për luftë jo konvencionale, FS dhe shërbimet sekrete kombëtare e ushtarake janë të parat në radhë. Shembuj në këtë drejtim na jep padyshim SHBA, Britania e Madhe, Franca, Spanja, Turqia, Gjermania, Italia, Polonia, Greqia, etj.

3. Po ashtu, tendenca e vendeve në rajon është po e tillë. Nëse shikojmë Turqinë, Kroacinë, Slloveninë, Sërbinë, FYROM-in, Greqinë, bile dhe Mali i Zi me një ushtri me vetëm 2000 vetë efektiv ka krijuar një Brigadë të FS, do të vërejmë mbajtjen e një kapaciteti të qenësishëm të FS brenda FA, me komanda deri me 3 yje, me një tendencë të dukshme në rritje në numër, të modernizimit dhe përmirësimeve cilësore të armatimeve, pajisjeve, komunikimit, zbulimit dhe transportit taktik.

4. Për më tepër, mësimet e nxjerra nga Afganistani, Iraku, Siria, etj kanë theksuar rëndësinë e të paturit gati të kapaciteteve të lehta, menjëherë të dislokueshme, shumë të stërvitura e të përgatitura për të përballuar luftën kundërkryengritëse (Lessons Learned Hand Book JALLC, 1, 2010). Më të suksesshme në këtë fushë dhe vitale për arritjen e suksesit në nivel strategjik janë cilësuar FOS. Mbështetur në këto vlerësime, unë gjykoj se mbajtja dhe zhvillimi me shpejtësi i një kapaciteti të FOS në FA Shqiptare është një domosdoshmëri e kohës. As më pak, as më shumë, do të doja të theksoja impaktin e lartë dhe “përfitim politik” që merr vendi ynë nga misionet “Eagle”, që FS Shqiptare po kryejnë me profesionalizmin më të lartë që prej 4 vjetësh, misione të cilat sot e kanë bërë ushtrinë shqiptare të vlerësohet me notat më të larta nga politikanët më të lartë të vendit dhe të huaj. Kjo është arritur me një investim minimal (në konceptin *Smart Defense*), në vend që të investohej me miliona Euro në “*Battle Group*” dhe ku nuk do të mund të merrnim këtë përfitim politik.

5. Ekziston një qasje e njëjtë në të gjitha FA të vendeve të NATO-s por edhe më gjerë, se natyra e sfidave, rreziqeve dhe e kërcënimeve të sotme, si “jo të zakonshme” dhe “jokonvencionale” është një detyrë ideale për FS. FS karakterizohen si një aset strategjik për shkak të aftësisë së tyre për të arritur objektiva strategjike, politike, ushtarake, psikologjike dhe informimi, që përfaqësojnë instrumentet themelore të fuqisë kombëtare (Mc Raven, 1995,1).

Domosdoshmëria e krijimit, mbajtjes dhe modernizimit të një kapaciteti të SOF realizohet nëpërmjet përcaktimit të saktë të vendit dhe rolit të tyre në një dokument strategjik dhe një strategjie kombëtare për FS. Hartimi i kësaj strategjie të tillë argumentohet me:

- Vetë natyrën e detyrave që zgjidhin FS dhe të taktikave dhe teknikave që ato përdorin për realizimin e tyre në interes të arritjes së objektivave/interesave kombëtare strategjike apo edhe të atyre në nivel operacional.
- Domosdoshmërinë e të paturit të një baze të fortë ligjore për përmbushjen e detyrave të tyre specifike si brenda dhe jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë.
- Përcaktimin qartë të misionit, detyrave dhe synimin për përdorimin dhe zhvillimin e këtij kapaciteti/aseti strategjik.

Kapacitetet e FS duhet të merren në konsideratë në zhvillimin e Strategjisë së Sigurisë Kombëtare dhe në Strategjinë Ushtarake.

FS i ofronë Këshillit të Lartë të Mbrojtjes Kombëtare një aset forcash të stërvitura e të pajisura në mënyrë të veçantë, të cilat mund të përshtaten lehtësisht për të ekzekutuar veprime në të gjithë zonën e operacionit dhe veprime që kërkojnë fshehtësi për të frenuar ose zgjidhur krizat e ndryshme (Demiraj, 2013). Në kohë paqe, FS mbështesin politikën e Sigurisë Kombëtare duke i ofruar kapacitet për të parandaluar ose ndaluar aktet e agresionit, ose akte kërcënimi terroriste që mund të pengojnë interesat Sociale, Politike, Ekonomike, Ushtarake dhe të Sigurisë.

Zinxhiri i komandimit duhet të sigurojë që FS të jenë të reflektuara në udhëzimet e Planeve të Mbrojtjes dhe dokumenteve të Strategjisë së Sigurisë Kombëtare. Kapacitetet e FS dhe shpërndarja e tyre duhet të jetë në Planin e Aftësive Strategjike Kombëtare. Shtabi i Përgjithshëm, në vartësi të situatave dhe terrenit ku veprohet, ndan burimet te komandantët e luftës, bazuar në armikun që kanë përpara, terrenin ku veprojnë, aftësitë ushtarake të njësive në terren, planet e luftës dhe buxhetin në dispozicion.

Të gjitha reformat dhe ristrukturimet që kanë bërë Forcat e Armatosura duhet të arrijnë mbajtjen e një force që në çdo kohë të jetë e gatshme të përmbushë misionin e saj kushtetues. Por gjatë këtyre reformave të thella dhe ristrukturimeve, Forcat e

Armatosura duhet të zbatojnë konceptin e mbrojtjes të NATO-s dhe të jenë të ndërveprueshme me strukturat e saj, duke mos e ulur shumë numrin e efektivave të FA dhe veçanërisht duke mos prekur, por përkundrazi shtuar numrin e FOS-it .

Politika e Mbrojtjes parashikon që NATO dhe vendet anëtare të saj do të jenë aleatë në zbatimin e konceptit të tyre të mbrojtjes dhe veprimet e tyre të jenë koherente dhe të zhvillohen paralelisht. Si pjesë e NATO-s, Forcat tona të Armatosura duhet t'i përmbahen konceptit të ri të mbrojtjes, të përmbushin detyrimet dhe të jenë pjesë e barabartë e zgjidhjes së detyrave të aleancës.

Duke parë kërcënimet e reja dhe mënyrën më efikase të reagimit ndaj këtyre kërcënimeve, është hartuar koncepti i ri strategjik i mbrojtjes së NATO-s. Zhvillimet e fundit të samitit të Çikagos për të ardhmen e NATO-s pas 2014 duhen marrë në konsideratë, pasi ato i dhanë një dimension të ri koncepteve dhe planeve të mbrojtjes.

Planet për të dorëzuar përgjegjësinë e plotë të sigurisë tek Afganët deri në fund të vitit 2014 mbeten prioritet. Afati i përfundimit të këtij tranzicioni është deri në fund të vitit 2014. Mendohet që misioni i tanishëm luftarak i ISAF-it do të përfundojë, por jo për FOS.

Që nga viti 2015, ai do të pasohet nga misioni i trajnimit, këshillimit dhe asistencës të udhëhequr nga NATO dhe ky nuk do të jetë një mision luftarak. Shqipëria do të vazhdojë të jetë një vend model përsa i përket realizimit të detyrimeve të Aleancës, duke vijuar kontributin e saj në operacionet e NATO-s me anë të një SOLTG-je ku FS për herë të parë do të jenë të integruara me forcat komando dhe CS dhe CSS nga FOS. Rezultati i reformave të ndërmarra në Forcat e Armatosura të Republikës së Shqipërisë ka bërë të mundur rritjen e kontributeve që vendi ynë jep në kuadër të Aleancës, gjë që reflektohet veçanërisht në kontributin tonë në teatrin e operacioneve në Afganistan. Pothuajse edhe pas 12 vitesh pjesëmarrje të SHBA dhe forcave të koalicionit në operacione luftarake, ruajtja e rezultateve të arritura, tërheqja e sigurt e trupave dhe reduktimi i tyre duke i kaluar pushtetin Afganeve, mbetet një çështje thelbësore për planet e Aleancës ndaj Afganistanit. Stërvitja e ushtrisë dhe e policisë Afgane shërben pikërisht për këtë synim (misioni FID). Shqipëria është angazhuar seriozisht përkrah trupave të Aleancës në këto misione trajnimi dhe luftarake. Misionet OMLT janë llojet e misioneve më të fundit në të cilat FARSH dhe BFS janë angazhuar si në trajnimin e ushtrisë Afgane, ashtu edhe në trajnimin e policisë Afgane në Qendrën e Stërvitjes së FS të Policisë (SPTC) në Wardak. Së fundi, po në këtë drejtim, FS

Shqiptare janë bërë pjesë e një misioni të ri. Krahas detyrave që ato kryejnë nëpërmjet kontingjenteve “Eagle”, tashmë janë angazhuar edhe me këtë detyrë të re.

Misioni i tyre është intensifikuar dhe konkretisht janë angazhuar me trajnimin e FS të Policisë Afgane. Kjo tregon një rritje kapacitetesh dhe aftësish për FS Shqiptare. Reformat e njëpasnjëshme, ristrukturimi dhe puna e BFS solli një dimension të ri në kontributin për ndërtimin e paqes dhe sigurisë në Afganistan, me dërgimin e FS për trajnimin, këshillimin dhe mbështetjen e FS të policisë Afgane.

Koncepti i ri strategjik i mbrojtjes së NATO-s ka sjellë mjaft risi dhe ndryshim konceptimesh për mënyrën e trajnimit të forcave, maksimizimin e përpjekjeve tek ato forca që sjellin më shumë efikasitet dhe që i përgjigjen më së miri mënyrës së re të kërcënimeve me të cilat përballet sot NATO. Një vend shumë të rëndësishëm në strategjinë e NATO-s, zë puna për rritjen e mëtejshme të kapaciteteve të FS si dhe për operacionet brilante që ato bëjnë në teatrin e luftimeve duke ndryshuar rezultatin në favorin tonë.

Duke parë këto ndryshime, edhe Forcat tona të Armatosura, nën mbështetjen e drejtpërdrejtë të MM dhe SHSHP, i kanë dhënë prioritet FS në investimet dhe angazhimet e tyre, për të patur një Forcë sa më kompetente dhe të aftë për të vepruar në të ardhmen si SOTG, përkrah aleatëve të aleancës. Misionet luftarake jashtë vendit janë sukses i jashtëzakonshëm për forcat tona. Performanca e FS në misionet luftarake gjatë këtyre viteve ka njohur një transformim rrënjësor, si për vetë FS dhe për FA duke sjellë eksperiencë, maturi dhe një rritje kapacitetesh të lakmueshme për çdo forcë konvencionale dhe jo konvencionale.

Vëmendje e veçantë i është kushtuar modernizimit dhe pajisjeve në mënyrë që të krijohen kapacitete standarde veprimi nga toka, deti dhe ajri për FS. Një vend të rëndësishëm zë edhe përgatitja e personelit të FOS në kurset brenda vendit dhe në vendet anëtare të NATO-s, duke patur parasysh mënyrën e funksionit FOS, detyrat që kryejnë dhe aftësisë apo fleksibilitetit që kanë, stërvitjeve të shumta vjetore që zhvillohen me FS të shteteve më të fuqishme të NATO-s. Reformat gjithashtu përshpejtojnë procesin dhe të ardhmen për FS për të vepruar si SOTG në të ardhmen e afërt, duke bërë hapin më të madh në historinë e saj. Prioritetet e mbrojtjes për vitet e fundit kanë qenë modernizimi i mëtejshëm i FS, pasi deri tani është bërë kompletimi vetëm i 40%

të TOP-it të BFS, duke i plotësuar ato me pajisje për operacione speciale në tokë, det dhe ajër. Këto kanë bërë që të vazhdojë të rritet më tej ndërveprueshmëria e BFS kjo e treguar në stërvitjet e përbashkëta me aleatët e FS të NATO-s dhe SHBA-së, misionet *Combat* dhe së fundi misionet trajnuese të FS Shqiptare dhe përfaqësitë në shtabet e FS në NSOCC-A në Kabul.


7.3. Rekomandime për zhvillimin e Forcave Speciale Shqiptare

Komanda e FS Shqiptare, bazuar në ekspertizën e grumbulluar në kurset e kryera në shkollat më të mira të NATO-s, SHBA, Gjermani, Turqi, etj stërvitjet e përbashkëta të intensifikuara vitet e fundit me njësitë më të mira të NATO-s, në eksperiencën e shkëlqyer të misioneve luftarake “Eagle”, në vlerësimet e rekomandimet e NSHQ, USSOCOM-it, SOCEUR për zhvillimin dhe strukturimin e FOS Shqiptare, si dhe në përvojën e vendeve të tjera të anëtarësuar në këtë strukturë, paraqet rekomandimet që unë gjykoj duhet të shërbejnë si “*Way a head*”, mbi të cilat duhet të zhvillohen FS Shqiptare:

1. Përcaktimi i plotë dhe përfundimtar i rolit dhe vendit të FS në dokumentet e Strategjisë të Sigurisë Kombëtare. Këto forca, duke qenë një **aset strategjik**, për shkak të veçorisë së përdorimit të taktikave dhe teknikave jo konvencionale për arritjen e objektivave në rëndësi të madhe politike, ushtarake, me rëndësi strategjike, duhet të kenë një përcaktim të qartë në dokumentet e strategjisë kombëtare. Kjo përbën bazën për hartimin e infrastrukturës ligjore të nevojshme për funksionimin dhe komandim-kontrollin e këtyre forcave. Në këtë kuadër, për FS Shqiptare nevojitet pikërisht përcaktimi i këtij roli në hierarkinë e dokumenteve të sigurisë si dhe një dokument më vete i nivelit strategjik (NATO, Special Operations Forces Study, 2012, 11).
2. Rishikimi i infrastrukturës ligjore që rregullon funksionimin e FOS, hartimi i doktrinës së FS (që është bërë tashmë) dhe ripërcaktimi i detajuar i misionit dhe detyrave që kryejnë FOS brenda dhe jashtë vendit, në përputhje me definicionet e strategjisë që do të hartohet për FS.
3. Zhvillimi i FS i orientuar drejt integritit dhe arritjes së ndërveprueshmërisë së plotë me ato të FS të NATO-s. Parësore është vendimarrja për krijimin e

kapaciteteve të një Task Force për Operacionet Speciale (SOTG) e cila që prej vitit 2014 ka ngelur në vend dhe nuk po investohet në atë drejtim. Ndërtimi i një kapaciteti SOTG, sot është një domosdoshmëri për 3 arsye: **Së pari**, prej tendencës së kapaciteteve të tilla që janë ndërtuar në të gjitha FOS të NATO-s; **së dyti**, ky kapacitet tashmë është ndërtuar si koncept dhe si detyrim që rrjedh prej dokumentit të ri **AJP-3.5, Allied Joint Doctrine for Special Operations**; **së treti**, pa një kapacitet të tillë është e pamundur që të marrim pjesë në operacionet e FS të NATO-s në Afganistan, në Irak, Siri apo në ndonjë konflikt të mundshëm.

4. Hartimi i një plani afatmesëm dhe afatgjatë të zhvillimit të FS, i ndarë në faza, me qëllim krijimin dhe deklarimin në NATO të SOTG si plotësisht operacionale (FOC) në fund të vitit 2016.
5. Rishikimi i strukturës së komandim-kontrollit dhe strukturës së FOS. Mbështetur në rekomandimet e NSHQ dhe eksperiencat e FS të vendeve aleate, rekomandojmë si të detyrueshme që ato të jenë nën vartësinë e SHSHP, gjithashtu, rekomandoj krijimin e një zyre për FS në SHP.
6. **Krijimi i Regjimentit të Operacioneve Speciale** ose Komandës së FS (ROS) nëpërmjet bashkimit të BFS dhe Batalionit Komando nën një komandë të vetme, **pra ROS-i ose ALBSOCOM**, pa u rritur në numër organikisht dhe pa ndonjë kosto të madhe fi si dhe krijimin brenda kësaj strukture të fuqishme dhe bashkëkohore, të kompanisë së Mbështetjes me Shërbime në Luftim (CSS), duke i dhënë dhe Skuadriljen e Helikopterëve Cougar në organikë.
(shih skemën 7-1).
7. Shtrirja e sistemit BICES, si çelësi për integrimin e plotë të FOS në familjen e FOS-it të NATO-s. Instalimi i këtij sistemi është **një nga rekomandimet kryesore** të ekipit të vlerësimit të NSHQ dhe tashmë është bërë kusht. Dokumenti përkatës i Strategjisë BICES jep një tablo më të qartë për strategjinë e BICES dhe implementimin e saj në FS.



Skema 7.1. Struktura e Regjimentit të Operacioneve Speciale (ROS) propozim.

SOF - RREGJIMENTI I OPERACIONEVE SPECIALE

SF - FORCAT SPECIALE

TKO - TRUPAT KOMANDO

CSS - MBËSHTETJA ME SHËRBIME NË LUFTIM

OPCON- KONTROLL OPERACIONAL

8. Stërvitja e personelit të të gjitha niveleve në kurset e ofruara nga NSHQ. Komanda e NSHQ ofron kurse **pa pagesë për zhvillimin e personelit të FOS-it**, për planëzimin, taktikat, teknikat, zbulimin dhe pajisjet më të fundit që FS përdorin në Afganistan (misionin e ISAF-it) duke rritur në shkallë të konsiderueshme profesionalizmin e personelit të tyre. Zbatimi i planit të aktiviteteve vjetore për stërvitjen e personelit të BFS do të ndikonte ndjeshëm në rritjen e nivelit të tyre profesional, në mënyrë që të krijohen kushte më lehtësuese për përgatitjen në kohë dhe me cilësinë e duhur të SOLTG (NSHQ, SOTG Manual, 2010, 127).
9. Mbështetja dhe ngritja e kapaciteteve të nevojshme logjistike, mjekësore dhe

personelit, në mënyrë që SOTG të kryejë operacione në mënyrë të pavarur në të ardhmen.¹

10. Komunikimi, prokurimi dhe marrja e mjeteve të ndërveprueshme të sigurta të komunikimit (çelësat e kriptimit) me vendet e NATO-s, do të rriste ndjeshëm kapacitetet e tyre deri në përdorimin e tyre në nivel strategjik.
11. Prokurimi i 18 mjeteve të blinduara për përdorim nga FS, për të mbështetur pjesëmarrjen në misionet luftarake kudo ku Aleanca ka nevojë në dispozicion të SOTG-së. Përbërja e tyre mund të jetë: 1 mjet komandim-kontrolli, 1 mjet ndërlidhjeje, 1 mjet auto ambulancë, 1 mjet zbulimi, 1 mjet karrofiçinë dhe 13 për mbështetjen e trupave në terren dhe rritjen e manovrueshmërisë dhe të sigurisë në operacion. Mjetet nuk duhet të jenë më të mëdha se me 5 vetë personel brenda tij dhe më të vogla dhe shumë më të manovrueshme se të forcave konvencionale, të pajisura me BFT, sistem montimi mitralozi, sistem IR dhe shikimi nate, Jammer, Mineroller, hapësirë për mjetet e ndihmës së shpejtë, municion rrezervë, poshtë fundit të saj në formë V-je, të sigurojë mbijetesën e jetës së personelit deri në 20 kg eksploziv, të ketë të montuara dymbi termale, etj.
12. Kompletimi i BFS me kapacitete për hedhjen nga ajri, kompletimi me armatimin e organikës së miratuar me të gjitha aksesoret përkatëse, prokurimi i pajisjeve të shikimit të natës, pajisjeve dixhitale dhe termale, të pajisjeve të zbulimit dhe të mbështetjes së luftimit.
13. Rritja ndjeshëm e pagesës së BFS me të paktën 100% dhe B Komando me 50% vështirësi pune dhe shërbimi, pasi stërvitja e përditshme dhe pjesëmarrja në misione luftarake paraqet rrezik të theksuar për jetën, vështirësi dhe dëmtim të vazhdueshëm të gjymtyrëve, dëgjimit, etj, të përmirësimit të kushteve të jetesës e punës, ushqimit me 3 vakte në repart, etj.

Përfundime

Si përfundim, anëtarësimi i FS shqiptare në NSHQ, që në vitin 2010 me përfaqësuesin e parë, Major Sajmir Mustafën, tashmë është realizuar dhe ka dhënë një

1. Angazhim i marrë nga MM në Bruksel gjatë takimit të MM, për krijimin e një SOTG brenda vitit 2014 dhe vënien në dispozicion të NATO-s.

ndihmë të madhe për zhvillimin e tyre. Pjesëmarrja në misionet e luftimit me misionet “Eagle 1-7”, në vitin 2010-2014 në Kandahar të Afganistanit, në misionin në Wardak tek SPTC-ja, në shtabin e FS të ISAF-it në NSOCC-A, ka rritur ndjeshëm kapacitetet luftarake të FS Shqiptare dhe njëkohësisht reputacionin e RSH të FA Shqiptare dhe të FS tona, kudo në botë.

Integrimi i tyre në këtë komunitet shumë të rëndësishëm të NATO-s do të jetë një sfidë në vazhdimësi që fillon me planëzimin dhe vënien në zbatim të rekomandimeve të mësipërme të ofruara nga ekspertiza e NSHQ dhe mësimet të nxjerra nga fushat e luftimit, gjë e cila kërkon një mbështetje të vazhdueshme nga ana e MM dhe në të njëjtën kohë është dhe e kushtueshme. Udhëzimi Politik i NATO-s (*Comprehensive Political Guidance, Latvia, Rige*) parashtrohet pritshmëritë që vijojnë për të ardhmen: “Ky ambient vazhdon të ndryshojë; ai është dhe do të jetë kompleks e global dhe subjekt i zhvillimeve të paparashikueshme në të ardhmen. Një shqetësim tjetër i NATO-s është terrorizmi, dëmi e pasiguria që ngjallin akte të tilla”.

Për këtë ambient strategjik, NATO ka identifikuar një numër fushash e kapacitetesh në mënyrë që të rrisë aftësinë e saj për t’u përballuar me këto sfida. Bazuar në kontekstin e mësipërm, FOS janë identifikuar si një nga kapacitetet e NATO-s më të përshtatshme për të përmbushur këto nevoja. Një nga kapacitetet e cilësuara nga NATO është: “...aftësia për të përshtatur shpejt dhe me efektivitet qëndrueshmërinë e forcës dhe përgjigjet ushtarake me rrethanat e paparashikueshme. Kjo kërkon një aftësi efektive për të analizuar ambientin dhe parashikuar kërkesat e mundshme, një nivel të lartë gatishmërie për forcat tona dhe fleksibilitetin e nevojshëm për t’iu përgjigjur çdo ndryshimi të mundshëm të kërkesave.” Një shqetësim tjetër i NATO-s është terrorizmi dhe dëmi e pasiguria që ngjallin akte të tilla.

NATO e ka kuptuar rëndësinë e FOS në arritjen e suksesit në operacione dhe, po t’i referohemi ngritjes dhe funksionimit/transformimit me një shpejtësi të pashembullt të Komandës së FS të NATO-s (NSHQ), do të kuptojmë se cila është e ardhmja e FS për vendet e NATO-s. Gjithashtu, kemi kuptuar se nuk ekziston një rrugë e shkurtër për të krijuar FS në momentin që godet kriza, por ato zhvillohen dhe mbështeten rregullisht që në kohë paqeje.

FOS “po luajnë një rol gjithnjë e më të rëndësishëm në mjedisin asimetric dhe janë forca shumë të përshtatshme për të ndihmuar në bllokimin e kërcënimeve ndaj NATO-s siç janë format e shumta të Terrorizmit”.

Të gjitha vendet anëtare të NATO-s kanë ngritur kapacitete SOTG (përveç nesh)

dhe 7 prej tyre kanë SOCC më vete dhe për më tepër kryejnë operacione në interes të Komandës së FS në Afgansitan (ISAFSOF-it). Këto vende kanë adoptuar me shpejtësi rekomandimet e ekspertëve të NSHQ dhe për një periudhë shumë të shkurtër, kanë reformuar forcat e tyre speciale, si nga pikëpamja strukturore, ashtu dhe nga ajo e teknikës së pajisjeve, duke i sjellë në nivelin e kërkuar të ndërveprueshmërisë me njëri-tjetrin.

Në varësi të madhësisë së FS dhe eksperiencave kombëtare, vende të ndryshme të NATO-s i kanë modeluar ato në nivel komande (10 vende nga 16 të studiuara), ose në nivel komponenti (7 vende). E përbashkëta e të gjitha organizimeve strukturore të këtyre forcave është aksesimi i tyre i drejtpërdrejtë tek lidërshipi i lartë politik dhe ushtarak për komandim-kontrollin dhe drejtimin operacional. Një tipar tjetër i përbashkët është ekzistenca e një zyre përfaqësie e SOF në Shtabin e Përgjithshëm të Forcave të Armatosura. Kjo zyrë këshillon vendimmarrësit e niveleve të larta politiko-ushtarake për misionet specifike me ndjeshmëri të lartë politike, si brenda dhe jashtë vendit.

Nëse i referohemi gjithashtu ndryshimeve strukturore që kanë pësuar FA të vendeve të NATO-s, do të shohim qartë një tendencë të dukshme në drejtim të fokusimit dhe investimit për rritjen e kapaciteteve të FOS. Reduktime të ndjeshme të njësive dhe të kapaciteteve për luftë konvencionale, Forcave Tokësore, Ajrore dhe Detare dhe ruajtje apo përmirësim i dukshëm i kapaciteteve për luftë jo konvencionale, FS dhe shërbimet sekrete kombëtare e ushtarake janë të parat në radhë. Shembuj në këtë drejtim na jep padyshim SHBA, Britania e Madhe, Franca, Spanja, Turqia, Gjermania, Italia, Polonia, Greqia, etj.

Po ashtu, tendenca e vendeve në rajon është po e tillë. Nëse shikojmë Turqinë, Kroacinë, Slloveninë, Sërbinë, FYROM-in, Greqinë, bile dhe Mali i Zi me një ushtri me vetëm 2000 vetë efektiv ka krijuar një Brigadë të FS, do të vërejmë mbajtjen e një kapaciteti të qenësishëm të FS brenda FA, me komanda deri me 3 yje, me një tendencë të dukshme në rritje në numër, të modernizimit dhe përmirësimeve cilësore të armatimeve, pajisjeve, komunikimit, zbulimit dhe transportit taktik.

FS i ofrojnë Këshillit të Lartë të Mbrojtjes Kombëtare një aset forcash të stërvitura e të pajisura në mënyrë të veçantë, të cilat mund të përshtaten lehtësisht për të ekzekutuar veprime në të gjithë zonën e operacionit dhe veprime që kërkojnë fshehtësi për të frenuar ose zgjidhur krizat e ndryshme. Në kohë paqe, FS mbështesin politikën e Sigurisë Kombëtare duke i ofruar kapacitet për të parandaluar ose ndaluar aktet e agresionit, ose akte kërcënimi terroriste që mund të pengojnë interesat Sociale, Politike, Ekonomike, Ushtarake dhe të Sigurisë.

Përcaktimi i plotë dhe përfundimtar i rolit dhe vendit të FS në dokumentet e Strategjisë të Sigurisë Kombëtare. Këto forca, duke qenë një **aset strategjik**, për shkak të veçorisë së përdorimit të taktikave dhe teknikave jo konvencionale për arritjen e objektivave në rëndësi të madhe politike, ushtarake, me rëndësi strategjike, duhet të kenë një përcaktim të qartë në dokumentet e strategjisë kombëtare (NATO, Special Operations Forces Study, 2012, 11). Kjo përbën bazën për hartimin e infrastrukturës ligjore të nevojshme për funksionimin dhe komandim-kontrollin e këtyre forcave. Në këtë kuadër, për FS Shqiptare nevojitet pikërisht përcaktimi i këtij roli në hierarkinë e dokumenteve të sigurisë si dhe një dokument më vete i nivelit strategjik.

Rishikimi i infrastrukturës ligjore që rregullon funksionimin e FOS, hartimi i doktrinës së FS (që është bërë tashmë) dhe ripërcaktimi i detajuar i misionit dhe detyrave që kryejnë FOS brenda dhe jashtë vendit, në përputhje me definicionet e strategjisë që do të hartohet për FS.

Zhvillimi i FS i orientuar drejt integritetit dhe arritjes së ndërveprueshmërisë së plotë me ato të FS të NATO-s. Parësore është vendimmarrja për krijimin e kapaciteteve të një Task Force për Operacionet Speciale (SOTG) brenda vitit 2014. Ndërtimi i një kapaciteti SOTG, sot është një domosdoshmëri për 3 arsye: **Së pari**, prej tendencës së kapaciteteve të tilla që janë ndërtuar në të gjitha FOS të NATO-s; **së dyti**, ky kapacitet tashmë është ndërtuar si koncept dhe si detyrim që rrjedh prej dokumentit të ri **AJP-3.5, Allied Joint Doctrine for Special Operations**; **së treti**, pa një kapacitet të tillë është e pamundur që të marrim pjesë në operacionet e FS të NATO-s në Afganistan apo diku tjetër në të ardhmen.

Krijimi i **Regjimentit të Operacioneve Speciale (ROS)** ose **ALBSOCOM**-it nëpërmjet bashkimit të BFS dhe Batalionit Komando nën një komandë të vetme, **pra ROS-i**, pa u rritur në numër organikisht dhe pa ndonjë kosto të madhe financiare, si dhe krijimin brenda kësaj strukture të fuqishme dhe bashkëkohore, të kompanisë së Mbështetjes me Shërbime në Luftim (CSS) dhe duke i dhënë dhe Skuadriljen e Helikopterëve Cougar në organikë.

Rritja ndjeshëm e pagesës së BFS me të paktën 100% dhe Bkomando me 50% vështirësi pune dhe shërbimi, pasi stërvitja e përditshme dhe pjesëmarrja në misione luftarake paraqet rrezik të theksuar për jetën, vështirësi dhe dëmtim të vazhdueshëm të gjymtyrëve, dëgjimit, etj, të përmirësimit të kushteve të jetesës e punës, ushqimit me 3 vakte në repart, etj.

KAPITULLI VIII

PËRFUNDIME PËRMBLEDHËSE

Rebelët në Afganistan mund të godasin fort dhe të jenë të pamëshirshëm. Kundërvënia ndaj taktikave të tyre kërkon një mendësi ofensive, madje edhe kur mbrojmë konvojat ose pozicionet tona statike. Forcat e Koalicionit duhet të hapin dhe ta mbajnë iniciativën dhe në mënyrë të vazhdueshme të vënë në përdorim momentin që paraprin, pa e lënë veten e tyre tepër të ekspozuar ndaj sulmeve dhe kur sulmohen të kundërsulmojnë fuqishëm dhe me tempo. Ky është një nga mësimet kryesore të kundërrebelimeve të së kaluarës në Afganistan, veçanërisht në nivelin taktik në ditët e sotme.

Anëtarët e fiseve Pashtune, të cilët mbushin radhët e Talebanëve, janë rritur në një kulturë të luftës së pandërprerë guerile. Pjesa më e madhe e tyre kanë mësuar të luftojnë që në moshë të vogël dhe janë luftëtarë të natyrshëm – fizikisht të përshtatshëm, janë të familjarizuar mirë me pushkën dhe janë të mësuar me vështirësitë dhe me rreziqet ekstreme. Ata janë të familjarizuar me zjarrin, manovrat taktike dhe në lëvizjet me shpejtësi përmes terreneve të vështira. Gjithashtu, janë të përgatitur mirë për sulme dhe për largime dhe dinë se si ta evitojnë artilerinë dhe sulmet ajrore të IS-AF-it. Ndaj një kundërshtari të tillë, teknologjia dhe zjarri i rëndë nuk janë efikase, por taktikat agresive të këmbësisë – manovrës së shpejtë, bllokimit të pozicioneve dhe ndjekjes mendoj që janë efikase.

Natyra rurale e luftës në Afganistan tregon se rebelët janë gjerësisht të shpërndarë midis fshatrave dhe qytezave të shumta. Nga ana e tyre, forcat e Koalicionit duhet të shpërndahen në baza të vogla larg pikave të furnizimit dhe të përforcimeve. Këto baza janë të cënueshme nga sulmet e përqëndruara, ndërkohë që rrugët është e pamundur që të sigurohen plotësisht në distanca kaq të largëta. Forcat e Koalicionit nuk mund të jetojnë në mes njerëzve dhe të mbrojnë popullatën në zonat rurale, në të njëjtën mënyrë si të ishin në qytetet e mëdha dhe qyteza. Forcat e SHBA-së dhe të NATO-s duhet të gjejnë mënyra për të operuar më mirë me taktikat e njësive të vogla dhe në terrene shkretëtirash dhe malore.

Afganistani ka një terren të ndryshëm, kjo do të thotë se natyra e luftimit ndry-

shon gjerësisht nga vendi në vend. Vetëm në Kandahar dhe në Helmand ka lugina të lumenjve që janë pjellore dhe tepër të populluara (të cilat kryesisht janë të mbjellura me drogë), male të ashpra dhe shkretëtira të zbrazëta – secila prej tyre me dinamikën dhe veçoritë e saj. Luftimi është mjaft i ndryshëm në fshatra, krahasuar me qytezat. Rebelët e Afganistanit kanë qenë të suksesshëm kur kanë menaxhuar të identifikojnë dhe të vënë në përdorim pikat e dobëta në mbrojtjen e forcave të Koalicionit dhe në përdorimin e tyre për të pushtuar krahët e forcave të aleancës.

Taktika e preferuar e rebelëve afganë kanë qenë pritrat *godit-dhe-largohu*. Ato janë të rrezikshme dhe nuk ka nevojë për shumë ekspertizë ose për shumë luftëtarë. Në Afganistan, distancat janë aq të mëdha dhe terreni është aq i vështirë, sa që është e pamundur që të parandalohen plotësisht sulmet kundër autokolonave. Pritat e vazhdueshme, kanë patur një ndikim të madh dobësues mbi kapacitetet logjistike të ushtrisë konvencionale. Forcat e Koalicionit mund t'i zbusin efektet e kësaj taktike, duke ngritur *kundër-prita*, përdorimin e shoqërimit të konvojave me helikopterë, ngritjen e pikave të rregullta të kontrollit, të përbëra nga forca të besueshme të sigurisë afgane dhe patrullimin e zonave rreth pjesës më të madhe të rrugëve ku mund të ndodhin pritrat.

Talebanët kanë në përdorim një rrjet të shtrirë informatorësh dhe zbuluesish në pararojë të cilët mbajnë në vërtetim të vazhdueshëm lëvizjet e forcave të koalicionit, qofshin këto në këmbë, automjete ose helikopterë. Është e sigurt të thuhet se armiku është në dijeni të pjesës më të madhe të patrullave dhe autokolonave dhe mund të parashikojë se ku do të shkojë ajo si dhe drejtimin të cilin do të ndjekë. Pjesa më e madhe e zbuluesve të pararojës lëvizin të paarmatosur, duke e ditur se duke vepruar kështu, kanë më pak mundësi t'i qëllojnë ose t'i fusin në burg. Trupat britanike në Helmand, kanë goditur në mënyrë të vazhdueshme mbi zbuluesit e Talebanëve, gjë që reduktoi numrin e sulmeve të suksesshme me mina surprizë dhe pritrat mbi patrullat e këmbësorisë.

Civilët që largohen ose fshatrat tashmë të braktisur nga popullsia, mund të tregojnë për një sulm të afërt. Në mënyrë të rregullt, rebelët i lajmërojnë civilët përpara se të ngrenë prita pranë zonave të populluara. Kjo praktikë i ofron mundësinë forcave të Koalicionit që të marrin paralajmërime që më parë dhe të organizohen më mirë. Në shumë raste, rebelët i kanë njoftuar civilët aty pranë pa mundur që fjala të mund të arrite edhe deri tek autoritetet – një tregues ky që qeverisja dhe Koalicioni nuk kanë një

rrjet të besueshëm zbulimi brenda popullatës dhe kanë pak përkrahje popullore. Mjeti më i mirë për të penguar një pritë, është zbulimi në kohë dhe i saktë nga popullsia vendase që është në gjendje të vrojtojë rebelët që po ngrenë pozicionet e zjarrit. Të pajisur me këtë informacion, trupat e koalicionit mund të jenë në gjendje t'i kundërvihen me sukses sulmeve në prita ose kundërprita. Asgjë nuk e demoralizon dhe frenon më shumë një palë që ngre pritën, sesa kur vetë është e sulmuar.

Rebelët afganë kanë prirjen të përdorin të njëjtat prita në mënyrë të përsëritur, veçanërisht pas sulmeve të suksesshme. Ushtria sovjetike rrallë i mbante shënim këto zona dhe në mënyrë të përsëritur goditej me sulme surprizë nga i njëjti vend. Është e rëndësishme që forcat e koalicionit të mbajnë shënime të kujdesshme për të gjitha pozicionet e pritave, duke përfshirë pozicionet e përdorura të zjarrit, të cilat duhet të jenë në dispozicion të të gjitha njësive që lëvizin nëpër zonë, ku preferohet më mirë një bazë qendrore të dhënash. Ky informacion mund të përdoret për të paralajmëruar autokolonat dhe për të kryer kundërsulme. Në mes të një prite, artileria dhe sulmi ajror mund të thirret më shpejt dhe më saktë, nëse koordinatat për pozicionet e zjarrit të përdorura më parë, janë tashmë në dispozicion.

Pjesa më e madhe e pritave në Afganistan janë të tipit *godit-dhe-largohu*, me rrugë daljeje të përgatitura tashmë. Rebelët shpesh hapin zjarr nga pozicione të fshehta ose të fortifikuara, duke e reduktuar efikasitetin e kundërgoditjes. Rebelët janë të më rrezikuar kur janë duke u larguar nga zona. Nëse forcat e koalicionit mund të lëvizin me shpejtësi për të rrethuar terroristët që kanë ngritur pritën dhe të bllokojë rrugët e largimit, ata kanë mundësinë të shkaktojnë dëme mbi rebelët dhe të fenojnë sulmet e ardhshme. Në pjesën më të madhe të sulmeve *godit-dhe-largohu*, një autokolonë ose patrullë këmbësore ka ndoshta shtatë deri në tetë minuta për të fituar epërsi në zjarr dhe të lëvizë përpara se rebelët të fillojnë të shpërndahen dhe të largohen.

Nëse rastet e pritave, ushtarët sovjetikë kishin tendencën të reagonin në mënyrë pasive, duke u mbështetur mbi trupë-shërbimin e armëve dhe mbështetjen ajrore dhe të artilerisë (e cila zakonisht mbërrinte pasi rebelët kishin filluar të ndërprisnin kontaktin). Këmbësoria sovjetike rrallë vepronte mbi Muxhahedinët. Këta të fundit mësuan se, nëse sulmonin shpejt dhe largoheshin përpara se të vinte mbështetja e afërt nga ajri, ose zjarri nga pozicionet e fortifikuara, ata mund të ngrinin prita të përsëritura ndërkohë që pësonin shumë pak humbje.

Rebelët afganë preferojë t'i ndalojnë shënjestrat e tyre me mina surprizë, gra-

natahedhës, mitraloz dhe zjarr të armëve të lehta – më pas u marrin krahët, i rrethojnë dhe madje i mbyllin, derisa të mund t'i asgjësojnë. Nëse janë duke kryer një sulm *godit-dhe-largohu* preferojnë të shkaktojnë dëme gjatë minutave të para, më pas të largohen të mbështetur me zjarr. Luftimi ndaj një prite, pritja për mbështetjen nga ajri ose artileri janë mundësia më e sigurt për një autokolonë të cilës i është zënë pritë. Një pozicion i tillë në mbrojtje, gjithashtu, u bën të mundur rebelëve të ruajnë iniciativën dhe të largohen thuajse të palënduar. Manovrimi i shpejtë dhe agresiv, i pasuar nga një ndjekje e pandërprerë është një mënyrë për të kapur krahun e sipërm, të shkaktojë viktima mbi armikun dhe të reduktojë mundësinë për prita në të ardhmen. Rebelët afganë kanë prirjen t'i frikësohen përdorimit të forcës në taktikat e vogla të këmbësores, më shumë sesa zjarrit dërmues.

Autokolonat e ngarkuara, janë shpesh më të çënuara sesa patrullat këmbësore. Rebelët afganë kanë prirjen të fokusohen mbi automjetet dhe shpesh nuk i vënë re ushtarët të cilët lëvizin në këmbë. Kjo mungesë vëmendjeje, me raste, ka bërë të mundur zbarkimin e këmbësores për të manovruar mbi armikun pa u vënë re.

Shumë prita në Afganistan, janë shtrirë për disa km. Rebelët mund të organizojnë prita të tilla vetëm në zonat e largëta, me pak ose aspak prani të forcave të Koalicionit. Prita të tilla të gjata mund të jenë jashtëzakonisht shkatërruese, kur nuk reagohej si duhet. Kur përballesh me këtë taktikë, gjykoj që të luftohet përgjatë pritës dhe të realizohet një tërheqje e organizuar. Mundësia më e mirë është kthimi prapa, organizimi i trupave për tu ruajtur nga vazhdimi i goditjes, pritja për mbështetjen nga ajri ose dërgimin i forcave luftuese, organizimi i mbrojtjes në të dy anët e rrugës për të pastruar pozicionet e mundshme të zjarrit.

Tërheqja e forcave drejt një prite të parapërgatitur është një taktikë e vjetër. Një ftesë në një *shura*, në një fshat ku ka prani të talebanëve, mund të jetë një kurth i organizuar që më parë. Sulmet mbi qendrat e banuara, mund të jenë një hile për të tërhequr forcat e ndërhyrjes së shpejtë në zonë, në të cilat ato forca do të jenë të çënueshme për t'u sulmuar. E njëjta gjë vlen edhe për sulmet mbi postat pararojë të policisë. Pritat mund të pengohen duke e ndërruar vendndodhjen e *shura-s* në minutën e fundit ose të qenit i sigurt se zhvillohet në një vend, i cili nuk mund të sulmohet lehtë, duke shkuar atje nëpër rrugë të ndryshme, lëvizja me mbështetje të afërt nga ajri, duke e rrethuar fuqishëm që më parë me forca shtesë dhe duke patur informatorë në zonë.

Sigurimi i rrugëve dhe linjave të tjera të komunikimit është thelbësor. Koalicioni duhet të ketë liri të plotë lëvizjeje. Për forcat e Koalicionit ka për të qenë e pamundur të kapë dhe të mbajë iniciativën, nëse ata janë të kufizuar në bazat e tyre dhe nuk kanë mundësi të lëvizin sipas dëshirës. Nëse rebelët kontrollojnë rrugët, mesazhi është se ata do të kontrollojnë edhe fshatrat dhe në fakt edhe vendin.

Nëpërmjet sulmeve të përsëritura mbi pozicionet fikse, Talebanët kanë tentuar të ndalin forcat e Koalicionit brenda bazave të tyre. Rebelët kanë marrë gjithashtu nën kontroll në shumë raste pika kontrolli të policisë dhe garnizone. Në krahasim me pritën, sulmet serioze mbi bazat i kanë vënë forcat e Koalicionit në mbrojtje dhe iniciativa u ka mbetur rebelëve. Kjo lloj taktike mund të pengohet nëpërmjet marrjes së kontrollit mbi zonat përreth bazave të rëndësishme nëpërmjet masave agresive, siç është patrullimi i rregullt i zonës pranë, krijimi i një rrjeti të besueshëm të zbulimit në zonat e populluara aty pranë dhe ngritja e pikave të zbulimit special dhe realizimi i pritave (preferohen gjatë natës kur talebanët kryejnë pjesën më të madhe të lëvizjeve të tyre) mbi rebelët që përpiqen t'i afrohen bazës.

Talebanët në Kandahar dhe Helmand bënë të mundur që të vinin në shënjestër bazat amerikane dhe britanike të patrullimit në mënyrë të pamëshirshme, duke kontrolluar zonat urbane që rrethonin këto pozicione. Në vitin 2008-2010, britanikët kishin arritur të shtyheshin jashtë bazave të tyre dhe të shtrinin kontrollin e tyre shumë më larg perimetrit të tyre të drejtpërdrejtë. Si rezultat, numri dhe shkalla e sulmeve mbi FOB-et e njëjësive të tyre, u reduktua në mënyrë dramatike dhe e njëjta gjë ndodhi edhe me helikopterët që ngriheshin ose uleshin për rikonicion. Për forcat e Koalicionit është thelbësore që të kenë ndikim të mjaftueshëm në zonat përreth për të paktën sa të dëgjojnë fjalë për sulmet e afërta, nëse nuk arrihen të ndalen plotësisht. Realizimi me sukses i kësaj kërkon shtimin e forcave, të cilat kanë për detyrë sigurimin e perimetrit të jashtëm të bazës.

Pjesa më e madhe e sulmeve serioze mbi bazat ndodhin gjatë natës, kur rebelët kanë edhe lirinë më të madhe të lëvizjes. Kundërvënia ndaj këtyre sulmeve mund të kërkojë pritë natën, të vendosura jashtë perimetrit të bazës. Realizimi me sukses i kësaj kërkon të paktën një gjurmim natën dhe zbulim të besueshëm dhe raportim të menjëhershëm nga vendasit që jetojnë aty pranë. Pasi përballuan shumë sulme surprizë mbi FOB-et e tyre, trupat britanike dhe amerikane, mësuam të krijojnë një marrëdhënie shumë të mirë me vendasit, jeta dhe prona e të cilëve ishte e kërcënuar nga këto sulme.

Ushtarët u dhanë vendasve elektrikë dore, me udhëzimet për t'i ndezur dhe fikur përpara një sulmi të afërt.

Dobësia e bazave ushtarake në qytetet më të mëdha të Afganistanit inkurajuan sulmet e talebanëve mbi këto pozicione. Këto sulme i detyruan trupat e ISAF-it të kundërpërgjigjen, duke shkatërruar ndërtesa dhe duke lënduar civilët. Kjo solli pasoja jo të vogla në mbështetjen e këtyre operacioneve nga ana e popullsisë afgane, ku dukej sikur shtrirja e pranisë së Koalicionit kishte sjellë luftime të rënda në zonat e populluara, të cilat i bënë civilët më pak të sigurt sesa kur ishin nën kontrollin e talebanëve. Luftimet e tilla dhe dëmet e shaktuara, tërhoqën rekrutë të rinj për rebelët. Nëse këto baza do të ishin mbrojtur më mirë, me forca të mjaftueshme për të mbrojtur perimetrin e tyre të jashtëm, do të kishte pasur më pak sulme, më pak kundër-sulme, dhe më pak dëme në jetë civilësh. Në qytetet ku ka kundërshtime të mëdha ose që kontrollohen nga talebanët, do të këshilloja që të mos vendosen baza patrullimi brenda kufijve të qytetit që në fillim. Një mundësi më e mirë mund të jetë pritja derisa operacionet e *kontroll-pastrimit* të kenë krijuar një mjedis më të sigurt – veçanërisht nëse ka më pak forca në dispozicion për të siguruar pozicionet.

Në shumë raste, talebanët shtrënguan bazat e izoluara (FOB-et) duke ju ndërprerë atyre përforcimet dhe furnizimin – nëpërmjet, për shembull, vendosjes së minave dhe pritave në të gjitha rrugët që të çonin për tek këto baza. Kur ndërtojnë një bazë të tillë, forcat e Koalicionit duhet të marrin parasysh sigurinë e rrugëve të komunikimit si dhe perimetrin e bazës. Një bazë që nuk mund të përforcohet ose rifurnizohet me një kosto të arsyeshme, përfundimisht do të duhet të mbyllet.

Talebanët janë më pak të mbrojtur në bazat e tyre. Megjithatë, këto pozicione janë të ruajtura dhe drejtuesit e tyre janë të informuar mirë në lidhje me operacionet e afërta dhe për rrugët e mundshme të përparimit të forcave të Koalicionit. Rebelët afganë janë mjaft të përgatitur për tërheqjet midis kordonëve të sulmit ose rrethimit dhe shmangies ndaj ofensivave madhore. Në pak raste, rebelët kanë qëndruar dhe kanë luftuar.

Kur sulmojnë zonat e bazës me qëllimin për të shkatërruar viktima dhe për të kapur armë, sekreti, surpriza, shpejtësia dhe bllokimi i pozicioneve ka provuar se janë thelbësore. Sulmet ajrore kanë provuar të jenë veçanërisht efektive, ashtu siç ishin dhe gjatë kohës së pushtimit për forcat sovjetike gjatë viteve 1979-1989. Kur qëllimi ishte pastrimi i një zone dhe ruajtja e saj në vazhdimësi me humbje minimale të jetëve të

civilëve, disa herë mjetet më të mira ishin ofrimi i njoftimeve paraprake dhe përparimi i ngadaltë me forcën goditëse, duke i mbajtur luftimet në minimum dhe me parandalimin që palët që nuk luftojnë, të mos gjenden në mes të zjarrit. Pjesa më e madhe e rebelëve nuk kishin për të luftuar me një forcë më superiore, duke dhënë pak shenja rezistence dhe pjesa më e madhe e civilëve largoheshin nëse do të dinin se do të zhvillohen luftime të ashpra.

Operacionet e mëdha të pastrimit në nivel batalioni kanë provuar të jenë joefektive në vrasjen ose në kapjen rob të rebelëve ose në kapjen e materialeve luftarake të tyre. Forcat e mëdha lëvizin me ngadalë dhe janë të dukshme, duke i dhënë Talebanëve kohë të mjaftueshme për të nxjerrë njerëzit dhe armët e veta jashtë nga zona e rrezikut. Kordonët, rrallë janë të shtrënguar mjaftueshëm për të parandaluar arratisjen e rebelëve – veçanërisht përgjatë zonave të mëdha, përmes terrenit të vështirë, ose në rajonet me shumë bimësi ku ka vend për tu fshehur. Ushtria sovjetike përdori shumë operacione *kordon-dhe-kërkimi* në nivel batalioni gjatë viteve 1980; pak prej tyre patën ndikim operacional mbi Muxhahedinët. Sasia e trupave që morën pjesë në këto operacione, kishte prirjen të ishte tepër i ekzagjeruar. Operacionet e mëdha të ofensivës janë më të dobishme për të frenuar rezistencën, ndërkohë që forcat e Koalicionit lëvizin për të marrë përfundimisht zonën e kontrolluar më parë nga rebelët. Pastrimi i zonave pa i mbajtur ato më pas, nuk kishte thujtë asnjë efekt dhe shpesh ishte antiproduktiv.

Kur një zonë është pastruar përfundimisht, rebelët afganë shpesh rikthehen shpejt pas kësaj për të sulmuar forcat që mbajnë zonën. Thjesht sepse rebelët u larguan ose bënë pak rezistencë, nuk do të thotë se zona është e pastruar. Shpesh, pastrimi i një zone kërkon muaj ose vite të patrullimeve të lodhshme, mbledhjes së të dhënave të zbulimit dhe mbajtjen e pikave të kontrollit. Forcat e Koalicionit duhet të jenë të përgatitura për sulme me mina surprizë dhe prita përgjatë rrugëve, mbi bazat e patrullimit dhe pikat e kontrollit. Pasi pësuan dëme të mëdha gjatë sulmeve masive të vitit 2006, talebanët mësuan se përpjekjet për të ruajtur terrenin ishin të kota dhe se është më mirë që të sulmojnë pa ndërprerje pozicionet e izoluara pararojë, autokolonat dhe patrullat, duke përdorur grupe të vogla rebelësh.

Talebanët përdorin streha për të vrojtuar rrugët kryesore për në zonat e bazave të rëndësishme. Ka të ngjarë që sulmi i autokolonave që lëvizin përgjatë rrugëve të jetë vrojtuar shumë përpara se ato të arrijnë në destinacion. Forcat sovjetike gjatë viteve 1980 patën pak sukses në hedhjen në sulm, duke përdorur rrugët e parashikueshme dhe

autokolonat e ngadalta të blinduara. U desh deri nga fundi i viteve 1988 që sovjetikët të mësonin që të sulmonin bazat e Muxhahedinëve – shpesh natën – duke përdorur skuadra të vogla të FS të trajnuara mirë Spetchnaz, të cilat lëviznin në këmbë përgjatë rrugëve të paparashikuara, të tilla si kreshtat dhe rrugët këmbësore.

Ka edhe një pikë të fundit për t'u mbajtur parasysh. Rebelët në Afganistan janë përshtatur në mënyrë të vazhdueshme. Ata kanë mësuar dhe vazhdimisht mësojnë nga taktikat e testuara me kohë dhe i kanë përshtatur ato në situatat e reja dhe kundër kundërshtarëve të ndryshëm.

Përfundimisht në fushata si ajo e Afganistanit që nga viti 2001-2015, ka treguar se vetëm përdorimi i FS dhe aseteve të ndryshme të inteligjencës kanë provuar se janë shumë efektive për të qënë të suksesshme në fushata të tilla.

BIBLIOGRAFIA

BURIME PARËSORE

1. 5th SF Group, SOF conference, [USSOCOM, DEP/CDR LTG John Mulholland], 2009, December, 11, Rome, Italy.
2. ISAF SOF Mission, The Way Ahead, [5th SF Group CDR, Colonel John Mulholland], 2001, December 15, Mazar i Sharif, Afghanistan.
3. Intervistë me LTC Haxhi Xhanan, [Autori], 2010, Nëntor 13, Kandahar, Afghanistan.
4. Intervistë me Captain Sahip Xhan, [Autori], 2010, Nëntor 26, Lakaray, Kandahar, Afghanistan.
5. Intervistë me Br.G Abdyl Raziq, [Autori], 2010, Dhjetor 12, Spin Buldok, Kandahar, Afghanistan.
6. Intervistë me Colonel Muhammed Araq, [Autori], 2011, Janar 14, Badurzai, Kandahar, Afghanistan.
7. Intervistë me N/Kol Hamdy Bahal, [Autori], 2011, Janar 18, Tahkut Ghar, Kandahar, Afghanistan.
8. Intervistë me Colonel Ridgey, US SF CDR, [Autori], 2011, Shkurt 2, KAF, Kandahar, Afghanistan.
9. Intervistë me Colonel Haxhi Xhanan, [Autori], 2012, Korrik 13, Shorabak, Kandahar, Afghanistan.
10. Intervistë me Colonel Haxhi Xhanan, [Autori], 2013, Janar 13, Adi Ghar, Kandahar, Afghanistan.
11. Intervistë me Kaptain Mohhamed Asllan, [Autori], 2013, Janar 15, Takhtopol, Kandahar, Afghanistan.
12. Intervistë me një koleg të SAS-it Anglez, [Autori], 2007, Kandahar, Afganistan.
13. Intervistë me Lt Murat Myftari, US Green Berets officer, [Autori], 2009. Ft.Bragg, NC, USA.
14. Intervistë me Admiral William McRaven, Komandant i FS Amerikane, [Autori], 2012. Tampa, Florida, USA.
15. Intervistw me Gjeneral Leitnant John Mulholland, Zv/Kom i FS Amerikane,

- [Autori], 2013, Pentagon, USA.
16. NATO SOF Conference, [Br. G Lance, UK SOF DEP CDR], 2011, May 11, Monx, Belgium.
 17. NATO SOF Conference, [Br. G Toibert, NOR SOF CDR, BG Toibert], 2011, May 11, Monx, Belgium.
 18. OPOR 74, [BDE Cdr, Colonel James Edwards], 2010, December 15, Kandahar, Afghanistan.
 19. OPOR 123, [1-38 CAV SQDN CDR], 2010, August, 18. Kandahar, Afghanistan.
 20. OPOR 128, [RCS CDR MG Terry], 2010, August 23. Kandahar, Afghanistan.
 21. OPOR 131, [1-38 CAV SQDN CDR], 2010, September, 3rd . Kandahar, Afghanistan.
 22. OPOR 143, [1-38 CAV SQDN CDR], 2010, September, 20. Kandahar, Afghanistan.
 23. OPOR 147, [1-38 CAV SQDN CDR], 2010, October, 22. Kandahar, Afghanistan.
 24. OPOR 151, [1-38 CAV SQDN CDR], 2010, October, 24. Kandahar, Afghanistan.
 25. OPOR 153, [1-38 CAV SQDN CDR], 2010, October, 25. Kandahar, Afghanistan.
 26. OPOR 154, [1-38 CAV SQDN CDR], 2010, October, 27. Kandahar, Afghanistan.
 27. OPOR 158, [1-38 CAV SQDN CDR], 2010, October, 29. Kandahar, Afghanistan.
 28. Raport 159, [Komandanti i Kontigjentit Eagle-1 dërguar KFT], 2011, Janar 15. Kandahar, Afganistan.
 29. SOF conference, [BG Smith, Dep ISAF SOF Cdr, British Army], 2011, May 21. Monx, Belgium.
 30. The future of ISAF SOF mission in Afghanistan, NATO SOF Meeting, [COMISAF SOF BG Smethurst], 2010, November 16, Monx, Belgium.
 31. Urdhër 76, [Komandanti i Kontigjentit Eagle-1, dërguar SHSHP], 2010, Tetor 22. Kandahar, Afganistan.
 32. Urdhër 27, [Komandanti i Kontigjentit Eagle-1], 2010, Gusht 21. Kandahar,

Afganistan.

33. Urdhër 121, [COMISAF, General David Petraeus], 2010, October 13.
Kandahar, Afganistan.

BURIME DYTËSORE

34. Armstrong, A and Barnett R. Rubin. (2003). *“Regional Issues in the Reconstruction of Afghanistan”*. World Policy Journal. USA. <http://proquest.com>
35. Beckwith, Ch. (2013). Delta Force. William Morrow Paperbacks.
36. Beckwith, Ch. (2007). Inside Delta Force: The Story of Americas Elite Counterterrorist Force. Delacorte Books for Young Readers.
37. Blaber, P. (2010). The Mission, The Man and Me. Dutton Caliber.
38. Bahmanyar, M. (2004). Afghanistan Cave Complexes 1979-2004: Mountain Strongholds of the Mujahedin, Taliban & al-Qaeda, Elite nr 26. Osprey Publishing.
39. Blehm, E. (2011). *The Only Thing Worth Dying For. How 11 Green Berets Fought for a new Afghanistan. New York Times Best Seller*. Harper Perennial.
40. Bradley, R. (2015). Lions of Kandahar. Bantam.
41. Clerk Jacqua. (1950). Secret Missions of Otto Skorzeny. New York: E.P Dutton & Co, Inc, USA.
42. Coll, S. (2018). Directorate S: The CIA and America’s Secret Wars in Afghanistan and Pakistan. Penguin Press.
43. Clausewitz C. (1976). The War. Princeton University Press, USA.
44. Callwell, E. (1996). *Small Wars: Their Principles & Practices*. University Press of Nebraska, USA.
45. Creveld van M. (2017). Modern Conventional Warfare: An Overview, Hebrew University, Jerusalem. Oxford University Press
46. Creveld van M. (2009). *The Transformation of War*. Free Press.
47. Cable, L. (1986). *Conflicts of Myths*. (New York: New York University Presss, USA.
48. Cooney, D. (2005). *Soldier’s Punishment Criticized*. Monterey Herald.
49. Campbell, D. (2017). Soviet Paratrooper vs Mujahedeen Fighter: Afghanistan 1979-1989. Osprey Publishing.

50. Driver, W and Bruce E. DeFeyter, (2008). *The Theory Of Unconventional Warfare: Win, Lose, And Draw, Naval. Postgraduate School Monterey, California, USA.*
51. Demiraj, D. (2017) *Ngritja dhe Rënia e Shtetit Islamik*. Tirana, Alb Paper.
52. Demiraj, D. (2016) *Ushtria e Kalifatit të Terrorit*. Tiranë, Alb Paper.
53. Demiraj, D. (2014) *Afganistani një Paqe e Vështirë*. Tiranë, Alb Paper.
54. Demiraj, D. (2015) *Nëpër Labirintet e Shtetit Islamik*. Tiranë, Alb Paper.
55. Demiraj, D. (2012). *Katalog FS Shqiptare në 100 vjetorin e Pararësisë*, Pegasus, Grece.
56. Demiraj, D. (2008). *10 Years Albanian Special Forces*, Dita, 2000, Tirana, Albania.
57. Demiraj, D. (2013) *Doktrina e Forcave të Operacioneve Speciale*. Tiranë, SHBU.
58. Demiraj, D. (2013) *Manuali i Planizimit të Forcave Speciale*. Tiranë, Dita 2000.
59. Demiraj, D. (2013) *Manuali i Planizimit të Grupimit të Forcave Speciale*. Tiranë, SHBU.
60. Demiraj, D. (2007) *Taktikat e Forcave Speciale-Pjesa e Parë*. Tiranë, SHBU.
61. Demiraj, D. (2007) *Taktikat e Forcave Speciale-Pjesa e Dytë*. Tiranë, SHBU.
62. Forrest B. Johnson. (1978). *Ora e Shpërblimit: Sulmi i Ranger-ve mbi Cabanatuan*. New York: Manor Inc Books, USA.
63. Gallager, T. (1969) *The X-Craft Raid*. New York: Harcourt Brace Javanovich, USA.
64. Grubbs, L. and Forsyth, M. (2005). “Is There a Deep Fight in Countrinsurgency?”. *Military Review* June-August, US Army.
65. Graw W. L. (2010). *The Bear Went Over Mountain. Soviet Combat Tactics in Afghanistan*. Military Bookshop.
66. Hastings, M. (2012). *The Operators. The Wild and Terrifying Inside Story of America’s War in Afghanistan*. New York Times Best Seller Plume.
67. Harding, G. (2006). “Afghans Blame Suicide Bombings on Foreigners”. *M&C News*, USA.
68. ISAF COM. (2011). *NATO SOF meeting- The future of SOF ISAF missions in Afghanistan*. SHAPE, Belgium.

69. ISAF COM. (2012). The future of SOF ISAF missions in Afghanistan beyond 2015. SHAPE, Belgium.
70. Kisner, F. (2011). *Meeting with NATO SOF commanders, NSHQ CDR*. Monx, Belgium.
71. Kisner, F. (2012). *Meeting with NATO SOF commanders, NSHQ CDR*. Rome, Italy.
72. Katzman, K. (2005). *Afghanistan: Post –War Governance, Security and U.S. Policy*. Washington DC: Congressional Research Service, USA.
73. Kapllan, F. (2013). *The Insurgents*. Tantor Audio.
74. Marshall, A. (2011). *Afghanistan: How The West Lost its Way*. Yale University Press.
75. Luttwak, E. (1983). “Notes on Low-Intensity Warfare”. Parameters, USA.
76. Lind, S. W. (2015). *4th Generation Warfare Handbook*. Castalia House.
77. McRaven, W. (1993). *The Theory of Special Operations*. PN.
78. McRaven, W. (1996). *Spec Ops. Case Studies in Special Operations Warfare. Theory and Practice*. Presidio Press.
79. McCrystal, S. (2014). *My Share of The Task*. New York Times Best Seller. Portofolio.
80. McManners, H. (2006). *Ultimate Special Forces*. DK.
81. McAdams, D. (2003). “Beyond Structural Analysis: Toward A More Dynamic Understanding of Social Movements”. Oxford University Press, USA.
82. Mulholland, J. (2001). TF-Dagger-CJSOTF-A, was the UW SOF Task Force, commanded by COL Mulholland, 5th SFG CDR. ISAF, Kabul, Afghanistan.
83. Macintyre, B. (2016). *Rogue Heroes. Britain’s Special Air Service-SAS-was the brainchild of David Stirling*. Crown.
84. Marsh, C and Pukhov, R. (2017). *Elite Warriors. Special Operators From Around the World. Russia, China, Iran, Turkey, Greece, Israel*. East View Press.
85. NSHQ. (2008) *Special Operations Forces Study*. SHAPE, Belgium.
86. NSHQ. (2009) *Special Operations Forces Study*. SHAPE, Belgium.
87. NSHQ. (2009). *SOTG MANUAL 1.0, NATO Special Operations Coordination Centre*. SHAPE, Belgium.
88. NSHQ. (2010). *SOTG Manual*. Monx, Belgium.
89. NSHQ. (2013). *SOCC Manual*. Monx, Belgium.

90. Pellerin, C. (2013). *American Forces Press Service, Afghan Security Forces Grow in Numbers, Quality*. USA.
91. NCSS. (2008). *Special Ops Forces Study, NATO Special Operations Coordination Centre*. SHAPE, Belgium.
92. NSTI. (2006). *Creation of the first NATO SF Centre*. Riga, Latvia.
93. NATO HQ. (1998). *Joint Pub 3-05, Doctrine for Joint Special Operations*. SHAPE, Belgium.
94. NATO HQ. (2003). *Allied Joint Doctrine of Special Operations, Allied Joint Publications*. SHAPE, Belgium.
95. NATO Special Operations Coordination Center (NSCC). (2008). *Special Operations Forces Study*. Monx, Belgium.
96. NATO Special Operations Coordination Center (NSCC). (2012). *Special Operations Forces Study*. Monx, Belgium.
97. Nauman, K Dr. (2007). *Toward a Grand Strategy for an Uncertain World- Renewing Transatlantic Partnership*. Noaber Foundation, AK, Lunteren.
98. NCSS, *Special Ops Forces Study*, 4 Dhjetor 2008.
99. Neville, L. (2008) *Special Operation Forces in Afghanistan (Elite)*. New York, Osprey Publishing.
100. Qendra e Analizave të Mbrojtjes, KDS (2011). *Kontigjentet e FARSH në Afganistan, Taktikat, Teknikat dhe Procedurat*. SHBU, Tiranë.
101. Qendra e Analizave të Mbrojtjes, (2011) *Kontigjentet e FARSH në Afganistan, Taktikat, Teknikat dhe Procedurat*. KDS, Tiranë, SHBU, Tiranë.
102. Riga Summit. (2006). *NATO Comprehensive Political Guidance*. Riga, Latvia.
103. Riga Summit. (2006). *Declaration by the Heads of NATO States and Government participating in Riga*. Latvia.
104. Spulak G. R. Jr. (2007). *“A Theory of Special Operations The Origin, Qualities and Use of SOF”*. USA.
105. Shefi i Zyrës së Madhërisë së Tij Britanike, *Combined Operations*. (1943). *The Official Story of the Commandos*. New York: The MacMillan Company, USA.
106. Schemmer, F.B. (2002). *The Raid. The Son Tay Prison Rescue Mission*. Ballantine Books.
107. Rashid, A. (2010). *Taliban: Militant Islam, Oil and Fundamentalism in*

Central Asia. Yale University Press.

108. "OEF–U.S. Casualties,"(n.d.):<http://icasualties.org/oef/>
 109. Petraeus, D. (2007). *Counterinsurgency*. Paladin Press, USA.
 110. Petraeus, D. (2009). *The Field Manual on Counterinsurgency Operations*. CreateSpace, USA.
 111. SHBU. (2009). *Enciklopedia e SOF, Qendra e Shtypit dhe e Botimeve Ushtarake*. Tirana, Albanian.
 112. US Army Command and General Staff College. (2003). *Special Operations Forces Study Guide, Special Operations Forces Element*. Ft Leavenworth, Kansas, USA.
 113. US ARMY, Department of the Army, (2003) FM 25-101, "Battle focused training" HQ, Kansas City, USA.
 114. United States Department of Defence, (2007). *Irregular Warfare (IW), Version 1.0*. Washington D.C. USA.
 115. United States Department of Defence (2013). *Joint Pub 2-01.3, "Joint Intelligence Preparation of the Operational Environment"*. Washington D.C. USA.
 116. US Department of the Army. (2000). *Field Manual FM 6 – 22.5, Combat Stress*. U.S. Government Printing Office, USA.
 117. US Department of the Army. (1994). *Field Manual FM 22-51, Leaders Manual For Combat Stress Control*. U.S. Government Printing Office, USA.
 118. US Department of the Army. (2009). *Afghanistan Counter IED TTP*, Washington DC: U.S. Government Printing Office, USA.
 119. US Department of the Army. (2001). *FM 3-05.20, Special Forces Operations*. Washington DC: U.S. Government Printing Office, USA.
 120. US Army Command and General Staff College. (2005). *Tactics in Counterinsurgency FM 3-24.2*. U.S. Government Printing Office, USA.
- Watson, P. (2005). "*Karzai Calls for a Shift in Battle against Taliban*," Los Angeles Times. <http://proquest.com>